

Viti XV. nr. 1



0353/7110




# ALTERNATIVA

Revistë për kulturë dhe shkencë



LUBLANA, 2005.



+ 403668

Alternativa - Revistë kulturore

ISSN 0353-7118

PERMBARTJA

# ALTERNATIVA

## Revistë e SH.K.SH. "Migjeni" për kulturë dhe shkencë

Në vend të hyrjes apo ndeshja e misionit të revistës ..... 3

Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e kulturës dhe shkencës ..... 9

Kosova: subjekti i cilësimit ..... 23

Ripërsëritjet e shpalljes së pavaresisë ..... 27

Liberalizimi politik i Rawlsit - hollësi dhe diskutime ..... 31

ne mungesë të konceptit politik? ..... 35

Subjekti i "natie" ..... 35

Vitet dhe mendime të përmendueshme rreth shtetit të Kosovës ..... 40

Euforia dhe mendime të përmendueshme rreth shtetit të Kosovës ..... 40

Prvim i parimit të vetëvendosjes ..... 42

Prof. Shqipëri kërkohet të jetë aktivi dhe përdorues i kulturës ..... 44

Me hapjen e procesit asgjë nuk mund të gjendet përtej ..... 44

Vendet e sovranizuar nga lufta ..... 44

duhet të përdoren për të përcaktuar identitetin e Kosovës ..... 44

Rëndësia e vlefshme e pavaresisë së Kosovës ..... 44

për raportet e shqiptarëve dhe serbëve ..... 44

Udhëshirja shqiptare sipas Krist Maloku ..... 44

Sistemi i organizimit të shtetit shqiptar ..... 44

Brethi i udhëshirësve shqiptarë të Kosovës ..... 44

Dimensionet e Shqipërisë së krishterë ..... 44

Kodiku i Purpurit i Beratit ..... 44

Kodiku i Artë ..... 44

Si u zbuluan Kodikët e Beratit ..... 44

Historia e mendimit ungjilior ..... 44

Fondi i rrallë ..... 44

Këtë botim e ndihmoi Ministria e Kulturës së R.Slllovenisë ..... 44

Historia e kodikut të Kulturës së R.Slllovenisë ..... 44

Rëndësia ..... 44

LUBLANË 2005

Viti XV. nr. I



920060638

**ISSN 0353-7110**

**Këshilli  
botues**

Akademik dr. Tom Berisha,  
Akademik dr. Aleksandar Stipčević,  
dr. Shaban Sinani,  
dr. Skender H. Skenderi,  
Arben Xhaferi,  
dr. Fadil Maloku,  
dr. Martin Berishaj,  
dr. Irena Šumi,  
dr. Hannah Starman,  
dr. Miran Komac,  
Dr. Milazim Krasniqi,

**Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës:**

**dr. Martin Berishaj**

Adresa: SHKSH "Migjeni" Celovška 177, Ljubljana,

E maili:

Dizajni i kopertinës: Albert Shaqiri

**Redaksia:**

Tahir Maliqaj, Kryetar i SHKSH "Migjeni"

Xhavit Shaqiri, Sekretar i SHKSH "Migjeni"

M.A. Alma Bejtullahu,

M.A. Zef Ahmeti,

M.A. Albert Ramaj,

Valentin Batalaku dipl.iur,

M.A. Dorian Jano,

**Këtë botim e ndihmojë Ministria e kulturës së R.Sllovenisë**

**Alternativa izhaja s finančno pomočjo Ministrstva RS za kulturo**

**ISSN 0353-7110**

## PËRMBAJTJA

Në vend të hyrjes apo ndesha e mirë - ALTERNATIVË .....	3
Faktorët që nxisin shpërbërjen e shteteve multietnike.....	9
Kosova- subjekt i cili “pret” dhe kahjet emancipuese.....	25
Ripërsëritjet e shpalljes së pavarësisë.....	27
Liberalizmi politik i Rawlsit – holizmi liberal ne mungesë të konceptit politik?.....	31
Subjekti në “pritje” .....	35
Vrojtime dhe mendime të përmbledhura mbi shtetin e Kosovës .....	40
Euforia që mund të deangazhojë .....	40
Privim i parimit të vetëvendosjes.....	42
Prej Shqipërisë kërkohet rol aktiv dhe qëndrim konstruktiv.....	42
Me hapjen e procesit asgjë nuk mund të quhet e përfunduar .....	43
Vendet e sovranizuara nga ish-Jugosllavia duhet ta mbështesin pavarësinë e Kosovës .....	51
Rëndësia e trefishtë e pavarësisë së Kosovës për raportet e shqiptarëve dhe serbëve.....	54
Lidershipi shqiptar sipas Krist Malokit në kontekstin aktual.....	56
Sistemi i organizimit të shtetit shqiptar.....	60
Rreth lidërsipit shqiptar të Kosovës .....	63
Dimensioni i Shqipërisë së krishterë .....	69
Kodiku i Purpurtë i Beratit dhe Kodiku i Artë .....	69
Kodiku i Artë.....	71
Si u zbuluan Kodiket e Beratit .....	71
Historia e mendimit ungjillor .....	74
Fondi i rrallë .....	76
Karakterit katalog .....	76
Historia e kodikeve .....	77
Rëndësia.....	78

Sprovë për pastërtinë e gjuhës shqipe.....	97
Globalizmi çështja e shtetit dhe Kosova .....	112
Ndikimi i niveleve të autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare në sistemin gjyqësor të Kosovës .....	119
Dy dokumente obligative juridike për mbrojtjen kushtetuese të pakicave kombëtare në shtete anëtarë të Këshillit të Evropës .....	124
Veprimi dhe roli i Këshillit të Evropës në lemën e mbrojtjes së pakicave kombëtare.....	125
Konventa kornize për ruajtjen e pakicave kombëtare .....	131
Karta evropiane mbi gjuhët rajonale apo të pakicave .....	135
At Zef Valentini - një albanolog dhe një albanofil i jashtëzakonshëm.....	138

## NË VEND TË HYRJES APO NDESHA E MIRË - ALTERNATIVË

Të gjithë ne, na bashkonte besnikëria e pandarë, të cilën e kishim si barrë të arsyes, për të kthye Alternativën në duar të lexuesit. Sot, pra po gjallëron Alternativa e dikurshme që kishte emër, Alternativa, nëpërmjet të cilës kushtrimonte botën Kosova, Alternativa, të cilën e lexonin shqiptarët kudo që ishin, e për të cilën u burgoseshin dhe u torturoheshin nga ai regjim që është sot në bankën e të akuzuarve për krime lufte në Hagë.

Paraqitja e revistës Alternativa në letrat shqipe, dhe imponimi i saj në të menduarit politik të pavarur shqiptarë ishte një ogur i bardhë për fizionominë politike të Kosovës edhe atëherë kur Kosova kullonte gjak, edhe sot kur Kosova pret definimin e statusit të saj politik përfundimtarë. Janë të rralla revistat kulturore dhe politike në gjuhën shqipe që lanë gjurmë aq të dukshme në kujtesën kombëtare. Nëse revistat; “Albania”, “Dielli”, “Shpnesa e Shqypnisë” etj. ishin gur themeli për arritjen e pavarësisë së Shqipërisë, revista Alternativa e Lublanës u bë qëndrim i qartë politik në kohë kur spiralja e dhunës arrinte padurueshmërinë kolektive të qenjes shqiptare, duke kthjellë mendjen, duke u paraprirë proceseve politike dhe në fund duke e balancuar frikën që kishte hyrë në palcë popullit të stërvuajtur kosovarë.

Alternativa si formë e re e të menduarit politik shqiptarë rrëzoi dhe i theu shtigjet e koncepteve konvencionale të asaj që ishte “lule mos e prek” duke i vendosur gjërat në vendin e vet. Ajo në pak vite që doli nuk belbëzojë, sepse e kishte të qartë qëllimin, ajo nuk çalojë sepse ishte koha kur qendrat e vendosjes politike duheshin të kuptojnë qartë kërkesat tona.

Alternativa ishte shkollë politike, ishte burrëri dhe qëndrim, thjesht, ishte revistë që meritonte të lexohet. Atë e udhëhiqnin shqiptarët e këtushëm, intelektualet dhe politikanet që u bënë pjesë e pandashme e historisë së re të Kosovës.

Sot kur Kosova po hynë në fazë e përmbylljes së procesit politik dhe definimit të statusit të saj, Shoqata shqiptare “Migjeni” nga Lublana

po del me Alternativë jo me mbush boshllëk, për kohën ku ajo mungonte, por po e kthejmë Alternativën aty ku ajo meriton të jenë. Porosia e Alternativës nga kjo distancë kohore dhe hapësinore drejtuar atyre që janë vu në ballë të proceseve politike në Kosovë sot është, që të bëjnë **URTINË SI BINDJE POLITIKE** për të bërë Kosovën shtet dhe për ti çel rrugën asaj në procesin e integritimit.

Tahir Maliqaj, Kryetar i SHKSH "Migjeni" në Lublanë



### Thirrje për bashkëpunim!

Duke u nisur nga fakti se ka shumë kohë që në shoqatën kulturore shqiptare »MIGJENI« nuk zhvillohen aktivitetet e pritura nga brezi i ri dhe nga shtresa studentore. Duke çmuar vlerat e juaja në fushën e krijimtarisë letrare dhe shkencore në diasporë dhe zhvillimin e mendimit shkencor e kritik. Duke çmuar lart potencialet e juaja studentore dhe vizionet tuaja për avancimin e shoqatës së juaj kulturore; kam nderin dhe përgjegjësinë t' u drejtohem me këtë thirrje për bashkëpunim. Të nderuar nxënës, student dhe intelektual shqiptar që punoni, studioni dhe jetoni në shtetin e Sllovenisë! Shoqata "MIGJENI" pas disa viteve të vështira në fushën ekonomike, tani ka arritur që të konsolidoj radhët e veta me një kryesi të freskuar dhe rezistente në punë. Sa i përket anës ekonomike shoqata ka arritur të pavarësohet në tërësi nga xhepi i anëtarëve dhe donatorëve. Ky është një rezultat i pakontesuteushëm Pra, në tërësi është bërë institucionalizimi në suaza ligjore të shtetit slloven. Kjo, do të thotë se çdo anëtar i saj nuk ka obligime materiale ndaj shoqatës, por vetëm duhet të kontribuojnë me potencialin e vet shkencor, kulturor dhe shpirtëror. Ju, të nderuar student, në veçanti ju të nderuar intelektual, për neve jeni pjesë e pandashme e aktiviteteve të shoqatës dhe të gjitha përpjekjeve që i bënë ajo në fushën e kulturës shqiptare dhe ballafaqimit me të gjitha hallet dhe problemet që i ka shoqëria shqiptare në diasporë. Para nesh janë shumë sfida të cilat dëshirojmë ti realizojmë së bashku me ju, me një përgjegjësi dhe obligim nda pjesës dërmuese që janë të kyçur në këto rrjedha. Së bashku do ta japin kontributin për jetësimin, institucionalizimin dhe funksionalizimin e shoqatës kulturore shqiptare "Migjeni". Pra, në emër të kryesisë ju lus, që në këto çaste të mobilizohemi të gjithë në shërbim të plotësimit të vlerave kulturore. Të gjithë ne së bashku, pavarësisht nga ajo se çfarë mendoni, ose çfarë koncepte dhe mendime paraqitni, duhet të veprojmë së bashku në truallin slloven me hallet dhe telashet tona, të diskutojmë, të nxisim përgjegjësitë që të veprojmë në mënyrë afirmative, t' i bashkojmë energjitë tona në shërbim të plotësimit të vlerave kulturore për ardhmërinë e brezit të ri që po jeton dhe vepron në kushte të vështira, në treva të huaja. Të nderuar nxënës, student dhe intelektual shqiptar dhe miq të të popullit shqiptar, kryesia e SHKSH "Migjeni" dhe unë personalisht,

besoj fuqishëm në forcën tuaj intelektuale dhe përgatitjen profesionale për dhënien e kontributit të juaj për ngritjen e shoqatës në nivelin e viteve të '90. Asnjëherë më shumë se sot, kontributi dhe angazhimi i Juaj konkret nuk kane pasur rëndësinë dhe vlerën e vete kulturore dhe kombëtare. Student dhe intelektualë të nderuar, Autoriteti i Juaj është me ndikim në shoqërinë shqiptare në atdhe dhe diasporë. Ju ftoj ta ushtroni atë. Anëtarët e shoqatës "Migjeni" dhe kryesia e sajë, me të drejtë presin kontributin tuaj të domosdoshëm për avancimin e vlerave kulturore. Nuk kemi nevojë që nga larg t'a fajësojmë veprimtarinë ose kryesinë e shoqatës, sepse përgjegjësitë dhe meritat duhet të na takojnë të gjithëve. Ushtrimi i detyrës së kryetarit, sekretarit etj paraqet një institucion të kufizuar, ndikimi i juaj dhe veprimtaria e juaj shkencore, kulturore dhe morale mbi diasporën dhe përgjegjësitë e juaja profesionale janë të veçanta dhe të pakufizuara. Prandaj, ju ftoj, që të jeni pjesë aktive e këtyre aktiviteteve kulturore. Është bërë shumë, janë siguruar lokalet, mjetet buxhetore, është bërë lidhja e shoqatave, është bërë lidhja me institucionet e Kosovës dhe Shqipërisë, është hapur prapë mësimi plotësues në gjuhën shqipe me mësuesen e vyeshme Alma Bejtullahu. Kontributi i juaj duhet të dëgjohet dhe ofrohet që nga Universiteti i Lublanës, Akademia e Shkencave, universiteti i Prishtinës, institutet e ndryshme, Shoqata të tjera simotra dhe ekspertët e pavarur.

Isha shumë i lumtur, kura para disa ditësh u lajmërua studentja e vyeshme nga bregdeti slloven, Rudina Heroi e cila bëri ftesë zyrtare për bashkëpunim me institucionet shqiptare në diasporë. Besojë, që këso raste do të ketë edhe në të ardhmen.

Xhavit Shaqiri,

sekretar gjeneral i shoqatës dhe lidhjes së shoqatave kulturore shqiptare në Slloveni.

## Mësimi plotësues i gjuhës dhe kulturës shqipe

Të nderuar prind,

Shoqata kulturore shqiptare Migjeni, në bashkëpunim me Ministrinë për arsim e sport të Republikës së Sllovenisë, po e organizon mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqipe në Lublanë.

Mësimi për këtë vit shkollor filloi nga tetori dhe do të vazhdojë deri në fund të vitit shkollor në qershor 2006. Orët mbahen në lokalet e shkollës fillore Hinko Smrekar, në rrugën Gorazdova 16 në Lublanë, në afërsi të lokaleve të Shoqatës Migjeni, çdo të premte pasdite, në katin e dytë. Mësimi mbahet rregullisht sipas orarit të shkollës, përveç gjatë ditëve të pushimit shkollor.

Mësimi është i organizuar për dy grupe. Grupi i nxënësve të klasëve të ulëta (me moshë 6-11 vjeçare) fillon me mësim në ora 16.30, nxënësit më të rritur (11-14 vjeçar) vazhdojnë me mësim në ora 17.15.

Orët mësimore në varshmëri nga mosha përfshijnë tema nga lëmi të ndryshme. Kryesisht fillohet nga poezia për fëmijë, dhe me këtë temë lidhen edhe lëmite tjera – vizatimi, puna praktike, muzika, ... Nxënësit po i mësojnë vjershat e shkrimtarëve të njohur për fëmijë si Vehbi Kika, Rifat Kukaj; përveç kësaj punojnë edhe me veprat klasike të shkrimtarëve shqiptarë si Çajupi, Ndre Mjedja, Naim Frashëri, Migjeni...

Metoda mësimore e mbërthen lojën dhe bisedën, në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi të shprehen sa më shumë gojarisht, njëkohësisht duke iu pasuruar fjalorin e përditshëm. Në fazat e mëvonshme do të punohet në drejtim të ushtrimit të shkrimit dhe përdorimit të drejtë të shkronjave shqipe.

Nëse vogëlushët tuaj ende nuk janë të kyçur në procesin mësimor, mos ngurroni t'i sillni fëmijët në shkollë tash. Mësimi mbahet ashtu që çdo nxënës i ri mund të kyçet lehtë në mësim. Poashtu edhe nxënësit tjerë do të gëzohen shumë nëse iu shtohet edhe ndonjë shoqe apo shok, sepse disponimi i fëmijëve në klasë është i mirë dhe i hareshëm. Për informata shtesë mund të drejtoheni në Shoqatë apo edhe mund t'i sillni fëmijët drejtpërdrejtë në shkollë sipas orarit të përmendur.

Përzemërsisht,  
Alma Bejtullahu

## DRAMCA MËNDIMESH

Përmesist  
Alma Bejullshu

## **FAKTORËT QË NXISIN SHPËRBËRJEN E SHTETEVE MULTIETNIKE**

**Arbën Xhaferi**

Njëri nga fenomenet më komplekse, njëherësh edhe më enigmatike është shthurja e brendshme e shtetit. Disa shtete, përkundër kontradiktave të mëdha, të brendshme dhe të jashtme, përkundër vështirësive ekonomike, përkundër kolapseve të llojllojshme gjatë funksionimit të administratës shtetërore megjithatë arrijnë të mbijetojnë, ndërkaq shtetet tjera që tregojnë rezultate pozitive në shumë dimensione megjithatë pësojnë implozion, shthuren dhe zhduken sikur të mos kishin ekzistuar fare. Bie fjala në vitin 1997 Shqipëria pësoi kolaps të administratës shtetërore, por shoqëria në të gjitha parametrat e brendshëm mbeti e shëndoshë, ndërkaq Jugosllavia që dallohej për të mirë nga të gjitha shtetet tjera të lindjes u shthur në mënyrë të pashpjegueshme. Këto paradokse nxisin imagjinatën e shumëkujt që për shkak të mungesës së një analize gjithëpërfshirëse, racionale ndikojnë në shfaqjen e teorive të ndryshme konspirative. Pse pra Shqipëria, e molisur gati gjysmë shekulli prej një regjimi komunist-totalitar, me efekte të ulëta administrative, ekonomike, me armiq të shumtë mbijetoi tranzicionin e rrezikshëm, ndërkaq Jugosllavia me administratë profesionale, me ekonomi shumë të zhvilluar, me perspektiva shumë më të mëdha, me përkrahje shumë dashamirëse u shpërbë në trajta tragjike, të paimagjinueshme. Për t'i përgjigjur kësaj pyetje duhet përkufizuar karakterin e këtyre shoqërive, të shtetit shqiptar dhe të atij jugosllav. Shqipëria pra është një shtet nacional, ku më se 90% e popullatës janë shqiptarë, ndërkaq Jugosllavia ishte një shtet federativ që funksiononte, ashtu si formacionet e tjera të ngjashme federative mbi bazën e vendimmarrjes konsensuale. Dallimi qëndron te kompaktësia etnike, përkatësisht te heterogjeniteti e shoqërive.

Gjatë historisë së njerëzimit kryesisht kemi raste të shthurjes së formacioneve komplekse shoqërore si janë perandoritë që në kohërat moderne u transformuan në federata apo konfederata multietnike. Këto shoqëri, apo këto shtete, heterogjene, të segmentuara, lëngojnë

prej një dobësie imanente, fleksibiliteti i lojalitetit ndaj sistemit, ndaj shtetit. Sipas teorisë politike, shtetet moderne mund të funksionojnë po qe se plotësohen tre kushte elementare:

- kohezioni i brendshëm, që manifestohet përmes lojalitetit të qytetarëve ndaj shtetit;
- mirëqenie ekonomike dhe
- respektimi i standardeve të demokracisë liberale.

Ky kushti i fundit është produkt i qytetërimit perëndimor që nuk lejon arritjen e kohezionit dhe mirëqenies përmes diktaturës dhe despotizmit si formë e rregullimit shoqëror. Siç dihet gjatë regjimit të Sadam Huseinit në Irak kishte kohezion të brendshëm dhe sado kudo një mirëqenie elementare qytetare. Mirëpo me eliminim të regjimit despotik, represiv, sërish u shfaqën antagonizmat etnikë, religjiozë dhe shoqëror në përgjithësi.

Këto antagonizma në shoqëritë moderne mund të zgjidhen konform respektimit të drejtave të njeriut me procedura demokratike. Popujt dhe shoqëritë që nuk arrin të veprojnë konform këtyre standardeve shumë shpejtë zhyten në krizë dhe shndërrohen në shoqëri jofunksionale.

Është me interes të pamohueshëm politik dhe shkencor që të analizohen faktorët që ndikojnë në humbjen e kohezionit të brendshëm, pra në shthurjen e formacioneve heterogjene shoqërore, kudo në botë.

Problemet janë objektive që janë të lidhura ngushtë me interesat e prekshme etnike. Kur këto interesa rrezikohen, objektivisht shfaqet fenomeni i disluajalitetit ndaj shtetit, ndaj një koncepti që ka filluar ta ngushtojë hapësirën një komuniteti të caktuar etnik. Për ta kuptuar fenomenin e shthurjes së një shteti, duhet përkufizuar shkaqet e disluajalitetit, të humbjes së kohezionit. Kryesisht janë tre:

- segregimi mbi baza etnike, racore, religjioze, kulturore, linguistike, krahinore etj;
- tendenca e vazhdueshme e mosrespektimit të marrëveshjeve që kanë krijuar bazën për bashkëjetesë, për ndërtim të një shoqërie oportunitetesh të barabarta;

- kapacitetet etnike, ekonomike, politike, kulturore, vetëdija kombëtare e popujve që kanë hyrë në relacione të bashkëjetesës etj.

Shoqëritë heterogjene janë më të ekspozuara ndaj ndikimit të këtyre faktorëve. Fati tragjik i Jugosllavisë nuk është aksident historik, por verifikim i një kauzaliteti kompleks. Ky rrezik është latent, i kanoset çdo formacioni multietnik shoqëror.

Jugosllavia funksiononte si federatë në sajë të një kontrate, marrëveshje që garantonte deri diku barazinë e popujve, e cila ruhej përmes mekanizmit të vetos. Regjimi i Millosheviqit në mënyrë arrogante e sulmoi këtë fetish të përbashkësisë. Fushata e tij nisi dhe përfundoi në Kosovë, ngaqë ai dhe ekipi rreth tij, i përbërë nga komunistë të deklasuar, klerikë të etshëm për ndikim politik, intelektualë nacionalistë, aventuristë dhe kriminelë që ofronin shërbimet e tyre, vlerësonin se elaborati për hegjemoninë serbe, (i katërti, pas atij të Garashaninit, Andriqit dhe Çubrilloviqit) duhet të testohet në një trup të huaj, ashtu si trajtoheshin shqiptarët në ish-Jugosllavi, për t'i evituar reagimet eventuale të popujve tjerë të Jugosllavisë. Ai luante në kartën e solidaritetit sllav dhe arrinte sukses derisa dolën në shesh pretendimet reale, hegjemoniste serbe që i rrezikonin interesat e popujve të tjerë të Jugosllavisë. Për t' i fshehur qëllimet hegjemoniste, propaganda serbe përhapte tezën e pabarazisë së Republikës së Serbisë në krahasim me republikat e tjera, e cila qenka fragmentarizuar, dezintegruar përmes imponimit të dy krahinave autonome. Në atë kohë askujt nuk i shkonte mendja te e vërteta paradoksale, te fakti se këto dy krahina autonome ishin dhënë si peshqesh Serbisë për ta kënaqur nacionalizmin serb. Po qe se ata njëmend do ta dëshironin të jenë të barabartë si republikat tjera, atëherë do të duhej të hiqnin dorë, të liroheshin nga dy krahinat dhe kështu barazoheshin me republikat tjera.

E përmenda këtë shembull për të ilustruar argumentimin naiv me të cilin nuk zgjidheshin problemet, por nxitnin konflikte të papërgjegjshme. Të pavetëdijshëm, apo të pandërgjegjshëm për peshën e fjalës, për efektin rrënues të saj, të bindur se kanë të drejtë të padiskutueshme, këto politika dhe politikanë prodhonin krizën dhe në të njëjtën kohë habiteshin nga shfaqja e saj. Në mungesë të përvojës

për mendim kritik, të krijimit të distancës ndaj vetvetes, këta politikanë krizën e shpjegojnë me veprimin e armikut të brendshëm apo të jashtëm. Sipas përvojave të deritashme rolin e armikut të brendshëm ia mveshnin grupit atipik brenda shoqërisë nga aspekti etnik, religjioz apo ideologjik. Kur ky grup nuk eliminohej lehtë, madje fitonte simpatinë apo mbrojtjen e faktorit ndërkombëtar, akuza jo kritike zgjerohej duke krijuar kështu edhe spektrin e armiqve të jashtëm. Kjo strukturë mentale që nuk arrin në mënyrë racionale dhe kritike ta analizojë mënyrën e të menduarit gjithkund ka bartur fajin te armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm. Këto janë modalitete tashmë të profanizuara të krijimit të teorive të konspiracionit, të komplotit. Elementet psikologjike, paragjykimet, stereotipet, botëkuptimet shpeshherë determinojnë një proces historik, më shumë se faktorët e tjerë ekonomik, social, gjeostrategjik. Në opinion imponohet një mendim me të cilin bëhen përpjekje që shfaqjen e antagonizmave etnike ta ndërlidhin me ndikimin e faktorëve ekonomikë. Por, kjo qasje nuk arrin të shpjegojë shfaqjen e antagonizmave etnike, religjioze etj në shtetet e zhvilluara, si Belgjika, Spanja, Irlanda, apo Kanada.

Shqiptarët si element jo tipik në shtetin e sllavëve të jugut shpeshherë kanë ndjerë peshën e të qenit armik, fajtorë për çrregullime të ndryshme në shoqëri, të akuzuar si instrument i forcave të huaja proveniencash të ndryshme.

Në Maqedoni po ashtu dendur shfaqen kriza për të cilën akuzohen shqiptarët. Këto akuza shpesh herë janë më të ashpra, më të paskrupullta, më fyese dhe më të padrejta.. Së këndejmi duhet analizuar konceptin e formacionit shoqëror që sot quhet Republika e Maqedonisë dhe për ta kuptuar gjeneratorin e krizës: a është ai në duar të shqiptarëve apo të maqedonasve?

Shqiptarët shpesh herë janë shkaktues të krizës për shkak se ata kanë kapacitet etnik, ekonomik, politik për ta afirmuar interesin e tyre të gjithëmbarshtëm. Ata tashmë kanë një vetëdije të lartë kombëtare dhe është e pamundshme që t'i nënshtrohen një procesi të asimilimit, apo të akulturimit dhe të marginalizimit. Shqiptarët kanë një nacionalizëm reaktiv, përkatësisht reagojnë ndaj pozitës së tyre të pabarabartë në sistem.



Maqedonasit nuk janë të vetëdijshëm se me konceptin e tyre për shtetin, për kombin, për sovranitetin, për identitetin, shkaktojnë po ashtu kriza, jo vetëm në raport me shqiptarët.

Shqiptarët asnjëherë deri më tani nuk kanë kontestuar asgjë që është e vlefshme për interesin maqedonas, shtetin, identitetin, gjuhën, autoqefalitetin e kishës ortodokse, ashtu si veprojnë fqinjët e tjerë të Maqedonisë. Në asnjë rast nuk kanë bërë aleanca, të fshehta apo të hapura kundër Maqedonisë. Përkundër këtyre fakteve të pamohueshme, maqedonasit shfaqin distancë më të madhe etnike ndaj shqiptarëve, sesa ndaj serbëve, grekëve, bullgarëve apo turqve dhe romëve. Bie fjala përqindja e martesave të përziera në mes të shqiptarëve dhe maqedonasve është skajshmërisht e ulët, më pak se 1%, ndërkaq me të tjerët ngritët deri më 65%.

Maqedonasit kontestojnë shumë vlera që kanë të bëjnë me interesin shqiptar, madje në periudha të caktuara historike, pa rezerva kanë qenë instrument i projekteve serbe. Ata jo vetëm që në vazhdimësi përpiqen t'i marginalizojnë shqiptarët vendor, por aktivisht, çmendurisht, pa rezerva, me arrogancë dhe publikisht inkuadrohen në ndërtimin e argumenteve për ta kontestuar aspiratën e qytetarëve të Kosovës për pavarësi, duke filluar nga përhapja e argumentit se pavarësia e Kosovës e destabilizon Maqedoninë, Ballkanin e deri te planet e Gligorovit për hapjen e një korridori përmes të cilit kosovarët gjatë eksodit do të dërgoheshin në shtete të largëta me shpresë se nuk do të kthehen kurrë.

Shqiptarët në Maqedoni janë popullatë autoktone që objektivisht kanë krijuar vlera kulturore dhe kanë vepruar në mënyrë sinkrone me hapësirat tjera shqiptare në Ballkan. Ata jo vetëm që jetojnë në territore që në mënyre kompakte ndërlidhen mes vetes, por edhe kanë kompaktësi shpirtërore, pa marrë parasysh dallimet fetare dhe të tjera. Kanë dhënë kontribut të madh pavarësisë së Shqipërisë, kanë mbështetur proceset politike në Kosovë, kanë dhënë kontribut të madh kulturor. Me këtë rast do të përmendim se alfabeti kombëtar shqiptar është miratuar në Kongresin e Alfabetit që u mbajt në Manastir në vitin 1908. Aso kohe Manastiri kishte përbërje tjetër etnike, në favor të shqiptarëve. Nuk duhet harruar as faktin se të dy

fituesit e çmimit Nobël me origjinë shqiptare, Nënë Tereza, për paqë dhe Ferid Murat, për medicinë kanë prejardhje prej Maqedonisë, konkretisht nga Shkupi dhe Gostivari. I përmendi këto detaje për të kuptuar më drejtë autoktoninë, kapacitetin e gjithëmbarshtëm të shqiptarëve të Maqedonisë dhe për t'i evituar stereotipat që i paraqesin shqiptarët si ardhacakë në këto hapësira.

Shqiptarët e Maqedonisë në momente vendimtare historike për Maqedoninë kanë dhënë kontribut shtetformues, duke filluar nga kryengritja kundër Perandorisë Otomane (Republika e Krushevës), themelimit të Republikës Popullore të Maqedonisë e deri te pavarësia e Republikës së Maqedonisë, gjatë shthurjes së Jugosllavisë. Këto fakte përmenden për të kuptuar më drejtë kërkesat e shqiptarëve. Ata nuk janë fenomen i vonshëm që abuzojnë me procesin historik që shthuri Jugosllavinë, por ata në Maqedoni, si popull me rrënjë të thella autoktone, me trashëgimi historike dhe kulturore pretendojnë t'i rikthejmë të drejtat e trashëguara dhe t'i fitojnë të drejtat njerëzore që garantohen me konventa ndërkombëtare. Nga e kaluara e kanë trashëguar të drejtën për shtetformësi, për përdorim zyrtar të gjuhës shqipe, të simboleve të tjera kombëtare etj.

Nga ana e tyre maqedonasit i paraqesin shqiptarët si fatkeqësi elementare që u shfaq befasisht dhe kanë kërkesa të pangopshme dhe të të porealizueshme. Për ta kuptuar më mirë origjinën e fërkimeve ndëretnike duhet t'i rikthehemi filleve të procesit historik që e hapën idenë e krijimit të një shteti të pavarur në zemër të Ballkanit, që sot njihet me emrin Maqedoni. Tashmë është njohur se të gjitha idetë për krijim të shteteve të veçanta në Ballkan u shfaqën gjatë periudhës së shthurjes së dy perandorive heterogjene, multietnike, asaj austro-hungareze dhe asaj otomane. Pas anulimit të Marrëveshjes së Shën Stefanit, me të cilën Bullgaria pat fituar të drejtën e zgjerimit në territorin e sotëm të Maqedonisë, përkatësisht rikthimit të këtij territori në juridiksionin e perandorisë otomane, u shfaqën lëvizje të ndryshme politike që synonin t'i largojnë definitivisht otomanët nga Ballkani. Në Bullgari u forcua ideja e krijimit të një shteti që do të quhej Maqedoni, sipas modelit zviceran ku barabarësishtë do të jetonin popuj të ndryshëm, bullgarë, shqiptarë, serbë etj. Ideja ishte që në mënyrë indirekte të realizohen interesat gjeostrategjike të

bullgarëve në këtë pjesë të rëndësishme të Ballkanit. Në atë kohë këto ide i lëviznin organizata të ndryshme politike, ilegale apo gjysmë legale që njihen me emrin VMRO, të cilët kishin degë të brendshme dhe të jashtme. Degët e jashtme të kësaj organizate, të përqendruara kryesisht në Bullgarinë e atëhershme, përhapnin idenë e kryengritjes imediate kundër autoriteteve otomane, ndërkaq degët e brendshme hezitonin nga frika e reprezaljeve. Mbisundoi krahu që nxiste kryengritjen e Ilindenit(1902) që u shuajt me dhunë të përgjakshme dhe e dekurajoi tej mase popullin e shumë vuajtur të Maqedonisë. Në këtë kryengritje, në krah të popullatës sllave, që aso kohe ende nuk identifikoheshin qartas me emrin maqedonas morën pjesë edhe shqiptarët.

Në Luftën e Parë Botërore Bullgaria zgjodhi anën e gabueshme dhe kontrollin mbi Maqedoninë e morën serbët që zgjodhën anën e aleancës fituese. Si shpërblim iu dha kontrolli mbi hapësirat e mëdha duke filluar nga Maqedoni e deri në Slloveni. Ky shtet heterogjen, që u vendos në gërmadhat e dy shteteve heterogjene paraprake, nuk arriti t'i kënaqë aspiratat të popujve të ndryshëm, të sllovenëve, të kroatëve, të boshnjakëve, të maqedonasve, të shqiptarëve etj dhe kur u sulmua nga Gjermania naziste dhe aleatët e saj ( prill,1941), askush nuk dëshoi që ta mbrojtë. Ky shtet që komunistët e asaj kohe e quanin sajësë artificiale dhe propozonin që të shthurej u pushtua për gjashtë ditë. Disluajalietiti i popujve e prishi kohezionin e brendshëm dhe askush, madje edhe serbët nuk treguan motiv për ta mbrojtur integritetin e këtij shteti të krijuar në tavolinë të gjelbër, si shpërblim për aleanca gjatë luftës.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në hapësirën e Jugosllavisë së parë u krijua Jugosllavia e Dytë sipas marrëveshjes së popujve të ndryshëm sllavë në Jajce të Bosnje-Hercegovinës. Kjo Jugosllavi u ndërtua mbi baza të një kontrate me të cilën popujt fitonin territoret e tyre, ashtu si në gjithë Evropën. Shqiptarët nuk morën pjesë në këtë ndarje hesapesh etnike, meqë paraprakisht, në një konferencë tjetër, në Bujan u patën marrë vesh me komunistët serbë dhe malazez që territoret me shumicë shqiptare t'i takojnë Shqipërisë. Me këtë kusht shqiptarët pranuan që bashkërisht me serbët, malazezët, maqedonasit të luftojnë kundër okupatorëve. Në atë kohë u formua edhe brigada

shqiptaro-maqedonase ose më saktë thënë kosovaro-maqedonase, e cila mori pjesë në çlirimin e Maqedonisë, Kosovës, Bosnjës, Serbisë etj. Në atë kohë u fitua e drejta për të qenë i barabartë. Për shkak të marrëveshjeve globale Kosova dhe territoret tjera shqiptare mbetën brenda Jugosllavisë me kusht që t'i gëzojnë të gjitha të drejtat. Meqë këto të drejta nuk jepeshin, madje përmes dhunës shqiptarët, etnikisht atipikë, stimuloheshin që të shpërngulen në Turqi, ashtu si boshnjakët fetarisht atipikë. Në këtë mënyrë vetvetiu u shfaq fenomeni i disluajalitetit ndaj shtetit me të cilin gjithnjë e më pak identifikoheshin shqiptarët. U krijuan shumë organizata ilegale që përhapnin idenë e vetëvendosjes. U organizuan disa kryengritje, demonstrata, që agravuan në vitin 1981. Këtë demonstratë pa dashje, hapën një problem global. Nëse lëvizja polake "Solidarnost" hapi çështjen e mos zgjidhjes të problemit të punëtorëve në kampin socialist, demonstratat shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni e viteve të '80-ta hapën çështjen e moszgjidhjes së drejtë të problemeve etnike në këto sisteme. Këto dy manifestime, në fakt i kontestuan premisat kryesore të formacioneve të ashtuquajtura socialiste të lindjes, të cilat pretendonin se çështja e të drejtave të punëtorëve dhe problemet etnike një herë e përgjithmonë janë zgjidhur. Demonstratat e shqiptarëve e aktivizuan nacionalizmin serb që priste pretekstin për ta çmontuar sistemin titist që sipas tyre paska ngulfatur zhvillimin serb në Jugosllavi. Me çmontimin e titizmit ata në fakt e çmontuan Jugosllavinë. Ky proces arriti kulminacionin e vet në vitin 1989 kur Beogradi arriti me dhunë ta abrogojë Kushtetutën e Kosovës të viti 1974, përkatësisht ta ulë statusin e saj duke e bërë tërësisht të varur nga Beogradi. Me këto ndërrime në thelb prishej kontratat jugosllave e përbashkësisë. Popujt e tjerë të Jugosllavisë vetëm atëherë u vetëdijesuan për efektet e dëmshme të nacionalizmit serb mbi interesat e tyre. Nga kjo frikë nisi edhe tek ata procesi i disluajalitetit ndaj sistemit të ri që e ngriti lideri i ri serb, Millosheviqi. Është me rëndësi të përmendet se pikërisht në këtë vit, 1989, nacionalistët maqedonas, duke ndjekur hap pas hapi metodat dhe qëllimet strategjike serbe, morën masa të ngjashme. Me anë të 25 amendamenteve kushtetuese, e ulën statusin politik dhe kushtetues të shqiptarëve, tashmë të anatemuar dhe të pambrojtur nga institucionet qendrore të shtetit. Ky është një kënd shikimi i ecurisë së shthurjes së Jugosllavisë. Republikat, në mes tyre edhe Maqedonia

fituan jo vetëm të drejtën e pavarësisë, por edhe të drejtën për kapitalizim të fryteve të nacionalizmit antishqiptar të viteve të 80-ta. Kushtetuta e 17 nëntorit të vitit 1991, pra Kushtetuta e Maqedonisë së pavarur u hartua mbi bazat e politikës represive, reduktioniste të vitit 1989. Në vend që kushtetuta e re të frymonte me vlera të reja të shoqërive të hapura, ku garantohen të drejtat e njeriut, e drejta për kultivim të diversiteteve, ajo, duke i nëpërkëmbur të drejta e trashëguara të shqiptarëve nga periudhat e kaluara, në thelb e legjitimoi politikën nacionaliste serbe të viteve të 80-ta që këmba-këmbës ndiqej nga politikanët maqedonas. Kjo Kushtetutë në vend që ta qetësojë Maqedoninë, ta demokratizojë dhe humanizojë atë u shndërrua në gjenerator të krizës. Në preambulë të saj u sanksionua aspirata maqedonase që shteti të identifikohet si pronë etnike e tyre, ku ata shpirtgjerësisht u garantojnë të drejtat qytetare shqiptarëve, turqve, serbëve etj. Ky koncept etnocentrik për shtetin e ri jo vetëm që anulonte të drejtat e trashëguara të shqiptarëve nga e kaluara, por njëkohësisht binte ndesh aspiratave dhe kapaciteteve reale të shqiptarëve që e përbënin 1/3 e popullatës dhe natyrisht reagimet pasuan:

- deputetët shqiptarë nuk e votuan kushtetutën e re që u imponua kundër vullnetit të tyre. Ky fenomen hapi një çështje shumë delikate politike, çështjen e keqpërdorimit të procedurës demokratike, të majorizimit etnik, që në shtetet multietnike shndërrohet në procedurë efikase për eliminim, marginalizim të popullatës pakicë. Këtë, regjimi i Millosheviqit e bënte brutalisht, me armë, ndërkaq Gligorovi me abuzim të procedurës demokratike, por efektet ishin të njëjta. Në hapësirat e qytetërimit perëndimor ky degjenerim i demokracisë është parandaluar me konceptin e demokracisë konsensuale, apo konsociale që aplikohet në çdo shtet me përmbajtje heterogjene apo multietnike. Ky abuzim i demokracisë nuk solli asnjë rezultat, pos që e aktivizoi virusin e disluajaliteti etnik;

- popullata shqiptare nuk doli në referendum për pavarësi të Maqedonisë meqë ata nuk u konsultuan për formulën e pyetësorit që nxiti idenë për organizim të një referendumi paralelë për autonomi politiko-territoriale të shqiptarëve të Maqedonisë, ashtu si në hapësirat e tjera të Jugosllavisë;

-pakënaqësia thellohej gjithnjë më tepër sa që fitoi përmasa ushtarake. Shqiptarët e Maqedonisë filluan t'i formojnë strukturat ushtarake, fillimisht me tolerimin e autoriteteve maqedonase për ta dekurajuar APJ-në që të mos filluar një aventurë të re, por pastaj ato u pavarësuan. Me largimin e APJ-së nga Maqedonia u humb nevoja për ekzistimin e këtyre strukturave dhe autoritetet maqedonase nisen ciklin e represioneve të reja për t'i disiplinuar shqiptarët. Në vitin 1993 u mbajt procesi i madh gjyqësor i njohur me emrin "Afera e armëve" që i ndëshkoi bartësit politikë shqiptarë që nuk arritën t'i çmontojnë këto struktura ushtarake. Për t'i frikësuar shqiptarët, strukturat represive maqedonase ndërmoren disa ekspedita ndëshkuese policore, për t'i disiplinuar shqiptarët. Sulmuan fshatin Ladorisht afër Strugës për të mbyllur një shkollë "ilegale" në gjuhën shqipe. Me këtë rast ata brutalisht i keqtrajtuuan banorët e këtij fshati. Po në këtë vit (1993) policia maqedonase, duke tentuar që ta arrestojë një fëmijë që shiste cigare, zuri të keqtrajtojë tërë kuartin, Bit Pazarin, në qendër të Shkupit, banuar me shqiptarë. Me këtë rast ata vranë 4 qytetarë të pafajshëm;

- në vitin 1994 shqiptarët, përkatësisht këshillat e tre komunave (e Tetovës, Gostivarit, Dibrës) duke respektuar procedurat ekzistuese themeluan Universitetin e Tetovës. Autoritetet maqedonase sërish reagues me vehemencë dhe brutalisht. Me këtë rast, krahas rrënimit të disa objekteve vranë edhe një qytetar të rastit;

-në vitin 1997 policia sulmoi dy komunat e banuara me shqiptarë, që kishin nxjerrë flamurin kombëtar shqiptar, një e drejtë e trashëguar nga e kaluara që me Kushtetutën e vitit 1991, përkatësisht me amendamentet e vitit 1989 ndaj kushtetutës të vitit 1974, ishte abroguar. Me këtë rast u vranë tre qytetarë, brutalisht u keqtrajtuuan me qindra të tjerë, ndërkaq kryetarët e dy komunave dhe kryesuesit e këshillave të komunave u dënuan me burg të rëndë;

-në vitin 1988 policia maqedonase intervenoi në një fshat afër Kërçovës, Zajaz në kërkim të një personi dhe vrau një qytetar.

Të gjitha këto intervenime brutale dhe shumë të tjera të përditshme banale ndërmerreshin në koordinim me veprimet e autoriteteve serbe

në Kosovë. Me intervenimin e NATO-s në Kosovë situatata në planin strategjik u ndërrua. Shqiptarët merrnin frymë më lirisht. Strategjet maqedonas nuk i dhënë rëndësi realitetit të ri dhe silleshin në mënyrë të vjetër. Në vend që të përkrahej politika e relaksimit të marrëdhënieve ndëretnike që si proces pat filluar me ardhjen në pushtet të koalicionit të ri qeveritar VMRO DPMNE-PDSH, opinion krijuesit maqedonas, gazetarë, politikanë, shkencëtarë, shkrimtarë përhapnin defetizëm, panik nga relacionet e reja, nga klima e re që filloi në mënyrë të ndrojtur të përhapej në Maqedoni. Ata kërkonin sërish disiplinimin rigoroz të shqiptarëve. Nga këto stereotipa, nga kjo ksenofobi, nga këto fërkime të përditshme në vitin 2001 shpërtheu kryengritja, e cila kishte tipare të një stihie emotive, të një shpërthimi të frustracioneve të akumuluar me dekada të tëra. Edhe me këtë rast doli në shesh strategjia paradoksale politike e shqiptarëve në përgjithësi. Në dallim nga strategjia serbe e cila nga qendra, nga Beogradi i dirigjonin kryengritjet e serbëve në Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë, qendrat politike shqiptare, përfaqësuesit legjitim të popullit shqiptarë nuk mbështetën këtë kryengritje, përkundër entuziazmit të qytetarëve shqiptarë që në masë inkuadroheshin në radhët e UÇK-së, madje edhe përkundër faktit se kryengritësit shqiptarë kishin mundësi reale të dilnin ngadhënjyes në këtë luftë. Prishtina dhe Tirana qartazi u distancuan nga lufta dhe kërkonin nga përfaqësuesit legjitim shqiptarë të Maqedonisë të angazhohen në ndërprerjen e armiqësive. Në vazhdë të këtyre qëndrimeve faktori shqiptarë e përuroi strategjinë e demokratizmit të krizës e jo të militarizmit të saj, ashtu si vepronte faktori i gjithëmbarshëm maqedonas. Derisa faktori shqiptarë angazhohej për qetësim të situatës duke i bindur udhëheqësit e luftës që t'i ulin armët, autoritetet maqedonase, përkundër faktit se do të dilnin humbës në këtë konflikt, gjithnjë e më shumë e thellonin krizën. Në kohën kur faktori politik shqiptar e bindi faktorin ushtarak, udhëheqësit e kryengritjes që të heqin dorë nga idetë për dezintegrim të Maqedonisë, përfaqësuesit maqedonas importonin një sasi të madhe armësh, helikopterë, aeroplanë, tanke, etj nga Ukraina, Bullgaria, Serbia etj.

Derisa përfaqësuesit shqiptarë hartonin plane për paqë pa kushte me faktorin ndërkombëtar, fillimisht në bashkëpunim me ambasadorin e OSBE-së, z.Frovik, maqedonasit i anatemonin në mënyrë brutale këto

përpjekje. Ata kërkonin diçka që objektivisht s'mund ta arrinin, fitoren glamuroze, spektakulare, të tipit "Oluja". Krijuan klimë të padurueshme, kryesisht mbi dyshimet paranoike, konspirative që ndikuan në shpalljen e z.Frovik persona non-grata. Oferta, plani i Frovikut përmbante vetëm modalitete teknike, pa kërkesa politike, për çarmatim të kryengritësve. Refuzimi i planit Frovikut hapi shtegun për negociata më serioze, me kërkesa politike që përfunduan me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit.

Z. Frovik u largua, por problemi mbeti. Përfaqësuesit shqiptarë të Maqedonisë, të ballafaquar me presionin nga Tirana dhe Prishtina, si dhe nga faktori ndërkombëtar arritën një marrëveshje politike në Prizren me përfaqësuesit e kryengritjes me të cilën afirmuan idenë se për çështjet etnike nuk duhet kërkuar zgjidhje territoriale me çka u mbrojt integriteti i këtij shteti të brishtë. Në këtë kohë, mund të thuhet me plot gojë se pavarësia dhe integriteti territorial i Maqedonisë, u mbrojt paradoksalisht nga shqiptarët. Vetë maqedonasit me siguri do të jepnin argumente dhe pretekste të shumta për dezintegrim të shtetit. Si do që të jetë shqiptarët në këtë kohë treguan kapacitete të mjaftueshme intelektuale, politike, për ta menaxhuar, me mjete demokratike dhe qytetëruese këtë konflikt që do të përfundonte gjithsesi me dezintegrim të Maqedonisë. Ata e trasuan rrugën për negociata politike që filluan në Ohër. Në këto bisedime, në vend të kërkesave territoriale ata parashtruan kërkesa për të drejta politike, të natyrshme për shtetet heterogjene. Duke marrë parasysh kategorinë e drejtave të trashëguara, sugjerimet e teorisë politike për ndërprerje të konflikteve në shoqëritë multietnike dhe zgjidhjet praktike në Evropë, faktori shqiptar kryesisht parashtroi tre kërkesa të natyrshme për çdo kënd:

- përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe ;
- përfaqësim adekuat në administratën dhe institucionet tjera shtetërore dhe
- zbatimin e modelit të demokracisë konsensuale që do të parandalonte majorizimin etnik.

Përderisa pala shqiptare nuk kontestonte asnjë të drejtë të qenësishme për maqedonasit, pala maqedonase, në vend që me gëzim t'i miratonte këto kërkesa të natyrshme të shqiptarëve mori një qëndrim refraktar.



Në vazhdë të kultivimit të një mendësie që shtetin e perceptonte, jo si servis neutral i qytetarëve, por si pronë etnike, në vazhdë të trajtimit të shqiptarëve si element i huaj, i rrezikshëm, si fatkeqësi elementare, negociatorët maqedonas nuk treguan respektin minimal për kërkesat e shqiptarëve. Në mënyrë monotone, me një kokëfortësi provinciale ata refuzonin idetë që sugjeronte teoria politike, lehtësuesit e bisedimeve dhe praktika moderne. Ata gjithsesi nuk do të pranonin asnjë nga kërkesat e shqiptarëve po të mos ishin të ballafaquar me trysninë ndërkombëtare. Së këndejmi "Marrëveshja e Ohrit" në vete ngërthen pozicionin gjithëshqiptarë kundër luftës, kërkesat e moderuara të shqiptarëve, qëndrimin refraktarë maqedonas si pasojë e perceptimit të shtetit si pronë etnike, perceptimit të shqiptarëve si element i huaj dhe përpjekjet e faktorit ndërkombëtar për harmonizim abstrakt të qëndrimeve.

Pozicionimi refraktarë përfundoi me diskriminimin e pesëfishtë të gjuhës shqipe në krahasim me gjuhën maqedonase, me ngushtim të përdorimit të parimit të vetos vetëm për çështje kulturore, dhe jo për çështje tjera shumë të rëndësishme për shtetet multietnike siç është çështja e përdorimit të barabartë të buxhetit dhe ngushtime të tjera të niveleve të ndryshme.

Restrikcionet që e ngushtuan hapësirën e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe krijuan një konfuzion, një inkoherencë të paqëndrueshme logjike dhe juridike:

- për ta përdorur zyrtarisht gjuhën shqipe duhet të plotësohet kuota e 20%-it;
- gjuha shqipe nuk do të përdoret në gjithë territorin e shtetit;
- gjuha shqipe nuk do të përdoret në qeveri;
- gjuha shqipe nuk do të përdoret në marrëdhënie ndërkombëtare;
- gjuha shqipe në parlament do të përdoret vetëm gojarisht, që do të thotë se propozimet e deputetëve shqiptarë do të jepen vetëm gojarisht;
- deputeti mund ta përdorë gjuhën shqipe vetëm në cilësi të deputetit dhe jo si kryesues i parlamentit, apo i komisioneve të ndryshme parlamentare etj.

Restrikcionet që u ndërtuan në Marrëveshjen e Ohrit sikurse nuk e kënaqën palën maqedonase, por vazhduan edhe në fazën e

implementimit të Marrëveshjes së Ohrit. Projekti ka të bëjë me eliminimin e përdorimit automatik, zyrtar të gjuhës shqipe, që do të thotë se gjuha shqipe mund të përdoret hipotetikisht, po që se një subjekt, qytetari do ta kërkojë këtë. Në vend të përdorimit, pra objektiv, sistemor, zyrtar të gjuhës shqipe kemi përdorim subjektiv. Këtë mënyrë të përdorimit të një gjuhe kemi çdo kund në botë. Bie fjala një shqiptar, kroat ose slloven nëse gjendet në gjyq në Japoni a diku tjetër dhe kërkon përkthyes për shkak të mosnjohjes së gjuhës të atij shteti, atëherë gjyqi është i obliguar t'i sigurojë atë. Ndonëse në Marrëveshjen e Ohrit, në mënyrë të qartë shkruhet se çdo dokument personal lëshohet edhe në gjuhën shqipe, prapë se prapë edhe këtu u zbatua parimi i kërkesës subjektive. Ky parim në thelb e aktivizon kujdesin, frikën, kalkulimin qytetarit, i cili druan nga trajtimet e posaçme po që se kalon kufirin shtetëror me një pasaportë të lëshuar në gjuhën shqipe. Natyrisht se ka edhe shmangie të tjera nga Marrëveshja e Ohrit, që e anulon parimin kushtetues që përcakton të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe. Në Maqedoni në mënyrë sistematike rikthehet praktika e ofrimit të drejtave të pashfrytëzueshme, e trashëguar nga e kaluara komuniste. Në krahasim me të kaluarën, sipas interpretimit të palës maqedonase, shqiptarët, pas gjithë asaj lufte, me Marrëveshjen e Ohrit, paskan fituar vetëm përdorimin verbal të gjuhës shqipe në seancat e parlamentit, që po ashtu ngushtohet meqë gjatë transmetimit fjala e deputetëve shqiptar përkthehet në gjuhën maqedonase. Variantet tjera të përdorimit të gjuhës shqipe kanë ekzistuar edhe më parë. Marrë në tërësi çështje e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe është degjeneruar. Është shndërruar në kërkesë kapricioze të shqiptarëve, përkatësisht në mjet përmes të cilit maqedonasit hakmerren ose e përbuzin përpjekjet e shqiptarëve për barazi. Kjo ndodh për shkak se maqedonasit, marrë në tërësi janë të bindur se lufta e vitit 2001 ishte një konspiracion ndërkombëtar ku shqiptarët luajtën rolin e instrumentit. Për ta Marrëveshja e Ohrit është imponuar nga jashtë prandaj mendojnë se opstrukcionet e tyre janë legjitime. Kjo Marrëveshje edhe në parametra të tjera nuk realizohet, duke filluar nga decentralizmi, përfaqësimi adekuat, mos respektimi i afateve, e deri te amnistia. Bie fjala me idenë e decentralizmit u bënë përpjekje që të eliminohen idetë për kantonizim, federalizim të Maqedonisë. Në vend të kësaj, ideja e decentralizmit u transformua në

një surrogat që quhet dekoncentrim i financave dhe kompetencave nga pushteti qendror në degët e tij në nivel të komunave.

Rasti i Maqedonisë flet qartë për vështirësitë objektive të funksionimit të shteteve multietnike. Në Marrëveshjen e Ohrit u bënë përpjekje që të hapet shtegu për një qasje të re moderne që do të duhej t'i relaksonte marrëdhëniet ndëretnike, pra të respektohet parimi i pasqyrimit të karakterit multietnik të shoqërisë në koncept të shteti.

Në Maqedoni shfaqet kriza për shkaqe objektive. Ato janë:

- S'përputhja në mes të përbërjes multietnike, më saktë binacionale të shoqërisë dhe tendencave etnocentrike të popullatës shumicë. Sforcimi i konceptit unitar për shtetin përkundër karakterit multietnik të shoqërisë;
- Perceptimi i shtetit si pronë etnike e popullatës shumicë;
- Koncepteve të gabuara lidhur me përkufizimin e identitetit. Përkatësia etnike trajtohet si substancë transhedentale, si esencë eidetike e Platonit që nuk i nënshtrohet ndryshimit. Në këtë mënyrë konceptet e të sotmes projektohen në të kaluarën;
- Identifikimi i historisë së vendit me atë të popullit. Ky gabim hap konteste të llojllojshme me fqinjët. Maqedonasit haptazi e afirmojnë idenë e "maqedonizmit si licencë e fuqishme historike". Ja si funksionon ky silogjizëm agresiv nacionalist:
  - Nëna Terezë, ka lindur në Shkup;
  - Shkupi është kryeqytet i Maqedonisë dhe përfundimi;
  - Nëna Terezë është maqedonase.
  - Ky silogjizëm përdoret jo vetëm për personazhet historike, por edhe për ngjarjet historike;
  - Zbatimi i koncepteve partikulariste ortodokse, një shtet, një popull, një besim. Aktualisht kjo qasje ka acaruar marrëdhëniet kishtarë jo vetëm maqedonase-serbe, por edhe me faktorë të tjerë që shfaqin brengosje për shkak të arrestimit të peshkopit serb, Vranishkovski, i emëruar nga kisha ortodokse serbe etj.

Në mesin e keqkuptimeve dhe keqinterpretimeve do të përmendja tezën historikisht dhe teoretikisht të gabuar që ka të bëjë me trashëgiminë evropiane. Këtu ekziston një bindje e gabuar se Evropa është shembull i multietnizmit. Faktet dëshmojnë të kundërtën. Në Evropë stabiliteti i brendshëm është arritur vetëm falë krijimit të

harmonisë, kongruencës në mes të elementit etnik dhe kufijve politik. Madje edhe Zvicra nuk mund të kategorizohet si shtet multietnik meqë kantonet, kufijtë e tyre janë vendosur duke i respektuar diversitetet etnike, religjioze, linguistike. Nga ana tjetër historia e Belgjikës nuk zhvillohet në drejtim të përforcimit të unitetit, por të separimit. Në ato vende tipike evropiane ku nuk është zgjidhur ky problem shfaqen vështirësi të mëdha si në Spanjë, Irlandë apo bie fjala në Kanada.

Shpesh herë nuk bëhet dallimi i qartë në mes të dy nocioneve: shoqërisë multietnike dhe shtetit multietnik. Problemet shfaqen kur duhet të ndërtohen mekanizma për pasqyrim të karakterit multietnik të shoqërisë në koncept shtetëror, pra problemi është te funksionimi multietnik i shtetit.

Në Maqedoni nuk ka gatishmëri për funksionim të shtetit sipas përbërjes multietnike të shoqërisë. Në vend që të marrë masa për t'i zgjidhur këto probleme, autoritetet maqedonase nuk e ndërrojnë realitetin, konceptin etnocentrik për shtetin, por retorikën.

A do ta pësojë Maqedonia fatin e Jugosllavisë, do të varet nga ajo vetë. As hyrja në Evropë dhe NATO nuk mund t'i hibernojë këto fërkime etnike, ashtu si nuk ka zgjidhur në vende tjera evropiane.

## KOSOVA- SUBJEKT I CILI "PRET" DHE KAHJET EMANCIPUESE\*

Dr. Martin Berishaj

Procesi i pavarësisë përfundon me momentin kur fitohet ajo, kur subjektivizohet intenca politike e një kombi e sublimuar në krijesë që quhet shtet. Poqëse e vendosim situatën e tashme politike në Kosovë në fillim të rrugës për negociata për përcaktim të statusit përfundimtarë politik, mund të konstatojmë se konceptin shtet dhe pavarësi, elita politike kosovare e dëshiron, e synon, mirëpo, mbasi që është takuar rrëshqitazi me koncept të shtetit dhe pavarësisë, ajo sillet në rreth vicioz. Ku mund ti gjejmë fillimet e këtij rrethi? Për ta shpjeguar dhe për ta thjeshtëzuar deri në kuptueshmëri këtë dukuri, do të kthehem për dy dekada mbrapa, në një emision të Televizionit të Prishtinës, po e quaj edukativ, megjithëse as vet nuk me kujtohet se a quhej ashtu. Gazetari kishte dal në fshatrat e Kosovës dhe bënte intervista me rini të një fshati. Njëra nga të intervistuarat në pyetje se çka dëshiron të bëhet dhe cila është dëshira e sajë, u përgjigj me të parën " dua të regjistrohem në fakultet dhe të jam studente", gazetari duke mos shpreh çudi për dëshirën e sajë të flakët e plotëson pyetjen se çfarë shkolle kishte kryer, kurse ajo në përgjigje i thotë "vallahe unë e kam veç shkollën fillore", gazetari me të parë se ne ç'situatë u gjind, e përkujton atë se, për tu regjistruar në fakultet duhet të kesh të përfunduar shkollën e mesme, pastaj duhet të paraqitesh në provim pranues dhe poqëse e kalon atë mundë të regjistrojnë dhe të quash vetën studente. Duke mos ja mbush mendjen gazetari asaj, ajo në mënyrë sovrane i përgjigjet ".. e di, por po kam qef"!

Nga këtu do të vazhdojsha mendimin tim mbi procesin e pavarësisë dhe shtetformësisë kosovare. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, u ndërpre procesi i pavarësisë dhe u prolongua për një kohë të caktuar. Proces ky, i cili në Kosovë u kuptua si arritje e lirisë politike gjegjësisht pavarësisë. Në fakt, lufta përfundoj në moment të ndërhyrjes së forcave tokësore të NATOS në Kosovë, dhe duke largua nga trualli i Kosovës këmbën e ushtarit serb. Mirëpo, poqëse e definojmë atë

---

\* apo debat mbi Intelektualet dhe sferën publike ne kontekstin e kolonializmit neoliberal dhe etnonacionalizmit ne truallin shqiptar

gjendje mund të konstatojmë se në Kosovë u sjell paqja. Koncepti i paqes, u transmetua nga klasa politike kosovare si koncept i lirisë, duke mos ditur ti shpjegohet popullit dallimi në mes këtyre dy koncepteve dhe ti servohet kosovarit si individ politik, teoria dushk për gogla. Jo se dinin se çka është gogla por fatkeqësisht atë e dëshironin ta quajnë dushk.

Poqëse hidhni një shikim të shkurtër në mediat kosovare të pasluftës, do të vëreni se me çfarë lehtësie u ofrohej kosovarëve mjegulla politike duke shtrembëruar filozofinë politike të formësisë shtetërore apo më mirë të quajmë të mosdijes së tyre deri ne palcë, që ndillte zi për teorinë politike të shtetit të ardhshëm. Proceset politike i emëronin si procese të hapura dhe të mbyllura, ngjashëm me terminologjinë e shkencave të natyrës mbi qarqe të mbyllura dhe të hapura elektrike!

Poqëse ndalemi pak tek këta procese të "hapura dhe të mbyllura" politike, tekste dhe mendime këto të prezencës së rastësishme të qenurit tekst e teori dhe mendim politik! na sjellin në shkallën e parë të atij rrethi vicioz me të cilin e fillova tekstin mbi çështjen e paqes dhe lirisë politike.

Dallimet thelbësore në mes paqes dhe lirisë politike shpjegoheshin po me të njëjtën filozofi të interpretimit të qarkut të mbyllur dhe të hapur!

Proceset politike, mund të jenë procese të filluara dhe të përfunduara apo të filluara dhe të papërfunduara, e kurrsesi të hapura dhe të mbyllura, sepse teoria politike mbi shtetin dhe pushtetin është poaq ekzakte sa që është ekzakte dhe teoria e pikës në matematikë. Si rrjedhojë e kësaj, do të vazhdoj interpretimin procesit të filluar e të papërfunduar, proces politik ky që më së miri i përshtatet Kosovës pas lufte dhe Kosovës tani, për të mund të zbardhë dallimin në mes lirisë dhe paqes. Në shikim të parë, asgjë e keqe, paqja nënkupton edhe lirinë, mirëpo, poqëse e shpalojmë teorinë politike të paqes në suaza të Kosovës së pas luftës, ku që ne fillim u vërejt dyshtresimi i mbulesës së individit (apo zenjes se frymës individit politike kosovar nga aspekti i lirive politike) nga njëra anë me vendosjen apo instalimin e administrimit civil ndërkombëtarë si rrjedhojë e fillimit të funksionimit të lirive politike dhe shtresës së dytë atij mbrojtësi (që solli paqen) që quhen forcat ushtarake të NATOS.

Vetvetiu na shtrohet pyetja se a mund të ekzistoj liri politike pa vendosje të paqes, ne truell që dëshirohet ti atribuohen premisat e shtetësisë?

Këtu pra fillon procesi apo më mirë çpështjellja e lëmshit të procesit politik. Fillimet e lirisë politike në Kosovë e paraqitën hijen e vetë me realizimin e zgjedhjeve të para lokale në Kosovë, dhe vendosjen e njëfarë pushteti sidokudo, por pushteti vendorë të cilin duhet mësua për të funksionuar sipas mënyrës që do ti përcaktohet nga shtresimi parë apo administrimi civil. Diskursi i politikut të dalë nga zgjedhjet mbante mostrën eklatante të habitusit dogmatik të romantikut shqiptarë për ta bërë Kosovën shtet, duke shpresuar se do të jenë mu ata nënshkruesit e asaj pavarësie së shumëpritur. Hapat e parë të administrimit civil ndërkombëtarë përqendroheshin në vendosje të gurëve në mozaik, e përkthyer në fjalorin tonë, ndërkombëtarët “të zgjedhurit” tonë i “ulën në tokë” duke i vendosur në vend ku realisht u takonte pozita, pra, pozita e subjektit të cilit i duhet të mësoj gradualisht fillimet e të qenit politik . Kjo pozitë jo e përshtatshme u kuptua nga politikët e dalë nga zgjedhjet si thyerje të koncepteve të “lirisë politike”, për të arsyetuar qënjen e vet të politikanit, këto hapa i definofshin si frenim i proceseve të pavarësisë kosovare. Zbardhja graduale në praktik e teorisë së paqes (e cila definohej deri atëherë si liri) dhe aplikimit i teorisë së lirisë politike, pozicionojë faktorin vendas duke e fut brenda kornizave të parapara nga administratoret ndërkombëtarë. Thjesht, politikanët vendas dita ditës filluan të ballafaqohen me dallimin të cilin ne retorikë politike nuk e vërenin, pra, ne mes paqes dhe lirisë politike.

### **Ripërsëritjet e shpalljes së pavarësisë**

Shkalla e devalvimit të vlerave politike nuk e ka rrënjën vetëm ne retorikë politike të subjekteve politik shqiptarë të cilët pa përgjegjësi flasin dhe ndërrojnë koncepte duke reflektuar mungesë të pafundme të dijes apo perceptimit të politikës dhe proceseve rrjedhëse, por edhe në belbëzim të menduarit të pakristalizuar. Nuk është hera e parë në praktikën e të vepruarit politik që hapat të cilët i bëjnë për të ndërtuar shtetin, e devalvojnë idenë e shtetit duke dështuar që në fillim. Poqëse në dhjetëvjetëshin e fundit shikojmë intencat për të shpallë pavarësinë e Kosovës do të mishërojmë këtë konstatim. Fillimisht kur

ish Kuvendi i Kosovës në vitin 1990 vuri hapat e shtetësisë kosovare, juridikisht, në shikim të parë, kishte përmbyllë bazamentin formal juridik për të shtruar shtratin e pavarësisë kosovare. Tendencat e njëpasnjëshme të elitës politike kosovare për ripërtëritje të shpalljes së pavarësisë (varësisht nga mandati në mandat i parlamentit Kosovar) prezantonin parimin themelor të devalvimit të koncepteve më të shenjta të shtetit. Tendenca për ripërtëritje të shpalljes, ne vetëdijen e elitës politike rezulton me dëshirën e tyre për të treguar se historia e Kosovës fillon aty dhe ma ta!. Këto tendenca ripërtëritëse të shpalljes së pavarësisë nga "institucionalistët" kosovarë shikoheshin si tendencë për ndërprerje të vazhdimësisë dhe assesi si devalvim të kërkesës. Prandaj elita politike kosovare dhe politikanet kosovar duhet përfundimisht të kenë të qartë se, pavarësia mund të krahasohet me lindjen e fëmijës, pra, ajo shpallet vetëm një herë, ashtu sikurse që lind edhe fëmija vetëm një herë!

Në rrugëtimin të cilin e bënë politikani në Kosovë në proces të filluar e të papërfunduar politik, momentalisht të përfytyruar në shkallën e konceptit të subshtetit me tendencë të subjektivizmit të sajë, po ai politikan kosovar në kuptueshmërinë e vet, pavarësinë si koncept politik (shikuar nga këndvështrimi i asaj se si veprojnë) e përjeton sikurse të ishte ajo frymorë, të cilën do ta takojnë një ditë prej ditëve në rrugët e Prishtinës, do ta përqafojnë dhe do ti thonë;

**"Allahile, pavarësi, a u lodhe, qysh i ki roptë, qysh je ti vet? Sa shumë na vanove bre"!**

Me këtë assesi nuk dëshiroj të relativizoj çështjen e pavarësisë, e aq më pak të shtetësisë kosovare, por dëshiroj të vë në pah, se si i devalvojnë vlerat ata që janë vu në ballë të procesit; me veprime të veta duke frenuar procesin e pavarësisë; duke mos përfill vullnetin politik në përditshmërinë e veprimeve të tyre; duke shtruar çështjen e përkohshmërisë si filozofi të jetësimit politik të teorisë mbi shtetin; dhe krejt këtë duke u përpiq të tregojnë njëri tjetrit se kush e do më shumë pavarësinë, në vend që të përpiqen t'i provojnë komunitetit ndërkombëtar se janë të aftë ta administrojnë Kosovën, ata funksionojnë në rrafsh paralele, duke krijuar vlera dhe identitete në dimensione të shumta horizontale, duke lënë anësh boshtin, vertikalen që i ndërlidh ato.

Nëse i qasemi problemit të përkohshmërisë që është bërë tanimë normë në veprimin e politikanëve shqiptarë do të shohim se gabimi



bëhet normë dhe kur ai përsëritet shpesh herë. Krejt procesin politik në rajon e në veçanti në Kosovë, e shikojnë si proces që zhvillohet tani për tani, sikurse ai mos të kishte vazhdimësi të rrjedhës dhe qëllim përfundimtarë. Prezencën ndërkombëtare qoftë ushtarake apo si administrim civil ndërkombëtarë e përjetojnë si përkohshmëri, jo se ajo prezencë si e tillë nuk e ka afatin e skadimit, por për shkak se procesin politik dhe të qenit në atë proces e akceptojnë si të tillë. Duke u nisur nga kjo që përmenda duhet konstatuar se politika që zhvillohet në Kosovë, aktorë të cilës janë vendoret, kryekëput është politikë e inercisë që diktohet nga qendra e vendosjes e cila si lavjerrës politik shpërndahet, fillimisht në retorikën e politikanëve vendorë, e pastaj gradualisht shtresohet si cipë e dimensionit të bindjes politike. Në teorinë politike koncepti i inercisë si diskurs, funksionon sipas logjikës së shndërrimit të subjektit në fjalë, nga subjekti i dëgjueshmërisë në tatimpagues (politik) të disiplinuar.

Duke shikuar njërin nga qasjet e mundshme të mekanizmave ideologjik: të rendit simbolik / material, rendit /fantazisë në brendësinë e se cilës jetojmë, veprojmë dhe mendojmë, ky tekst ka për qëllim që me qasjen kritike në mendimin e John Rawlsit<sup>1</sup> të pozicionojë praktiken kritiko refleksive e cila aktualisht dhe potencialisht në mënyrë emancipuese i kalon dhe i tejkalon matricat ideologjike simboliko materiale ndërshqiptare. Qasja në mendimin e Rawlsit përqendrohet në qëndrimin si vijon: Projekti i liberalizmit politik, praktikave kritiko refleksive si dhe çështjes së intelektualeve dhe sferës publike në truallin shqiptarë në përgjithësi pamjaftueshëm i qaset. Për shkak të vetëm se koncepti politik liberal në fund të fundit mbetet peng dhe i kufizuar sa i përket konceptit «politik» dhe përgjegjësisë etiko politike në kontekstin e projektit të lirisë dhe barazisë.

---

<sup>1</sup> Debati në këtë tekst u qaset temave të ndryshme të cilat Rawlsi I ka shtjelluar në tre librat e tij: John Rawls, *The Law of Peoples* (Cambridge, MA: Harvard University Press, 2001), John Rawls, *Political Liberalism* (New York: Columbia University Press, 1993), John Rawls, *A Theory of Justice* (Oxford: Oxford University Press, 1972).

Përkundrazi kjo assesë nuk don të thotë se duhet teorinë dhe mendimin e Rawlsit *a priori* ta mënjanojmë dhe ta marginalizojmë. Kësaj teorie duhet ti qasemi nga aspekti kritik sepse ajo paraqitet si gur themel i mendimit të vonshëm liberal demokratik, për shkak se mendimet e tilla mbi lirinë dhe barazinë paraqiten gjithherë si çështje urgjente. Pse duhet ti shkoj pas, jashtë dhe /apo mos të takohemi me Rawlsin duke e kthyer kështu çështjen politike në qendër të vëmendjes, kurse përgjegjësin etiko politike serish ta konceptojmë në aspekt që ai të kthejë premtim emancipues të fuqishëm, kur behet fjalë për projektin e lirisë barazisë dhe autonomisë si bashkësi themelore politike e projektit demokratik dhe të mirës individuale dhe kolektive ?

Pjesa e parë e tekstit prezanton shikim të shkurtër dhe qasje në procesin e vijueshmërisë së mendimit politik kosovarë, duke u marrë me mungesat në veçanti sa i përket angazhimit të intelektualëve në sferën publike dhe bashkësi politike që veprojnë brenda paradigmes liberale ose do të donin të veprojnë në drejtim të sajë. Në lidhje me këtë tematikë e duke u nisur nga debati në mes të Rawlsit dhe Habermasit, do të qasem dhe disa koncepteve të akceptimit progresiv të liberalizmit në veprat e Chantal Mouffe dhe William E. Connolly.<sup>2</sup> Nga ai lloj diskursi i koncipuar poashtu është paramenduar shema e impresionuar nga stërvitjet mendore lakaniene dhe postlakaniene,<sup>3</sup>

<sup>2</sup> Shiko Chantal Mouffe, "Democracy, Power and the "Political", u *Democracy and Difference: Contesting the Boundaries of the Political*, (Princeton, New Jersey: Princeton University Press, 1996), Chantal Mouffe, *The Democratic Paradox* (London: Verso, 2000), Chantal Mouffe, *The Return of the Political* (London: Verso, 1993); poashtu dhe William E. Connolly, "The Complexity of Sovereignty," në *Sovereign Lives: Power in an Era of Globalisation*, ed. Jenny Edkins, Pin-Fat, Véronique Pin-Fat i Shapiro, Michael J. (New York: Routledge, forthcoming, 2004), William E. Connolly, *The Ethos of Pluralisation* (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1995), William E. Connolly, *Identity/Difference: Democratic Negotiations of Political Paradox* (Ithaca: Cornell University Press, 1991), William E. Connolly, *Politics and Ambiguity* (Wisconsin: University of Wisconsin Press, 1987).

<sup>3</sup> Për më tepër shiko , Jacques Lacan, *Ecrits: A Selection*, (New York: W.W. Norton & Company, 1982), Dany Nobus, ed., *Key Concepts of Lacanian Psychoanalysis* (London: Rebus Press, 1998)..

brenda se cilës munde te eksplikohen, te analizohen dhe te pozicionohen mbylljet e llojlojshme shqiptare e ne veçanti kosovare, apo depërtimet potenciale ne praktiken kritiko reflektuese te filozofeve, shkencëtareve dhe artisteve si intelektual te angazhuar ne sferën publike. Kjo lloj optike universale është me se e nevojshme për shkak te praktikimit te përgjegjesisë etiko politike dhe *ethosit* te kritikes radikale ndaj mekanizmave neoliberal te kolonializmit dhe etnonacionalizmit brenda matricave diskursive te udhëheqjeve partiake / udhëheqësive politike/ nder shqiptare.

### **Liberalizmi politik i Rawlsit – holizmi liberal ne mungesë të konceptit politik?**

Teoria e drejtësisë e Rawlsit si e drejtë qe bazohet në pohimin kantian mbi paritetin e te drejtës mbi te mirën, ku e drejta, paraqitet ne principin e drejtësisë pavarësisht nga konceptet partikulare te se mirës.

Kritika komunitare e teorisë se Rawlsit<sup>4</sup> dhënies se prioritetit te drejtës mbi te mirën, ne përgjithësi nënkupton ontologjinë atomistike. Kundrejt kësaj i bashkëngjitëm konstatimit te Shanea O'Neill se mendimi i Rawlsit duhet ta kuptojmë si holizëm liberal, megjithëse kjo ne tërësi nuk munde te mbrojnë nga kritiket komunitare.<sup>5</sup> Ne lidhje me lloje te posaçme te inkonzistences inherente (mendimi i Rawlsit ne këtë aspekt mundet lehtësisht të thyhet si i tillë) – siç është sprovë për izolim të aspekteve politike te moralitetit dhe përgjegjesisë nga tërësia e qasjeve morale, apo siç është shqyrtimi i kësaj problematike nëpërmes konceptit te reduktuar dhe te limituar politik .

---

<sup>4</sup> Si me eminentet do i cekim p.sh., Alasdair MacIntyre, *After Virtue: A Study in Moral Theory* (London: Gerald Duckworth & Co., 1981), Michael Sandel, *Liberalism and the Limits of Justice* (Cambridge: Cambridge University Press, 1982), Charles Taylor, *Sources of the Self: The Making of Modern Identity* (Cambridge: Cambridge University Press, 1989).

<sup>5</sup> Shiko, Shane O'Neill, "Tensions in Rawls's Liberal Holism," *Contemporary Political Studies* 1-2 (1994), fq. 740.

Kritika komunitare e përgjithësuar rrjedh ne kahje se teoria e drejtësisë se Rawlsit u nënshtrohet koncepteve atomistike dhe johistorike te subjektit, kolektivitetit, individues, bashkësisë, drejtësisë dhe te se mirës. Mirëpo, si rrjedhoje, përgjigjet e Rawlsit ne këto kritika vërtetojnë se konstrukti i tij kantian nuk është atomistikë, johistorik por e mban kahjen ne mes perfekcionizmit dhe skepticizmit duke e karakterizuar drejtësinë dhe te drejtën si çështje politike dhe jo si koncepte metafizike, duke e pranuar se identiteti, qasjet morale dhe koncepti i te se mirës janë pjesërisht te konstituuar historikisht, mirëpo duhet tu largohemi (rrime larg) kur behet fjale për përfaqësinë, zhvillimin politik dhe procedural te drejtësisë.<sup>6</sup> Kjo lloj mbrojtjeje e Rawlsit nga kritika nëpërmjet te liberalizmit politik posaçërisht te koncipuar edhe me tutje qëndron si princip qendror, prioritet i drejtësisë edhe pse e pranon se drejtësia dhe e mira janë komplementare, konstaton se çështja e moralit politik munde te ndahet lehtësisht nga trajtimet e tërësishme morale.<sup>7</sup> Nga ky qëndrim moraliteti ynë ka aspekt politik qe i përket rregullimit te strukturës themelore te shoqërisë, dhe aspekt jo-politik sa i përket dimensioneve te ndryshme te jetës sonë. Mu ne këtë pike dukshëm luhatet holizmi liberal i Rawlsit, duke zhveshur tezën mbi izolimin e moralit politik nga qëndrimet tona te tërësishme qofte për konceptet e drejtësisë qofte për konceptet e te mirës.

Para se gjithash, edhe atëherë kur e drejta proceduralisht është e koncipuar brenda shtetit liberal demokrat, nuk qëndron konstatimi se është ai shtet e me te dhe proceduara, neutrale dhe joanësore sa i përket koncepteve te ndryshme substantivë te se mirës. Qytetaret nuk janë lojal njëfarë forme abstrakte te drejtës procedurale gjegjësisht demokracisë por mishërimit te tyre historiko kulturor.<sup>8</sup> Aspak nuk është e rastësishme qe, ne shtetin demokratik me histori dhe territor te caktuar qytetaret te mos identifikohen me bashkësi politike te caktuar e cila do te mund tu mishërojnë te drejtën dhe demokracinë atyre si qytetareve te vet. Kësi qytetaresh «antipatriotik» nuk janë ndoshta kundër demokracisë liberale ose te drejtës procedurale si te

---

<sup>6</sup> John Rawls, "Justice as Fairness: Political Not Metaphysical," *Philosophy and Public Affairs* 14 (1985).

<sup>7</sup> O'Neill, "Tensions in Rawls's Liberal Holism", fq. 743.

<sup>8</sup> Ibid., fq. 746.

tille, por konkretisht kundër diçkahit që në Kosovë do të duhet të quhej demokraci apo akceptim i të drejtës, qytetarisë, të mirës participimit brenda Kosovës si bashkësi politike. Në atë rast liberalizmi politik është i kapshëm poqese shteti i jep privilegj apo e mbështet qytetaret «patriotik» të predestinuar ndaj atyre «antipatriotik».

Është shumë me rëndësi të shihet se çka ndodhe kur nuk ekziston konsenz mbi atë të cilin e mbështet shumica e madhe e qytetareve aktiv politikisht dhe qytetareve «patriotik»? Çka ndodhe kur qytetari nuk e ndien Kosovën si bashkësi politike, por në të kundërtën ndien Kosovën si territor dhe si kulturë? Liberalizmi demokratik është jokompatibil me kapjen joliberalë të akceptimeve morale të cilët p.sh. tek në rrjedhin nga matrica ideologjike e matricave etnonacionaliste. Përpos kësaj, poqese ata të cilët nuk e ndiejnë përkatësinë ndaj Kosovës në mënyrë jokonvencionale dhe jokompatibile me matricat neokolonialiste të UNMIKut që u ofrohet si opsion i dytë? A ekziston rruga e tretë? Morali politik nuk është vetëm çështje e përkatësisë, por është i tëri *modus vivendi* ku e drejta dhe mirësia, individualja dhe kolektivja ndërlidhen aq shumë sa që shteti liberal i Rawlsit nuk është i mundur jo vetëm në Kosovë por as atje ku religjioni për çështje të abortimit i ndanë qytetaret në liberal dhe joliberal.<sup>9</sup> Çështje të tilla akute siç është çështja e ndjenjës territoriale, qytetare, kulturore /dhe apo /historike ndaj Kosovës tregon se nuk mund të izolohet aspekti politik i moralit apo akceptimi i të drejtës dhe aspekteve tjera. Me fjale tjera, dimensionin bëhet politik atëherë kur mbështjell tërësinë, sepse po ai është i fshehur nga fantazmat simboliko/materiale apo edhe ndaj emancipimit për rreth nesh.

Sa i përket holizmit liberal të Rawslit mund të konstatojmë se ai e lën pas dore çështjen e solidaritetit si lidhje politike, çështje po aq të rëndësishme për modelin participues të bashkësisë politike i cili nënkupton sferën publike vibruese, e që janë po aq të rëndësishme edhe për drejta individuale.<sup>10</sup> Në procedurën e Rawslit thjesht, nuk ekziston teoretizimi detaj i sferës publike dhe participimit të thellë

---

<sup>9</sup> Ibid., fq. 747-8.

<sup>10</sup> Posaçërisht është interesante kritika e Rawslit të cilën, për këtë dhe çështje tjera e bënë Chantal Mouffe në veprën e vet Mouffe, *The Return of the Political*..

brenda te shoqërive pluraliste demokratike. Nga kjo rrjedh debati ne mes te Rawslit dhe Habermassit ku insiston ne modelin e qytetarisë vetëqeverisëse me ç'rast qytetaret merren me te mirën e përgjithshme ne një ane dhe vendosjes se institucioneve te se drejtës dhe mbajtjen e atyre institucioneve qe mbështesin vlerën efektive te cilat ata u garantojnë ne anën tjetër.<sup>11</sup> Te gjitha konstatimet morale gjinden para një pikëpyetjeje te madhe sepse nuk dihen paraprakisht se a janë ato konstatime qe dalin nga morali politik apo jo. Çështja mbi kufirin e te drejtës dhe te mirës duhet ne mënyrë konstante te rishqyrtohet ne debate te hapura demokratike e qe janë te nënvizuara me moralitetin tone politik, prej te cilave ne fund te fundit nuk munde te iket sepse moraliteti ynë dhe me te lidhshmëria e konceptit te drejtës dhe te mirës gjithherë është e nënvizuar mu nga ai moral ynë politik. Fakti nga i cili duhet te iket është pikërisht ikja e Rawslit nga debati i koncepteve te përgjithshme mbi moralin, mirëpo duhet njëkohësisht te përqendrohemi ne prioritetin e te se drejtës, me ndihmën e praktikës demokratike ne mënyrë kritike dhe refleksive duke i rishqyrtuar qasjet fundamentale te pas shpinës sonë, jo vetëm te moralit politik por edhe te drejtës si përgjegjësi etiko-politike dhe prakes se intelektualit ne sferën publike si dhe shqyrtimit dhe rishqyrtimit demokratik. Kjo d.m.th. Se ne projektet qe merremi për lirinë dhe drejtësinë, barabarsin dhe te mirën duhet te ndalojmë te izolojmë moralin politik dhe ate vetëm «politik» ne mënyrë te njëjtë si e izolon Rawlsi ne shqyrtimin e vete liberal te drejtës.

Kontribut te posaçëm këso lloj qasjeje ka dhëne Chantal Mouffe ne teoretizimin vetanak te demokracisë radikale participuese plurale duke u fokusuar ne prioritetin e te se drejtës dhe se mirës por poashtu barazinë dhe te mirën si asaj individuale poashtu dhe kolektive.<sup>12</sup> Si ajo poashtu William E. Connolly insistojnë ne marrëdhënien kritiko-refleksive ndaj asaj politike si dimension i përhershëm i antagonizmit dhe agonisë qe është prezent ne shqyrtimet demokratike ku ai

---

<sup>11</sup> Shiko; Kenneth Baynes, *The Normative Grounds of Social Criticism: Kant, Rawls, and Habermas* (New York: State University of New York Press, 1991).

<sup>12</sup> Shiko; Mouffe, "Democracy, Power and the "Political"", Mouffe, *The Democratic Paradox*, Mouffe, *The Return of the Political*,

moment nuk nënshtrohet ne mënyrë totalitare.<sup>13</sup> Përkundrazi aty behet fjale për kultivimin e etnosit te kritikes radikale dhe pashtersin e pluralizmit te mendimeve, identifikimeve dhe veprimeve, formave dhe mënyrës se jetës ne ato te pjesërishme, konteksteve reale ekzistuese shoqërore dhe kulturore,<sup>14</sup> siç është shembulli i Kosovës se ne cilën formë do te energjizohet sfera publike dhe participimi demokratik ne mënyrë qe mos te «zhysin» ate politik e duke luftuar për vlerat universale te mirës dhe te drejtës, lirisë dhe barazisë.<sup>15</sup>

### Subjekti në "pritje"

Dëshiroj qe shkurtimisht te lidhem me shemën e cila është si shtojce 1., për te ju qas asaj dhe ne mënyrë te vazhdueshme te lëvizim ne katër dimensione komplekse te kahjes si domosdoshmëri për të kuptuar premisat që janë më se të nevojshme, në mënyrë që ti zhgoglisim mendimet e Rawlsit. Mirëpo momenti i kahjes se vazhdueshme paraqet *conditio sine qua noni* një marrëdhënie kritike dhe emancipuese ndaj diskursit /praktikes intelektuale i cili duhet brenda te sferës publike te ballafaqohet me përgjegjësit etiko-politike te cilat na paraqesin barriere momentale ne kontekstin e kolonializmit neoliberal dhe etnocentrizmit ne Kosove. Ne kontekstin hierarkik me produktive janë gjithsesi mendimet teorike te Mouffese apo te Connolyt, poashtu dhe mendimtarëve siç janë Cornelius Castoriadis dhe Pierr Bourdieu.<sup>16</sup> Si vegla heuristike janë edhe qasjet qe shpien

---

<sup>13</sup> Shiko Connolly, *The Ethos of Pluralisation*, Connolly, *Identity/Difference: Democratic Negotiations of Political Paradox*.

<sup>14</sup> Connolly, *The Ethos of Pluralisation*.

<sup>15</sup> Étienne Balibar, "Subjection and Subjectivation," në *Supposing the Subject*, (London: Verso, 1994).

<sup>16</sup> Shiko me shume në: Cornelius Castoriadis, *The Imaginary Institution of Society* (Cambridge: Polity Press, 1987), Cornelius Castoriadis, *Philosophy, Politics, Autonomy: Essays in Political Philosophy*, ed. David Ames Curtis (Oxford: Oxford University Press, 1993), Cornelius Castoriadis, dhe Curtis, David Ames, *Political and Social Writings: Recommencing the Revolution: From Socialism to the Autonomous Society* (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1993).; Pierre Bourdieu, *In Other Words: Essays Towards a Reflexive*

deri te mendimi poststrukturalist e posaçërisht postlacanizmi dhe postmarksizmi qe ka rrjedh mu ne këto hapësira.<sup>17</sup>

Te marrim shembull konkret subjektin tipik ne kontekstin kosovar i cili ka dalë nga lufta, e qe ka kaluar traumën dhe i cili jeton ne fukarallëk, pra, ushtari i demobilizuar i UÇK-se, i cili është ende në pritje për deri sa firma ne te cilën ka punuar pret ne privatizim dhe investime te huaja, apo gruan e te humburve qe shkon ne identifikim te afërmeve te vet dhe pret te kthehet ne shtëpi te vet ne te cilën nuk mundet te kthehet!. Ajo/ai, pra, te gjithë subjektet ne «pritje» janë subjekte tipike kosovare e qe janë te ekspozuar, nënçmimit deri ne palcë, traumës gjithëpërfshirëse, histerisë, apatizmit, padrejtësisë dhe fukarallëkut, e qe është si pikë referuese ne pjesën e djathte te fushës. Ndaj atij/asaj duhet te veprohet ne emancipimin shpresëdhënës te drejtës dhe mirës, lirisë dhe barazisë, kurse ndaj atij subjekti, intelektualet duhet te kryejnë detyrën e vete, te «zbulojnë» modelin e diskursit praktik ne sferën publike. E poqese merremi vetëm me mendimin e Rawlsit atëherë do te jemi te kufizuar me një ose dy, nga katër dimensionet te shemës, e ashtu do te humbet shpresa emancipuese. Sepse intelektuali ne aso rrethanash ( ne hapësirë absolutisht te traumatizuar dhe te vobekte) duhet te jene analitik dhe si i tille te lëvizë neper te katër fusha/modele. Subjekti «ne pritje» pret zgjidhje nga ajo suate, suate te cilën munden ta zgjedhin ne

---

*Sociology* (Stanford: Stanford University Press, 1990), Pierre Bourdieu, *Language and Symbolic Power*, ed. Joh B. Thompson (Cambridge: Polity Press, 1992), Pierre Bourdieu, *The Logic of Practice*, prev. Richard Nice (Cambridge: Polity Press, 1990), Pierre Bourdieu i Wacquant, Loic W.D., *An Invitation to Reflexive Sociology* (Chicago: University of Chicago Press, 1992).

<sup>17</sup> Rastko Močnik, "The Balkans as an Element in Ideological Mechanisms," në *Balkan as Metaphor: Between Globalization and Fragmentation*, (Cambridge, MA: The MIT Press, 2002).; Slavoj Žižek, *Manje ljubavi - više mržnje!*, (Beograd: Beogradski krug, 2001), Slavoj Žižek, *Tarrying with the Negative: Kant, Hegel, and the Critique of Ideology, Post-Contemporary Interventions* (Durham, USA: Duke University Press, 1993), Slavoj Žižek, *The Ticklish Subject: The Absent Centre of Political Ontology* (London: Verso, 2000).; Renata Salecl, *Protiv Ravnodušnosti* (Zagreb: Arkzin, 2002), Renata Salecl i Slavoj Žižek, ed., *Gaze and Voice as Love Objects* (Durham, USA: Duke University Press, 1996).



aspektin e sferës publike, ku intelektualët me ndikimin e vete në «te Zotet e politikës» me empati dhe me marrëdhënie pozitive ndaj procesit munde të lëvizin gjerat në drejtim të duhur, me c rast subjektet «në pritje» munde të shndërrohen në aktere aktiv të emancipimit. Për të ardhur në përfundim të praktikës kritiko-refleksive ndaj intelektualit i cili do të gjallërojë përgjegjësin etiko-politike në sferën publike, është e domosdoshme që me logjike të unazës të zhveshim logjiken e mekanizmave ideologjik në rregullimet simbolike të pushtetit që na rrethon. Rawlsi dhe mendimi politik i tij munde të na shërbejë si lloj i udhërrëfyesit por jo edhe i vetmi! Në këtë lloj praktike në të cilën nuk mundet me të «pritet».

#### LITERATURA:

- Balibar, Étienne. "Subjection and Subjectivation." Në *Supposing the Subject*, London: Verso, 1994.
- Baynes, Kenneth. *The Normative Grounds of Social Criticism: Kant, Rawls, and Habermas*. New York: State University of New York Press, 1991.
- Bourdieu, Pierre. *In Other Words: Essays Towards a Reflexive Sociology*. Stanford: Stanford University Press, 1990.
- . *Language and Symbolic Power*. Uredio by John B. Thompson. Cambridge: Polity Press, 1992.
- . *The Logic of Practice*. Preveo Richard Nice. Cambridge: Polity Press, 1990.
- Bourdieu, Pierre, i Wacquant, Loic W.D. *An Invitation to Reflexive Sociology*. Chicago: University of Chicago Press, 1992.
- Castoriadis, Cornelius. *The Imaginary Institution of Society*. Cambridge: Polity Press, 1987.
- . *Philosophy, Politics, Autonomy: Essays in Political Philosophy*. Oxford University Press, 1993.
- Castoriadis, Cornelius, Curtis, David Ames. *Political and Social Writings: Recommencing the Revolution: From Socialism to the Autonomous Society*. Minneapolis: University of Minnesota Press, 1993.

- Connolly, William E. "The Complexity of Sovereignty." Në *Sovereign Lives: Power in an Era of Globalisation*, New York: Routledge, 2004.
- . *The Ethos of Pluralisation*. Minneapolis: University of Minnesota Press, 1995.
- . *Identity/Difference: Democratic Negotiations of Political Paradox*. Ithaca: Cornell University Press, 1991.
- . *Politics and Ambiguity*. Wisconsin: University of Wisconsin Press, 1987.
- Lacan, Jacques. *Ecrits: A Selection*. New York: W.W. Norton & Company, 1982.
- MacIntyre, Alasdair. *After Virtue: A Study in Moral Theory*. London: Gerald Duckworth & Co., 1981.
- Močnik, Rastko. "The Balkans as an Element in Ideological Mechanisms." Në *Balkan as Metaphor: Between Globalization and Fragmentation*, Cambridge, MA: The MIT Press, 2002.
- Mouffe, Chantal. "Democracy, Power and the "Political"." Në *Democracy and Difference: Contesting the Boundaries of the Political*, Princeton, New Jersey: Princeton University Press, 1996.
- . *The Democratic Paradox*. London: Verso, 2000.
- . *The Return of the Political*. London: Verso, 1993.
- Nobus, Dany, uredio. *Key Concepts of Lacanian Psychoanalysis*. London: Rebus Press, 1998.
- O'Neill, Shane. "Tensions in Rawls's Liberal Holism." *Contemporary Political Studies* 1-2 (1994), fq. 740-50.
- Rawls, John. "Justice as Fairness: Political Not Metaphysical." *Philosophy and Public Affairs* 14 (1985), fq. 223-51.
- . *The Law of Peoples*. Cambridge, MA: Harvard University Press, 2001.
- . *Political Liberalism*. New York: Columbia University Press, 1993.
- . *A Theory of Justice*. Oxford: Oxford University Press, 1972.
- Salecl, Renata. *Protiv ravnodušnosti*. Zagreb: Arkzin, 2002.
- Salecl, Renata, i Žižek, Slavoj, ur. *Gaze and Voice as Love Objects*. Durham, USA: Duke University Press, 1996.
- Sandel, Michael. *Liberalism and the Limits of Justice*. Cambridge: Cambridge University Press, 1982.

- Taylor, Charles. *Sources of the Self: The Making of Modern Identity*. Cambridge: Cambridge University Press, 1989.
- Žižek, Slavoj. *Manje ljubavi - više mržnje!*. Beograd: Beogradski krug, 2001.
- . *Tarrying with the Negative: Kant, Hegel, and the Critique of Ideology, Post-Contemporary Interventions*. Durham, USA: Duke University Press, 1993.
- . *The Ticklish Subject: The Absent Centre of Political Ontology*. London: Verso, 2000.

## VROJTIME DHE MËNDIME TË PËRMBLEDHURA MBI SHTETIN E KOSOVËS\*

**Dr. Esat Stavileci**

*Në mes të deklarimit të Këshillit të Sigurimit dhe mbledhjes së rradhës së Grupit të Kontaktit*

Mbledhja shumë e pritur e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "u kurorëzua" me hapjen e "dritës së gjelbër" bisedimeve për Kosovën dhe u shoqërua me një deklaratë e cila, në thelb, "la shumë për të kuptuar" në lidhje me statusin e Kosovës. Nga shumë anë u tha se ajo shënon për Kosovën një ngjarje historike. Padyshim, bëhet fjalë për një "kthesë për historinë më të re politike të Kosovës", por jo edhe për një vendim historik i cili do ta "kurorëzonte atë kthesë". Nga ky çast vërtetë është vështirë për të parashikuar statusin, ndoshta për faktin se, megjithatë, në deklarimet në lidhje me mbledhjen e Këshillit të Sigurimit, së paku, tash për tash, bëhet fjalë jo për statusin përfundimtar, por për statusin e ardhshëm të Kosovës. Është pritur që deklarata të mbështes rekomandimet e z. Kai Eide, kështuqë tash rekomandimet e tij, në fakt, u shndërruan në rekomandimet e Këshillit të Sigurimit për Grupin e Kontaktit i cili, siç është paralajmëruar, do të mbledhet me 2 nëntor në Uashington. Sipas një logjike, duhet pritur që edhe rekomandimet e Grupit të Kontaktit të "mos lëvizin shumë nga parimet" e përgjithshme të cilave u mungon vetëm përlligjja në qëndrime.

### **Euforia që mund të deangazhojë**

Në një shkrim të mëhershëm kisha tërhequr vërejtjen se duhet të ruhemi nga euforia që "na ka mundur". Pas mbledhjes së Këshillit të Sigurimit ajo veçsa është rritur, me deklarimet se veç "është diçka" që "pritet të ndodhë" ose të "jetë më vonë". Në këtë shkrim vetëm se po e

---

\* Nga interneti i ka përzgjedhur Xhavit Shaqiri, Sekretar i SHKSH Migjeni në Lublanë

përforcoj atë vërejtje, gjykuar përmbajtjen e Deklaratës Presidenciale dhe rekomandimet e saj, duke medituuar për modalitetet e materializimit të saj në qëndrimet e Grupit të Kontaktit. Nga më shumë të panjohura në lidhje me statusin e Kosovës, dy sikur zhvishen dhe bëhen të qartësuar. E para, çështja e Kosovës, siç shprehet Deklarata, nuk hyn në fazën përfundimtare të përcaktimit të statusit të saj, po në “fazën e rradhës së pranisë ndërkombëtare”, po sikurse që ishte shprehur z.Kai Eide, në raportin e tij për Kosovën. Pra, nuk bëhet fjalë për përcaktimin e “statusit përfundimtar”, por për përcaktimin e “statusit të ardhshëm të Kosovës”, fakt që flet se Kosova edhe për një kohë të cilën është shumë vështirë ta parashikosh, do të ballafaqohet me kufizimet e qeverisjes institucionale. Pra, përfundimi bëhet i qartë. Kosova do të ketë një status kalues, me “elemente të shtetit”, por me gjasë, nuk do të jetë shtet me “atributet e plotë të tij”. E dyta, vendosja e statusit të ardhshëm të Kosovës nuk do të shoqërohet edhe me vendosjen e sovranitetit të plotë të Kosovës, sepse nga theksimet në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit dhe në Deklaratën Presidenciale, po sikurse edhe në raportin e z.Kai Eide, sikur sugjerohet një “sovranitet i kufizuar” që vetvetiu do të diktonte edhe një prani ndërkombëtare, fakt që flet se statusi i ardhshëm i Kosovës nuk do të përmbillet me “përligjjen e plotë të kërkesave të popullatës shumicë në Kosovë”, por sipas të gjitha gjasave, me qëndrime ekuivoqe, për të “joshur palët e interesuara”, me porosinë se asnjëra nga to nuk do të dalin as fituese dhe as humbëse nga negociatat, me qëllim që edhe njera edhe tjetra “të kenë mundësinë” jo vetëm të arsytimit, por edhe të “shfajësimit para popullatës së vet”. Këtyre dy të njohurave për Kosovën, mund t’i bashkangjitet edhe një e tretë, se diskutimet për Kosovën, në pjesën më të madhe, do të zhvillohen me “lehtësimin e tyre” nëpërmjet një “diplomacie fluturuese”, se do të zgjasin disa muaj, me mundësinë e ndërprerjes së kohëpaskohshme të tyre dhe se do të përfundojnë me një “qëndrim të njëanshëm” të bashkësisë ndërkombëtare i cili “do t’iu imponohet palëve të interesuara” të cilat të nëjtin qëndrim do ta interpretojnë ndryshe para popullatës së vet, për të kualifikuar vetën si fituese, edhe pse ndërkombëtarët, qysh tash, me të madhe, theksojnë se nuk do të ketë as fitues dhe as humbës nga negociatat, pra se do të ketë një zgjidhje kompromisi që, çfarëdo qoftë ajo, më e papranueshme do të jetë për shqiptarët, për vet faktin se ata hyjnë shumë të hendikepuar

në negociata të imponuara prej bashkësisë ndërkombëtare, për shkak se institucionet e Kosovës ende nuk kontrollojnë gjithë territorin e Kosovës, sepse ende ato institucione janë të karakterit të përkohshëm, sepse ende në to nuk është bartur një numër i madh i kompetencave, sepse Kosova ende përthekohet me Rezolutën 1244 dhe Kornizën Kushtetuese, sepse Kosova ende nuk ka ndërtuar një rend juridik dhe ekonomik të vetin, e tjera e tjera.

### **Privim i parimit të vetëvendosjes**

Megjithatë, më e njohura ndër të panjohurat është se Kosova po privohet nga mundësia që çështja e saj të zgjidhet në bazë të parimit të vetëvendosjes dhe, pa marrë parasysh deklaratimet e zyrtarëve të Kosovës se pavarësia nuk do të negociohet, ajo në fakt do të mund të ndodhë, sepse në tavolinën e bisedimeve nuk do të gjindet një variant i vetëm, pavarësia e plotë, si kërkesë e shqiptarëve të Kosovës, por edhe varianti serb për një zgjidhje në mes të autonomisë dhe pavarësisë ose, siç shprehet regjimi i Beogradit, "më shumë se autonomi dhe më pak se pavarësi" që, si do që ta marrësh, fsheh tendencën për ta ruajtur sovranitetin mbi Kosovën. Pra, ajo që kërkohet prej liderëve tanë është që "ta mbajnë fjalën". Sado që pala shqiptare deklarohej se është e përgatitur për bisedime dhe sado që është optimiste se nga ato do të dalë me "pavarësi në xhep", ia vlen që të tregohet shumë e vëmendshme për hapat që do të ndërmerren, të cilët kërkojnë mençuri, por edhe maturi, dije profesionale, por edhe formësim politik, po sikurse edhe urti filozofike, por edhe shkathtësi diplomatike.

### **Prej Shqipërisë kërkohet rol aktiv dhe qëndrim konstruktiv**

Edhe pse kohëve të fundit nga Shqipëria sikur "trimërojnë zërat" e artikuluar në lidhje me çështjen e Kosovës dhe të ardhmen e saj në mbështetje të pavarësisë së Kosovës, ministri i jashtëm shqiptar vazhdon që vazhdon me të vetën, duke propaganduar pavarësinë e kushtëzuar për Kosovën, si zgjidhjen më të mirë, më parë në Uashington e së fundi në Bruksel, duke dëshmuar përkushtimin e të qenët "i moderuar", çfarë po kërkon që të jetë bashkësia

ndërkombëtare prej tij dhe prej Shqipërisë. Duke mos dashur që edhe një herë tjetër ti kthehem Mustafajt dhe konceptit të tij, do të nënvizoja vetëm atë se prej Shqipërisë kërkohet rol aktiv dhe qëndrim konstruktiv në lidhje me Kosovën dhe të ardhmen e saj. Prej Shqipërisë nuk kërkohet që të jetë “e moderuar”, por kombëtarisht e mobilizuar në lidhje me të ardhmen e Kosovës.

### **Me hapjen e procesit asgjë nuk mund të quhet e përfunduar**

Pas mbledhjes së Këshillit të Sigurimit, zyrtarë në Kosovë veçsa nuk “festojnë”. Të konsiderosh në këtë fazë të rrjedhave se “çdo gjë ka përfunduar” në të mirën e Kosovës është më shumë se një miopi politike. Bashkësia ndërkombëtare kishte mundësinë për ta zgjidhur çështjen e Kosovës edhe më heret, por mungonte gatishmëria e saj. Mbështetur në neglizhimet e saj për t`i çuar proceset deri në fund, nuk duhet të anashkalohet mundësia e zvarritjes së procesit deri edhe te bllokimi i tij, duke pasur parasysh jo vetëm konceptet diametralisht të kundërta të palëve të interesuara, por edhe kryeneçësinë serbe për të shantazhuar procesin, duke llogaritur në parimin se nuk do të vendoset asnjë zgjidhje e papranueshme për palët.

### **Vakuum i madh në mes të asaj që po bëhet dhe asaj që pritet të ndodhë**

Duhet të përmbushet një vakuum i madh i krijuar në mes të asaj që po bëhet në Kosovë dhe asaj që “pritet të ndodhë” me të ardhmjen e saj. Po qe se do të shprehej me një fjali gjendja e tashmë në Kosovë, ajo do të mund të përshkruhej se koha po ikën, ndryshimet po ndodhin, por rezultatet nuk po shihen. Nuk mund të presim një konsensus të jashtëm për Kosovën, pa u vendosur një konsensus i brendshëm për të. Të bësh shtetin është shumë më shumë se të deklarohesh për të. Në rrugëtim e sipër, edhe vetë duhesh të bëhesh pjesë e përpjekjeve për ta jetësuar një vullnet të nëpërkëmbur me shekuj. Vërtetë është kohë e fundit për të kuptuar se “nuk ka më kohë për të blerë” për interesa partiake dhe të pjesshme, por për t`u bashkuar në interesa kombëtare dhe të përgjithshme. Vetëm ata që ecin me kohën e fitojnë kohën. Kjo është arsyeja që në sfondin e titullit të librit tim të fundit, me titull

Kosova dhe çështja shqiptare në udhëkryqet e kohës, është vënë ora që tregon akrepat tek 11 shi dhe 12 shi. Pra, për shqiptarët është pesë në 12 ose 12 pa pesë. Pesë minuta, të shprehem figurativisht, janë shumë të gjata po qe se mendohen të kalohen në pritje, ndërsa janë shumë të shkurtëra nëse përmbushen me ngrehjen e kulmit. Në të kaluarën kemi shembur shumë themele, pa ngrehur kulme. Historia u përsëritet të gjithë atyre që nuk mësojnë prej saj. Vërtetë populli dhe kombi shqiptar kanë histori shumë të hidhurar që ta harrojnë.

### **Pavarësia e Kosovës si udhë e daljes së saj nga rrethi i mbyllur**

Nuk duhet të krijohen iluzione se me pavarësinë e Kosovës do të zgjidhen menjëherë dhe në mënyrë automatike, një numër i madh i problemeve me të cilat përballet Kosova sot. Pavarësia mund t'i hapë proceset dhe t'i krijojë kushtet dhe mundësitë për zhvillimin e tyre. Janë, më së paku, dy arsye që shtrojnë nevojën "e marrjes me Kosovën" dhe të ardhmen e saj sot:

*e para*, përcaktimet ende të paqarta rreth statusit të Kosovës dhe *e dyta*, nevoja e rirreshtimit të forcave në Kosovë dhe angazhimi i gjithë resursit krijues "për të ecur rrugës" të cilën e ka përzgjedhur populli për të ardhmen e Kosovës, e cila nuk do të jetë as e lehtë dhe as e pamundimshme.

1. Edhe pse bashkësia ndërkombëtare sikur "asnjëherë më shumë se gjatë këtij viti nuk ka qenë e interesuar rreth procesit politik dhe çështjes", siç shprehet ajo, "të statusit final të Kosovës", krijohet përshtypja, megjithë "ravijëzimin e kornizave të ardhmënisë së Kosovës" se ajo, në fakt, sikur ende është në dilemë "nëse zgjidhja e statusit të Kosovës do të mund të kishte efekte zinxhirore dhe do të prodhonte jostabilitet në vendet e tjera të Ballkanit"? Pyetja do të mund të shtrohej edhe ndryshe: "Çfarë ndikimi do të mund të kishte ajo në pjesë të tjera të botës dhe në politikën ndërkombëtare"? Pa i pritur gjykimet e kohës, mendojmë se, duke qenë "çështje më vete", Kosova nuk do të mund "të prodhonte jostabilitet në vendet e tjera të Ballkanit dhe se ndikimi do të mund të ishte i favorshëm për pjesët e tjera të botës dhe politikën ndërkombëtare.



2. Kosova, e lënë, për kohë të gjatë, në "sallat e pritjes", sot ballafaqohet me "trysni në rritje" për hapjen e bisedimeve për statusin e saj. Statusi ende i paqartë i Kosovës ka prodhuar pasoja në shumë fusha, nga të cilat do të veçojmë problemet e zhvillimit ekonomik dhe pamundësitë e bashkëpunimit rajonal.
3. Përkufizimi i paqartë i mandatit të UNMIK-ut, për faktin se në Kosovë "nuk u vendos një protektorat ndërkombëtar" në kuptimin që njeh e drejta ndërkombëtare, megjithë zhvillimet në disa fusha, la të hapur çështjen e statusit të Kosovës dhe "e shtyri atë në pafund". Mirëpo, pikërisht këto dy momente ndoshta ndikuan që, megjithatë, sot të arrihet një "shkallë e konsiderueshme pajtimi" në mes të ndërkombëtarëve dhe vendorëve se status quoja është e paqëndrueshme ose, thënë ndryshe, se përcaktimi i statusit është "çelësi i hapjes së udhëve" për t'i zhvilluar proceset zhvillimore në Kosovë dhe, nëpërmjet tyre, për të ndikuar në stabilitetin e rajonit dhe më gjerë. Shtylla e parë dhe më e fuqishme e vendosjes së themelit të shtetit të Kosovës është njohja e së drejtës së vetëvendosjes së popullit të saj. Një parim, pothuajse i harruar, parimi i vetëvendosjes, "u riaktivizua në lëvizjet postkomuniste në Evropë në dekadën e fundit të shekullit të kaluar". Një analist yni me të drejtë u shprehej se "u riaktivizua", meqë gjatë luftës së ftohtë, sipas tij, që shpërfaqur mendimi se "me rrumbullakimin e sovranizimit juridiko-shtetëror", nga 1918-ta deri në fillim të shtatëdhjetave, "kishte pushuar nevoja për këtë parim". Mirëpo, më vonë ndodhi "sovranizimi postkomunist i popujve", i cili "u paraqit qoftë në formën e sovranizimit të plotë të shteteve të bllokut lindor, me daljen e tyre nga doktrina e "sovranitetit të kufizuar", qoftë nëpërmjet shpërbërjes të ish federatave komuniste, BRSS, RSFJ". Kështu ngjau që tri kategorive të mëdha rastesh "t'u njihet e drejta për vetëvendosje: rasteve të vetëvendosjes post-imperiale; rasteve të vetëvendosjes post-koloniale dhe rasteve të vetëvendosjes post-komuniste". Rasti i Kosovës "u gjind jashtë trekëndëshit", edhe pse ai, vështruar krahasueshëm, "do të mund të zgjidhej "në secilin prej këtyre proceseve".

4. Është thënë se rasti i Kosovës "bie ndesh me parimin e mosndryshimit të kufijve, edhe pse, ç'është e vërteta, Kosova kishte kufijë interfederalë në ish-Jugosllavi, po sikurse që u bë e qartë se kufijtë evropianë u ndryshuan: "ata të Helsinkit, me bashkimin e Gjermanisë; ata të Jaltës-me shpërbërjen e ish-BRSS-së dhe kufijtë e Versajës-me shkatërrimin e ish-RSFJ-së dhe ish-Çekosllovakisë". Ajo që do të duhej të qartësohej është se në rastin e Kosovës nuk mund të mbrohet regjimi i kufijve evropianë sipas Konferencës së Londrës (1913), sepse Kosova, në të vërtetë, bile kumullativisht, i plotëson të gjitha kushtet që popullit shumicë të saj t'i njihet e drejta për vetëvendosje. Ekzistojnë, së paku, tri argumente që mund të zërthehen gjerësisht. Po i theksojmë:  
*e para,* "se Kosova është aneksuar nga Serbia (1912) me okupimin ushtarak";  
*e dyta,* "se trajtimi i shtetit aneksist ndaj popullit të aneksuar ishte jo vetëm represiv, por edhe gjenocidal";  
*e treta,* "se populli i aneksuar, në mënyrë plebishitare është deklaruar për pavarësi, po sikurse edhe me rezistencën e armatosur (1997-99)".
5. Kosova "po ecën" nëpër standarde që i ka vendosur bashkësia ndërkombëtare. Standardet "sigurisht se synojnë një cak", por ato do të duhej që përfundimisht, si pjesë e një procesi të shtetbërjes, "të ndërlidheshin" jo me hapjen e negociatave për statusin e Kosovës, por me anëtarësimin e saj në mekanizmat ndërkombëtare. Ndryshe, disa prej standardeve nuk janë të përmbushura edhe nga shumë vende anëtare të Kombeve të Bashkuara, madje edhe nga disa prej tyre, anëtare të Këshillit të Sigurimit.
6. Mungesa e statusit është bërë peng i shumë zhvillimeve. Nuk e mendojmë se zgjidhja e statusit do të thoshte njëkohësisht zgjidhje të gjitha problemeve me të cilat ballafaqohet sot Kosova, por hapje dhe krijim të mundësive për t'i zhvillua ato "në drejtimin e duhur".
7. Në bërjen e pavarësisë kërkohet që "të kalohet në një rrugë". Në ecje e sipër, Kosova duhet të ndërtojë rendin e vet kushtetues dhe

ky është, sipas mendimit tim, çelësi kryesor me të cilin do të hapeshin proceset e shtetbërjes në Kosovë.

8. Në ecje e sipër, duhet të bëhet “bartja e plotë e pushtetit të UNMIK-ut ” në institucionet e përkohshme vetëqeverisëse, të cilat do të duhej që, më në fund “të shndërroheshin në institucione permanente dhe të patjetërsueshme”.
9. Në ecje e sipër, pushteti serb duhet që përfundimisht të heqë dorë nga “territorializimi i çështjes serbe në Kosovë” dhe krijimi i organeve paralele dhe enklavave në baza etnike.
10. Pavarësia e Kosovës paraqet sot një opsion “realisht të balancuar dhe në drejtpeshim përbrenda horizontit të kohës në Ballkan”. Ajo nuk paraqet “kurrfarë solucioni ekstrem, por është solucion i drejtpeshuar i kohës, me interes të thellë kombëtar, jo vetëm për kombin shqiptar, por edhe për kombin serb në Ballkan”.
11. Vështruar edhe në raport me kohën, proceset e shtetkrijimit përreth Kosovës, flasin në mënyrën më bindëse se Evropa sikur më herët “ka heqë dorë nga disa kanune” të saj në lidhje me formimin e shteteve të reja. Sot janë 34 shtete anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara me sipërfaqe më të vogël se Kosova, nga Vatikani 0,4 deri te Libani 10.452; sot janë 58 shtete, anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me popullsi më të vogël se Kosova, prej Vatikanit 1.000 deri te Mauritania 2.284.000; ndërkohë, 34 shtete, nga viti 1990-2002, janë pranuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.
12. Asnjë zgjidhje për Kosovën nuk mund të qëndrojë pa pëlqimin dhe vullnetin e popullit shumicë të Kosovës. Kosovën mund ta qeverisë dhe duhet ta qeverisë vetëm popullata e saj. Ajo popullatë këtë truall e ndien për të vetin, sikur që i ndien për të vetat edhe të gjitha pasuritë e atij trualli.
13. Edhe pse sikur “mbizotëron” pikëpamja se pavarësia është e vetmja zgjidhje e drejtë për Kosovën, ende qarkullojnë opsione të ndryshme për Kosovën dhe të ardhmen e saj dhe ato “shtrihen

prej vetadministrimit deri te pavarësia". Me të drejtë është thënë se "hapësira mes vetadministrimit dhe pavarësisë është bukur e gjerë" dhe se në të "mund të hyjnë një varg kushtëzimesh". Nga një numër kushtëzimesh që bën bashkësia ndërkombëtare për Kosovën është konceptuar modeli i "pavarësisë së kushtëzuar". Në vend se të jetë "e kushtëzuar" pavarësia mund të jetë "e mbikëqyrur" nga bashkësia ndërkombëtare. Kosova ndien nevojën për praninë ndërkombëtare në Kosovë, si lehtësuese e ndërtimit të shtetit në kuptimin demokratik, përfshirë aty të drejtat dhe liritë e pakicave dhe të grupeve etnike, marrëdhëniet ndërfqinjësore dhe integrimet rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

14. "Pëshpëritet" me të madhe se Këshilli i Sigurimit i OKB-së "do ta ketë fjalën e fundit" në lidhje me statusin e Kosovës, në vend se "t'i jepet" kjo e drejtë popullit të Kosovës, "siç parashikojnë vlerat dhe parimet demokratike", prandaj mund të ndodhë që roli i Kosovës "të jetë i kufizuar". Po qe se kjo do të ndodhë, atëherë në fakt, do të ndodhte, "suspendimi i të drejtës së popullit shqiptar për vetëvendosje", ndonëse ajo atij "do të duhej t'i takonte": qoftë "si e drejtë e vetëvendosjes kombëtare, qoftë "si e drejtë e vetëvendosjes së popullatës së territorit të individualizuar".
15. "Pëshpëritet" edhe për një ndikim "të shtuar të Bashkimit Evropian" në raport me Shtetet e Bashkuara. "Protektorati evropian" do të mund të shpinte kah reduktimi i rolit të Shteteve të Bashkuara në Kosovë. Administrimi i "tipit evropian" mund të kërcënojë me rrezikun e krijimit të një mentaliteti tjetër "vartësie" të Kosovës, nga ai që është vendosur gjashtë vjet më parë.
16. "Pëshpëritet" edhe për "pavarësinë pa sovranitet". Pavarësi ose ka ose nuk ka. Pavarësia pa sovranitet është "vendosje e kulmit" pa themelin në të cilin do të mund të mbahej ai. Vetëm atëherë kur mësojmë se ç'është, në të vërtetë, sovraniteti, do të kuptojmë se ç'është "pavarësia pa sovranitet". Sovraniteti është, siç shprehet Fjalori Politik i Oxfordit, "kërkesa për të qenë autoriteti i fundmë politik që nuk i nënshtrohet asnjë pushteti më të lartë përsa i përket marrjes dhe zbatimit të vendimeve politike". Në fakt, sovraniteti shpreh vetëqeverisjen e shtetit. Kohëve të fundit

“qarkullojnë pikëpamje” që përpiqen “të devalvojnë” rëndësinë e sovranitetit. Në to thuhet “se sovraniteti është një kategori historike, e lindur në kushte të caktuara, të ndryshme nga ato të sotme, prandaj nuk ka vlerë absolute” ose “se sovraniteti është një parim i vjetruar”. Nga teoria e shtetit janë më interes, së paku, këto dy njohuri të përgjithshme për sovranitetin.

*E para*, “kur një vend fiton sovranitetin shtetëror, kjo prodhon pasoja juridike e politike edhe në planin ndërkombëtar”, meqë “shtrohet njohja e shtetit të ri sovran nga ana e shteteve tjera”.

*E dyta*, “njohja e një shteti sovran nga të tjerët nënkupton edhe njohjen e qeverisë që është formuar në këtë shtet”. Pra, një përfundim i logjikshëm nga këto dy njohuri të përgjithshme për sovranitetin është shumë domethënës për të kuptuar atë si “palcën kurrizore të shtetit”.

17. Vetëm pavarësia e plotë e Kosovës do të mund të zgjidhte çështjen e territorit të saj, një element shumë i rëndësishëm i shtetit. Prandaj, bashkësia ndërkombëtare duhet të deklarohet në mënyrë shumë të qartë dhe jo në mënyrë ekuivoke në lidhje me territorin e Kosovës. Për ne ky paraqet problem qendror.
18. Mendohet sikur këtë e ka “qartësuar mirë” Grupi i Kontaktit. Ç’është e vërteta, Grupi i Kontaktit “ka qartësuar” se çfarë nuk do të ndodhë me Kosovën”, por jo edhe se “çfarë do të ndodhë” me te. Bashkësia ndërkombëtare, nëpërmjet të një numri parakushtesh “për negociatë”, sikur ka vendosur që të mos e vë në agjendë “pavarësinë e plotë”. Prandaj, në “ofertat e propozuara” të saj ka çështje të hapura. Përgjigjja në ato pyetje përbën sfidën më të madhe për Kosovën. Prandaj, ajo që do të mund t’u sugjerohej institucioneve të Kosovës është që të angazhohen që në një proces të mundshëm negociator për statusin e Kosovës, *së pari*, që “pozicioni politik i Serbisë në raport me Kosovën” si çështje e ndjeshme përfundimisht të mbyllet, faktikisht dhe juridikisht. Bashkësia ndërkombëtare do të duhej që, përfundimisht, të kundërshtojë skenarët serbë të shprehur nëpërmjet formulës “më shumë se autonomi, e më pak se pavarësi” që, në fakt, bazohen në konceptin e federatës, konfederatës ose unionit.

- së dyti*, "pozicioni i Shteteve të Bashkuara ndaj Kosovës, pas pavarësimit të saj të shërbej si një garanci për shtetin e ri të Kosovës".
- së treti*, "përmasat dhe mënyra e monitorimit ndërkombëtar" të rasteve të ndjeshme etnike në Kosovë të përcaktohen në përputhje me realitetin etnik në Kosovë.
19. Vendimi i bashkësisë ndërkombëtare do të duhej të kishte parasysh veçanërisht këto dy momente:
- se pari*, heqjen dore nga ideja e çfarëdo kushtëzimeve për pavarësinë.
- se dyti*, heqjen dore nga prolongimi i vendimit. Përcaktimi i bashkësisë ndërkombëtare për pavarësinë e Kosovës duhet të jetë i qartë, e jo në mënyrë ekuivoke, me mundësi për interpretime të ndryshme.
20. Pavarësia e Kosovës paraqet një zgjidhje "të drejtpeshuar të kohës", e jo një "kërkesë ekstreme" dhe "zgjidhje përfundimtare". Ajo, në fakt, paraqet një "zgjidhje kompromisi" në raport me synimet shekullore të shqiptarëve për të jetuar me një shtet. Janë shumë faktorë, historikë e politikë, të cilët e formësojnë dhe e fuqizojnë, në mënyrë burimore, statusin e pavarur të Kosovës dhe institucionalizimin politik të tij". Në mbyllje mund të thuhet se pala shqiptare duhet të formulojë qëndrim të qartë përse i përket statusit: Kosova duhet të jetë shtet i pavarur dhe i njohur ndërkombëtarisht dhe, së pari duhet të pranohet në OKB, e pastaj edhe në BE. Pala shqiptare duhet të bëjë të qartë nevojën për një prani ushtarake ndërkombëtare për të garantuar sigurinë e brendshme dhe për të mbikëqyrur kufijtë. Pala shqiptare duhet të këmbëngulë kundër imponimit të një zgjidhjeje "nga jashtë", e cila "nuk do të ishte e qëndrueshme" dhe nuk do t'i kontribuonte stabilitetit afatgjatë në rajon". Pala shqiptare duhet të jetë e kujdesshme ndaj sugjerimeve që do t'i bëjnë Shtetet e Bashkuara, duke pasur parasysh faktin se bashkësia ndërkombëtare prët nga Shtetet e Bashkuara që të shfrytëzojnë ndikimin në Prishtinë, po sikurse që prët nga Rusia që të ushtrojë ndikimin e saj në Beogradin. Institucionet vetëqeverisëse në Kosovë "duhet të jenë të vetëdijshme për shkallën e përgjegjësisë

që kanë për të ecur “në drejtimin e duhur drejt realizimit të vullnetit të popullit”. Rruga nëpër të cilën do të ecin nuk do të jetë e lehtë. Përkundrazi, e rëndë. Prandaj, duhet të mbledhin “rreth vetes” gjithë resursin krijues. Ato nuk duhet të “jetojnë në iluzione” se me pavarësinë e Kosovës vetvetiu do të zgjidhet një numër i madh problemesh me të cilat ballafaqohet sot Kosova. Me pavarësimin e Kosovës do të hapeshin proceset dhe do të krijoheshin mundësitë për vendosjen e reformave, si në ristrukturimin e ekonomisë, ashtu edhe në avancimin e demokracisë politike. Prandaj, ato do të duhej që prore të dëshmoreshin se janë të afta për të rritur kapacitetet vendimmarrëse, me synim ndërtimin e shtetit të ri të Kosovës.

*Përmbledhje e fjalës së tij në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, të mbajtur me 6 korrik 2005*

### **Vendet e sovranizuara nga ish-Jugosllavia duhet ta mbështesin pavarësinë e Kosovës**

Ato dinë më së miri se ç'farë pozite kishte Kosova si përbërës i ish-Federatës, prandaj do të duhej të njëhej edhe si përbërës i shpërbërjes së saj, me të drejtë për vetëvendosje dhe suksesion –

Shkas i drejtpërdrejtë i këtij shkrimi është një deklaratë e z. Dimitrij Rupel, kryesuesit të rradhës së OSBE-së, njëkohësisht ministrit të jashtëm slloven, gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, se “Sllovenia ende nuk ka qëndrim të qartë rreth statusit të Kosovës”. Nuk është vetëm Sllovenia që “ende nuk ka qëndrim të qartë”, por janë edhe Kroacia, Bosnjë e Hercegovina dhe Maqedonia, vende të sovranizuara nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë që ende nuk e “kanë bërë të qartë qëndrimin e tyre rreth statusit të Kosovës.

### **Indiferenca**

Me gjithë shkasin e drejtpërdrejtë të këtij shkrimi janë, më së paku, edhe dy arsye të tjera, që më shtynë të shtroj këtë temë: e

para, aktualiteti i saj, në kohën kur çështja e Kosovës gjindet "në buzë" të hapjes dhe të zhvillimit të diskutimeve për të; e dyta, indiferenca e republikave të ish-Jugosllavisë për të marrë një qëndrim ndaj statusit të Kosovës që, në mos asgjë tjetër, flet për mungesën e ndjenjës së korrektësisë ndaj një njësie federale të ish-Jugosllavisë, ndonëse jo me statusin e republikës me të cilën, siç thuhet, kanë krijuar dhe kanë ndarë "fatet e përbashkëta".

Askush nuk di më mirë për pozitën që kishte Kosova në ish-Jugosllavi se ç'dinë republikat e mëparshme të saj të cilat, mbi bazën e të drejtës për vetëvendosje, u sovranizuan dhe u krijuan si shtete të pavarura.

Shtirirja e kësaj teme sot dhe vendosja në një rrafsh e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë me statusin e Kosovës bëhet për shkak të ndikimeve të ndërsjella që kishin ato ndërmjet tyre, me mundësinë e ndikimit në përcaktimet në lidhje me statusin e Kosovës, nga njëra anë, për shkak se procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë filloi në Kosovë dhe rreth Kosovës, ndërsa nga ana tjetër, për arsye se çështja e Kosovës mu për shkak të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, sot paraqitet me një dimension të ri politik, por edhe konstitucional juridik e ndërkombëtar, me shumë interes për të marrë një qëndrim të drejtë ndaj statusit të saj.

Me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, Kosova si dhe shqiptarët që jetonin në hapësirën e saj, në territore ku përbënin shumicën, kanë pritur që objektivisht dhe realisht të paraqitën si subjekt të vetvetës, pra subjekt i vendosjes për fatin e vet në rrethanat e reja historike, në bazë të parimit të vetëvendosjes. Mirëpo, zhvillimet që ndodhën pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë nuk morën në konsideratë këtë parim në asnjërin prej rasteve me shqiptarët, as në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, as në Kosovën Lindore, as në Mal të Zi dhe para së gjithash, në Kosovë që, pa asnjë mëdyshje, paraqet përbërësin themelor të çështjes ende të pazgjidhur shqiptare.

### **Për çfarë flasin realitetet**

Kosova paraqet sot një rajon politiko-territorial të individualizuar në Ballkan. Është ky një fakt që nuk mund të injorohet, po sikurse që nuk mund të injorohet fakti tjetër për realitetin nacional-demografik të popullit të Kosovës që i kundërvihet çdo përpjekjeje për "ta paraqitur Kosovën" si një mjedis shumëetnik". Mirë iu tha z. Rupel, gjatë qëndrimit të tij të fundit në Kosovë se "Kosova është po aq multietnike



sa është edhe vetë Sllovenia”. Shtetet e sovranizuara nga ish-Jugosllavia e dinë më mirë se asnjë vend tjetër se Kosova në ish-Federatën multinacionale të Jugosllavisë kishte status të njësisë konstitutive, ndonëse jo edhe të republikës; ato e dinë më mirë se asnjë shtet tjetër se Kosova në ish-Jugosllavi kishte kufijtë e saj interfederalë që nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e saj, po sikurse që edhe kufijtë e jashtëm të ish-Jugosllavisë, nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës, fakte këto shumë të rëndësishme për të marrë një qëndrim të drejtë ndaj të ardhmes së Kosovës, mbi bazën e garancisë së kufijve nga Kushtetuta e ish-Jugosllavisë e vitit 1974. Përfundimi është i qartë se parimi i njohur në të drejtën ndërkombëtare uti possidetis, ashtu siç është zbatuar për republikat e ish-Jugosllavisë (1991-1992), ka qenë dashur të zbatohet edhe në rastin e Kosovës. Pra, ky parim u zbatua në mënyrë selektive: iu njoh karakteri ndërkombëtar vetëm kufijve të republikave dhe jo edhe të kufijve të krahinave autonome, me gjithë faktin konstitucional-juridik se edhe kufijtë e krahinave autonome, do të thotë edhe të Kosovës, përcaktoheshin dhe garantoheshin me të njëjtin akt kushtetues, madje edhe me të njëjtën normë kushtetuese. Nëse nuk është zbatuar dje, pse të mos zbatohet sot e nesër.

### **A do t'i kushtojnë dhe sa do t'i kushtojnë Kosovës “interpretimet politike” të Badinterit?**

Kosova nuk mund të jetë “peng” e interpretimeve, më shumë politike, se sa konstitucionale – juridike e Komisionit të Badinterit, në mënyrë që të vazhdojë të trajtohet në dritën e atyre interpretimeve. Qëndrimet e Komisionit të Badinterit do të duhej të zbatoheshin njësoj edhe për kufijtë e Kosovës, si njerës nga tetë konstituentët e ish-Jugosllavisë. Në fakt, Kosova, në përputhje me parimin uti possidetis, me plebishtin e popullit (1991) ndërkombëtarizoi kufijtë e saj, por ai ndërkombëtarizim i kufijve të Kosovës nuk u përligj. Kosova, po sikurse edhe republikat e ish-Jugosllavisë, të cilat shpallen sovranitetin dhe pavarësinë, paraqet rast të vetëvendosjes së jashtme. Shtetet e sovranizuara nga ish-Jugosllavia e kanë shumë të qartë se rikonstruktivimi i plotë dhe i drejtë ndërkombëtar i ish-Jugosllavisë nuk mund të quhet “i kryer” pa zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës, pra “pa valorizimin e plotë dhe të drejtë ndërkombëtar të trungut etnik të Kosovës dhe të vullnetit politik të artikuluar dhe të

institucionalizuar të shumicës dominante shqiptare të popullsisë së Kosovës". Prandaj, nuk mund të kuptohet qëndrimi ende indiferent i shteteve të sovranizuara nga ish-Jugosllavia në lidhje me statusin e Kosovës, kur, nga ana tjetër, disa nga shtetet e perëndimit dhe SHBA-të ose favorizojnë pavarësinë e Kosovës ose angazhohen drejtpërsëdrejti për të si zgjidhje të drejtë.

Jam shumë i vetëdijshëm se ekzistojnë një varg i tërë rrethanash të cilat mund të ndikojnë në "indiferencën" dhe "luhatjen" ose "lëkundjen" e shteteve të sovranizuara nga ish-Jugosllavia ndaj statusit të ardhshëm të Kosovës. Po qe se vështrohen nga një "plan më i gjerë", ato sikur "arsyetohen" me "kryqëzimin e interesave" në Ballkan. Serbia e konsideron Rusinë mbrojtësen kryesore historike të vetën. Rumania mban marrëdhënie të mira me Serbinë. Hungaria frikësohet nga konflikti ushtarak me Serbinë. Bullgarisë nuk i përgjigjet konflikti me Serbinë, për shkak të Maqedonisë. Turqia pretendon të bëhet fuqia e parë e Ballkanit dhe ta neutralizojë ndikimin grek. Greqia i mban rezervë kërkesat territoriale ndaj Maqedonisë dhe Shqipërisë, ndërsa Serbinë e ruan si aleat dhe e bashkërendon me të politikën ndaj Shqipërisë.

### **Rëndësia e trefishtë e pavarësisë së Kosovës për raportet e shqiptarëve dhe serbëve**

Mirëpo, në gjithë këtë vorbullë, pavarësia e Kosovës paraqitet me rëndësi të trefishtë, sepse "involvohet njëkohësisht në tri rrafshë hapësinore":

*së pari*, "në raportin interetnik shqiptaro-serb në Kosovë",  
*së dyti*, "në raportin interetnik shqiptaro-serb në hapësirën e ish-Jugosllavisë" dhe  
*së treti*, "në raportin interetnik global të kombit shqiptar dhe kombit serb në Ballkan".

Nisur nga rëndësia e madhe që ka zgjidhja e drejtë e çështjes së Kosovës për ekuilibrin politik në Ballkan, shtetet e sovranizuara nga ish-Jugosllavia, po sikurse edhe shtetit e rajonit në përgjithësi, do të duhej që, të ndihmonin në krijimin e ekuilibrit, me mbështetjen e

pavarësisë së Kosovës. Pavarësia e Kosovës paraqitet me shumë favore për ruajtjen e stabilitetit në Ballkan. Çdo zgjidhje që do të injoronte vullnetin e popullit të Kosovës, qoftë ajo edhe kaluese, me kërcënimin që “të konservojë gjendjen”, do të linte të hapur mundësinë për konflikte. Shtetet e sovranizuara nga ish-Jugosllavia janë të ndërgjegjshme se me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, pjesë e së cilës ishin, bashkë me Kosovën, do të duhej të konsideroheshin edhe si faktorë të shpërbërjes së saj, sërish bashkë me Kosovën, me të drejtën për vetëvendosje dhe suksesion. Më në fund, Kosova edhe sot paraqet një entitet nacional dhe social-politik, me identitet dhe individualitet të pamohueshëm që paraqesin argumente të fuqishme për të përmbyllur dosjen e saj me pavarësi.

### **Për Kosovën, shteti paraqet një përfundim logjik dhe konstitucional-juridik**

Nga pikëpamja logjike, po sikurse edhe nga pikëpamja konstitucionale-juridike, është e padiskutueshme se shqiptarët paraqesin një etnikum të qartë me të cilin identifikohet popullata kompakte me territorin e vetë, prandaj, si logjikisht, ashtu dhe polito-gjenetikisht, secilit etnikum, pra edhe etnikumit shqiptar, si popull me shumicë të theksuar në Kosovë, i takon e drejta për të ndërtuar shtetin në të cilin, ç’është e vërteta, me shqiptarët do të bashkëjetojnë edhe pjesëtarët e pakicave dhe të grupeve etnike. Ata që e shohin Kosovën si “shtetin e dytë shqiptar” sikur injorojnë të vërtetën se “ekzistimi i dy shteteve shqiptare në Ballkan”, përpara se të konsiderohej përparësi, do të duhej të kualifikohej hendikep, për shkak të synimeve shekullore të shqiptarëve për të “ndërtuar dhe jetuar në një shtet të vetëm”. Që pra, pse shtetet e sovranizuara nga ish-Jugosllavia do të duhej që “indiferencën ndaj statusit të Kosovës” ta zëvendësonin me përcaktimin e qartë dhe mbështetjen e pavarësisë së Kosovës.

## LIDERSHIPI SHQIPTAR SIPAS KRIST MALOKIT NË KONTEKSTIN AKTUAL

**Zef Ahmeti**

Krist Maloki\*, një figurë e madhe shqiptare, nuk ka shkruar ndonjë libër për ta kujtuar atë si dijetar shqiptar, por ai ka lënë një opus të madh dorëshkrimesh me vlera të veçanta. Disa shkrime që ai i ka botuar sa ishte gjallë, kanë dëshmuar logjikën e fortë të analizës së tij. Pjesa më e madhe e vlerësimeve, studimeve dhe analizave që ka bërë Krist Maloki kishin mbetur të pa publikuara, deri kur Albert Ramaj fillioi t'i botonte ato, ma së pari me shkrime të pjeshme (në Phoenix, Shkodër, dhe Urtia, Kroaci-Kosovë), e në fund duke ia përgatitë punimet e tij në një libër.

Nga libri dhe ajo që kam parë, vërtetohet thënia e studiuesve shqiptarë që kanë shkruar për Malokin se, ai ka shkruar një sërë studimesh të ndryshme, ku ka shprehur pikëpamjet dhe mendimet e tij moderne për Kombën dhe shtetin, për Kosovën dhe Shqipërinë në tërësi, zgjidhjen e problemit shqiptar; kritikën e tij letrare kanë lënë në literaturën shqiptare një formë të kritikës objektive.

Në këtë shkrim ne do trajtojmë Krist Malokin, pikëpamjet dhe vlerësimet lidhur me liderin shqiptar rreth çështjeve që kanë si temë kryesore problemin shqiptar. Pikëpamjet e tij rreth problemeve shqiptare ai i trajton në aspekte të ndryshme sociologjike, juridike, filozofike, psikologjike, sipas mësimave që ka marrë në Universitetin e Graz-it, duke i inkorporuar këto fusha me elementet e kulturës shqiptare e duke dhënë analiza të veçanta për ta kujtuar vetveten. Për t'u inkuadruar në temën që kemi zgjedhur, ne duhet patjetër të fillojmë me shkrimin e tij të (mirë)njohur „*Oriental apo okcidental?*“.

---

\* Me rastin e 105 vjetorit lindjes dhe 33 vjetorit të vdekjes

## Lidershipi shqiptar oriental a aksidental

I nxitur nga ngjarjet socio-politike të kohës, gjegjësisht të viteve 1930' në Shqipëri, Maloki paraqiti shkrimin e tij „Oriental apo okcidental?“, duke hyrë kështu në dialogun që zhvillohej atë kohë „ndërmjet Pleqve dhe të Rinjve“. Sipas Malokit, në „...luftën tragji-komike ndërmjet Pleqve dhe të Rinjve“ janë dalluar disa rryma që mund të klasifikohen me sa vijon:

- a) rryma e parë që kishte për „objekt sulmimi“ kolltukët qeveritare. Dhe se, shton Maloki, bajraku i të Rinjëve ishte motoja e padukshme „Ulu ti, të hypi unë!“, ndërsa Pleqt kishin „Besën“,
- b) rryma tjetër mendohej ta paraqiste gjendjen si luftë mes gjeneratave të ndryshme, prirje kjo që nga Maloki refuzohet kategorisht, duke arsyetuar se „problemi Pleq a të Rinjt s`ka punë me njat luftë e me generacione në pikëpamje biologjike-sociologjike!“;
- c) për Malokin kishte edhe një rrymë të tretë, që më së shumti i afrohej thelbit të problemit dhe kjo ishte lufta mes „mendsinash e botkuptimesh“. Më konkretisht bëhej fjalë për „luftë ndërmjet Orientalizmës dhe Okcidentalizmës“.

Që rryma e tretë të kuptohej më drejt, Maloki shpjegonte fillimisht se çka kuptohet me semantikën e fjalëve orientalizëm dhe oksidentalizëm. Në të vërtetë, sikur të mos kishte bërë një shpjegim të saktë të këtyre koncepteve, ai do ishte keqkuptuar tërësisht. Duke e arsyetuar rrymën e tretë, Maloki jep argumenti se „lufta e ardhme asht luftë e djalërisë shqiptare kundra anmikut në zemër të vet, asht luftë mendësie krijuese kundra një mendësie destruktive, asht luftë botëkuptimi drite kundra një botëkuptimi errësire, asht lufta Okcidentale shqiptare kundra Orientalizmës shqiptare...“

## Semantika

**Orientali shqiptar** përshkruhet si një person që i pret të gjitha të mirat vetëm për vete nga të tjerët. Bota për atë është burim i „pashterrun mjetesh, qejfesh e lezetesh të cilat i shfrytëzon në çdo mënyrë e

*metodë...*" Sakrificën vetëmohuese, ndershmërinë nuk i njeh, në të kundërtën, orientali shqiptar "i ngjitet trupit kolektiv dhe shoqnor dhe ja thith gjakun pa asnjë droje e skrupul". Më tutje Maloki vazhdon shpjegimin e tij duke përcaktuar se, orientalisti "s`njef turp a marre... aj ska cipë që t`i nxihet... është i zoti për të gjitha... shet ba`e nanë... për mos me than shpirtin e trupin e vet; vetëm e vetëm që t`i shkoj kungulli mbi uj, vetëm që mos t`i prishen telat e karadyzenit". Ndërsa idealet që ka orientalisti janë "kollluku e llokma" dhe për ta arritur këtë qëllim e "përdor aj çdo mjet" kurse instinktët e tij janë "t`ujkut monoambulant, t`ujkut tek ... deviza e tij karakteristike që e përcjell asht një thanie ... "kudo rafsha, mos u vrafsha!". Atdheu është burim ku ushqehet orientali dhe e shfrytëzon atë, ndërsa pse prishet një shtet, komb a botë, s`është asgjë, shpjegon Maloki.

**Burimi i orientalizmit** "asht një dhanti (=darovë) fatale e kristianizmit, me gjithë që e një kristianizmi euro-aziatik..." Dhe ky burim vjen me ndarjen e kishës dhe sundimin bizantin, thotë teoria e Malokit. Për ta konkretizuar edhe më shumë burimin e orientalizmit te shqiptari shton: "Por s`ishte aq fort ndamja (skizma) kishtarë se sa njaj shpirt i administratës bizantine plot angh e myk që u pllakos si një shpirtër e zezë si një hije murtaje mbi mbarë kombin shqiptar... dmth. ner mardhëniet e shqiptarit me shqiptarin dhe ner marrëdhëniet e shqiptarit me shtetin eprorët e tij u fut e u përhap shirita bizantine si një epidemi rrënimtare dhe e deformati karakterin e drejt të shqiptarit në një bollë amorfe e sisfingore". Kurse Turqia e mëvonshme trashëgon dhe kujdeset për "miraz-in bizantin".

**Oksidentalizmi shqiptar** në anën tjetër vlerësohet e kundërta orientalizmës. Në të vërtetë studiuesi Maloki vlerësonte se "shqiptarët e sotshëm (atëhershëm shënimi i imi) gjinden aq larg nga okcidentalizma e vërtetë...". Ai shprehet shumë qartë dhe u bën me dije se "vet djelmnia e shkollueme e ka gabim kur kujton se okcidentalizma përmbahet vetëm ner veshje e mbathje evropiane, apo në të ndejunit plot kotësi ner sallona...". Oksidentalizmi i vërtetë dëftohet me kryerjen e ndonjë detyre të ndershme... bile karakterizohet edhe me mënyrën se si ai e ngarkon vetën, pra me vetë dëshirë, me detyra të rënda bile edhe jashtë detyrave ordinare e të domosdoshme... lartësia morale rreth një ideje të lart... rreth një "ideje që s`ka punë me kollluke,

*me llokma e me meashe...*" na shkruan Krist. Ai thotë se oksidentali shqiptar duhet të jetë shembull pozitiv për të tjerët. Shpirti fisnik që duhet të demonstrojë me atë se si *"merr pjesë ner dhimbjet e brenga të botës peranë!"*. Vijimi dhe edukimi në shkollat evropiane nuk të bëjnë oksidental, sepse edhe në Evropë ka orientalizma, shpjegon autori Maloki.

Studiuesi Maloki na jep edhe shembuj konkret që dalin nga shkrimet e tij lidhur me shqiptarin orientalist. Ai kështu e quan Ahmet Zogun, *"një oriental dinak nën maskën e një gentleman-i, një injorant karagjoz me hijen e një dashunori shkencash e artesh, një gangster ballkanik e i përgjakun me gjestet e një borgjezi të përshpirtshëm..."* Kurse ata që i shërbyen i quan marioneta teatrore. Dhe gjithë individët më të njohur që i kanë shërbyer Zogut i analizon edhe në aspektin psikologjik duke futur në lojë edhe fëmijërinë e "marionetave" dhe edukimit e Abas Kupi, Gaço Gogo-ja dhe Dr. Nuçi Kotta që thotë se, megjithë dallimeve individuale, ata kanë të përbashkët *"një romantizëm fantazmagorik, një botëkuptim anakronik dhe një vetmohim (a vetëmashtrim) verbues dhe shkatërrimtar"*. Kurse mercenar i quan *"...ata zogista andej e këndeje botës që spekulojnë me rriardhjen e "Mbretit", për t'i sigurue vedit sot a nesër një copë bukë apor ndonjë ofiq qibari"*. Zogu nuk ka pas ndonjë koncept të vërtetë politik, ai nuk ka lodhë mendjen e tij për mbarëvajtjen e vendit dhe kombit, dhe nëse ai ka bërë diçka, ai atë e ka bërë për interesin e vet, sipas motos *"shteti jam unë!"*. Dhe në *"qoftë se ka pasë Ahmet Zogu ndonji fjalë apor ideologji politike, ajo ka qenë e përmbajtur në divizën revoltuese e dërmuese: "Qëllimi i shejtnon mjetet!"*". Për ta përforcuar këtë mendim, Maloki cek disa dëshmi (akte) e vjen në përfundim se A. Zogu ka qenë i gatshëm *"po ta lypte nevoja d.m.th. interesi i tij..... me i pranue të gjitha kërkesat e shteteve të ndryshme rreth e perqark Shqipnisë... që të rinjitet mbret..."*. Ai e quan Zogun fotokopje të Esat Toptanit, njeri materialist (Zogu duhet të ketë pas një rini në varfëri) që i mungojnë gjitha vetitë e vlerave ideale, dhe vazhdon mëtutje duke bërë edhe vlerësimin e bashkëpunëtorëve të tij ku shprehet *"do të mjaftonte një përshkrim psikologjik apor një pikturim... i rrethit të tij të ngushtë ... e sidomos brenda kohës 1925-39 d.m.th të personave që kanë qenë vegla imediate të dallavereve zogolliane: një galeri e gjallë korrupsionistash, kriminelash, pederastash, kodoshësh e kontrabandistash ... që të*

*kuptohet materializmi i rrënjosur shpirtnor i "mbretit të derrave" (simbas Faik Konicës!)..."*

### **Sistemi i organizimit të shtetit shqiptar**

Në një shkrim të botuar në *Hylli i Dritës* në numrin e nëntorit të vitit 1935 me titull: *Diktaturë, liberalizëm apo shtet autoritar?* Krist Maloki shtjellon këto koncepte dhe me vlerësimet e analizat e tij mundohet të shpjegojë se cila nga parimet e përmendura do i përshtatej më së miri shtetit shqiptar të lodhur.

Lidhur me konceptin "*diktaturë*" si sistem i mundshëm për shtetin shqiptar, ai jep disa shembuj me disa shtete të asaj kohe, si Gjermania dhe Italia, duke shpjeguar se kjo formë ishte e papërshtatshme për Shqipërinë. Kjo sepse, nuk ekzistonin në ato kohë "*klasa t`atilla shoqnore, kompakte o plot ideale kolektive -nacionale*", që mund të mblidhnin "*turmat shoqnore*" në të njëjtën mënyrë sikur bënë Musolini dhe Hitleri, nëpërmjet sugjerimit të "*shpresave të reja*" dhe rrëmbimit të tyre me një "*ideal i ri kombëtar*". Në Shqipëri mund të ketë vetëm një diktaturë ushtrie e xhandarmëri, dhe se një diktaturë e tillë nuk do të zgjidhte problemet vitale e paqësore të kombit.

Për rrethanat ekzistuese të viteve të 1930', kur fryma e liberalizmit ishte aktuale dhe ishte futur edhe në Shqipëri, Maloki këtë ide që ishte në përhapje në Shqipëri e quan "*pseudoideologjie*"! Ai thotë "*e vërteta asht se liberalizem do me than : konkurrencë e pakufishme, konkurencë me çdo mjet, a ma mirë: konkurrenca pa shpirt e pa shkrupullë, shkurt: dallavere orientale...*". Koncepti, principi i liberalizmit është i papranueshëm për Malokin dhe kjo për arsye të "*analfabeti (t) bilmez*" shqiptarë që s`ka kurrfarë haberi për problemet dhe nevojat jetike të kombit e të shtetit- në liberalizëm "*mbi fatet e atdheut*" dhe se "*një demokraci e vërtetë e ka vendin ndoshta në Zvicer, Francë, e n`Anglië d.m.th.n në ato shtete që kan një tradicjon politik shekullor, ku populli s`ka as 5 perqind analfabeta*", kështu që ky grup njerëzish do të votonin me siguri "*90% përfaqësuesia orientale...*" Maloki pohon dhe thekson numrin e lart të analfabetizmin ndër shqiptarë pas tërheqjes së Turqisë nga Ballkani. Mendohet së në atë kohë, popullata të ketë qenë 90-95% analfabet. Maloki kujton se në literaturën shqiptare nuk



është fare e njohur dallimi mes *Potestas* dhe *Auctoritas*. Në shpjegimin që i bën koncepteve të dhëna më lart, ai shpjegon edhe qëndrimin e tij për situatën tranzicion të Shqipërisë në vitet 1930.

Përderisa koncepti *potestas* nënkupton forcën brutale e kërcënuese, *auctoritas* është forcë imponuese shpirtërore produktive me besim të plotë se të gjitha punët e shtetit bahen në të mirën e popullit. *Potestas* nuk e merr parasysh elementin e vullnetit të popullit, në të kundërtën ky element injorohet fare, kurse në anën tjetër shteti që udhëheq sipas principit të *auctoritas*, mbështetet kryesisht në vullnetin dinamik. Sipas analizës së Malokit "*auctoritas mund të kenë vetëm njata prijsa e burra shteti, të cilët, pos zotësisë (shkencëtare-mendtare-praktike), kanë edhe kualitete morale, të cilat në Shqipërinë paraqiten sidomos nën devizën: Besë, Burrnië, e Nder shqiptari!*". Përgjigja që Maloki i jep pyetjes, se cili sistem i organizimit shtetërorë do t'i përshtatej më së miri Shqipërisë, në kohën që po e trajtojmë? Është: një sistem autoritar. Mirëpo ai nuk jep ndonjë sqarim si do kishte mundur që ky sistem autoritar të ngrihej brenda rrethanave ekzistuese në Shqipëri.

### Ideja shqiptare dhe shteti apor kombi e Malokit

Ndër shkrimet e nivelit shumë të lartë e të veçantë të Malokit, vështruar në aspektet studimore politiko-juridike, sociologjiko-filozofike, duhen përmendur: *Ideja shqiptare* dhe "*Shteti apor kombi!*". Këto shkrime tërësisht lidhen përherë me trajtimin e çështjeve brenda shqiptare.

Kur flet për dallimin mes *kombit* dhe *nacionit*, Maloki jep një shpjegim shumë të bukur, që e thonë edhe filozofët më të hershëm perëndimorë, këtë shpjegim ai e bën për ta kuptuar më mirë çështjen dhe dallimin mes kombit dhe nacionit shqiptar. Për ta kuptuar dallimin, së pari ai jep shpjegim për teorinë rreth kombit, që ka një kuptim etnik, të cilin Maloki e shprehë si vijon "*kombi përmbledh në gjë të vet një grumbull personash që janë lidhë shoq me shoq (ideal!) nëpër gjakun e fisin e njajt dhe ma fort nëpër një botëshikim e botëkuptim (Weltanschauung!) të përbashkët. Porse ky botëkuptim bazohet ma fort nder ndjenja d.m.th. nder kujtime abstrakte të një vitaliteti të veçantë*

(=të gjakut!) dhe jo aq nder kujtime abstrakte të një sistemi filozofik e racional". Me të drejtë, me siguri duke u bazuar në filozofët gjermanë e francezë, ai e shpjegon saktë edhe nocionin *nacion*, se ka kuptim politik, dhe që lind në kohën kur për të parën herë fillon krijimi i shteteve në kuptimin e sotshëm (shek. XVI sipas K.M.). Me *nacion* në gjuhën shqipe, shpjegon Maloki, kuptohet "*populli shtetnor*", ndërsa kombi është një term etnik, që nënkupton, përfshin, e i kalon edhe kufijtë shtetëror. Dhe kështu ai vjen në pikën ku thotë se, duke u bazuar në shpjegimet e lartcekura, ideja *nacionale* nuk ka kurrfarë pune me idenë kombëtare. Nisur nga ky këndvështrim Krist kujton "*enciklopedistat*" shqiptarë brenda e jashtë se, nacionalist mundet me qenë si vllahët, si grekofonët apo edhe jevgjit e Shqipërisë. I brengosur për kombin të cilit i takonte dhe e donte aq shume, në formë të drejtëpërdrejtë dhe pa përdorë shprehje diplomatike ai do të shkruante: "*Gabimin ma të madh e ma të trashë e bajnë nder ne disa fantasta, të cilët - të marrun mendsh nëpër studimet e shkencat e veta eoretike - xhixhilluese - përpilojnë plane politike -shtetnore pa u interesue aspak se a hyn nder ato kallepe (eoretike) materiali real i kombit dhe vendit (gjeografik e geopolitik) shqiptar. Këta njerëz janë për t'u vue në dajak dhe për t'u dërgue mandej nder klaset e para të shkollave shqiptare që të mesojnë së paku gjeografinë dhe historinë e kombit shqiptar. Jo, zotni, për me ngrehë një shtet, ashtu në kuptimin e plotë të fjalës, nuk jemi të zot na tridhjetëvjeçarët e sotëm. Dhe do të kondendohemi edhe ma tutje me një gjendje gjysmake, për mos me thanë provizore; sepse na - arkitektat fantasta - s'kemi haber mbi materialin real, sepse na s'e njofim as kombin, as vendin, as ... Sepse na kemi ndoshta shumë dije (dituri shkencëtare!) por jo mend e shpirt! ..."*

Ai nuk jep vetëm kritikë, por shpjegon se si mundet të dilet nga gjendja ekzistuese kur thotë: "*Dhe zgjidhja e "Problemit Shqiptar" kërkon para së gjithash shumë mend e shpirt. Djelmnia shqiptare asht mësue me e shikue kombin e vendin e vet nëpër syzat e do vagabondave të tymosun kafehanesh, apor të do pseudo - pedagogëve pedantë e skolastikë, apo edhe të do shkrimtarëve të huej që nuk kanë pasë as zotsinë e nuk e kanë marrë kurrë mundimin e duhun për me i kushtue problemeve tona një "vëmendje" të plotë e objektive. Prandaj s'asht çudi që brenda djelmnisë shqiptare vlon një anarki pikëpamjesh e mendimesh mbi kombin, popullin e vendin e vet. Dhe, "shpëtimtar i*

*kombit” mund të quhet me gjithë mend ai shpirtmadh që i falë asaj djelmnie ideologjinë e vërtetë të “Shqiptarizmës” reale - kombëtare.” I shqetësuar për fatin e kombit, por edhe me dëshirën që kombi të marrë rrugën e duhur, me dhimbje e emocion njëkohsisht, me logjikë dhe frymë idealiste, pra në frymën okcidentale, Krist Maloki do të shprehej: “Fjalët e pallavrat e kafeneve e as bisedat e shkrimet akademike s’ e shpejtojn kombin nga vdekja që i kercnohet. Jo, shpetimi i kombit shqiptar varet vetem nga ndergjegjësja e tijë. Dhe këtë ndergjegjëje mund t’ a zgjojë dhe t’ a ndezi vetem flaka dinamike e një djalerije të pastër, të një djalerije vetmohimtare dhe plot aktivitet shembëllor. Nga aparati mekanik-qeveritar s’ ka shka pritët në këto punë. Qeverija mund t’ i dorëzoj popullit ilaçe e mjete për kurim e perparim, porse ajo s’ mund të kujdesohet edhe për mirëpërdorimin e tyre. Këto të gjitha janë punë ndergjegjëje, janë punë të shpirtit. Dhe shpirti ndezet vetem nga një shpirt tjetër, nga një shpirt i flakët...”*

## **Rreth lidërshiptit shqiptar të Kosovës**

Dëshira e Malokit për “...një djalerije të pastër ...një djalerije vetmohimtare”, për një “shpëtim” kombëtar nuk arrihet. Me gjithë dëshirën e tij për kombin e tërë, Shqipëria më 1913 dhe më 1919 cungohet. Pjesë të kombitshqiptar i jepen nga Fuqitë e Mëdha të kohës shteteve të etura ballkanike. Edhe Kosova, si pjesa më e ndjeshme nga gjitha pjesët tjera të banuara me shqiptar, hynë në trajtimet e Malokit. Mendimet rreth Kosovës kryesisht ai i shpreh në letrat e tij, të cilat njëkohësisht janë edhe pjesë dëshmie e kohës dhe qëndrimeve që ai i përmbahej. Ai brengosej po ashtu në mënyrë të veçantë për Kosovën, mbase ishte edhe vendlindja e tij. Në letrën dërguar Kazim Prodanit, (të cilin e vlerëson shumë, duke e quajtur se “jeni një tip i veçant politikian dhe zhurnalist shqiptar” dhe i vetmi që e meritonte të quhet ashtu sipas profesorit), dalin shumë të dhëna dhe mendime interesante të Malokit rreth problemeve shqiptare dhe në veçanti Kosovës, gjegjësisht asaj që në dokumentat diplomatike europiane të kohës së para copëtimit njihet si *Upper Albania*. (ne për saktësi duhet të themi Shqipëria Verilindore). Maloki shprehë shqetësimet e tij, veçanarisht për sjelljet e “elitës” shqiptare të Kosovë, që në atë kohë (vitet 1950’) vepronte e sillej duke e “refuzuar”

identitetin e vet, duke u munduar të mbulohej me një petk të rrejshëm dhe të përkohshëm. Për këtë fenomen në letrën e parë dërguar Prodanit shkruan: *"një realitet tjetër i Kosovës është që as gjysma e kosovarëve as që kanë prishur ndjenjat për një bashkësi dhe liri kombëtare... paraqiten më tepër si turq se si shqiptarë... me gjithë se s`dinin turqisht... Akademiku kosovar preferon zyrtar, spitalet, dhe ndërmarrjet shtetërore jashta Kosovës, mësuesi i normalës kosovare kërkon të futet o në qytete o në krahina sllave, ku paska "ma lezet jeta"... në policinë sekrete (UDB) me qindra kosovar ... qenkëkan më të zot dhe më të çkathët ... Populli i fushave dhe malësive kosovare i ka lënë zakonet dhe adetet e moçme shqiptare dhe ka nisur ta gëzojnë jetën o fare orientale o fare moderne, në daç si kundrejt seksit femëror si dhe seksit të përkundërt... hajde pastaj dhe i beso shqiptarizmit të kompatiotëve kosovarë!..."* Maloki flet për *"pisllek shpirtërorë"* që është përhapur në jetën e përditshme në Kosovë. Maloki *"Problemin Kosovar"* e ka përcjellë përherë, madje edhe duke dhënë propozime se si ka mundësi që të bëhet *"internacionalizimi"* i saj. Me gjithë kontaktet dhe vlerësimet e ndryshme që ka bërë, ai nuk gjen dot shokë për një studim serioz që do ta lëvizte *"Problemin Kosovar"*. Kolegët e tij, nën presionin e kushteve politike në cilat jetonin, e kishin refuzuar një punë të atillë, duke argumentuar se *"ende s`kishte ardh koha"*, apo duke u fshehur pas frazave evazive.

Maloki ishte një personalitet që në shpirtin e vet kishte barrën kombëtare. Shpesh herë ai shprehej: *"une jam kosovar nacionalist, kam qenë gjithë jetën t'ime kosovar patriot..."* ndërsa procesin e shpëtimit të Kosovës e shprehë duke shënuar: *"Shpëtimi i Kosovës dhe ringjallja e Shpirtit Kosovar munt të vijë vetëm nga brenda dhe nëpër vepra të verteta dhe të perbashkëta kulturrare të të gjithë kosovarëve, kudo qofshin në botë"*.

Dëshiroj të ndalem më tepër në jehonën aktuale të mësimëve të Krist Malokit, në Kosovën e Evropës së vitit 2005. Ja plotësisht i një mendjeje me kolegët e mi se *"para se të jetë problem i diplomacisë evropiane, çështja Shqiptare në Kosovë, në radhë të parë është një problem i brendshëm i vetë shqiptarëve. Kjo në kuptimin se shqiptarët, ma saktë klasa politike shqiptare, priten të bëjnë zgjedhjen përfundimtare në mes të qenurit objekte të paqëndrueshme dhe kalimtare politike, apo subjekte të vetëdijshme politike të një shteti demokratik dhe evropian, që priret të integrohet në kontinentin e*

vjetër". Fatmirësisht sot *de facto*, në Evropë ekzistojnë dy shtete shqiptare: Republika e Shqipërisë dhe Kosova, kjo e fundit e administruar përkohësisht me Rezolutën 1244 të OKB. As personazhit ma dritëshkurtër në Serbi nuk do t'i shkonte ndërmend që ndonjëherë në të ardhmen Kosova do të rikthehej në Serbi. Mirëpo ne ende nuk kemi një afat të saktë mbi përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Përveç faktorëve që kanë të bëjnë me ekuilibrat e brishtë ballkanikë dhe evropianë, në vonesën e zgjidhjes së çështjes së shtetit të dytë evropian shqiptar në Ballkan, sot jemi duke ndikuar më shumë ne shqiptarët. Pra, ne jemi në provë nga komuniteti ndërkombëtar për shkallën e seriozitetit dhe aftësisë shtetformuese, jemi vënë në provë nëse mund të arrijmë të nxjerrim një leadership të besueshëm, të kualifikuar nga pikëpamja intelektuale, dhe do të dimë të shmangim gangsterët nga vendosja në zyrat qeveritare.

Shteti i ri evropian shqiptar në Evropën Juglindore duhet jetë tashmë gjykatës i kthjellët, pajtues dhe tutor i rendit shoqëror dhe politik në një territor gjeo-politik objekt kontestimesh historike, një faktor stabiliteti në Ballkan dhe ma gjanë, një njësi e sigurt politike kundër depërtimeve të terrorizmave dhe aktiviteteve kriminale ndërkombëtare. Qenia popull shumicë e shqiptarëve në Kosovë nuk asht privilegj për të sunduar mbi nacionalitetet dhe grupet e tjera kulturore, siç konceptohej në mënyrë të padrejtë nga regjimi i Millosheviqit, apo siç mund ta kuptojë edhe ndonjë mendje e fanatizuese shqiptare, por një obligim për të siguruar një përfaqësim proporcional në legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor dhe në përgjithësi në administratë e në vendimmarrjen politike të të gjithë qytetarëve të Kosovës së ardhshme. Hapi i parë në këtë drejtim, është përfaqësimi i përpjesshëm dhe i drejtë mes komponentëve përbërës të vetë shqiptarëve. Vendimmarrja e ardhshme politike në Kosovë nuk duhet të konceptohet në asnjë mënyrë vetëm si demokraci e shumicës, por para së gjithash si konsensus mes shumicës me pakicat, bazuar në shtyllat themelore të funksionimit të një sistemi demokratik perëndimor; kurse qeveria duhet të jetë ajo ma qytetarja, ma e pjekura, ma a hapura dhe ma e pastra në pikëpamje të biografisë jetësore dhe ma e besueshmja për komunitetin e vendeve demokratike perëndimore, më profesionalja dhe intelektualja. Kjo është jehona që ne ndjejmë sot nga mësimet e Malokit. Mospërfshirja

e personaliteteve intelektuale të Kosovës në drejtimin e qeverisë së re, emërimi i "anonimëve" të paditur e të pashkolluar në mënyrë të përshtatshme, në një kohë kur djemtë më të mirë të Kosovës, të edukuar në Kolegjet më të dëgjura të Evropës Perëndimore mbeten ende një potencial i pashfrytëzuar dot nga vendlindja. Sot kur Perëndimi, korigjoi gabimet historike të fillim shekullit XX dhe na e dhuroi të gatshme Kosovën, na mbetet ne shqiptarëve të bëjmë hapin e fundit, na mbetet neve të tregojmë se jemi një popull i vjetër evropian me ndërgjegje të lartë shtetformuese. Pikërisht sot më shumë se kurrë Presidenti shqiptar duhet të dalë nga kulla e fildishtë në të cilën ndodhet "i ngujuar" dhe të marrë përgjegjësinë e udhëheqjes së përditshme të popullit të tij. Një intelektual i nderuar i takon të qeverisë me intelektualë të vërtetë, i takon të sjellë në drejtimin e vendit mendjet më të shkolluara të Kosovës, i takon të shmangë militantët e paditur. Është koha që këtë ta bëjmë sot se nesër do të jetë vonë. E një gjë të tillë kërkon një konsensus të gjerë, kërkon këshilltarë të besueshëm e të kualifikuar. Evropa është në pritje të shfaqjeve më të mira të aftësive tona shtetformuese. Ne duhet të punojmë që Kosova duhet të shkojë drejt pavarësisë nga procesi stabizim asocimit dhe pastaj anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Kjo rrugë nuk prish ekuilibrat gjeopolitike në Ballkan dhe me gjere, ruan stabilitetin e vendeve fqinje, e ne të njëjtën kohë një vend i asociuar dhe anëtarësuar në EU është një vend me i sigurt ndaj depërtimeve të trafiqeve dhe terrorizmave. A ka ndonjë strategji të qartë të përpunuar se paku në letër udhëheqësia Kosovare?

## **Përfundim**

Figura e dijetarit shqiptar nga Kosova, gjegjësisht Shqipëria Verilindore, që ka jetuar e vepruar në Grac të Austrisë, është e lidhur ngushtë me "politikën e Kombit Shqiptar" dhe çështja e kombit shqiptar luante një rol kryesor në agjendën e tij. Për atë "totaliteti" (sipas filozofisë së Aristotelit), Kombi Shqiptar, kishte rëndësi më shumë se sa gjithë pjesët e saj.

Shkrimet e tij edhe pse nga gjuha ishin të ashpra, ishin reale dhe përkonin me realitetin shqiptar. Ato shkaktuan "dridhje" kur

publikoheshin. Dhe si njeri "idealist" me zemër në kombin kudo dhe ngado që shkonte, ai bënte kritika për ato fenomene negative në shoqërinë shqiptare, të cilat e hendikaponin zhvillimin e tij. Dhe për këto "pisllëqe shpirtërore" që lundronin në kombin e tij, që në agjendën e tij ishte në rangun e parë, ai vuante shumë, brengosej tejmasë.

Ishte një kundërshtar i rreptë i asaj "elite" shqiptare që ishte e infektuar nga "orientalizma". Kërkonte një djalëri të pastër. Dhe vetëm djalëria e pastër që do duhej të dilte nga vetë shpirti i Kombit, do ta shpëtonte atë. Kritikonte oksidentalizmin formal, ndërsa e avancon atë oksidentalizmin e vërtetë shpirtërorë e të pastër.

Duke njohur mirë organizimet e shoqërive në perëndim, i ndikuar edhe nga filozofët e mëdhenj, ai kurr nuk kishte distancë nga identiteti shqiptar, përkundrazi, ai elementet kryesore që e përbënin "shpirtin shqiptar" Besa, Ndera dhe Burrnia ishin elemente që e përcjellin gjatë gjithë jetës. Ai i mbronte këto tri elemente të "shpirtit shqiptar" me një logjikë interesante dhe nuk kishte kurrfarë probleme që ato t'i harmonizonte si veti të shenjta edhe me filozofinë moderne të organizimit shoqërorë. Ai në këto tre elemente shihte edhe bazën e një shoqërie të shëndoshë shqiptare oksidentale.

Në të vërtetë dijetarin tonë, gjendja kombit shqiptar e rëndonte në mënyrë të jashtëzakonshme. Ishte idealist por edhe realist dhe gjërat i shikonte në mënyrë objektive, mbase edhe si shkencëtar që ishte, ai nuk i lejonte vetës të shkruante dhe të fliste pa gjuhën e argumentit.

Puna e Krist Malokit është e veçantë. Mendimet tij rreth temave të ndryshme lidhur me kombin shqiptar, ai i shtjellon nga një kënd ndryshe nga të tjerët. Problemet i lokalizon shumë shpejt dhe në formë precize. Ai kapte problemin në thelb, aty ku "orientalistave" nuk iu pëlqente fare.

Sot në 33-vjetorit të vdekjes e tij, kombi i Malokit ka nevojë për një djalëri të shëndoshë. Djalëria e shëndoshë që ka kërkuar përherë Krist Maloki ende nuk ka marrë në dorë fatin e kombit. Populli shqiptar ende ka nevojë për një leadership oksidental të vërtetë dhe jo për aso që vetëm nga pamja duken dhe paraqiten se janë të tillë.

Pushoftë në paqë!

**Literatura :** *Krist Maloki, Refleksione,*( përgatitur nga A. Ramaj), Faik Konica, Prishtinë 2005; K. Maloki, *Shteti apor Kombi*, në: Phoenix, nr. 15(2000/1), Shkodër; K. Maloki, *Ideja shqiptare*, në:Phoenix, nr. 5-6, 1998, Shkodër; K.Maloki, *Patriotizmi shqiptar, dorëshkrim*, K.Maloki, *Kombi në rrezik*, *Hylli i Dritës*, Vjeta XII, Shtatuer 1926, nr. 12; Isak Ahmeti, *Një Figurë moderne e kulturës shqiptare – Krist Maloki rradhitet ndër krijuesit tanë më të spikatur*, në: Rilindja, 10 mars 1999; Hamdi Oruçi, *Shejza*, nr.: 5-8, XVII-1973; K. Maloki, *Oriental apo okcidental?*, në: *Hylli i Dritës*, nr. 1, 1937, Shkodër; *Nëpër gjurm t`ujkut oriental, dorëshkrim*, Romeo Gurakuqi, *Fjala e Rastit e Mbajtur në Metingun e organizuar në Kishën e Shën Palit, Rochester Hills, Detroit Michigan, 28 nëntor 2004, botuar në gazetën Illyria, New York 3 dhjetor 2004*



## **DIMENSIONI I SHQIPËRISË SË KRISHTERË**

Prof. as. dr. Kaliopi Naska

Prof. as. dr. Shaban Sinani

Për praninë e Kodikëve në trevat shqiptare njoftimin e parë e ka dhënë Episkopi i Beratit Anthim Aleksudhi, nga gjysma e dytë e shek XIX-të në vitin 1868 në librin "Përshkrim i shkurtër historik i Mitropolisë së Shenjtë të Beratit" botuar në Korfuz. Në vitin 1885 vjen në Shqipëri studiuesi francez Pjer Batiffoli. Gjatë vizitës së tij nëpër kishat orthodhokse të Beratit, ai mbeti i mahnitur kur zbuloi Kodikët. Siç thotë edhe vetë Batiffoli, që u njoh vetëm me një pjesë të Kodikeve, për të cilët hartoi një katalog në formën e një biografie të shkurtër të librave. Në këtë katalog Batiffoli nënvizon: "Nuk m'u lejua veçse një inventar i shkurtër, kam përshtypjen dhe s'jam aspak i sigurt të kem parë gjithçka".

Ndër Kodikët më të njohur, që përmend Batiffoli në katalogun e tij janë edhe "Codex purpureus Beratinus Ø", vepër e shek. VI-të dhe "Codex aureus Anthimi". Ai gjeti tre Kodikë kristografikë të stilit bizantin të shkruar me ar dhe me argjend, ndërkohë kur në mbarë botën numëroheshin jo më shumë se 12 të tillë.

### **Kodiku i Purpurtë i Beratit dhe Kodiku i Artë**

Sigurisht që më i rëndësishmi dhe më i famshmi prej tyre është ai që njihet me emrin "Codex purpureus Beratinus" (Kodiku i purpurt nga Berati). Ky është një nga Kodikët më të vjetër në të gjithë botën (dy të tjerët, po të shek. V-të dhe VI-të pas Krishtit janë në Rusi). Ai përfaqëson një dorëshkrim (ekземplar i vetëm origjinal) e përbëhet nga 190 fletë pergamenë të ngjyera në të kuqe të theksuar (të purpurtë). Kodiku përmban dy Ungjij, sipas Markut dhe sipas Matheut. "Kodiku i purpurtë i Beratit" u shkrua në një kohë kur ende nuk qenë vendosur se cilët do të ishin librat kanonikë të Dhiatës së Re, prandaj ky dorëshkrim ka disa shmangie dhe mospërputhje nga teksti

original. Gjithashtu sipas Batiffolit, Ungjilli sipas Matheut ndodhet ndërmjet faqeve 1-112, ndërsa faqet që vijojnë i përkasin Ungjillit sipas Markut. Në kohën që e vëzhgoi Batiffoli, kodikut i mungonin rreth 40 faqe. Për herë të parë "Kodiku i Purpurtë i Beratit" përmendet në "Diptikët e kishës së Shën Gjergjit", e cila ndodhej brenda kalasë së Beratit. Ky kodik është shkruar me shkronja argjendi të tretur, me përjashtim të disa (fjalëve e shprehjeve) që janë me shkronja të arta, në pergamenë. Kodiku daton në shekullin e VI-të. Studiuesit shqiptarë, ndonëse nuk kanë përfunduar ndonjë vepër të thelluar për këtë dorëshkrim, mendojnë se është shkruar nga murgj vendas. Ka arsye të mendohet se ky kodik është vazhdim i një tradite të hershme, kontributit të iliro-shqiptarëve në përhapjen e Krishterimit.

Prandaj ky kodik merr rëndësi të madhe për historinë e Krishterimit e për historinë e traditës së shkrimit, për faktin se është ruajtur në gjendje të lexueshme për 15 shekuj me rradhë.

Kapaku i Kodikut është metalik e i zbukuruar me figura biblike, ndërsa teksti është në greqishte të vjetër. Kodiku ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit. Për nga rëndësia e veçantë që ka për historinë e traditës kulturore të vendit dhe të asaj botërore Kodiku ruhet në tre forma:

1. I restauruar me teknologji kineze të laminimit në mesin e viteve 70-të (çdo fletë vendoset ndërmjet dy xhamave, për këtë arsye origjinali një-vëllimsh është ndarë në nëntë vëllime).
2. I riprodhuar si tekst i shfrytëzueshëm, duke ndjekur analogjikisht origjinalin (në lëndë, në kaligrafi, në stilizimin e shkronjave dhe në zbukurimet shoqëruese: vinjeto, miniatura, figurina në një vëllim).
3. I riprodhuar në formën e maketit në gjendjen që ruhej deri para restaurimit – në pamje të jashtme identik me origjinalin.

Mund të themi se Kodiku i purpurtë i Beratit "Codex purpurus Beratinus Ø" bën pjesë tek variantet më të vjetra të dorëshkrimeve Biblike. Gërma Ø, tregon radhën që ai zë në vargun e dorëshkrimeve të lashta Biblike.

## KODIKU I ARTË

Kodiku i dytë për nga rëndësia dhe vjetërsia është ai me emrin "Codex aureus Anthimi" (Kodiku i artë). Ndryshon nga i pari, sepse ky kodik është shkruar në pergamen me shkronja ari të tretur. Si vëllim Kodiku i artë është më i madh e përmban 413 fletë. Në të përfshihen të katër Ungjijtë (sipas Matheut, Markut, Llukës e Joanit). Ky kodik i takon shek. IX-të dhe është i shkruar me gërma të një tipi të ri, të rrumbullakët dhe me bishta, të quajtur korsiv minuskul. Edhe ky Kodik është i shkruar në greqishten e vjetër.

### Si u zbuluan Kodiket e Beratit

Studiuesi francez Pjer Batiffoli, gjatë vizitës nëpër kishat e Beratit në vitin 1865 mbeti i mahnitur nga zbulimi i disa Kodikëve të vjetër kishtarë. Nga Kodikët më të njohur, për të cilët na flet Batiffoli është Codex purpureus Beratusius Ø, vepër e shek. VI-të si dhe Codex aureus Anthimi që i përket shekullit të IX-të.

Por si u bë e mundur që ky Kodik të mbërrinte deri në ditët tona?

Atdheu ynë, Shqipëria gjithmonë ka qënë në fokusin e pushtimeve nga armiqtë e ndryshëm. Luftrat e panumërta sillnin gjithnjë me vete përndjekje e shkatërrime si edhe grabitjen e vlerave kulturore.

Në vitin 1356 serbët dogjën Beratin, që ishte një nga qendrat kryesore të zhvillimit të arbërit dhe të Kishës Orthodhokse. Pikërisht në këtë situatë të vështirë, meshtari Skuripeqi së bashku me murgun Theodhulos ngarkuan në 27 thasë Kodikët e Shenjtë kishtarë dhe i fshehën, me qëllim që kultura shqiptare të mos dëmtohej dhe grabitej e që ky komb të mos mbetej pa traditë e histori. Gjatë Luftës së I-rë botërore austriakët që pushtuan Beratin dhe rrethinat e tij përdorën të gjitha mjetet, që nga premtimet joshëse dhe deri tek kërcënimet kundër epitropëve të kalasë, për të treguar vendin e fshehtë.

Kështu që këto vepra të shenjta mbijetuan në sajë të njerëzve shpresëtarë e patriotë të Kishës sonë. Kjo histori e thjeshtë por heroike është përsëritur sa e sa herë nëpër shekuj, ku të huaj të tjerë herë nën

petkun e mikut e herë nën kërcënimin e armëve, u përpoqën t'i grabisin këto thesare të popullit tonë. E në të gjitha këto raste, shpresëtaria e popullit orthodhoks i ka dalë për zot duke i ruajtur si dritën e syve këta libra të shenjtë, ashtu siç ka ruajtur edhe thesaret e tjera që përbëjnë identitetin tonë kombëtar.

Deri në pushtimin e Shqipërisë nga italianët fashistë, Kodikët e Beratit u paraqiteshin besimtarëve vetëm një herë në vit, në të kremten e Shën Joan Pagëzorit. Më vonë ata u ruajtën me fshehtësi nga kleri dhe epitropët e kishave të Beratit. Kodikët e Beratit janë zbuluar shumë vonë. Në gjysmën e dytë të shekullit të XX-të. Zbuluesi i tyre është psalti i qytetit të Beratit Nasi Papavli nga lagja Mangalen. Zbulimi i tyre u bë në këto rrethana;

Nasi ishte djalë prifti dhe çdo të Djelë që në moshë të re, shoqëronte të atin kur ngjitej në lagjen kala për të meshuar në Kishën e Shën Trinisë, për ta ndihmuar dhe për të mësuar të psalë. Kur djali u rrit dhe ishte në moshë madhore, një ditë pas meshës, kur kisha ishte e boshatisur nga besimtarët, i ati e thirri brenda në Hierore dhe i tha se do t'i tregonte një sekret të rëndësishëm. Ai i tregoi një kapak pranë Tryezës së Shenjtë dhe i tha që ta hiqte. Para syve të djalit u duk në errësirë një gropë e thellë. Aty i tha i ati, janë fshehur dy libra me vlerë të madhe, të cilët të huajt janë përpjekur t'i shtien në dorë.

Pasi i ati vdiq Nasi mori rrugën e kurbetit, shkoi në Amerikë për të siguruar jetën e familjes. Pas shumë vjetësh u kthye në atdhe. Thonë se amanetin se tret dheu dhe Nasit i rëndonte shumë amaneti i të atit, por nuk shihte asnjë rrugëdalje. Në vitin 1939 Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste dhe italianët nisën të interesoheshin për ato dy libra. Pas çlirimit të vendit në vitin 1956, Nasi u transferua familjarisht në Tiranë dhe u krijuan kushte për ta ndjekur problemin. Megjithatë nuk e pati të lehtë sepse përmbajtja e librave ishte fetare dhe regjimi ishte ateist. Më në fund, trokiti në Institutin e Shkencave ku kërkoi takim me Prof. Dr. Aleks Budën, kryetar i këtij Instituti. Ai e priti, e dëgjoji me vëmendje dhe i premtoi se do të interesohet dhe do ta njoftonte. Në takimin tjetër Prof. Dr. Aleks Buda i tha se çështjen ja kishte referuar Degës së Brendshme të Beratit, kishte shkuar edhe vetë në Berat, por përgjigje nuk kishte marrë.

Siç duket epitropët e klasës nuk kishin besim tek autoritetet komuniste. Pësëmbëdhjetë vjet me radhë Nasi, çdo dy javë shkonte në Institutin e Shkencave për të marrë ndonjë përgjigje. Më në fund vëllimet u gjetën dhe vetëm atëherë Nasi mësoi se dy librat aq të kërkuar nga të huajt ishin Kodikët e shekujve të hershëm me vlerë të rrallë historike. Por Kodikët ishin dëmtuar keq nga lagështira dhe kishin nevojë të restauroheshin, prandaj u dërguan në Kinë rreth viteve 70-të. Duart e arta të artizanëve kinezë i kthyen Kodikët në gjendjen e mëparshme dhe pas disa vitesh iu dorëzuan Arkivit Qendror të Shtetit ku ndodhen edhe sot, nën dispozicionin e studiuesve shqiptarë. Dorëzimi i Kodikëve u bë me ceremoni. Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësues të lartë. Ato ditë Prof. Dr. Aleks Buda botoi një artikull të gjatë në gazetën "Zëri i Popullit" për rëndësinë e Kodikëve të Beratit, ku shprehte njëkohësisht konsideratën e tij të veçantë për familjen e Nasi Papapavlit. Kur i biri e falenderoi atë për çka kishte shkruar në gazetë, Prof. Dr. Aleks Buda iu përgjigj: "U çlirova nga një barrë e rëndë morale karshi babait tuaj, i cili me një përkushtim, këmbëngulje dhe durim të habitshëm nuk reshti së ardhuri në Institut çdo dy javë, për 15 vjet rresht, për të marrë ndonjë përgjigje për fatin e Kodikëve."

Ne librin "Kodiket e Shqipërisë", vepër shkencore e ilustruar, janë përzgjedhur e botuar pjesa më e madhe e artikujve dhe shkrimeve me karakter studimor e njoftues për dorëshkrimet ungjillore, që i janë paraqitur publikut për një periudhë afro 135-vjeçare, qysh se ipeshkvi i Beratit, Anthim Aleksudhi (Anthimus Alexoudes), dijetari, "miku i artit", siç e quanin me mirëdashje në Kostandinopojë, përshkroi, për të parën herë, në librin e tij "Përshkrim i shkurtër i mitropolisë së shenjt të Beratit", disa nga kodiket më të vjetër, që ruheshin në kishat e manastiret e besimtareve shqiptare.

Në vepër janë përfshirë dhe studime të paleografëve, tekstologëve, kataloguesve dhe bibliologve të huaj e vendës.

Tradita e shkrimeve kishtare

Sikurse do të vihet re prej vete lexuesit, tradita e shkrimeve kishtare në Shqipëri ka pasur me shume vëmendje në shkencën botërore se sa në atë antropologjike shqiptare, në atë kuptim që shkenca amerikane njëson dijen për historinë e kulturës njerëzore. Kjo lidhet me shume arsye, nga të cilat njëra është ajo e pozitës ateiste të shtetit shqiptar për një periudhë relativisht të gjatë, por kryesorja është mungesa e specialisteve me njohuri ndërdisiplinore për të gjykuar e vlerësuar.

Studiuesit e huaj ia kanë kushtuar vëmendjen kryesore "Kodikut të Purpurt të Beratit" - Codex Purpureus Beratinus F - i njohur gjerësisht me emrin e shkurtër "Beratinus". Në fakt emrin e Beratit e ka marrë si epinon edhe "Kodiku i Arte i Anthimit", i cili mbiquhet shpesh "Beratinus-2". Kjo ka ndodhur jo vetëm për faktin se "Beratinus" i takonte një periudhë shume të hershme (i shkruar në kufijtë e fundme të paleokrishtëritimit); jo vetëm sepse për një kohë të gjatë emri i tij është lidhur e vazhdon të lidhet me emrin e Shën Gjon Gojartit (Joan Chrysostome), një prej protagonistëve dhe reformatoreve më të mëdhenj të historisë së krishterimit të hershem; jo vetëm sepse dorëshkrime si "Beratinus" kanë mbijetuar në bote me pak se gishtat e dorës; por, mbi të gjitha, për faktin se, siç e ka vënë re menjëherë P. Batiffol, në tekstin e këtij dorëshkrimi ka here pas here "shmangie leximi" ("conflate reading"), që lidhen me karakterin jonormativ të këtyre fragmenteve kalimtare.

### **Historia e mendimit ungjillor**

"Beratinus" mori rëndësi botërore si një dorëshkrim i hershem që mund të ndihmonte për të plotësuar historinë e zhvillimit të mendimit ungjillor, nëpërmjet studimeve të posaçme të tekstologjisë kritike ("textual criticism"), që mund të thuhet se, në dijen shqiptare, sapo kanë filluar. Në një vështrim më të gjërë këto studime do të evidentonin se çfarë ndodhi në procesin e kalimit prej fjalës së shenjta tek shkrimet e shenjta, prej predikimit ungjillor gojor tek predikimi kanoni.

Rëndësia e "Beratinus-it" u theksua edhe më nga fakti se në tipologjinë e tekstit të tij gjenden gjurme të shkrimeve siriake (të Lindjes) dhe të

Perëndimit njëherësh. Këtij mendimi i janë përmbajtur shume dijetare, prej Batiffol-it deri tek Aleks Buda e me pas Roderic L. Mullen. Kjo e ben ate një prej dorëshkrimeve me te rendesishem për te krahasuar shkollat e shkrimeve ungjillore dhe procesin historik te kanonizimit te shkrimeve te shenjta ne përgjithësi.

### Numri i kufizuar

Për fat te keq, numri i kodikeve me njohje ndërkombëtare te ruajtur ne Shqipëri, duke përjashtuar "Kodikun e Arte te Anthimit" (një dorëshkrim i rralle krysografik, ne pergamene te purpurt) dhe disa te tjerë, me gjithë këtë vëmendje, qe e tejkalon interesin e shkencës vendëse, është i kufizuar. Te pakte kane qene ata qe kane bere studime duke pasur njohje te drejtpërdrejtë për kodiket . Disa te tjerë kane shkruar duke pasur si burim jo vetëm kodiket, por studimet mbi to.

Ne Shqipëri dijetari i pare qe ka bere te ditur ekzistencën e Beratinus-it dhe te disa kodikeve te tjerë ka qene Ilo Mitke Qafezezi. Ky qe me shume i preokupuar për "Kodikun e Koste Beratit", ne te cilin gjendej një alfabet i panjohur i shqipes me grafema helene, por nuk harroi te përmendte pak me gjerësisht vlerat e thesarit doreshkrimor beratas. Me këtë rast ai krijoi edhe neologjizmin "shkresedore", për "manuscript" - dorëshkrim, qe nuk pati fat te mbetej ne gjuhen aktive.

Redaksia qe përgatiti veprën "Kodiket e Shqipërisë" parapëlqeu ne kriter përzgjedhjen e studimeve dhe artikujve me karakter shkencor, botuar ne revista akademike-universitare dhe buletine shkencore. Një numër artikujsh te botuar here pas here ne shtyp thjesht për qëllime njohjeje dhe vlerësimi nuk jane përfshire. Për ndonjë prej këtyre te fundit, qe ka pasqyruar përparim te dijes e te informacionit rreth kodikeve, është bere përjashtim.

Duke iu përmbajtur kuptimit terminologjik qe i është dhëne fjalës "kodik" ne arkivistike, kane mbetur jashtë kësaj vepre një numër studimesh me karakter filologjik, nder te çilet veçohen studimet e albanologut gjerman Armin Hetzer, shkrimet e te cilit kane pasur dhe kane rendësi për te bere te njohura vlerat gjuhësore te disa kodikeve te

Shqipërisë; si dhe studimet e ak. Alfred Uçi kushtuar veprës së Teodor Kavaliotit: logjikes, fizikes dhe metafizikes së tij, tekste të akademisë së Voskopojës.

### **Fondi i rrallë**

Me "kodike të Shqipërisë" në këtë vepër, me ndonjë përjashtim tejet të rrallë, kuptohet vetëm "Fondi 888" i AQSH-së, ku janë koleksionuar 100 kodike dhe 17 fragmente. Ndoshta numri i kodikeve që gjenden në fonde të tjerë në këtë arkiv (argjipeshkvia e Gjirokastrës / Drinopolit /, argjipeshkvia e Shkodrës, manastiri i Shën Gjon Vladimirit dhe disa fonde të tjerë, nominale) është i barabartë me ato të "Fondit 888". Por këto janë ende të pakataloguar në një regjistër tërësor. Ka dhe për to të dhëna të thjeshta informimi, por në fondin ku gjenden.

Disa kodike, si "Liturgjia e Shën Gjon Gojartit", që përshkruan Batiffol-i, pa bërë fjalë për disa të tjerë që ky nuk arriti t'i shohë me sy, si një kodik i shekullit të parë që ruhej në Gjirokastrë, si dhe një kodik tjetër i shekullit të 4t, ekzistenca e të cilëve pa dyshim do të ndryshonte kalendarin e kulturave në shkallë evropiane e botërore, sikurse dihet, me vone u zhduken pa gjurmë. Tani ato ekzistojnë vetëm në përshkrimet e studiuesve.

Një numër i madh kodikesh gjenden në institucione të tjera: në Bibliotekën Kombëtare, në Muzeun e Artit Mesjetar të Korçës, në bibliotekat e institucioneve të Akademisë së Shkencave, si dhe në bibliotekat e qytetareve. Deri në fillim të viteve 1990, nga veprimtarët e shërbimit arkivor, janë raportuar dëshmi për ekzistencën e kodikeve të tjerë mesjetare në familjet qytetare shqiptare. Në këtë kuptim, mungon një regjistër kombëtar, ndër-institucional, i të gjithë kodikeve të Shqipërisë.

### **Karakterit katalog**

Shumica e shkrimeve që botohen në këtë vepër janë të karakterit "katalog". Alexoudis përshkroi 6 dorëshkrime. Batiffol përshkroi e



analizoi 16, megjithëse përmendi shume me tepër: nuk pati mundësi t'i shihte e t'i analizonte. Ne formën e një katalogu paraqitet edhe studimi i Johannes Koder-it e Erich Trapp-it: këta patën mundësi të vizitojnë arkivat e Shqipërisë dhe të shohin koleksionin e kodikeve që ishin mbledhur deri atëherë (mesi i viteve 1960) dhe ruheshin në AQSH. Studimet e tyre shpallen në listat ndërkombëtare ekzistencën e një numri kodikesh të panjohur të botes shqiptare. Në atë kohë një pjesë e madhe e kodikeve gjendeshin ende në pronësi të kishave dhe manastireve dhe Koder-Trapp nuk patën mundësi t'i katalogonin të gjithë. Një skedë me të dhëna të plota të përditësuara u përgatit prej tyre për dy me të rëndësishmit e kodikeve të Shqipërisë: Beratinus-1 e Beratinus-2.

Në këtë botim nuk janë përfshirë katalogët e R. Gregory-t (botuar në fillim të shekullit të 20-te) dhe të Gregory-Aland (botuar në fund të shekullit të 20-te), sepse në to behet fjale për rreth 5000 dorëshkrime me karakter kishtar dhe në to disa kodike të Shqipërisë përmenden sipas radhës kronologjike në liste, por jo me vete. Në këto studime, për vete karakterin global të tyre, për kodiket e Shqipërisë behet fjale kalimthi.

Kataloguesit e huaj gjithnjë i janë përmbajtur ndarjes së dorëshkrimeve ungjillore në tre grupe: 1. Maiuscule (shkronjemedha); 2. Minuscule (shkronjevogla) dhe 3. Lectionary (ligjerata ungjillore, fragmente ungjijsh, ungjij në perikope).

Të dhënat e kataloguesve të mëdhenj të letërsisë ungjillore (Gregory-Aland), sa u takon kodikeve të Shqipërisë, megjithatë, janë të pranishme në këtë vepër përmes evokimit të tyre prej studiuesve të tjerë.

## **Historia e kodikeve**

Në Shqipëri një katalog të kodikeve të Shqipërisë pati përgatitur Theofan Popa, i cili iu kushtua kësaj pune në vitet e fundit të jetës së tij, në vitet 1980. Katalogu i Popes u përgatit për nevoja shërbimi, si mjet informimi dhe kërkimi arkivor. Në këtë katalog, përgjithësisht,

kodiket renditen sipas radhës kronologjike, por jo gjithnjë respektohet kriteri kronologjik, kryesisht sepse dorëshkrime të hershme janë zbuluar e pranuar në arkiv në një kohë kur vendin e tyre sipas radhës kohore e kishin zënë të tjera, që ishin bërë me herët prona e arkivave. Në përshkrimet e Popes here pas here, në të rralla, përmendet edhe numri i referencës në inventarët e Gregory-Aland, por nuk zbatohet kriteri klasifikues i tyre. Ende mungon një analogim përfundimtar i numrave të referencës të dorëshkrimeve ungjillore të Shqipërisë në katalogun e AQSH-se dhe në katalogun e Gregory-Aland apo të Koder-Trapp. Botimi "Kodiket e Shqipërisë" mundëson komunikimin e studiuesve brenda dhe jashtë vendit, duke siguruar, pike se pari, identifikimin e të njëjtit objekt.

Duke qenë se katalogu i Popes nuk është përgatitur nga autori si një vepër për botim, redaksisë i është dashur të punojë me përgjegjësi me daktiloshkrimin, për qartësimin e mendimit dhe rrjedhshmërinë e frazës, për saktësimin dhe njehsimin e termave, si dhe për disa plotësime të domosdoshme.

### **Rëndësia**

Merr rëndësi, në këtë kuadër, studimi i Dr. Roderic L. Mullen, nga universiteti i Birminghamit, i cili përshkroi dhe krahasoi, ndonëse jo tërësisht (vetëm për dorëshkrimet me karakter ungjillore) numrat e referencës të katalogut të Gregory-Aland me ato të katalogut të Popes, duke lehtësuar e mundësuar shfrytëzimin e literaturës shkencore tradicionale dhe të re për kodiket.

Katalogu i Popes, së bashku me studimin hyrës, që është e para vepër me të dhëna arkeografike dhe kulturore-historike thuajse për të 100 kodiket e "Fondit 888", i cili gjithashtu u krijua nën drejtimin e tij; botohet për herë të parë.

Renditja e artikujve dhe studimeve të përfshirë në këtë vepër bëhet sipas radhës së botimit. Kjo për të respektuar autorët, përparësitë e tyre, si dhe për t'i dhënë mundësi lexuesit të vërejtjeve se çfarë ka sjelle të re, në kohën dhe kontekstin e vet, secili nga studiuesit që është marrë

me kodiket . Katalogu dhe studimi hyrës i Popes është vendosur ne kronologji, duke pasur si reference datën e përfundimit dhe te dorëzimit ne AQSH (mesi i viteve 1980).

Ne shkrimin e emrave te njerëzve dhe te vendeve redaksia ka zbatuar parimin e drejtshkrimit te shqipes, sipas te cilit forma me e hershme e një huazimi është normeformuese, përkundër te tjerave, qe mbeten ne përdorim me te kufizuar. Shqipja është një gjuhe qe e ka prekur fjalorin biblik qysh prej kohës se krishterimit te hershem. Një varg emrash te përveçëm biblike e ungjillore, toponime historike te kësaj hapësire, emra te përgjithshëm te terminologjisë kishtare, kane, për ketë shkak, formën e tyre te shqipëruar. Kështu, është shkruar „Gjon“ për „Joan“, sepse forma „Gjon“ del si e tille ne trajte te shkruar ne faltoret e shqiptareve qysh ne shekullin e 7-te. Megjithatë, ne te shumtën e rasteve, kur emrat e përveçëm nuk kane te bëjnë me figura biblike, por me personazhe historike, ne kllapa është dhënë edhe forma e huazimit te mëvonshëm te njëjtit emër biblik, kurse ne disa raste te tjera është zbatuar parimi historik dhe është respektuar forma qe ka përdorur vete personaliteti, si: Jan Kukuzeli i Ri, Joasafi i Beratit etj.

Pothuajse te gjithë artikujt dhe studimet e këtij botimi, duke qene se kane qene shkruar dekada e shpesh shekuj me pare, redaksia i ka pajisur me shënime shpjeguese, saktësuese ose krahasuese, ne dy forma: si shënime te brendashkruara ne tekstin e autorit, duke bere dallimin me kllapa (katrore ose te kurbeta) dhe si shënime ne formën e fusnotës. Ne rast se autoret kane pasur vete shënime ne forme fusnote, shënimet e redaksisë jane dalluar me kursiv.

Për te lehtësuar kuptimin e kësaj lende relativisht te panjohur ne boten shqiptare te letrave është përgatitur një fjalorth shpjegues. Theksojmë se fjalorthi u referohet kuptimeve qe kane këto terma ne studimet për kodiket. Ne raste te veçanta, kur ka qene e nevojshme te saktësohet një kuptim prej tjetrit, është dhënë edhe përmbajtja semantike e termit ne përdorimin kishtar.

Për botimin e kësaj vepre, nga redaksia, punonjësit e Drejtorisë se Përgjithshme te Arkivave dhe bashkëpunëtoret e saj te jashtëm, është

punuar afro tre vjet. Një pune e vështirë ka qene përzgjedhja dhe përgatitja e ilustrimeve, qe jane pjese e rëndësishme e promovimit te kësaj pasurie te madhe.

## NJË "PASAPORTË EVROPIANE" PËR SHQIPËRINË

Pyetje: Ne përshëndetjen e Dr. Koïchiro Matsuura, Drejtor i Përgjithshëm i Unesco-s, shkruar për botimin "Kodiket e Shqipërisë", dy dorëshkrimet me te vjetra kishtare te vendit, "Beratinus-1" dhe "Beratinus-2" jane shpallur pjese te programit "Kujtesa e Botes". Ç'vlere i kane bere këto dy dorëshkrime te jene pasaporta kulturore e këtij vendi ne programin me te rëndësishëm ndërkombëtar te vlerave te trashëgimisë njerëzore?

Përgjigje: Për here te pare këto dy dorëshkrime janë konsideruar te vlefshëm për programin "Kujtesa e Botes" ne librin "I Vangeli dei Popoli", botuar ne Rome nga Biblioteka Apostolike e Vatikanit, ne 2000-vjetorin e krishterimit. Pas pohimit te Dr. Matsuura-s ne fjalën përshëndetëse te botimit "Kodiket e Shqipërisë" nuk mbetet tjetër veçse regjistrimi formal ne këtë program. Kjo është arsyeja qe pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Arkivave është krijuar dhe ka filluar te funksionojë Komiteti Kombëtar i programit "Kujtesa e Botes". Dy dorëshkrimet qe ju përmendet janë te vetmet vlere kulturore qe janë shpallur pjese te këtij programi nga bota shqiptare.

"Beratinus-1" është një dorëshkrim qe njihet, se paku, qe nga fundi i shekullit te 12-te, kur "franket kampaneze", apo anzhuinët e Shampanjës, siç do te thuhej ne shqipen e sotme, qe zotëronin gjithë bregdetin shqiptar deri ne thellësi, kërkuan nga kisha dhe populli i Beratit te dorëzonin "ungjillin e arte".

Një studiues greko-shqiptar, Nikolaos Mystakidis, ne një studim te botuar ne vitin 1904 ne Athine, përmend disa burime antike, sipas te cilave "një ungjill i shkruar me ar e argjend" u porosit prej perandorit te

Kostandinopojës për t'iu dhuruar një kishë ne Illyricum-in e jugut, bashke me një copëz prej kryqit te kryqëzimit te Krishtit.

Afërsisht 135 vjet me pare, ne fillim peshkopi i Beratit, Athim Aleksudhi dhe me pas studiuesi belg Pierre Battifol, duke u marre me këtë dorëshkrim, patën vene re se shkronja e tij ishte aq e ngjashme me shkrimin e Shën Gjon Gojartit, saqë mund te besohej se ishte "tamam dora e tij". Te dy studiuesit, për te arritur ne këtë përfundim, i referoheshin një shënimi përshkrues për një ungjill qe ruhej ne Patmos dhe qe dihej se ishte dorëshkrim i Shën Gjon Gojartit.

Duke qene se, siç dihet, Shën Gjon Gojarti, një nga "katër dotorete" e kishës, siç pati shkruar P. Bogdani, ne vitin 407 vdiq, kurse dorëshkrimi "Beratinus-1" është pranuar te jete shkruar afërsisht nga mesi i shekullit te 6-te, me vone kjo lidhje u vu ne dyshim. Mirëpo kohet e fundit jane vene ne dukje fakte te rinj, qe tregojnë se kjo lidhje nuk mund te shturet kaq lehte. Se pari, sepse "Beratinus-" është shkruar "jo me vone se mesi i shekullit te 6-te", por askush nuk e ka përjashtuar se mund te jete shkruar me herët. Se dyti, sepse dy dijetare, fillimisht Zef Valentini (1929) dhe pastaj Kristo Frasheri (1995), nga burime te ndryshme, kane provuar me dëshmi te shkruara se Shën Gjon Gojarti e pati prekur fizikisht hapësirën e brendshme ilirike, duke qene "internue n'Epir" pikërisht ne vitet e fundme te jetës se tij. Murg dhe i internuar, dijetar reformator dhe njëkohësisht i rroposur si heretik - Shën Gjon Gojarti nuk kishte ngushëllim me te përkryer dhe me te bekuar se shkrimi i ungjijve.

Te tjerë studiues, shqiptare e te huaj, kane sjelle fakte qe mjeshtëria e shkrimit ne hapësirën historike shqiptare ka qene me karakteristika te dallueshme vendore. Unë e quaj shume te rëndësishëm faktin e vërejtur nga Prof. Neritan Ceka, i cili vëren një ngjashmëri befasuese midis shkronjës se "Beratinus-1" dhe shkronjës se përdorur ne mbishkrimet e byllineve ne krishterimin e hershem.

"Beratinus-1" është një prej tre arketipave me te përveçëm te dorëshkrimeve ungjillore ne shkalle botërore (Battifol, Mullen, Popa, Buda). Prej disa vitesh, me nismën e International Biblical Society, ne Londër punon një redaksi studiuesish te paleografisë, te bibliologjisë, te tekstologjisë kritike, detyra e se cilës është te përgatisë një tekst te shkencorizuar te Dhiatës se Re. Kjo redaksi ka përbërje ndërkishtare dhe mbështetet nga te gjitha kishat ne punën e saj. Pjesëtare te kësaj redaksie kane ardhur te këshillojnë kodikun "Beratinus-1", sepse nuk

mund ta arrijnë qëllimin që i kanë vënë vetes pa u njohur me përmbajtjen e tij. "Beratinus-1" ka ungjillin sipas Mateut dhe ungjillin sipas Markut. Lënda e këtyre dy ungjijve nuk është njësoj si në librat kanonike kishtarë. Disa shmangie të vogla, që studiuesit i kanë cilësuar si "shprehje e kompetencës së arsyes njerëzore mbi fjalën e shenjtes", kompetence që vetëm pak kohe më vonë do të merret fund, kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për krahasime dhe për të ndriçuar historinë e mendimit të krishterë në përgjithësi në shkallë botërore. Këtij qëllimi mund t'i ndihmojnë vetëm 4-5 sode të tjerë: "Vaticana B", "Sinaiticus", "Sinopensis", "Rosanensis" e "Petropolitanus".

Dorëshkrimi "Beratinus-2", ose "Kodiku i arte i Anthimit", çmohet për vlera të tjera, sidomos për kaligrafinë, që është e ngjashme vetëm me "Codex Graecae 53" (Peterburg) dhe që është kthyer në një pikë referencë për të gjithë ungjijtë shkronjëvegjël, për periodizimin e historisë së këtyre shkrimeve, para dhe pas tij. Tek "Beratinus-2", që është shkruar tërësisht me germa ari, gjenden edhe gjurme të shkrimit të periudhës së paleokrishtërit. Me e veçanta prej këtyre gjurmëve është ajo që quhet "shkronjë gjysme-onciale", që më vonë nuk shfaqet më në shkrim.

Pyetje: Jeni shprehur se në dorëshkrimet kishtarë të Shqipërisë ruhen dëshmi të një tradite të theksuar ekumenizmi. Ku e mbështetni këtë vlerësim?

Përgjigje: Ky vlerësim është i hershem. Në studimin tim vetëm se e kam paraqitur në një kontekst më të shëndetshëm, duke mos i lënë dëshmitë e përveçuara nga paraardhësit si episode pa lidhje me njeri-tjetrin. I pari ndër studiuesit huaj që vërejti këtë cilësi të çuditshme tek "Beratinus-1" ishte Pierre Battifol (1886). Duke shkruar monografinë "Codex Purpureus Beratinus et les manuscrits grec en Albanie", ai pati konstatuar se në kodikun "Beratinus-1" gjendej një arketip që nuk mund të hynte as në shkollën siriake-lindore, as në shkollën western-perëndimore, për shkak të ekzistencës së disa pasazheve kalimtare, të cilat kombinonin të dyja shkollat e shkrimit të krishterimit të hershem. Për këto kombinime, interferenca, mbivendosje dhe konvergjenca leximesh, ai përdori termin anglisht "conflate reading". Në këtë konkluzion Battifol pati arritur duke krahasuar tekstin e "Beratinus-1"

me modelet e shkollave dhe traditave të shkrimeve të krishterimit të hershëm, që gjendeshin në klasifikimin e studiuesve G. Westcott dhe Hort. Battifol identifikoi një pjesë të vargjeve ungjillore të Beratinus-1, që fillonin sipas traditës siriake-lindore dhe përmbylleshin sipas traditës western-perëndimore, ose anasjelltas.

A ka lidhje ky fakt me prirjen ekumenike dhe frymën e konvergjencës që është trashëguar në botën shqiptare? A është e rastit që arketipi i trete i tekstit të Dhiatës së Re, arketipi i ndërmjetme, i shkollës së konvergjencës, u shpreh si model pikërisht tek "Beratinus-1"? Le të kujtojmë se, në kohën kur u shkrua ky dorëshkrim dy perandoritë ishin ndare, kishte ndodhur herezia e parë e arianizmit, si dhe ishin kapërcyer skizma akaciane dhe ajo nestoriane.

Në një dorëshkrim të shekullit të 14-te, që ka qenë prone e mitropolitit të Beratit, ka lende martirologjike dhe jete shenjtore. Dy studiues shqiptarë, Theofan Popa dhe Kosta Naco, kanë konstatuar se ky dorëshkrim ka një rendësi të veçantë, sepse tregon për disa ndikime në jetën e kishës lindore prej qendrës të tjera kishtare, nga duhet të ketë ardhur arketipi i këtij martirologu, për t'u kopjuar me pas nga një shkruar vendës në greqisht. Në këtë dorëshkrim jetëshkrimet e martireve përshkruhen njësoj si në letërsinë martirologjike të karakterit perëndimor, megjithëse vepra është porositur për një kishë të ritualit lindor. Të gjendur para këtij fakti, të dy studiuesit arsyetojnë se ndoshta ktitore të këtij dorëshkrimi mund të kenë qenë familjet bujare të Topiajve apo të Balshajve, sundimi i të cilëve në atë kohë shtrihej deri në Berat, ku autoriteti i kishës lindore ishte më i fuqishëm, por Topiajt e Balshajt kishin lidhje të forta me krishterimin perëndimor. Jo vetëm teksti, por edhe miniaturat, e gjithë zbukurimorja, në këtë dorëshkrim është e karakterit perëndimor: veshjet e klerikëve të lartë, të figurave të mbretërve e perandorëve, duke përfshirë shëmbëllimin e shenjtoreve. Mbase "edhe vete piktori ka qenë nga Perëndimi".

Një kodik tjetër, dikur prone e një kishë në Berat, i shkruar në mesin e shekullit të 18-te, përmban letërsi ungjillore-morale (gr. "hrystoithia" - zakone të mira, zakone të arta). Joasafi, peshkopi i asokohshëm i Beratit, ka lënë një shënim, në të cilin thuhet: "Hrystoithia është përkthyer nga gjuha latine në gjuhën greke nga i dituri, i rëndësishmi, i shkëlqyeri Andon, profesor". Ka të dhëna që mund të provojnë se autori i origjinalit është një klerik florentin. Peshkopi beratas nuk pati

asnjë ngurrim për ta marre këtë vepër nga kisha romane dhe për t'ua dhënë besimtareve të ritualit lindor, duke ua rekomanduar si libër për veti të arta, për virtyte të shkëlqyera.

Pyetje: A ka ndonjë lidhje midis traditës 15-shekullore të dorëshkrimeve kishtare dhe historisë së shkrimit në gjuhën shqipe?

Përgjigje: Shqipëria, siç e kanë provuar dijetarë të huaj e vendës (Ceka, Korkuti, Zanichelli, Mullen), ka qenë një vend shkruesh (scribe) dhe shkrimtoresh (scriptorium-esh). Në qytetet kryesore të Shqipërisë mesjetare kishte shkollat bukurshkrimi. Fan Noli, në veprën e tij kushtuar Gjergj Kastriotit, informon kalimthi se Skënderbeut ia hartoi fermanin e rreme, me anë të cilit bëhej zot i Krujës në emër të sulltanit, një prej këtyre mjeshtrëve shkruesh.

Që ka pasur një shkollë shkruesh vendësishme shekuj para fillimeve të historisë së shkrimeve në gjuhën shqipe, kjo është krejtësisht jashtë dyshimit. Ka dorëshkrime në të cilat greqishtja shkruhet me shumë gabime drejtshkrimore, madje ka të tilla ku fjalëve në greqisht u hiqet fare mbaresa "-s", karakteristike për këtë gjuhë. Në disa kodike thuhet shprehimisht se porositës (ktitor) i veprës ka qenë kjo familje patronimike arbërore (sidomos Topiajt, Muzakajt dhe Arianitet). Në një anëshkrim që gjendet në "Kodikun e 50-të të Beratit", shkruar në vitin 1411, thuhet: "U përfundua se shkruari ky psaltir me kontributin dhe shpenzimet e të nderuarit jeromonak e arkimandrit Maksimit, dhe iu dha manastirit të shenjtë e të adhuruar të Virgjëreshës dhe u mor në dorëzim nga arkimandriti për përdorim në atë kishë të shenjtë të Perëndisë, si dhe për të mësuar fëmijët. Kushdo që e nxjerr jashtë kishës këtë psaltir pastë kundërshtarë Hyjlindesen. U shkrua nga dora e të përvuajturit, Teodorit, që ishte sekretar ("gramatia") i Beratit pranë zotit Teodor Muzaka, dhe që qëndron i burgosur prej tre vjetësh në kalanë e Skraparit. Kushdo që ta lexojë, të më kuptojë dhe të lutet për mua të mjerin, sepse e shkruajta me vuajtje të mëdha".

Në kohën kur Evropa u trondit rrënjësisht prej tërmetit rilindës të humanizmit dhe kisha përjetoi një prej reformave më të mëdha të historisë së saj, edhe në botën shqiptare lindi shkrimi në gjuhën e vendit. Nuk është e rastit që veprat e para të dorëshkuara dhe të shtypshkuara të letrave shqipe i takojnë pikërisht fondit të letërsisë së krishtere. Bukurshkruesit shqiptarë barten një prej traditave kulturore



me jetëgjata të popullit dhe lehtësuan kalimin prej shkrimit në gjuhët imperiale në shkrimin në gjuhën kombëtare.

Pyetje: Si shpjegohet që dorëshkrime ungjillore në latinisht kanë mbetur fare pak deri në kohërat moderne, krahasimisht me ato në gjuhën greke?

Përgjigje: Mbase duhet thënë me sakte se kanë mbetur fare pak në hapësirën shqiptare, sepse e vërteta është pak me ndryshe. Nuk ka ndonjë shpërpjesëtim midis dorëshkrimeve në greqisht dhe atyre në latinisht. Në një kodik që dikur u ka takuar autoriteteve kishtarë të Durrësit, jo më i vonët se shekulli i 15-te, gjuha e kronikes ndryshon vetëtimthi nga latinishtja në greqisht dhe anasjelltas e përsëri në të kundërtën. Në hapësirën shqiptare nuk ka qene ndonjë dukuri e çuditshme ndryshimi i autoritetit të kishave, romane e bizantine, dhe bashke me të edhe ndërrimi i autoritetit të gjuhës së shkrimeve. Provat tregojnë se shumica e dorëshkrimeve ungjillore të botes arbërore shtegtuan drejt Perëndimit bashke me mërgatën e parë të fisnikërisë vendëse. Në argjipeshkvinë e Rossano Calabro-s gjendet një kodik me një shkronjë- binjake me ate të "Beratinus-1". Ky kodik, që njihet me emrin "Rosanensis", ruhet në Rossano prej afro 5 shekujsh. Ka studiues që nuk e shohin të rastit as ngjashmërinë Beratinus-Rosanensis, as faktin që ky rajon i Italisë jugore prej pese shekujsh banohet nga popullsi arbëreshe. Në një shkrim të kohëve të fundme I. Kadare është shprehur se bojaria shqiptare, duke marrë rrugën e mërgimit, nuk harroi të merrte me vete kujtimet e të parëve, armët, emblemat, stolitë, kryqet, epitafet, kambanat dhe kambanoret. Faktet na provojnë se familjet patronimike morën me vete edhe shkrimet e lashta. Shume kodike mesjetare, shkruar në latinisht, që lidhen me hapësirën historike dhe kulturën kombëtare shqiptare, gjenden në biblioteka perëndimore. Vete "Meshari i Gjon Buzukut", në sinjaturen burimore të vendit ku ruhet (Biblioteca Apostolica Vaticana), është dorëshkrim i tipologjisë "kodik". Prof. Kristo Frasheri përmend dorëshkrimin ku gjendet "Formula e pagëzimit", duke e paraqitur me titullin "Kodeksi i Pal Engjellit". Ky kodik ka 37 flete, të numërtuara me dore, dhe përmban krysobulat perandorake bizantine, por në latinisht! Një studiues më i hershem, që nuk ka nënshkruar, në artikullin me titull "Për rreth botimit të dorëshkrimit shqyp të shekullit të 14-te",

botuar ne "Hylli i drites", nr. 7-8, 1930, ka veçuar edhe dorëshkrime te tjera ungjillore, qe terminologjikisht janë emërtuar "kodike" dhe qe ruhen ne biblioteka perëndimore. Veç "Ungjillit te pashkëve", si kodik nga ky autor përmendet madje edhe një "Vjershe e paleçitur e Gavrilit i Dharenjevet", vepër e shekullit te 17-te, dialekti i shqiptareve te Italisë, qe ka si tregues burimi: "Codice Barberini latin. 3454, XLIII, 2". Ne te vërtete, i njëjti numër reference, "Codice Barberini Latino 3454", ne pronësi te Bibliotekës Apostolike te Vatikanit, perveçon veprën ne dorëshkrim te Lukë Matranges "Dottrina cristiana - albanese", veçse me nen-ndarjen LXIX.

"Shproporcionet" qe vërehen ndërmjet dorëshkrimeve greqisht dhe atyre latinisht duhen kuptuar duke pasur ne konsiderate çfarë ndodhi me kishën e ritualit roman pas Reformes dhe sidomos pas Kunderreformes. Një shumice dorëshkrimesh te karakterit ungjillor, liturgjik dhe

teologjik-filozofik, për t'u lejuar te botoheshin, duhej te paraqiteshin ne zyrat eprore te Propagandës se Shenjte, qe kishte autoritetin te jepte lejen e shtypshkrimit. Është i njohur tashme fati i dorëshkrimit te "Çetës se profetëve", një kopje e autografit te cilit mbeti ne Raguze, gjate udhëtimit te autorit për ne Padova, ku do te merrej vendimi për dhënien ose jo te lejes se botimit. Dorëshkrimi origjinal qe ruhet ne Dubrovnik dëshmon se veprës se botuar i mungon gati një e katërta, ne mos me shume.

Studiuesi i njohur Miroslav Vanino, ne librin e tij "Aleksandar Komulovic", botuar ne Sarajeve ne vitin 1935, njofton se "ne vitin 1584 ... ne Rome u shtypen 500 katekizma ne gjuhen shqipe, te porositur prej priftit Duka Armani, i cili ne vitin 1590 u be peshkop i Shkodrës dhe se bashku me një shqiptar te shkolluar i morën këto libra ("Na početku g. 1584 krenuše vizitator iz Rima preko Ancone Jakina, Hvara i Dubrovnika u Albaniju, ponesavši uz misale i razne knjige još mnogo nabožnih predmeta, kojima će darivati svećenike i narod. U Rimu su dali otisnuti 500 katekizama na albanskom jeziku. Pratila su ih tri albanska: svećenik Duka Armani, koji je g. 1590 postao skadarski biskup, jedan djak Ilirskog Koegija i još jedan školovani Albanac, koji će toga djaka pomagati u poučavanju "str. 44, vep. cit.). Nuk është e vështire te çmohet rëndësia e këtij katekizmi te shtypur ne 500 kopje shqip, qofte edhe për faktin se ky tirazh nënkupton ekzistencën e një lexuesi te rëndësishëm, brenda klerit dhe ne boten laike.

Kodike janë edhe aktet përmbledhëse të së drejtës urbane mesjetare, që u themeluan në periudhën e fisnikërisë arbërore. Njeri prej tyre, ai që njihet me titullin "Statutet e Shkodrës", ruhet në: Venezia, Biblioteca Museo Correr, Mss. Correr 295. Ky dorëshkrim quhet "Codice cartaceo in 8<sup>o</sup> del secolo 16-simo di 40 carte numerate e 9 non numerate" - "Statuti della città di Scutari", conserv. presso il Consiglio dei X.

Pyetje: A ka gjurme të etnosit shqiptar në bibliotekën e dorëshkrimeve të Shqipërisë dhe nëse nuk ka, pse duhet t'u kushtohet vëmendje?

Përgjigje: Tradita e shkrimeve biblike e ungjillore në Shqipëri, një prej traditave më të vjetra të kulturës së kësaj bote, "te botes sane", siç thoshin klasikët e shkrimit shqip, e afirmuar në plotësinë e vet, na lejon të mendojmë se në përmbajtjen e tyre ka bote laike dhe etnos shqiptar, drejtpërsëdrejti e tërthorazi. Në tërësinë e studimeve kushtuar këtyre shkrimeve, që zgjaten në afro 140 vjet, del përfundimisht se në hapësirën shqiptare, qysh prej periudhës ilirike, ka ekzistuar një shkolle lokale shkruesish; dhe kjo shkolle shkruesish e scriptorium-esh bënte pjesë në historinë e shkrimit dhe të kulturës vendëse. Ajo është një prej dëshmive më të drejtpërdrejta të vazhdimësisë iliro-shqiptare edhe në periudha të "boshllëkut" historik. Prej kësaj tradite, nëse kemi vullnetin e mjaftueshëm, në mund të zbulojmë një "Shqipëri tjetër", një Shqipëri që ka pasur gjithnjë elitën e vet kulturore dhe ka rrojtur me shije metropoli; një Shqipëri evropiane që ka ndjekur rrjedhat më të përparuara të kohës. Në këto dorëshkrime ka jo vetëm lende kishtarë, por edhe shumë bote laike, etnos në kuptimin e plote të fjalës, kulture e qytetërim, që mund të duhet të ndriçohen. Por për këtë nuk mjafton vetëm vullneti. Së pari duhet një konceptim antropologjik për kulturën dhe traditën e vendit. Kjo do të thotë që etnosi shqiptar të mos kërkohet vetëm në gabimet drejtshkrimore të atij shkruesit që greqishten nuk e kishte gjuhë amtare dhe madje guxonte ta shkruante pa formante. Një shumicë dorëshkrimesh kishtarë janë të karakterit të nomokanoneve. Në këto dorëshkrime e drejta kanonike kishtarë gërshetohet në mënyrë të pandashme me të drejtën zakonore vendëse. Bota laike në lenden biblike të kodikeve vjen duke zënë vend gjithnjë e më shumë gjere, sidomos gjate dhe pas Rilindjes Evropiane.

Ne një prej kodikeve të argjipeshkvisë së Shkodrës gjendet një dorëshkrim i shkurtër dygjuhësh, shqip e italisht, i vitit 1744, në të cilin janë shënjuar 19 mallkime "chi i lescon ypesckfi teinten emade" ("që mund t'i urdhëroje ipeshkvi të enjten e madhe"). Në këto mallkime ka informacion të përmbledhur për presionet e së drejtës zakonore lokale mbi të

drejtën kanonike kishtarë, për shkak të shfaqjes së faktorëve të rinj në mjedisin tradicional. Dy prej këtyre mallkimeve informojnë për rrezikun e martesës jashtë kurore dhe për shfaqjen e poligamisë, nën këtë presion, të dhëna këto që janë me vlefshmëri jo të zakonshme për etnologët: "Kioft mallekuem ai, chi nsve unor me prift te famullies mbate nat chi martohet", "Kioft mallekuem ai, chi te mbaan dyy graa" ("Qofte mallkuar kush s've kurore në kishë ditën e martesës", "Qofte mallkuar ai që merr dy gra"). Një pjesë e kodikeve, si "Kodiku i 100-te, i Fierit", ose me gjere i njohur me emrin "Kodiku i manastirit të Shen Kozmait", kanë lende të mirëfillte etnografike: kontrata fejesash dhe martesash, si mund të martohet një i krishterë me një jo të krishterë etj.

Tani edhe mund ta prekësh Kodikun e Purpurt të Beratit. I purpurt për shkak të pergamenës, si shenjë respekti hyjnor ndaj shkrimeve të shenjta e cila pas shek. VI nuk do të përdorej më. Për 15 shekuj ky kodik ose i quajtur Beratinus u shfaqej në praktikën liturgjike besimtarëve vetëm një herë vit në ditën e emrit të Shën Gjon Gojartit. Kjo ndodhi deri në vitet 30 të shek. XX. I rrezikuar katër herë seriozisht për t'u grabitur. Tani edhe mund ta prekësh Beratinus-in, gjithçka për një nga 7 dorëshkrimet e purpurta e më të vjetra në botë të Besëlidhjes së Re, në studimin e dr. Shaban Sinanit që mban të njëjtin titull, "Beratinus".

Codex Purpureus Beratinus- Kodiku i Purpurt i Beratit, një dorëshkrim bibliok-ungjillor konsiderohet si dëshmia më e hershme e krishterimit nëpër trevat shqiptare. I parë në dritën e antropologjisë kulturore në studimin e dr. Sinanit, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Beratinus 1 ose Beratinus zë një vend në hapësirën shpirtërore të njerëzimit. I shkruar me ar dhe argjend ai është dëshmi e një shkolle vendase e kopjimit të teksteve të shenjta, por nuk është një apokrif i Testamentit të Ri. Dëshmi e Beratit si qytet i skriptorëve në shek. IV-V ose i shkruarve të fjalës së shenjtë "skriberëve" që ishin "mjeshtër të

një prej arteve më të vjetër të zbatuar, artit të bukurshkrimit". Studiuesi Sinani vlerëson në veçanti kontributin e Theofan Popës, për përshkrimet që iu bënë kodikëve në tërësi, koleksioni i tyre është rreth 100, në kohën kur nuk mund të zihet në gojë emri i Virgjëreshës, e jo më lutja asaj. Është padyshim edhe meritë e studiuesit Sinani i cili prej vitit 2000 kur një pjesë e Kodikut të Purpurt të Beratit do të ekspozohej për herë të parë jashtë vendit në ekspozitën "Ungjijtë e popujve" në Vatikan në 2000 vjetorin e Krishterimit, do të tërhiqte përfundimisht vëmendjen ndërkombëtare ndaj kësaj pasurie të rrallë të krishterimit të hershëm në Shqipëri, i ruajtur për 15 shekuj në të njëjtin territor, shqiptar. Së fundi janë depozituar pasaportat e dy kodikëve Beratinus 1 dhe Beratinus 2 në programin e UNESCO-s "Kujtesa e Botës" ku tashmë komisioni i posaçëm ka marrë miratimin e shpalljes së tyre.

Një pjesë e mirë e dorëshkrimeve kishtare që përshkruhen në këtë libër janë porositur prej familjeve të mëdha aristokratike të periudhës së Skënderbeut. Ka dorëshkrime të porositura dhe të paguara prej Muzakajve, Topiajve ka dhe një dorëshkrim të porositur prej Gjergjit të Madh, për të cilin diskutohet nëse është Gjergj Kastrioti apo është Gjergj Arianiti. Përveç të tjerave, ka dhe një dorëshkrim që lidhet drejtpërsëdrejti me figurën e Skënderbeut. Është dorëshkrimi, kodiku i statutit të qytetit të Drishtit dhe për kështjellat që kishte nën administrim Skënderbeu, kodik i konfirmuar prej kryekancelarit të Skënderbeut, Pal Ëngjëlli, madje dhe faksimilja e zgjedhur për ilustrimin e atij dorëshkrimi ka në përmbajtje pikërisht emrin e Pal Ëngjellit. Pra, është një lidhje me familjet patronimike shqiptare ndër të cilat ka qenë dhe familja e Kastriotëve, të cilat kanë qenë siç quhet në terminologjinë e dorëshkrimeve të vjetra ktitorë-porositës. Ky ka qenë rregulli në të gjithë periudhën mesjetare. Familjet e mëdha porositnin dorëshkrimet kishtare, sepse ishin shumë të kushtueshme. Dhe shënohet emri i atij që e kishte kopjuar, shkruar dhe emri i ktitorit i cili ia kishte dhuruar këtij manastiri apo asaj kisha. Kjo është lidhja, nuk është thjesht viti i botimit. Brenda dorëshkrimeve kishtare ka mjaft informacion për familjet patronimike shqiptare. Koha e shkrimit të Kodikut nuk përkon me kohën e lavdisë së Skënderbeut, në këtë kohë Gjergji i Madh nuk ishte Gjergj Kastriot Skënderbeu i cili akoma nuk ishte bërë emër i mirënjohur. Po të shikoni treguesin e emrave aty dalin të gjithë mbiemrat patronimikë shqiptarë. Të gjitha familjet e

mëdha kanë porositur, janë kujdesur, kanë dhuruar ose ka informacion për to.

Si rrjedhojë parashtrohet pyetja se nga ç'traditë lindi ky kodik dhe çfarë dëshmon për arealin e Beratit të asaj kohe?

Poqëse i qasemi kësaj çështje duhet hyrë pak thellë në histori. Berati është një prej qyteteve që i ka dhënë botës shqiptare, për botën e madhe, jo një emër, po një mbiemër pra Beratinus-Beratini. Në një farë mënyrë ka bërë të famshme një traditë me anë të një mbiemri që ndodh shumë rrallë. Nuk ka ndonjë qytet tjetër në Shqipëri që të ketë dhënë mbiemra përveç Beratit. Kjo është e lidhur me faktin se Berati ka qenë një kryeqendër kishtare, kronologjikisht mbas Bylisit dhe Gllavinicës si kryeqendër, sepse si qendër ipeshkvnore del që në shek.IV, kur nuk e kishte këtë emër, por kishte emrin Bulheriopolis. Berati e ka ndryshuar disa herë emrin, Antipatrea, Bulheriopolis, Belegrado, Berat siç është sot. Për hir të këtij roli, si kryeqendër kishtare në Shqipëri, rol që filloi të zbehej mbas mëkëmbjes së argjipeshkvisë së Ohrit, dëshmohet që në Shqipëri ka pasur një shkollë tradicionale shkrueshish. Berati ka qenë kryeqendra e mjeshtërisë së të shkruarit. Për këtë arsye thuhet se ka një shkollë shqiptare të shkrimit. Shkrimi nuk është dhe nuk mund të pretendohet vetëm në gjuhën amtare. Pretendimi për ta reduktuar vetëm në gjuhën amtare si pretendim varfërues për kulturën kombëtare, në çfarëdolloj forme, është historia e të shkruarit në gjuhën perandorake, në radhë të parë në gjuhën greke, pasi Berati bënte pjesë nën përgjegjësinë juridike të Patriarkanës së Stambollit. Pra Shqipëria kishte një shkollë shkrimesh dhe Berati ishte kryeqendra e kësaj shkolle. Kanë ekzistuar zeje, shkolla të vërteta ku nxënësit mësonin bukurshkrim, për t'u përgatitur si kopjues të letërsisë ungjillore dhe biblike.

Ç'vend zë Beratinus në hierarkinë e dorëshkrimeve kishtare të Shqipërisë?

Beratinus është një dorëshkrim që nuk e nxë hapësira shqiptare, nuk mund të vendoset në një hierarki brendapërbrenda hapësirës shqiptare as asaj të sotme, as në atë historike. Ai mund të vendoset në një hierarki vetëm në shkallën botërore të historisë së dorëshkrimeve kishtare. Nëse do të kërkohej kjo hierarki, dy prej gjërave elementare që mund të thuhet janë që: Beratinus 1, Beratinusi i parë është një prej

tre arketipeve të Dhjatës së Re në shkallë botërore. Ka një arketip siriak apo lindor, ka një arketip perëndimor, ka dhe një arketip të ndërmjetëm që është Beratinus. Të gjitha studimet vertikale, historike të tekstologjisë kritike për historinë e shkrimit ungjillor nuk mund të bëhen pa iu referuar Kodikut të Purpurt të Beratit, Beratinus.

Ka dhe një hierarki tjetër. Në gjithë botën ka shtatë kodikë të purpurt nga të cilët dy janë në Shqipëri dhe të dy janë Beratinus. Sa i takon një hierarchie të brendshme, të dy kodiket më të hershëm janë të përjashtuar, sepse askush nuk mund të jetë konkurrentë me to. Mbas kodikut të dytë të Beratit fillon konkurrimi i disa shkollave. Janë kodikët e Vlorës që shfaqen diku nga shek. X, kodiket e Gjirokastrës që shfaqen më vonë, të Korçës po ashtu, të Shkodrës. Ndoshta do të kishte qenë e mundshme që të vendosen të dy kodiket më të vjetër të Beratit në një hierarki të brendshme nëse do të ishin ruajtur tri dorëshkrimet të cilat përmenden në burime, por që sot nuk ekzistojnë. Për shembull, Batiffoli që është marrë i pari, para 140 vjetësh, me Beratinusin thotë se kishte parë në Berat një dorëshkrim të shek. IV i cili sot nuk gjendet dhe kishte mësuar se në Gjirokastrë ruhej një kodik i shek. IV dhe një kodik i shek. I, por këta dy kodikë nuk gjenden. Po ashtu themeluesi i historisë së krishterimit, Origeni, përmend që në Drianopolis ka ekzistuar një dorëshkrim ungjillor i shek. I. pra po të kishin ekzistuar këto dorëshkrime do të mund të bëhej një hierarki. Arsye të tjera që kjo vepër hyn në "Kujtesën e Botës"?

Ndër arsyet që e bënë këtë vepër të jetë pjesë e programit "Kujtesa e Botës" është se është një dorëshkrim ungjillor kanonik, pra i përdorur si libër liturgjie dhe meshimi nga kisha deri në shek. XX. Por njëkohësisht ka fragmente të pjeshme të cilat përbëjnë shmangie të vogla jokuptimore, por shmangie formale prej tekstit kanonik. Si të thuash, shkruesi i dorëshkrimit i ka dhënë vetes të drejtë që diçka të ndryshojë. Prof. Aleks Buda që është marrë herët me këtë dorëshkrim thotë që ky fakt tregon se në kohën kur u kopjua apo u shkrua ky kodik, akoma arsyeja njerëzore kishte kompetencë mbi tekstin hyjnor, ungjillor. Ky raport, e drejta për të ndërhyrë mbi një tekst tashmë të kanonizuar që nuk gjendet në dorëshkrimet e tjera, por vetëm tek ky dorëshkrim dhe që mund të shërbejë për të dëshmuar evolucionin e mendimit të krishterë, i jep rëndësi botërore.

Ky studim është një përpjekje për ta parë Beratinus në këndvështrimin e antropologjisë kulturore... Sepse duke u nisur prej faktit më elementar që është kulturë e lidhur me botën shqiptare, por që nuk mund të quhet një kulturë mirëfilli shqiptare. Është një kulturë që i takon kësaj bote dhe një kulturë që i takon njerëzimit mbarë. Kultura e ruajtjes është kulturë e këtij populli, e kësaj hapësire. Kultura e pritjes në momentin e fillimit është kulturë e kësaj hapësire. Kultura e krishterimit të hershëm gjithashtu është kulturë e kësaj hapësire. Shumë pak popuj kanë pasur krishterim të hershëm. Por vetë teksti është tekst ungjillor që i takon njeriut, qenie e kësaj bote, pra është një tekst mbikombëtar. Nëse do të flitej për një dorëshkrim që i takon një tradite kulturore kombëtare, atëherë do të ngushtohej shumë, deri në një zhvlerësim, vlera e këtij dorëshkrimi. Kjo është kontradikta e parë që duhet të kapërcejë studiuesi kur merret me një dorëshkrim të tillë. Ka një raport shumë delikat midis pjesës kombëtare dhe pjesës ndërkombëtare që nuk dihet cila është më shumë. Së dyti, këto dorëshkrime nuk mund të studiohen me disiplinë në ngushtë. Detyrimisht bashkojnë disa dije duke përfshirë historinë e krishterimit, sidomos të krishterimit të hershëm, historinë e shkrimit, historinë laike të popujve, etnologji dhe etnografi, historinë e së drejtës, deri diku dhe historinë e arti, të dizajnit, të vizatimit. Shkenca etnologjike nuk do të mjaftonte për të studiuar këtë traditë shkrimesh në Shqipëri, ajo mund të merrej shumë-shumë me pjesën e informacionit laik që përmbajnë këto dorëshkrime, që në fakt janë anëshkrime. Vetëm në hyrje dhe në mbyllje të dorëshkrimeve ka tekste laike, sikurse ka tek "Meshari" i Gjon Buzukut në pasthënie. Etnologjia mund të merrej dhe me raportin e të drejtës zakonore, me të drejtën kishtare në disa dorëshkrime që quhen kanone, nomokanone, që janë rregulla të brendshme të jetës së kishës. Po ashtu historia nuk do të ishte e mjaftueshme për t'u marrë me këtë traditë, sepse kjo histori arti në një farë mënyre, nuk është histori politike. Tjetër arsye që çon tek pranimi i këtij vështrim antropologjik është domosdoshmëria e një konvergjence të disa dijeve.

Me botimin e kësaj monografie, do të thoshit se s'do të bënit dot një libër "tjetër si ky", pse?

Nëse nuk do të isha në këtë detyrë që jam, jam i bindur se këtë vepër unë nuk do ta kisha shkruar. Jo vetëm unë, po kushdo që do të përiqej



të shkruante një libër të tillë, duke qenë abonent i jashtëm i shërbimit arkivor. Kam pasur mundësinë që të këshilloj lirisht dorëshkrimet që janë baza dhe pikënisja e punës, të kem në dispozicion mjetet e informimit sado të thjeshta e të kufizuara që janë për këto dorëshkrime, për faktin se në periudhën kur janë hartuar nuk ishte e lejuar të shkruhej për përmbajtjen. Juve mund t'ju duket e çuditshme, por i ndjeri Theofan Popa që ka hartuar pasaportat e 100 kodikëve të Shqipërisë të cilat janë botuar para dy vitesh, nuk kishte guxim të përmendte emrin e Shën Mërisë dhe kur harton pasaportën e një dorëshkrimi thotë: në këtë imazh gjendet një figurë të cilën sllavët e quajnë Bogorodica. E thoshte kështu që të paktën njerëzit me të cilët punonte të mos e merrnin vesh se po bëhej fjalë për Shën Mërinë, pasi ndalimi fetar bënte që as emri i Shën Mërisë të mos përmendej. Ai informacion ka qenë një bazë e mirë për të inkurajuar punën time. Fillimi ishte hartimi i pasaportës ndërkombëtare të udhëtimit të Kodikut të Purpurt të Beratit për në Vatikan, në vitin 2000. Hap pas hapi mu krijua një bibliotekë shumë e pasur. Vërejta një solidaritet të jashtëzakonshëm të dijetarëve që merren me këtë fushë, sidomos të dijetarëve, austriakë, gjermanë, francezë, italianë, grekë, të njohur e të panjohur që më dërgonin vazhdimisht libra. Asnjëherë nuk e kisha menduar se ekzistonte një literaturë kaq e bollshme, një bibliotekë e tërë, për studimin e kodikëve të Shqipërisë. Ka një shporpacion shumë të madh midis studimit të këtyre kodikëve nga autorët shqiptarë në krahasim me vëmendjen që u është kushtuar këtyre dorëshkrimeve në letërsinë e ngjashme ndërkombëtare. Ka një shkollë studimesh të paktën prej 140 vjetësh për studimin e kodikëve. Në këtë kuptim kjo do të mbetet një temë e hapur për mua. Është një libër i hapur dhe një libër që më tremb në kuptimin e plotë të fjalës. Vërtet, zor se mund të shkruaj diçka tjetër të tillë.

Vetëm këto vite të fundit Beratinus po fiton njohjen ndërkombëtare, duke hyrë dhe në "Kujtesën e Botës" si dëshmi e krishtëritimit të hershëm në Shqipëri, ndërkaq Shqipëria e sotme si për paradoks njihet si myslimane.

Çfarë mund "të rregullonte" në këtë kontekst imazhi i ekzistencës së një dorëshkrimi të rrallë?

Ka dy vështirime mbi besimin e një populli. Vertikalisht shqiptarët janë një prej popujve më të krishterë të botës. Nuk besoj të ketë as në Greqi, as në Itali, në Romën e dikurshme, peshkopë që në vitin 56. Në

këtë vit kemi në Durrës peshkopin Caesar. Po të hapim vëllimin e 8 të Illyricum Sacrum, në Durrës ka peshkop që në vitin 56. Është një prej vendeve që është ungjillizuar në kohën e apostujve. Nuk dua të bëj krahasime, por shumë popuj të tjerë janë ungjillizuar 7-8 shekuj më vonë. Ungjillizim në periudhën e krishtërimin të hershëm kanë pasur grekët, shqiptarët, romakët, latinët dhe thuhet se krishterim të hershëm ka pasur dhe në Spanjë. Në vende të tjera të Rajonit krishterimi fillon pas shek.5-6. Vetë fakti që nëpër hapësirën shqiptare janë zhvilluar aq e aq kryqëzata tregon se në këtë vend që ishte krishtëruar kalonin popuj të cilët për të marrë, si të thuash, pagëzimin si të krishterë udhëtonin prej Britanisë siç është rasti i Rikard Zemërluanit, deri në Jeruzalem që të bëheshin të krishterë. Mund të thuhet që Illyricum-i ishte për 15 shekuj i krishterë, prej shek.I-XV. Nuk ka qenë një popull i krishterë për modë, për solidaritet. Ka qenë një popull që ka kontribute të përveçme në krishtërimin e hershëm. Nxori Shën Jeronimin që i dha Perëndimit të parin përkthim të Biblës në latinisht, "La Vulgata", është populli që nxori Shën Niketën e Dardanisë që kompozoi të parën lutje të krishtërimin "Te deum laudeamus"-Ty Zot të lavdërojmë, që vazhdon të jetë kryelutje, një popull që dha martirë dhe shenjtorë, shën Cezari dhe shën Ashti në Durrës, që e përjetoi në mënyrë aktive krishtërimin e hershëm, megjithëse në këtë periudhë ishte një krishtërim ilegal. Nuk kishte dalë akoma Dekreti i së dielës, i vitit 321 që shpallte ditën e diel si ditë të Zotit dhe krishtërimin si fe të njerëzimit. Rrethanat historike shpjegojnë islamizimin e një pjese të madhe të shqiptarëve pas shek.XV-XVI që nuk duhet marrë si një dukuri që përfaqëson një devijim, sikur ka ndodhur një deformim, si ndonjë hata në botën shqiptare. Por nëse do të kërkohet në thellësinë e besimit të shqiptarëve, gjithkund do të dalë shtresa e krishterë. Malësorët e Shqipërisë së veriut festojnë Shën Gjergjin, Shën Mërinë, Shën Gjonin, Shën Markun. Në faltoren e Shna Nout në Milot, kanë shkuar dhe shkojnë të krishterë e myslimanë për të shprehur lutjen dhe vullnetin e tyre, për të çliruar besimin e shërimit apo tejkalimit të vështirësive, pra thjesht për devocion. Për këtë arsye është dhe një vepër që i kushtohet heroit të fundit të krishtërimin? Është edhe kjo padiskutim, një shprehje nderimi për figurën protagoniste të fundit të krishtërimin të lulëzuar në Shqipëri. Krishterimi nuk lulëzoi më pas Gjergj Kastriot Skënderbeut. Por është siç e thashë në fillim dhe një tërheqje

vëmendjeje për të mos e kuptuar këtë vepër thjesht si një histori e shkrimeve biblike-ungjillore në Shqipëri. Duke e lidhur këtë botim me emrin e Gjergj Kastriotit, është një ftesë për ta lexuar si një libër ku bota laike shqiptare, bota e fisnikërisë arbërore është shumë e pranishme dhe disa të dhëna që gjenden në këto dorëshkrime janë të vlefshme për të vendosur ngjarjet në kronologjinë e tyre. Janë të vlefshme dhe për historinë si të tillë, jo vetëm për historinë e shkrimeve.

Kodikët janë objektet më të vjetra dhe më origjinale që vërtetojnë për kulturën e traditën e lashtë të popullit tonë ndër shekuj. Kodikët janë libra që përmbajnë shkrime të shenjta agjiografike e jetë shenjtorësh. Kodikët konsiderohen si dëshmitë më të hershme të historisë së shkrimit nëpër trevat shqiptare. Rëndësia shkencore e të dhënave historike që përmbajnë Kodikët kishtarë qëndron në faktin se ata janë me prejardhje shqiptare. Zbulimi i Kodikeve vërteton qartë se Kisha Orthodhokse ka qenë djepi i kultivimit dhe i ruajtjes së kulturës kombëtare. Në Arkivin Qendror të Shtetit ndodhen 100 kodikë të plotë. Por ky nuk është numër i saktë, sepse kërkimet e viteve të fundit kanë bërë të mundur evidentimin e mjaft Kodikeve të rinj, që ruhen nëpër bibliotekat familjare. Të gjithë këta të marrë së bashku e pasurojnë gjeografinë e shpërndarjes së tyre. Përsa i përket përmbajtjes, Kodikët janë një kompleks i vlerave shpirtërore.

Kodikët u shkruan kryesisht prej shekujve VI-XVIII-të. Pothuajse të gjithë përfaqësojnë dorëshkrime me përmbajtje biblike e liturgjike (jetë shenjtorësh dhe histori kisha). Në Kodikët e shek. XII-të e këndej ka edhe të dhëna etnografike. Gjithashtu në Arkivin Qendror të Shtetit ndodhen edhe 17 Kodikë të dëmtuar, të cilët janë vetëm fragmentarë.

Kodikët janë të larmishëm e ndryshojnë ndërmjet tyre:

- Kodiku i shek.VI-të është shkruar me shkronja kapitale, me argjend të shkrirë, në pergamenë të purpurtë.
- Kodiku i shek. IX-të është shkruar me shkronja të vogla ari.

Kodikë të tjerë të shekujve të mëvonshëm janë të shkruar me shkronja ngjyrë kafe, iniciale ari, në pergamenë ose në letër. Gjuha me të cilën janë shkruar Kodikët është greqishtja e vjetër ose latinishtja si edhe pak sllavishte e vjetër. Kaligrafia prej ari e argjendi është shoqëruar

edhe me silueta figurinash me motive lulësh, vinjeta në formë katërkëndëshi, me shpezë të stilizuar jashtë vinjetave etj. Ka Kodikë ku çdo faqe paraqet diçka të veçantë. I tillë është një nga Kodikët e Beratit ku në çdo faqe, kanonet e Eusebit janë stolitur me skema gjeometrike, kolona e fusha të pikturuara me lule të stilizuara. Kapakët e këtyre librave janë kryesisht prej dërrase, të veshur me lëkurë apo pëlhurë kadife të stampuar me pamje ungjillore, motive lineare të pasuara me lule e gjethe të stilizuara. Arkivi Qendror i Shtetit disponon një katalog me rreth 200 faqe dorëshkrim, ku përshkruhet përmbajtja e çdonjërit prej Kodikëve. Ky katalog është hartuar nga teologu i apasionuar Theofan Popa.

## SPROVË PËR PASTËRTINË E GJUHËS SHQIPE

Kostaq Xoxa

Libri i fundit i Mehmet Elezit, "Gjuha shqipe në bunker?" (2005) nuk është vetëm "një sprovë e përvujtë", siç e cilëson me modesti shkrimtari dhe publicisti Mehmet Elezi, i cili na zbulohet edhe si gjuhëtar, por është, në të vërtetë, një studim i thellë gjuhësor që meriton vëmendjen më të madhe të gjuhëtarëve dhe të dashamirëve të gjuhës sonë, në procesin aq të vështirë dhe të ndërlikuar të standardizimeve. E japim në shumës fjalën "standardizimet", sepse këto kanë interes të jashtëzakonshëm në këtë vepër. Janë, madje, nga më të debatuarat. Autori, në këtë libër të ri, pas veprave të shumta me karakter letrar (në poezi e në prozë), pas veprave me përmbajtje të publicistikës, të historisë (shto edhe atë gjuhësore, veçanërisht), pas përsiatjeve dhe studimeve me tipare kombëtare, ka ndërmarrë tani përballimin e problematikës të gjuhës shqipe të sotme, me një kahje (sens) tepër kritike. Veçse në këtë detyrë të një gjuhëtari të mirëfilltë ai, pavarësisht nga mendimet vetjake gjuhësore që i shpalos në këtë libër, e respekton njësimin gjuhësor të fundit (në kuptim të sanksionimit), ndonëse ky njësim u bë, për fat të keq, gjatë kohës së një regjimi totalitar dhe diktues edhe në shkencë.

Këtu më duket se duhet me dallue dy veçori, me rëndësi të padyshimta: Së pari, se koha kishte bërë të detyrueshme (imperative, urdhëruese) një gjuhë të njëjtë, të shkruar dhe të përdorur në mediat, për të gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë kufijve zyrtarë. As diktatura (aq më tepër ajo, me megalomaninë e saj tipike,) nuk do të duronte një gjendje inferioriteti gjuhësor, - ende në dy kryedialekte kryesore, - përkundërt gjuhëve të tjera evropiane, të cilat rrethanat historike, - fatlume për to, - i kishin ndihmuar më tepër e më shpejt në njësimin e gjuhës së tyre, ndërsa gjuha jonë tepër e lashtë, "nga më të lashtat" sipas d'Anzhelisë, nuk kishte arritur tanimë në këtë stad. Nga ana tjetër një gjuhë e pakristalizuar në këtë drejtim do të ishte jashtëkohore (anakronike); e kjo u vu re edhe pas diktaturës në çështjen gjuhësore, që mori përmasa mjaft acaruese, të cilat u vunë re në Konferencën e Ohrit. Do të mjaftonte si shembull për problemin, që nuk mund të merret i shkëputur nga këndvështrimi kombëtar,

veçanërisht në ditët e sotme, kur mjaft mjedise fqinjësore e kanë treguar haptazi dashakeqësinë e tyre ndaj nesh. Së dyti: Pa një standardizim përfundimtar, gjuha po shkonte përherë e më tepër drejt një kaosi, drejt një anarkie gjuhësore, qoftë në kohën e diktaturës nga propagandistë gjysmakë, qoftë pas saj, në proceset e para të shkëputjes nga diktatura, gjer në ditët e sotme.

Në një analizë të gjatë gjuhësore, studiuesi i gjuhës dhe publicisti Eshref Ymeri, ("Rimëkëmbja", 10.05.'05), pasi e vlerëson së tepërmi me argumente librin e Mehmet Elezit dhe e cilëson si "një vepër të mirëfilltë shkencore që përfaqëson në vetvete një tërësi organike trajtesash interesante", shkruan se autori, "në analizë të fundit, nuk kërkon kurrësi të bëhet ndonjë përmbysje në gjuhën shqipe". Dëshirojmë të citojmë edhe këtë periudhë nga ky studim: "Mendimi për të ligjësuar dy standarde të shqipes, standardin geg dhe atë tosk, nuk ka bazë shkencore, pasi si toskërishtja ashtu edhe gegërishtja përfaqësojnë të njëjtën gjuhë, gjuhën shqipe". Edhe Ymeri pajtohet me këtë mendim të Elezit.. Një faqe të gazetës që përmendëm, në të njëjtin numër, ia kushton "Gjuhës shqipe në bunker?" edhe kryeredaktori Abdi Baleta që shprehet se gëzohet për punën e mirë që ka bërë Mehmet Elezi në studimin e këtij problemi të mprehtë të gjuhës shqipe dhe uron që këto arritje të jenë më të mëdha, më pas. Autori i këtij shkrimi vë në dukje sesi shkrime që mëtohet se shkruhen në një gegërishte të rrjedhshme, dalin jashtë binarësh të cilitdolloj standardi, duke mos njohur ligjet thelbësore të gjuhës dhe duke mos u druajtur aspak nga mbingarkesa e fjalëve të huaja, që janë tërësisht të mënjanueshme. Në shkrime të mëparshme kam shkruar për këto orvatje, që nuk e çojnë gjuhën në hullinë e një shqipeje të re të njësuar, pas një harku kohor prej më shumë se gjysmëshekulli. Gjendja vërtet shqetësuese e zvetënimit të gjuhës. Për ta shtjelluar pak më gjerësisht këtë mendim do të më lejohet të zgjatem paksa më tepër. Gjatë diktaturës po se po, para disa vendimeve të fillimit të '70-s, por edhe pas rënies së saj, pati një vërshim të papërballueshëm skriptomanësh dhe shkruesish, që e ndien veten të "çliruar" nga korrektoret letrarë dhe nga redaktorët, të cilët dolën jashtë loje, natyrisht. E ç'nuk pamë, në këtë rast, në faqet e shtypit tonë, madje edhe në titujt: "matriale" për materiale; "martenitet" për maternitet, "sakrofag" për sarkofag, "afrititet" për afinitet (fj. e huaj kjo e fundit, por e saktë); "afruar" për ofruar (ose anasjellas); "degustuar" (njohës verërash duke i shijuar) për

deziluzionuar (zhgënjyer); “Protestantë ( kalvinistë, apo luterianë?), për protestues; “Materiale DHE lëndore”; “inteligjent DHE i zgjuar”; “human DHE njerëzor”; “internacionale DHE kombëtare” (sikur të mos ishin të njëjtat fjalë!). . . e ç’të përmend më tepër “zbukurime” të tilla të çmendurisë shkrimore, shpesh në emër të një “modernizmi” të zbrazur nga ana kuptimore, duke i rënë më qafë fjalisë së bukur shqipe (fjali e errësuar përdhunshëm). E.Ymeri vë re se politikanë të rëndomtë (mediokër), s’e kanë për gjë që të përdorin objeksion (kundërshtim, mospranim, vërejtje), për objektiv (synim, qëllim).

Duke i kërkuar ndjesë lexuesit për këtë shkëputje (digresion), më duhet të nxjerr në pah edhe dukurinë tjetër, po aq të dëmshme: lumin e madh tërë lllum të fjalëve të huaja, plotësisht të zëvendësueshme, për me përshfaqë “kulturë”, veçanërisht nga ata që s’dinin asnjë gjuhë të huaj: “kompromentuar”, për komprometuar; “kontigjent” për kontingjent; “instiktiv”, ose “istinktiv”, ose “istikitiv”, për instinktiv; “demonstratë” për demonstratë; “elenk” për listë; “moribondë” për heqësit, për ata që janë në orët e fundit”, për ata që janë në prag të vdekjes, apo çdo togfjalësh tjetër, - mjafton që të mos gjejë vend ajo fjalë e shëmtuar në “shqip” - ; vepër “autoriale”, për e autoritetshme; “flagjel” për shuplakë, fshikullim, kob, (rrahje me kamxhik). Në një broshurë, kinse gjuhësore, lexojmë: “auziliar” për ndihmës, madje edhe imbotilim! Serxhio Romano buçiste, në Revistën italiane javore “Panorama” (15.05.’04) për “snobopordhacët”(sarkazëm i E. Tupes) italianë, që përdorin single për beqar! Nuk janë të paktë edhe snobët tanë tangërllëkës që e përdorin këtë fjalë, përveç fjalëve të tjera, të zbukuruara me lule prej letre! Në një përkthim flitet stacionet balneare (të plazhit). Përdoren italianizma si ata folën në katër sy (folën vetëm për vetëm). Të gjymtuarit përmenden herë si handikapë, herë si antikapë, duke shfytyruar edhe fjalën e huaj!

Në një intervistë përballë D. Shehit (26.03.2003, ora 22), drejtuesi i programit e kishte si për lezet të përdorte disa fjalë si facilitete (lehtësira), limitrofe (kufitare, afërndenjëse), të shoqeruara kurdoherë me OK! (Kjo e fundit e tërbon analistin Serxhio Romano), etj. Shkruhet e flitet petagog, obsion, anfiteatër, anforë (shtamë antike), anfib, linfë, (këto katër të fundit, duhet të kenë bashkëtingëlloren m në vend të n-së, si në frëngjisht, jo sipas italishtes.). Në një bisedë nga një TV i Tiranës më 28.3.’93 për zhvendosjen e spitalit në Elbasan, përdoret fjala martenitet! Shumë herë, madje, që të na e kapë mirë veshi!

Duke shkuar më tej në këto shpërdorime e duke folur për drejtshkrimin, na janë dhënë si leksione nëpër broshura me mbiemrin "gjuhësore" sesi anhidridi karbonik na u dashka shkruar pa h (po hidrocentrali, hidroteknika, hidrogjeni, hidrauliku, etj?); sesi alkooli i paska të tepërta të dy o-të; sesi "Shtetet e Bashkuara" apo "kujtimet e bukura" duhet të ndryshokan mbiemrat në "...e Bashkuarë", në "... e bukur", e plot marrëzira të tjera, që s'kanë aspak lidhje me shpërfilljen e gegërishtes. Etja për të qenë mitomanë e "modernistë" i ka nxitur mjaft të paditur (profanë, që janë tapë topi në shkencë) se mund të fabrikojnë edhe fjalë të reja, si në kovaçhanë, duke përvetësuar (uzurpuar) punën e gjuhëtarëve të aftë në këtë drejtim, në vend që të merreshin me qëmtimin e fjalëve të gurrës popullore, burim fjalësh pasuruese të fjalorit. (Njëri ndër këta: "Ilogjikimuar" për logjikuar: zburime fjalësh, në një shkrim me mendime të varfra!). Organe kulturore u shndërruan në kulturologjike, (pa qenë nevoja për me imtësue mbiemrin) dhe pa u bërë merak sesi emërtohen revistat e mëdha kulturore në vendet e zhvilluara perëndimore. Mehmet Elezi, në shkrimet e tij të shumta gjuhësore në gazetë, ka dhënë shembullin më të mirë sasi përdoret gjuha, jo vetëm në mënyrë të paqortueshme, por edhe në stil letrar, duke e shtjelluar mendimin e tij në mënyrë të hijshme. Pra, libri i tij i tanishëm, ka dalë pas një morie shkrimesh gjuhësore.

#### Dy cilësi të autorit

Duke lexuar veprën e Mehmet Elezit mësojmë se edhe në një gjuhëtar kritik ndaj gabimeve dhe fajeve të mëparshme, nuk gjen dot tek ai asnjë gabim drejtshkrimor dhe, - ajo që është për të marrë shembull, - lexuesi njohës i shqipes vëren shmangien e pamëshirshme të fjalëve të huaja, me një bisturi të mprehtë (Le të shënojmë, për tani, se ai shkruan kundërkomunist, për antikomunist). Kjo pastërti gjuhësore e tij meriton një trajtesë më vete, që do përmbahet në këtë shkrim. Nga vepra që kemi në dorë vërejmë dy parime-bazë të autorit:

1. Ai e njeh me të gjitha hollësitë atë që quhet "gjuha e njësuar e sotme" dhe e respekton rreptësisht (rogorozisht) atë, në drejtshkrim, në sintaksë, në gramatikë.

2. Në shkrimet e tij (jo vetëm gjuhësore) fjalët e huaja thuajse nuk gjejnë vend. Për të parën, të habit fakti sesa me përpkimëri e bërdor



standardin e sotëm pikërisht ai që është kaq i ashpër dhe aq kundërvënës ndaj harbutësisë (prepotencës) së ushtruar nga regjimi, që kishte marrë nëpër këmbë leksikun shumë të pasur verior. Elezi duket se është i përkorë, megjithatë, kundër një mendimi të skajshëm për ta zhbërë tërësisht një përpjekje dhjetrvjetëshash nga ana e gjuhëtarëve seriozë, që synonin për t'i dhënë një pamje (një fizionomi) të re përparimit gjuhësor afrues ndërmjet kryedialekteve nga ana e gjuhëtarëve të përkushtuar, të detyruar të punojnë në kushte të vështira të diktatit, si Eqrem Çabej, K. Cipo, S. Riza, Aleksander Xhuvani, - për të përmendur vetëm disa. Nga ana tjetër një njohës kaq i thellë i gjuhës amtare si Mehmet Elezi, duket se nuk ka dashur t'ia lejojë vetes rebelimin për të rënë ndesh me atë që quhet sanksionim, domethënë nuk është shtyrë për me i quejtë të paqena vendimet që janë marrë në instanca të larta gjuhësore (kongrese, apo konmferenca të përgjithshme). Një mosnjohje e standardit të fundit do të nxirrte jashtë loje redaktorët e korrektorët letrarë, gjë e cila nuk do të ishte e udhës, me atë anarki gjuhësore që u krijua nga urrejtja e disave për të ashtuquajturën “gjuhë të E. Hoxhës (!)”. Mendime të tilla të skajshme sollën, për njëfarë kohe, një kaos gjuhësor, me libra të vetëfinancuar e pa redaktorë dhe me gabime të gjithllojshme të organeve të shtypit, gjer në titujt e mëdhenj. Për të rivendosur gjendjen e shthurur u bë e domosdoshme, në mënyrë të vetvetishme (spontane), vendosja e redaktorëve dhe e korrektorëve. Po cili do të ishte ai korrektor që do të pranonte të merrte përsipër një gjë të pamundur, nëse nuk do të kishte një kod, një normativë sipas së cilës të përcaktohej fjala e saktë nga e pasakta? ( Për ta bërë më të qartë mendimin, sot për sot: cënuar është e gabuar. Duhet: cenuar. – Duhet të bëhet e palejueshme, pra, edhe zhdukja e ë-së, për rehatim të radhitësve. – Nuk mund të jenë të dyja trajtat e sakta: e përgjithshme, e përgjithëshme. A duhet të shkruajmë të gjithë njësoj, si në të gjitha gjuhët e tjera të përparuara?). Në f. 20 të “Gjuhës shqipe në bunker” lexojmë: ” Në frëngjisht redaktori ta kryqëzon një fjalë të re, nëse ajo nuk gjendet në fjalorin Robert”. Duhet hapur këtu edhe një kllapë e dytë për shkrime, e zeza në të bardhën, që mallkojnë korrektorët e redaktorët “kapterra”, të cilët nuk do të lejonin, në shkrime letrare, konvencione shkurtuese kompjuterike si 7lartë, për7je, u 7nga, 3dhje, shirat e 9torit e pseudomodernizma të tjerë, të mpleksur me një vërshim fjalësh të huaja...

## Paskajorja

Natyrisht ka ardhur koha për ndryshime të rëndësishme në lëmën gjuhësore. Do të kemi, si të thuash, një sanksionim të ri gjuhësor, domethënë një rishqyrtim të gjithanshëm të gjuhës në organe të larta vendimarrëse, në të cilat do të ballafaqohen mendime të ndryshme, madje edhe të kundërta. Por jam i sigurt se normat e reja do të përvetësohen jo si me shkop magjik. Ata që do të jenë më të prapambetur në të ardhmen e evolucionit tonë gjuhësor, kam bindjen se do të jenë bash ata që nuk mundën dot ta zbatojnë, gjer tani, standardin e sotëm.

Gjuhëtari Mehmet Elezi, me këtë vepër me vlera të padyshimta, ka dhënë shembullim vetjak sesi mund të zbatohen në mënyrë të pagabueshme sanksionimet e gjertanishme gjuhësore. Ai është respektues si pakkush i normativës gjuhësore, pavarësisht se shkrimet e tij të shumta përmbajnë edhe vulën e individualitetit të tij shkencor. Për shembull, ai përdor paskajoren (infinitivin) në të shkruarit e tij. Ai e ka argumentuar këtë mendim të vetin gjuhësor në mjaft shkrime të mëparshme, mbi këtë temë të posaçme. Doemos ai e ka hulumtuar këtë temë të veçantë gjuhësore që sapocekëm edhe në librin për të cilin po shkruajmë. Për mendimin tim nuk i prish asnjë punë njësimi të shqipes përdorimi i paskajores. Autori argumenton, madje, nevojën e këtij përdorimi. Le të citojmë këtë periudhë: "Të gjithë ata që ndihen të lumtur se shqipja standarde është bërë pa paskajore, njëlloj si greqishtja e si disa gjuhë sllave, mund t'i përgjigjen, në mundshin, një pyetjeje të vetme: çfarë fitoi gjuha shqipe prej "shkishërimit" të paskajores; në ç'pika është bërë ajo më e pasur, më tingëlluese, më shprehëse?" (f.106).

A mund të shkohet në një kongres, me vendime të paracaktuara?

Gjuhëtarët nuk mund të tregohen shpërfillës dhe moskokëçarës (indiferentë) ndaj kësaj vepre që i trajton thellësisht problemet e thekshme që na vë përpara gjuha jonë e njësuar, që do të ishte një detyrë parësore edhe për çështjen tonë kombëtare. Që në hapje të kësaj vepre, lexojmë këtë ftesë: "Ty, që këndon me vëmendje këtë sprovë të përvutë, pavarësisht nga pajtimet ose mospajtimet, Zoti të bekoftë!". Pra, problemet janë të një rëndësie thelbësore dhe kërkojnë debat. Autori e mirëpret këtë debat gjuhësor. Ai është i barazpeshuar, i

përkorë në analizën historike të gjuhës, vlerësues i punës së përkushtuar të gjuhëtarëve që punuan në kushte tepër të vështira nën diktaturë, i guximshëm dhe i papajtueshëm me dhunën ndaj gjuhëtarëve tanë të mëdhenj që u lanë në harresë (shembulli i Nikollë Gazullit është domethënës), vlerësues i gjuhëtarëve të huaj që s'i kishte për zemër diktatura (N. Malkolmit, për shembull), kritik i paepur për atë mëkatin e pashlyeshëm të "fjalëve dëshmore të padëshmuara". Kjo metaforë e bukur e fundit ka të bëjë me nxjerrjen jashtë FGJSSH (Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe) të visareve të kombit, gurrës popullore, ciklit të kreshnikëve, por edhe fjalët e rralla të më të mëdhenjve të poezisë sonë kombëtare (Fishtës, për shembull). Autori nuk është kryeneç në tezat e tij. Ai e dëshiron kundërvënien "pavarësisht nga pajtimet ose mospajtimet", siç e pamë që në faqen e parë të veprës së tij. Ajo që nuk do të duronte dot, është të paragjykuarit e librit nga ata të cilët, pa hyrë te thelbi, merren me "shkëputje fjalish nga tërësia e përmbajtjes". Megjithatë, ndaj këtyre personave ai shprehet: "Zoti i faltë!". Asnjë mendim i tij nuk është shprehur pa një shqyrtim të gjithanshëm dhe pa analizën e ftohtë. Por, sidoqoftë, një libër i tillë, i idhët në mjaft çështje gjuhësore, probleme të cilat dëshirohen nga mjaft persona që t'i përpijë errësira e pambaruar, probleme të debatueshme që janë lënë të paprekura (tabu), do të zgjojnë, pa dyshim, pajtime dhe mospajtime. Mos të mendohet se tani mund të shkohet në një kongres gjuhësor si më parë, me vendime të paracaktuara. Mungesa e një debati publik serioz paraprak, do t'i vështirësonte punët e një kongresi të tillë. Le të shpresojmë se gjuhëtarët do të merren me këtë vepër, duke shqyrtuar problematikën e shumanshme që shtron ajo, në dobi të shmangies së të metave serioze në këtë lëmë, mangësi të cilat doemos që kërkojnë zgjidhje. Kritika letrare gjuhësore, përmes penës së gjuhëtarëve dhe studiuesve, duhet ta thotë fjalën e saj. Në të vërtetë, përveç disave, që merren me këto probleme dhe komunikojnë me publikun (Emil Lafe, Gjovalin Shkurtaj, Edmond Tupe, Ali Dhrima, Mehmet Çeliku, Pavli Haxhillazi, Ardian Ndreca, Eqerem Shijaku), pjesa tjetër (më e madhe) merret me punën-rutinë të përditshme, e mbyllur, si me thënë, në kullën e fildishtë të studimit. Më aktivët kanë qenë Edmond Tupja dhe autori i librit tonë, Mehmet Elezi. Mjaft studiues shqiptarë, jashtë kufijve tanë zyrtarë, janë shprehur, gjithashtu (Mërgim Korça, për shembull, nga SHBA-të). Një studiues nga Brukseli

më ka marrë në telefon dhe, pavarësisht nga disa vërejtje, është entuziast për veprën "Gjuha shqipe në bunker?". Ai është në përgatitje të një shkrimi. Përmendëm edhe dy studime që kanë zënë shumë faqe gazete. Marr vesh se edhe Qemal Sakajeva, stilin e të cilit e çmoj shumë, është marrë me librin për zhbunkerizimin, me studimin "Në rrezen e nje diskutimi" të E. Ymerit tani, në shkëputjen e përkohshme nga gazeta, meqë po merrem me një përkthim, që duhet të dalë së shpejti. Por është pak, shumë pak. Me këtë praktikë nuk mund të arrihet në Kongres në një mendim lehtësisht të kristalizuar. Vetë autori, siç kam kuptuar nga leximi i kujdesshëm i librit të tij, do të dëshironte të dinte se në cilat nga argumentet e tij të shumta, do të ishte i kundërshtueshëm. Me fjalë të tjera: cilat janë pikat më të zjarra të debatit. Do të mund të bëhej, kështu, një përzgjedhje (një seleksion) i çështjeve thelbësore dhe puna do të vazhdonte, më tej, më e përqendruar. Debatet gjuhësore u zgjuan, në njëfarë mënyre nga krijimi i Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe (KNGJSH). Synimet e tij janë ambicioze dhe mirëkuptuese, si me thënë, për të shëruar një sëmundje. Është shpallur se personat e zgjedhur në këtë Këshill do të kenë në qendër të vëmendjes një standard të ri, si varietet mbidialektor. Në dashamirët e përkushtuar të gjuhës (edhe ndër ata joprofesionistë), u zgjuan shpresa se do të vlonin debatet gjuhësore, analizat e thella, kritikën dhe kundërkritikën, tezat analitike në dobi të një sanksionimi të ri gjuhësor (në vendime që do të përcaktojnë një normativë të re, që do të jetë e detyrueshme për të gjithë shkrimin shqip, si edhe të folurit në mediat), brenda kufijve dhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Jo vetëm në ristrukturimin dhe në zgjerimin e një Fjalori të ri të Shqipes së Sotme, që do të vërë në vendin e duhur leksikon tepër të pasur, por të qethur verior, por edhe një drejtshkrim të detyruar për të gjithë. Por qe si një flakë kashte. Debatet gjuhësore u flashkën shpejt. Pati edhe kritika, veçanërisht në dyshimin se të ngarkuarit për këtë punë janë përgjithësisht të njëmendjeje, në mbrojtje të gjithçkaje që ishte bërë në 1972 e më tej. Oponentët më aktivë, nga ç'është thënë, kërkohet të mbahen mënjanë. Veçse, a është kjo rruga që duhet ndjekur për me jetësue një çështje me rëndësi vërtet madhore? Mjaft dashamirë të vërtetë të gjuhes nuk e shohin si ndjellmirë këtë gjum (këtë gjendje letargjie) në vazhdim të një ndërmarrjeje shpresëlënëse, e cila duhej të kishte krijuar një klimë debati dhe ballafaqimesh, që diskutimet të mos përqendroheshin vetëm e vetëm në një kongres të

ardhshëm, pa u shoshitur problemet, më parë, hap pas hapi. Libri i M. Elezit, shumëplanësh (poliedrik) në trajtimet e të gjithë problematikës gjuhësore, nuk i lë pasadore edhe pikëpyetje të tilla. Ndërkaq, pavarësisht nga kritika e çiltër e autorit të zhbunkerizimit, nuk më duket se ajo përkon me mendimet e skajshme të ndonjë studiuesi, që mëton të rifillohet puna nga e para, me zhbërjen tërësore e gjuhës, nga krijimi i një baze të re gjuhësore, gjë që do të ishte fluturake dhe jo e matur, sepse do të kërkonte një kohë jo dhjetëvjetëshash, por shumë dhjetëvjeçarësh, një luks ky i mbarsur me dëme të paparashikuara, gjer në cenimin e interesave kombëtare. Një orvatje e tillë do të ishte e pamundur, praktikisht.

#### Ana tjetër e medaljes: zhbërja

Mehmet Elezi ka dhënë shembullin sesi mund të përdoret gjuha, në të gjitha shkrimet e tij, pa mundur të vërë dorë korrektori letrar apo redaktori, në respektim të gjuhës së sotme, pavarësisht nga ndryshimet që ai mëton të bëhen në dobi të nje gjuhe të pranueshme për të gjithë. E kjo meriton analizën kritike të gjuhëtarëve, jo heshtjen e tyre. Duke qenë të bindur se kritika gjuhësore do të ballafaqohet me mendimet e librit "Gjuha shqipe në bunker?" që sapo ka dalë në qarkullim, do të dëshiroja të ndeshesha me ndonjë mendim të një autori tjetër, për të bërë një krahasim ndërmjet mendimeve të drejtpeshuara të Elezit dhe mendimeve tej orbite të atij studiuesi, emrin e të cilit e kam përmendur ndër ata që kanë qenë aktivë në shtyp për trajtimin e problemeve gjuhësore, që janë shqetësuese, në të vërtetë. Është i vetmi, për kulturën e tij të padyshimtë, që meriton një replikë për mendimet që qëndrojnë, siç përmendet në nëntitull, në anën tjetër të medaljes. Të tjerët, në mendime të tilla, nuk mund të shqyrtohen seriozisht, sepse kërkojnë të merren me gjuhësi, me një breshëri fjalësh tuhafe (ekstravagante) dhe me një batërdisht fjalësh të huaja, të dënuara në mënyrë të njëzëshme nga të gjithë gjuhëtarët, pa përjashtim. (Aleksandër Xhuvani: "Fjalët e huaja duhen kapur me mashë dhe duhen nxjerrë jashtë"). Por le të citojmë atë studiuesin, mohues (nihilist) të normave, që do të kuptohet nga riprodhimi i mendimeve, nëse është vërtet i tillë: "Me bashkue sot (...) gegnishten e tosknishten në një standart (standard, K.X.) □sht si me dashtë me gjetë me anë të një "ars combinatoria" të tipit leibnizian (lajbnician, -K.X.)

nji gjuhë të përbashkët qi me mujtë me thirrë njiherit pulat e macet, e mundësisht me mujtë me ndjellë edhe gardalinat". Vazhdojmë: "Cila është arsyeja qi ndërmjet dy të folmeve gegnisht e toskënisht, të zgjidhet si normë e dyta ...?".

Le të hamendësojmë se është e mundshme e kundërta e kësaj, në kushtet e sotme. Por ende s'mund të flitet, sipas tij, për një bashkim gjuhësor, për një standard të përbashkët, sepse s'qenka i mundshëm asnjë art kombinatorik bashkimi me që, aq sa mund të bashkohen pulat, macet e gardalinat, po aq mund të bashkohen edhe të folmet tona,- sipas tij. Ai duket se nuk shqetësohet as për një drejtshkrim të përbashkët: "Në fund të fundit drejtshkrimi nuk është një çashtje kapilare e gjuhës: ajo çka i ndan shqiptarët s'është mënyra se si shkruajnë e flasin gjuhën e tyre, por mënyra se si e mendojnë të ardhmen e gjuhës së tyre, tue dyshue se a janë të denja më u thirrë "mendime" hungërimat e artikulueme me inatin ndaj traditës 500 vjeçare të shkrimit shqip". Flitet kundër mllëve, inatëve, por edhe për hungërimat, domethënë për britmat therëse e kërcënuese që nxjerrkan qentë e ujqit, që nuk mendojnë si ai. Ai do ta mendonte si heretik atë kundërvënien që do të mund t'i bëhej mendimit të vet se drejtshkrimi nuk na qenka një çështje kapilare dhe se mënyra sesi shkruajnë shqiptarët nuk paska ndonjë rëndësi të madhe. A thua se me këto paraqitje mendimesh autori nuk do të pranonte se këto mënyra të të shprehurit, përveç se nuk janë të përkora, të çojnë në një mosrespektim të normativës drejtshkrimore dhe në "lirinë" që njëri t'i bjerë gozhdës e tjetri patkoit? A mos, vallë, do të quheshin hungërima bindjet e të tjerëve se kështu gjuha do të kalonte në anarki dhe korrektoret letrarë e redaktorët do të dilnin jashtë loje? (Mehmet Elezi ka paraqitur, në librin e tij, dy redaktorë dhe një redaktore letrare). Në një shkrim kundërveprues të kohës kur doli shkrimi që po replikohet në këta rreshta, citojmë: "A mund të thotë autori i cituar nëse njeh ndonjë gjuhë të përparuar në të cilën të ketë dytrajtshmëri të të shkruarit, siç shprehet për gjuhën tonë? Citohet ende autori kundërveprues: "Këto tjerët, si Naimi..." – Ai ngulmon në këtë përemër në gjuhën fëmërore (por edhe në pasaktësi të tjera): -"Çka duhet me bërë sot tue kenë se gjuhëtarët (gjuhëtarëve) tonë (tanë) jua (ua) ka lanë lija zanat me shkruë e me mendue si atëherë". Këtu nuk e kemi aspak me gegërishten. Veçse ja përdoret gabimisht nga ai si pjesëz ose si lidhës: Si në shembullin: Ja, si ndodhi. Ja fol, ja rri. Por duhet: "atyre ua

ka lanë lija zanat!". Duke e lene mënjanë mllëfin, që është i dukshëm këtu, mo'Zot nëse do të na thuhej edhe këto burra! Me këto mendime se "drejtshkrimi nuk është kapilar", zënë vend në shkrimet tona kamaleon për kameleon, madje edhe Napoleon Bonaparti, që po na shkruhet Napolon ...(kartmonedhë). Dhe jepen autorët dhe titujt e shkrimeve për këto papërgjegjshmëri në të shkruar. Po na jepen edhe leksione, nga të tjerë, që të hiqen kapterrit, domethënë redaktorët)!

### Pastërtia e gjuhës

Veçse ka edhe çështje, në librin "Gjuha shqipe në bunker", për të cilat të gjithë emrat e përmendur pak më sipër dhe të gjithë gjuhëtarët tanë, në tërësinë e tyre, janë plotësisht të njëmendjeje: pastërtia e gjuhës, fjala shqipe si zëvendësuese e fjalës së huaj, shpërdorimet e mëdha në këtë drejtim. Ndër këta shpërdorues, për fat të keq kemi edhe studiues (të paktë, për fat të mirë), që janë si në një trans (hipnozë të frikshme), adhurues mazokistë, përkundrajt fjalës së huaj. Bukuria e shkrimeve, sipas këtyre, qëndron jo në hijeshinë e mendimit, por në fjalën bubulluese (doemos të huaj).

Kështu një çështje e paqenë është bërë gangrenë. Në një kritikë letrare, për shembëll, shohim nëntituj me shkronja të mëdha, në të cilët përdoren fjalë e togfjalësha e sajesa gjuhësore, si ëndërr tripletike, intertekst funksional, qëmtime autoriale, sekuenca teskstologjike, imanenca të artthënies, temporitmika e përsëritjes, shprehësia narrative. A duhet rikujtuar shprehja e Elezit se "në frëngjisht redaktori ta kryqëzon një fjalë të re, nëse ajo nuk gjindet në faqet e fjalorit Robert" ?. (Do të jetë ditë zije për zvetënuesit tanë, kur të kryqëzohen edhe fjalët e përçartura të tyre). Pas shtatë faqesh, duke u marrë me vlerësimin e fjalës shqipe nga Gazulli, me Kanunin e Lekë Dukagjinit për traditën dokësore shqiptare, me disa qëmtime të bëra në Plavë e në Guci (P. Haxhillazi, S. Ahmeti), e me disa studime të gjuhëtarëve tanë e të huaj, M. Elezi shkruan: "Shpërfillja e pasurive të tilla gjuhësore, në rastin më të pafajshëm, është shprehje inferioriteti. Për të mos thënë shumë më keq se kaq: mënjanim i qëllimshëm i vlerave të mirëfillta kombëtare". Tani do të më duhet të citoj disa nga nëntitujt e "Gjuhës shqipe në bunker?" për të bërë një krahsim me nëntitujt që janë përmendur disa rreshta më lart: "Fjalët dëshmore të

padëshmuara", "Pushkatimi pa gjyq i Komissisë Letrare të Shqipërisë", "Gjuhës i zihet fryma", >, >, "Pafajësia e fajshme", "Dialektet: binjakë të një vezë, por...". Ndërsa të parat janë joshprehëse (joekspresive), të dytat e përmbajnë domethënien e letrarizuar në shqip. Ndërsa të parat janë të përmbushura me fjalë të huaja kumbuese [tripletike, imanencë, sekuencë, tempormikë, autoriale (kjo e fundit sajesë pa kuptim)], të dytat i kanë nën thonjëza një togfjalësh latin të njohur (non grata = i padëshirueshëm) dhe një fjalë ruse, po nën thonjëza (njet = jo). Ndërsa të parat janë të kategorive për efekte të jashtme (butaforike), të trajtave si ato të një të njohuri tim gazetar, i thekur për t'u bërë i pëlqyeshëm të lexuesi duke shpalosur të gjithë fjalorin teatror dhe melodramatik [rekuizitë, rimel, temporitmikë, makijazh (këtë e shkruan gabim në pikëpamjen drejtshkrimore, pa harruar edhe fjalë të kuzhinës si mëny e ku të di unë), - të dytat kanë veshjen e një gjuhëtari-letërar, me metafora të goditura, që lënë përshtypje në lexuesin që kërkon të zgjerojë në vijim, kuptimin e nëntitullit. Le të vihet re sa mbresëlënëse është ajo figura letrare e "Fjalëve dëshmore të padëshmuara" (se s'po dalin dot ende në dritë). Fjalë dëshmore, viktima të diktaturës! Dhe sa i bukur tingëllon ai aliteracioni stilistik i përsëritjes së rrokjeve të njëjta, që na kujton vargjet më të frymëzuara të Nolit, me trim tribunët e tij! A mund të gjendet dot një nëntitull më i zgjedhur, që zgjon ngashërime (emocione) aq të forta? Të vihet re, veçanërisht, se fjali të tilla, pa asnjë fjalë të huaj, kanë bukurinë e luleve aromatike, jo të atyre prej letrash të zhubravitura! Në këtë kuptim e kam përdorur mjaft herë cakun gjuhëtar-letërar. Duket se Mehmet Elezi është aq i neveritur ndaj vërshimit të fjalëve të huaja, me vend e pa vend, sa nuk bën lëshim edhe ndaj fjalëve shkencore me prejardhje të lashtësisë greke, apo latine, për të cilat mendimi i gjuhëtarëve është më lëshues në publicistikë (ndërsa në letërsi fjalët e huaja tingëllojnë gjithmonë shëmtueshëm) dhe i ashpër prerazi në letërsi. Termat shpesh zëvendësohen, në librin në shqyrtim, nga fjala caqet. Po ashtu horizonti: lëbozë (e ka pasë përdorur M. Camaj, te Dranja). Komb: lem (Kanuni i Skanderbeut). Rokulli me origjinë nga orbita, lakorja siç mund të quhet edhe kjo. E ka përdorur Fishta: "...Se për qark ksaj rrokullije / Si Shqipnia 'i vend nuk ka!'. Tranzicion: kapërcyell. Ironike: gazidhët. Resto: cukëm (Gazulli). Pension: mbëngojë (Gazulli). Spital: shëndetore (Konica: Dr. Gjilpëra). Ring (cak sportiv) : rrethak. Pa u shtrirë në më tej në fjalët shqipe të librit, autori



shtjellon edhe etimologjinë e fjalës, autorin, vendin e përdorimit. Ai s'është sajues neologjizmesh, siç e kanë marrë përsipër ta bëjnë këtë, tani, mjaft sevdallinj që pjellin fjalë të reja nga fantazia e tyre. [Në mediat përmendet me qejf të madh neologjizmi surprizuar, nga surprizë (befasi). Sajohen edhe fjalë kilometrike: antagonizmuar! Tani është bërë e modës që çdo emri t'i bashkëngjitet folja përkatëse, me prapashtesë uar! Kanë zënë radhën të bëhen të gjithë leksikografë, edhe ata që s'dinë, për së mbari, asnjë gjuhë të huaj. Pra, dimë shumë fjalë të huaja (pa e njohur gjuhën e huaj), por nuk dimë shqip! Në këtë drejtim libri i Mehmet Elezit është shumë mësimdhënëse. Njohuritë e thella gjuhësore janë të çiftëzuara me komente interesante në stilin e një letrari, që mendimi i autorit të përvetësohet më lehtësisht. Veçse duhet thënë edhe se këto përsiatje nuk ngarkohen shumë me fjalët e rralla të shqipes. Duket se autori nuk mëton të shtyhet shumë në këto mbingarkesa, mbase sepse është i ndërgjegjshëm se shkrimi do të rëndohej në kuptueshmërinë e tij (meqë jemi të varfër në njohjen e shqipes). Por një gjë del mjaft e qartë, megjithatë: se shqipja nuk është e varfër në fjalorin e gjerë të saj, që u cungua artificialisht. Del edhe një detyrë: Të njohim thellë e më thellë fjalët shqipe e të shmangim dora-dorës fjalët e huaja të zëvendësueshme. Është një meritë tjetër e "Gjuhës shqipe në bunker?". Por duket se plogështia (inercia) është tepër e fortë: Ndryshe s'ka si të kuptohet që në përkthimet, moribondo të jepët "në shqip" moribond; që flagello të përkthehet flagjel e bukurirat e tjera që s'po i jap, për të mos na e prishur humorin. Zhan Bleni shkruan, në paraqitjen që i bën "Fjalorit europian të filozofive", të Barbara Kasinit se kjo vepër, që ka dalë në Francë para pak vitesh, "është një prurje që njihet si një ngjarje filozofike, sipas së cilës asnjë gjuhë nuk duhet shenjtëruar gjer në atë shkallë sa të përmbajë fjalë të papërkthyeshme". Mehmet Elezi shtjellon në librin e tij të Bunkerizimit një mori aq të madhe fjalësh shqipe, të shpjeguara nga ana burimore, për të na bindur se shqipja nuk është aspak e varfër, siç kërkojnë të na mbushin mendjen ata që edhe në përkthime i mballojnë "shqip" fjalët e huaja, me një prapashtesë ose me një përdredhje "origjinale" qesharake!

Mehmet Elezi e përmend Ismail Kadarenë edhe për pastërtinë e fjalës. Unë do të shtoja se në "Paqyrën e një gruaje" e përmend një personazh të spikatur të veprës, në fjalinë se "nuk shoqëronte më kurrfarë dërgate (delegacioni) (f.41). Ndërsa ai i njohuri im, që i kishte

qejf fjalët kozmetike, në vend që të thoshte, në një reportazh, se x.y.-i kishte "shprehur mendimin se...", shkruante "delegoi mendimin...!" "Rënia në përkitje (në kontakt) me...(65) shkruan Kadareja. Në f. 86, shakatë, shpotitë, qesënditë, jepen me mahitë. Një shkruer përdor fjalën avalangë për ortek bore. Avalanga nuk është as në italisht: valanga; as në frëngjisht : avalanche. Në të parën mungon a-ja. Në të dytën gjen vend sh-ja. Kadareja shkruan: "Atje ku lindin rrungajat" (136), që e ka edhe Fjalori ynë shpjegues për ortekët e borës (f.1066). Kadareja përdor gegërishten, ashtu siç përdor edhe toskërishten, ndërsa neve na thuhet nga zhbërësit e gjuhës (apo ribërësit e saj) se s'ka asnjë aftësi kombinatorike për me bashkue pulat e macet!

Të patundurit nga llogorja, në mbrojtje të fjalëve të huaja Por le të mos duket çudi: ka edhe ndonjë teoricien në mbrotje të këtyre fjalave, paçka se mund të jetë i vetëm dhe pa mbështetje në përlligjje të këtyre fjalëve të shëmtuara. Me këmbëngulje. Me kryençësi. As që duan t'ia dinë çka thënë A. Xhuvani, me atë metaforën e fjalëve që "duhen kapur me mashë e duhen nxjerrë jashtë". As që duan t'ia dinë çka thënë Emil Lafe, tamam për këtë temë. Duket se nuk kanë lexuar as shkrimet e shumta të M. Elezit, model pastërtie të gjuhës shqipe. Në ngulmimin e tyre përdorin emra autorësh: citojnë Huserlin, Hajdegerin, Gadamerin, Levinasin, Derridanë, Shpenglerin, Norbert Elias, T. Kunin, Kantoroviçin, Ariesin, Mishel Fukonë, Aleksandër Kozhevin, Liotarin, Zhil Delëzin, Guatarin, Bill Gejtsin... Por asnjëri prej tyre nuk është gjuhëtar i mirëfilltë. (M Elezi përmend në librin e tij së paku dhjetë herë më tepër emra gjuhëtarësh të huaj e shqiptarë, emra librash e revistash, jo vetëm në shqip, emra burimesh të fjalëve të popullit). Por ai tjetri nuk thotë se cili prej autorëve jogjuhëtarë, që cituam më sipër, që nga i pari e deri tek i fundit, ka qënë ithtar i fjalës së huaj! Nuk thuhet as nëse Mitrush Kuteli do t'i dëshironte ato lavde, të mbarsura me fjalët e rrungajave të vërshimit fjalëhuaj – që të përdorim edhe ne fjalën rrungajë të Kadaresë. Zhan Bleni, e quan si një vepër nga më të shquarat fjalorin e Kasinit, pikërisht sepse "bashkëpunëtorët e këtij fjalori filozofik dhe gjuhësor janë njerëz me njohuri të thella shkencore dhe gjuhësore" (Cituar). Le të pranojmë se këta mbrojtës të fjalëve të huaja, siç janë quajtur në këtë nëntitullin e fundit, janë njohës të filozofisë. Por a i njohin parimet e një gjuhe të njësuar? Kjo nuk do të përmendej fare sikur të kishin modestinë që të

mos merreshin fare me shkrime gjuhësore. Ose le ta studiojnë mirë këtë libër për të cilin po flasim, që të kuptojnë abecenë e çdo standardi

## GLOBALIZMI ÇËSHTJA E SHTETIT DHE KOSOVA\*

Interes kombëtar i një vendi nuk është mbyllja dhe izolimi por përkundrazi hapja dhe demokratizimi i brendshëm i raporteve shoqërore.

### Dr. Fadil Maloku

Në politikën globale, sot është e padiskutueshme tendenca e procesit të globalizimit, e cila si e tillë dalëngadalë por sigurt është duke i mbizotëruar kornizat e zhvillimeve dinamike politike në botë me qëllim të marginalizimit sa më të mundshëm të formave tradicionale të organizimit dhe të menaxhimit të jetës së qytetarëve që i dalin asaj si pengesa serioze në galopimin e mëtejshëm të afirmimit. Në këtë kontekst, duket që as trendi i kompetencave të reja që burojnë nga vlera e diskursit të sovranitetit të shtetit që për globalistët është identifikuar si një "rezervat" i tipit të veçantë apo siç do të thoshte Aristoteli, një "zoom politikoom-i", nuk bëjnë ndonjë përjashtim karakteristik kur është në pyetje procesi i shtimit të interesave globale të tyre. Dilema më e madhe që u sjell sot sociologëve të globalizimit, kur janë në pyetje këto ndryshime marramendëse padyshim që kanë të bëjnë me rolin dhe perspektiven e institucionit të shtetit në të ardhmen. Për vendet e zhvilluara kjo dilemë deriduku është materializuar përmes formave të reja integruese, kurse për ato në zhvillim ende ka ngecje dhe ngurrime sa i përket rolit të këtij institucioni në procesin e bartjes së një pjese të kompetencave (lexo sovranitetit) në forma të reja integruese rajonale.

Për Kosovarët, të cilët për dallim prej të gjithë të tjerëve, natyra e trazimeve të brendshme kur është në pyetje ndërtimi i kapaciteteve të reja të institucionit shtet komb, ka gjithandej specifika të cilat nuk mund t'i hasish në asnjë model zhvillimor të procesit të ndërtimit të institucionit shtet - komb në botë. Në Kosovë, meqë është ende aktuale çështja e pretendimit të bërjes (jo e ridefinimit) së shtetit

---

\* marrur nga: <http://www.agimi.com/modules.php?name=News&file=article&sid=287>

përgjithësisht në via të trasha, do të mund të identifikoheshin dy specifika cilësore që rrallë kund apo askund nuk mund t'i hasish: specifikën e ndërtimit të infrastrukturës elementare demokratike dhe ate të realizimit të synimit për të ndërtuar këtë infrastrukturë elementare me mekanizmin e institucionit të sipërpërmendur. I cili për të tjerët ka filluar të pësojë ndryshime dhe modifikime të theksuara në vetë formën dhe përmbajtjen e vetë shkak i proceseve të reja të globalizimit. Nëse i adresohemi synimit të kamotshëm të kosovarëve për ta ndërtuar këtë mekanizëm identifikues edhe për vetë identitetin e ri kombëtar, fitohet përshtypja që ky proces është identifikuar jo si nevojë e komoditetit por e ekzistencës së qytetarëve të sajë gjatë tërë shekullit të kaluar në kushtet dhe rrethanat e reja të një procesi tashmë të afirmuar si globalizëm, atëherë që padyshim lypset të kuptohen trendët e reja zhvillimore përreth. Kjo mënyrë e qasjes duhet involvuar edhe për shkak të vonesës së theksuar historike që e kemi pësuar jo me fajin tonë.

Është mirë pra që më në fund ka filluar të zgjidhet ky lëmsh rreth Kosovës dhe për Kosovën. Por a është kështu, do të pyeste ciniku?

Do theksuar parimisht që vlerat "klasike" (siç i kanë identifikuar shumica e sociologëve të sotëm), siç janë ato që kanë të bëjnë me: interesin kombëtar, integritetin territorial, e pastaj me sovranitetin kombëtar e sidomos tash së fundi me sistemin e sigurisë kolektive, në botën perëndimore nuk e gëzojnë më edhe gjithaq atë shkëlqimin apo rëndësinë që e kishin përpara, psh. në shek XIX kur edhe u afirmuan si vlera substanciale për rregullimin e raporteve mes qytetarëve dhe shoqërive.

Në aulat intelektuale, politike e sidomos ato kulturore në botë sot janë duke u zhvilluar debate të sofistikuara rreth këtyre formave dhe përmbajtjeve të reja vlerore. Dilema kryesore tani për tani mbahet ajo që ka të bëjë me ambiguitetin apo interpretimin dualist që e fuqizojnë diplomatët dhe ekspertët e lëmive të ndryshme, në mënyrë që procesi i (ri)pajisjes, si të themi me licencën e mekanizmit të quajtur shtet të bëhet në qetësi dhe pa zhurmë të madhe në opinionin e gjerë. Natyrisht, një numër i madh sociologësh të njohur ende konsistojnë në qëndrimet arbitrare, se ende nuk ka ardhur momenti i (ri)pajisjes apo zëvendësimit (apo edhe në variantin më të keqe: reduktimit të menjëhershëm rolit të institucionit të shtetit në të ardhmen!) të këtij

diskursi me ndonjë pseudoinstitucion tjetërfare. Për shumicën e tyre (si A. Giddens, Fridman, Beck, etj) institucioni i shtetit (jo edhe gjithaq ai i kuptimi modern, por ai klasik) është ende një mekanizëm i qëndrueshëm rregullativ i jetës së njerëzve në mbarë globin.

Në Evropën e modelit të Unionit, pra në qarqet e eurokratike ekziston një projekt (në formë diskursi teknokrat) ende i pa afirmuar sa duhet për shumicën e vendeve të tranzicionin, se poqese qytetarëve të këtyre vendeve u ofrohen më shumë të drejta qytetare (eufemizmi për të drejtat e njeriut) dhe më shumë paqe e qetësi kolektive, atëherë padyshim që çështja e sovranitetit të shteteve do të mund të marginalizohet me lloj mekanizmin e sigurisë kolektive rajonale.

Në anën tjetër është poashtu e vërtetë që kapitalizmi i shek. i identifikuar si globalizëm është duke instaluar një tip të ri apo një formacion të ri të shtetëzimit si mekanizëm më të drejtpërdrejt që duhet të ushtrojë pikësëpari menaxhimin me të mirat dhe begatitë e një vendi. Ky tip apo thënë më ndryshe ky model nën ndikimin e Unioneve të ndryshme monetare globale, fenomenit CNN-it, KTN-ëve, Internetit dhe OJQ-ëve, për shumicën e sociologëve të sotëm, gjerë tani nuk është duke dhënë rezultatet e pritura. Ai është duke bankrotuar skajshmërisht si ide! Të përmendim vetëm rastin e refuzimit të Francezëve për Kushtetutën e re Evropiane!

Në rajonin e Ballkanit perëndimor, ku uria për identitetin shtetëror ende është e gjallë dhe një paranojë e llojit të vetë edhe për faktin se për të janë zhvilluar madje edhe luftëra gjenocidiale, (shembulli i Bosnjës dhe i Kosovës) çështja e (ri)pajisjes apo zëvendësimit të rolit të shtetit është e paimagjinueshme, e hershme dhe në s'përputhje me kohën e zhvillimit dhe të rrumbullakimit të synimeve kolektive të kombeve. Ithtarët e këtij koncepti në perëndim sot bëjnë ekspertiza dhe analiza të thukëta, duke fuqizuar mendimin akademik se : çështja e (ri)pajisjes apo reduktimit të sovranitetit shtetëror nuk ka qenë dhe nuk është diçka e re.

Ajo sipas tyre ka ekzistuar me të krijuarit e paradispozitave për të lind ky mekanizëm, qysh në shek. e XIX. psh. Amerika ka pasur përherë një lloj autonomie dhe kontrolli rigoroz ndaj kësaj çështje, bile edhe sot me xhelozinë më të madhe e bënë këtë. Ta përkujtojmë vetëm luftën e sajë që ajo e zhvillon aktualisht në emër të terrorizmit, që kryekëput zhvillohet në emër të këtyre idealeve dhe interesave parasëgjithash

kombëtare që ajo i projekton në gjithë rruzullin tokësor. Thënë me thjesht sovraniteti edhe sot e kësaj dite ka mbetur tërheqës për shumicën dominuese të vendeve të zhvilluara dhe atyreve që janë në zhvillim, kurse mos të flasim për ato që janë në procesin e tranzicionin dhe të procesit të shtet-formimit, siç është rasti i Kosovës, ku interesimi mobilizues i qytetarëve të sajë lidhur me dëshirën dhe pasionin e tyre shekullor për të pas një shtet të vetin e ka burimin e vetë shpjegues dhe shumë identik me popujt tjerë përreth.

Pra, ideja e të poseduarit të sovranitetit të plotë të shtetit të ri të Kosovës anipse shikuar me dioptrinë e një eksperti të marrëdhënieve ndërkombëtare nuk e ka peshën e mëtejme se të një njohje formale ndërkombëtare në akusherin e OKB-s, ku edhe (de)legjitimohen sovranitetit e shteteve, përmes të cilës pastaj thithja e begative materiale dhe atyre financiare bëhet më e lehtë dhe më durueshme, ajo prapëseprapë e ka madhështinë vetë identifikuese. E kjo madhështi nuk është edhe gjithaq ideale ashtu siç është projektuar zakonisht në kokat e masave të gjera popullore, por para se gjithash pragmatike, ngaqë institucionet dhe qytetarët e mbarë rruzullit tokësorë transaksionet e tyre të ndryshme akoma i ushtrojnë mu përmes këtij mekanizmi anipse ai herë pas herë gjatë qenësimit të vetë të gjertanishëm historik ka ditur të gjenerojë autoritet dhe arbitraritet të pakontestueshëm dhe një lloj egalitarizmi të diskutueshëm.

Do përmendur kalimthi, se në kohën kur Zhan Boden dhe Tomas Hobsi, për herë të parë filluan të përpunojnë idenë e vëllimit të sovranitetit të shtetit në shek. XVI dhe XVII, rolin e tij e kishte "uzurpuar" e drejta hyjnore për të cilën u zhvilluan luftëra të përgjakshme. Për këta autorë çështja e sovranitetit ishte një sinonim i ligjësisë dhe i një rregulli të veçantë, ku të nënshtruarit nuk kishin asfar të drejte të rebelohen, mirëpo më vonë kuptuan se ky absolutizim i tepruar i sovranitetit mund të qojë dashtë e padashtë shoqërinë në tirani (gjë që ngjau shpesh gjatë historisë së njerëzimit) dhe në despotizëm të patolerueshëm.

Por çfarë kuptimi ka sot në kohën tonë diskursi mbi sovranitetin?

Ai, të themi kushtimisht ka filluar të luhetet me të mbaruarit e luftës së ftohët dhe me të filluarit e ndërtimit të rendit të ri botëror të identifikuar si globalizëm, westernizëm apo edhe amerikanizëm.

Ideja e sovranitetit, poashtu ndërlidhet shumë edhe me Paqen e Westfalisë (1648) që është e njohur si Marrëveshje (në të vërtetë e dy Marrëveshjeve: asaj të Minsterit dhe asaj të Osnabrickit) historike, ku u krijuan paradispozitat e para për një sistem modern të shteteve të pavarura në Evropë. Në të vërtetë, kjo Marrëveshje me shumë i adresohet çështjes që kishte të bënte me delegjitimitetin hegjemonist të Kishës së shenjët Katolike të njohur si perandori e llojit të vetë, se sa të idesë se marrëdhëniet ndërkombëtare duhet t'i lëvizë parashikimi lidhur me baraspeshën e fuqisë midis vendeve.

Poashtu, një ndër provokimet më të rënda që i është bërë ndonjëherë diskursit të sovranitetit padyshim, që ka të bëjë me të drejtat universale të njeriut në gjithë globin tokësorë. Përmes këtij diskursi, sot mekanizmat ndërkombëtar (OKB) kanë të drejtën e intervenimit moralo-politik (Rezolutat e aprovuara), por jo gjithkund dhe gjithherë edhe të drejtën e intervenimit ushtarak, siç ishte rasti i Kosovës. Ndryshimet e fundit marramendëse tekniko-teknologjike kanë bërë që, në një mënyrë e kanë thyer, si të themi atë barrierën e shteteve sovrane. Ngaqë, ndikimi i mediave globale (rasti i gjiganti të quajtur CNN-n dhe Alxhazira-s) kanë bërë që me asgjë të mos mbetet nën mëshirën e pushtetmbajtësve lokal. Sot pra si interes kombëtar i një vendi nuk janë mbyllja dhe izolimi por përkundrazi hapja dhe demokratizimi i brendshëm i raporteve shoqërore, pra ndërtimit të një diskursi më të përsosur të qeverisjes dhe menaxhimit me qytetarët e cilitdo vend, ku institucionet legale të dalura nga zgjedhjet funksionojnë në mënyrë të admiruar.

Roli i shteti të ardhshëm me siguri që do të anojë më tepër kah roli i menaxhmentit ashtu siç ka filluar aktualisht në perëndim, por pyetja se si do të mund të afirmohet çështja e sovranitetit të cunguar (« autonomi substanciale ») apo atij të reduktuar (« pavarësia e kushtëzuar ») në kushtet dhe rrethanat e reja të procesit të globalizimit, siç është rasti me Kosovën mbetet për t'u parë. Ngaqë, sot për sot është një çështje që ende nuk ka arritur të ketë ndonjë përgjigje të pranueshme as nga diskursi politik e as nga ai shkencor.

Së këndejmi çështja e reduktimit të sovranitetit duket që ende është në fazën eksperimentale dhe eldorado e vërtetë, ndërsa ambient më të përshtatshëm se Ballkani për këtë veprim prokrustian, duket që akoma nuk ekziston. Në fakt, mbetet një nevojë që ka të bëjë decidivisht me ndërtimin e institucioneve të pakorruptuara, përmes të cilave do të



ngritej vetëdija racionale për veçantinë e posaçme, si vlerë e procesit të globalizimit. Edhe pse modeli i komb-shtetit, për disa është bërë një pengesë serioze në fuqizimin e arkitekturës së integrameve globale, prapëseprapë do thosha ai nuk mjafton vetëm të marginalizohet dhe si i tillë të bartet në muzeun e tradicionales edhe për shkak se ende nuk ka ndonjë mekanizëm tjetër që do ta zëvendësonte atë si të tillë. E çka është edhe më interesant korniza e shtet-kombit, tash për tash mbetet e vetmja shpresë dhe i vetmi identifikim (që meriton edhe të sakrifikohet për të) përmes të cilit mund dhe po ndërtohet aktualisht demokracia si diskurs botërorë. Në anë tjetër, çështja e (jo)reduktimit, nuk është edhe gjithaq çështje e realizimit apo mos realizimit të synimit për të menaxhuar me vetveten si shoqëri e re demokratike, sa çështje e zhvillimit të aspekteve social-ekonomike të qytetarëve të vendeve të tranzicionit, aty ku aktualisht e ka vendin edhe Kosova. Pra, roli i shtetit në kushtet dhe rrethanat e reja është një domosdoshmëri e llojit të vetë, ngaqë vendet e tranzicionit ende nuk e kanë perfeksionuar sa duhet zejen e menaxhimit me vetveten. Institucioni i shtetit edhe gjithashtu është duke përjetuar një krizë do thosha tredimensionale, sidomos kur janë në pyetje sferat e kompetencave të tij si institucion i fortë në menaxhimin e të mirave materiale të qytetarëve të vet.

Argumenti i parë i kësaj krizë, është duke u manifestuar në sferën e ekonomisë dhe të politikës, ku ai një pas një është duke pësuar humbje në kuptimin e privimit nga disa ingerenca që i ushtronte më herët. KTN (Kompanitë Trans Nacionale), për shumicën e sociologëve të sotëm thuhet se janë ato që në një farë mënyrë kanë tendencë t'i zëvendësojnë në këto sfera disa nga kompetencat e shtetit klasik. Kësaj tendence thuhet që as SHBA-t, nuk po mund t'i ikin, ku me se miri u pa me rastin e pushtimit të Irakut.

Argumenti i dytë, për krizën e dukshme të institucionit të shtetit tani dhe në të ardhmen, thuhet që është padyshim ekzistimi i një vullneti dhe një dëshirë globale politike, për ta ndërruar procesin e zhvillimit të kapitalizmit. Duke mos hy në ndonjë analizë më të thukët, vlen të përmendim bie fjala disponimin e elitave pushtetmbajtëse të botës perëndimore, sidomos asaj amerikane, angleze, spanjolle, italiane, etj. p.sh. Në një takim të « Komisionit Trelateral », D. Rockefeller, përndryshe Kryetar i këtij asociacioni, ka theksuar se: »Pushteti mbinacional i bankierëve dhe i elitës intelektuale ndërkombëtarë,

duhet të qëndrojë mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje » (!?). G. Soros, njëri ndër zëdhënësit më të fuqishëm të globalizmit politik, procesin e kontrollit të tregut global e sheh vetëm në ndërtimin e institucioneve mbinacionale.

Argumenti i tretë, i krizës së ashtuquajtur shtetërore ka të bëjë me humbjen e cilësisë së rolit të tij në formimin e ashtuquajturit ethos kombëtar, që sipas Giddens është pasojë e rritjes së « vetëdijes kozmopolite ». Me sa mund të hetohet, shumica e sociologëve janë të pajtimit se roli i shtetit në rrethanat e reja të globalizmit domosdoshmërisht do të reduktohet përkatësisht do të zbehet sovraniteti i tij, mirëpo ai asnjëherë tërësisht nuk do të mund të zëvendësohet me ndonjë mekanizëm tjetër. Dilema jonë është se Kosovën që e pret sfida e definimit të statusit politik, është apo nuk është në rrugëtimin e proceseve të lartpërmendura? Përgjigjën le ta japin politikajt aktual gjatë këtij mandati të qeverisjes historike!

## NDIKIMI I NIVELEVE TË AUTORITETEVE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE NË SISTEMIN GJYQËSOR TË KOSOVËS

**Valentijn Batalaku**, univ. dipl. iur.

Në kushtet kur mungojnë mundësitë e zakonshme për përdorimin e mjeteve kërkimore dhe të shfrytëzimit të të dhënave, ata që interesohen për gjyqësinë kosovare, shpeshherë, janë të detyruar të udhëtojnë nëpër shtigje ,deri diku, të përdredhura për marrjen e informatave të caktuara. Këtë udhëtim tashmë po e bëjnë gazetarët "profesionist" dhe të ashtuquajturit analistë politikë, të cilët fatkeqësisht ndodhen në një qorrsokak sa i përket informimit të denjë dhe prezencës së tyre në proceset gjyqësore në Kosovë. A do të ndikojnë mikro-makro nivelet e autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare në marrjen e vendimeve gjyqësore në Kosovë edhe pas definimit të statusit përfundimtar të Kosovës? A është harxhuar energji dhe kohë në përpjekje për të siguruar një deklaratë për pavarësi në parlament, në vend se të kanalizohet energjia në përgatitjen e Kushtetutës së Kosovës dhe funksionimit të mirëfilltë të sistemit gjyqësor?

Në kohën kur e tërë diplomacia botërore është përqendruar në Kosovë, mendoj se do të ishte jokorrekte, të presim prej të dërguarit të posaçëm Ahtisarit të na shpalosë apriori "agjendën" e bisedimeve të palëve të përfshirë në negociata, agjendë që do ti kënaqë të dyja palët. Tashmë, i dërguari posaçëm Ahtisari kushtimisht po perceptohet si një ndërmjetës "gjyqtar" ndërkombëtar me preferenca të larta profesionale diplomatike, por edhe si dorë e zgjatur e qendrës të vendosjes ndërkombëtare.

Siç na është e njohur, me qëllim që të ndihmohet procesi gjyqësor në Kosovë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), qysh në fillim të mandatit të tij, ka vendosur që të angazhojë gjyqtarë dhe

prokuror ndërkombëtarë në sistemin gjyqësor të Kosovës. Me Rregulloren, nr. 6/2000, mbi Emrimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtarë dhe Prokurorëve Ndërkombëtarë, ai sidomos përcaktoi angazhimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar në Mitrovicë. Brenda pak kohe rregullorja e përmendur u ndryshua me amandamentet, të cilat u përfshin në Rregulloret 34/2000, 64/2000 dhe 2/2001; këto ndryshime pastaj mundësuan angazhimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në tërë sistemin gjyqësor të Kosovës.

Për sa i përket vendimeve gjyqësore, parimisht gjyqtarët janë të pavarur nga bashkëpunëtorët dhe eprorët e tyre. Organizimi hierarkik i drejtësisë dhe diferenca në grada dhe nivele nuk mund ta cenojnë të drejtën e gjyqtarëve që të japin lirisht gjykimin e tyre. Se gjyqtarët a i ushtrojnë funksionet e tyre si gjyqtarë të vetëm ose në kuadër të trupit gjykues, duke zbatuar me përpikëri ligjin në kuadër të sistemit juridik të Kosovës, këtë duhet ta vlerësojnë vetë qytetarët e Kosovës.

Në lidhje me ushtrimin e diskrecionit gjatë veprimtarisë vendimmarrëse gjyqtarët ndërkombëtarë në Kosovë janë mbështetur kryesisht në qëndrimin e tyre ideologjik për marrjen e vendimeve. Vendimet e gjyqtarëve kanë qenë në funksion të asaj që ata kanë preferuar të bëjnë, gjyqtarët që kanë pasur sens për liri dhe barazi kanë shfaqur prirjen që të votojnë në mbrojtjen e vlerave të luftës, ndërsa ata që kanë qenë konservativë kanë anuar nga votimi kundër këtyre vlerave. Gjyqtarët ndërkombëtar dhe vendor vlerat e luftës i kanë kuptuar në mënyra të ndryshme, madje edhe për sa i përket interpretimit të dispozitave ligjore që janë në fuqi.

Në këtë mënyrë mund të besojmë, se botëkuptimi i atij që merr vendim përbën një pjesë të rëndësishme për njësimin e vendimeve, ndoshta përbën edhe pjesën më të rëndësishme. Ata që dëshirojnë të kuptojnë veprimtarinë e marrjes së vendimeve gjyqësore nuk mund të injorojnë rolin që luajnë preferencat ideologjike të gjyqtarëve. Mirëpo në anën tjetër edhe makro-niveli institucional politik ndikon në marrjen e vendimeve gjyqësore, e cila vuan nga tendenca që t'i shikojë gjyqtarët sikur ata veprojnë brenda një boshllëku dhe jo në një botë të

gjallë politike të mbushur me kërkesa të ngutshme që kanë individët dhe grupet ndaj vendim-marrësve.

Shpeshherë, gati është bërë standard, se gjyqtarët nuk mund të veprojnë ashtu siç dëshirojnë ose as në mënyrën që mendojnë se duhet të veprojnë. Në vend të kësaj, qëndrimi i tyre ngushtohet nga strukturat e institucioneve të UNMIK-ut dhe mjediset më të gjëra politike ndërkombëtare- ata pengohen nga ajo që ata e gjykojnë si të përshtatshme për të bërë. Ajo që gjyqtarët preferojnë të bëjnë nuk është e thënë që të pajtohen me atë që ata inkurajohen apo lejohen për të bërë. Kjo tashmë ka ndodhur me sistemin gjyqësor në Kosovë. UNMIK-u në vend se të ndërtoj procedura institucionale të rregullta gjyqësore - ajo këto procedura i ka futur në një "kafaz papagallësh" duke demonstruar autoritetin gjyqësor para qytetarëve të Kosovës në mënyre të dyshimtë dhe jokorrekte.

Në këtë kontekst, po kështu, edhe mjedisi ndërhyr në veprimtarinë e gjyqtarëve, duke kufizuar rrugët në të cilat ata mund të ushtrojnë diskrecionin e tyre. Arrestimet ndaj ish pjesëtarëve të UÇK-së, kontestet pronëso-ro-juridike si dhe kontestet gjyqësore ndërmjet personave fizikë që ushtrojnë veprimtarinë publike (rasti i fundit në Ferizaj) kanë përcaktuar një sfond të rëndësishëm për marrjen e vendimeve gjyqësore. Tash është koha që të vijë në shprehje autoriteti i Gjykatës Supreme të Kosovës që të vendos mbi ankesat kundër aktgjykimeve dhe vendimeve të tjera të gjykatave në territorin e Kosovës dhe të vije në shprehje transparenca e punës së Dhomës së Veçantë pranë kësaj gjykate, e cila akoma çalon në punën lidhur me kërkesat që kanë të bëjnë me vendimet apo veprimet e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës (AKMS-së).

Nevoja për të ruajtur legjitimitetin dhe mbështetjen, si nga institucionet politike dhe nga qytetarët e Kosovës, ndikon, dukshëm në veprimtarinë e gjyqtarëve. Mospërfillja e kësaj bote më të gjerë politike paraqet rrezik për shoqërinë kosovare. Megjithëse, duhet pranuar se ekzistojnë rrugë të tjera krejt legjitime, nëpërmjet të cilave opinioni publik mund të ushtrojë ndikim në veprimtarinë e gjyqtarëve. Për shembull, gjyqtarët ndërkombëtarë fare mirë mund të marrin parasysh konceptet dhe mentalitetin e qytetarëve të Kosovës, për

rastet që marrin ndonjë vendim në lidhje me mbrojtjen e vlerave të luftës apo në lidhje me lirinë e shtypit.

Gjyqtarët në një anë ndikohen nga punëdhënësit-institucionet ku shërbejnë dhe në anën tjetër nga mjedisi ku ndodhen, që don të thotë se në Kosovë aktualisht po krijohet një "situatë juridike e niveleve të kryqëzuara" që do të ketë ndikim në marrjen e vendimeve gjyqësore. Pra, shumica e proceseve gjyqësore që zhvillohen aktualisht nuk perceptohen në mënyrë të njëjtë nga të gjithë njerëzit dhe institucionet vendore, sikurse nuk binden që të gjithë njëlloj.

Reagimet ndaj autoriteteve institucionale dhe presionit të shoqërisë kosovare, ndryshojnë sipas llojit të individëve. Megjithatë ky lloj qëndrimi mund të akuzohet për thjeshtim të tepruar -mbështetja më shumë se ç'duhet në supozimin se "shuma" mund të zvogëlohet në "pjesët" e saj përbërëse - përpjekjet që bëhen për të modeluar ndikimet e procesit të nivelit makro në marrjen e vendimeve duhet, së paku, të skicojnë proceset e mikro-nivelit që prezymohet se mund të ndodhin. Çështja e prononcimit të krerëve politikë dhe autoriteteve qeveritare para mediave elektronike për momentin është shumë e rëndësishme, sepse ato mund të përcaktojnë kahjen e zhvillimit të analizave të kryqëzimit të niveleve vendimmarrëse.

Në këtë kontekst ngelin një numër problemesh që mbesin për tu zgjidhur. Ne dimë pak rreth rrugëve të ndërlikuara nëpërmjet të cilave, orientimet ideologjike dhe të detyrës bashkëveprojnë me perceptimin e fakteve për formimin e vendimeve gjyqësore. A i perceptojnë gjyqtarët ndërkombëtarë faktet njësoj si gjyqtarët vendor? A vlerësohen faktet e njëjta, në mënyrë të ngjashme? A mbështeten gjyqtarët e ndryshëm në llojet e ndryshme të fakteve për marrjen e vendimeve? A dallohen gjyqtarët ndërkombëtarë me ata vendor nga llojet e fakteve që ata i konsiderojnë të nevojshme apo të dobishme për marrjen e vendimeve të duhura? A duhet ti heqim qafës gjyqtarët ndërkombëtarë? Kur do të barten definitivisht kompetencat e sistemit të drejtësisë tek vendorët?

Faktorët që ndikojnë për marrjen e vendimeve nga gjykatat kosovare ndryshojnë, ndërsa proceset nëpërmjet të cilave ato bashkëveprojnë

janë të ndërlikuara. Shumë lloj ndikimesh hasen në mikro-nivel - për shembull preferencat ideologjike të gjyqtarëve. Po kështu edhe influencat e autoriteteve të makro-nivelet, siç është prononcimi i krerëve politik dhe mediat publike elektronike "të pavarura", kufizojnë veprimtarinë e këtyre gjykatave duke ngushtuar diskrecionin që zotërojnë gjyqtarët. Andaj, bashkëveprimi ndërmjet autoriteteve të mikro-nivelet dhe makro-nivelet është njëra ndër çështjet më të rëndësishme që për momentin ka mbetur pa u zgjedhur institucionalisht dhe me ligj.

Kosovës i mungon një strategji gjyqësore. Mirëpo, strategjia gjyqësore nuk mund të krijohet nëse institucioneve të zgjedhura të Kosovës nuk iu mundësohet kyçja trendëve të përgjithshme të zhvillimit të shteteve demokratike, si institucione të Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

## DY DOKUMENTE OBLIGATIVE JURIDIKE PËR MBROJTJEN KUSHTETUESE TË PAKICAVE KOMBËTARE NË SHTETE ANËTARË TË KËSHILLIT TË EVROPËS \*

**Dr. Martin Berishaj**

Në suaza të Këshillit të Evropës u miratuan në fillim të viteve 90. dy dokumente multilaterale obligativo juridike që janë të dedikuara mbrojtjes së pakicave gjegjësisht gjuhëve të pakicave. Ato janë »Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare« në vazhdim (Konventa kornizë) dhe »Karta evropiane mbi gjuhët rajonale apo të pakicave« në vazhdim (Karta). Asnjëri nga këta dy dokumente nuk janë drejtpërdrejt ekzekutiv, mirëpo, shtetet anëtare nënshkrues të kësaj konventës kornizë dhe Kartës duhet të sigurojnë në legjislaturën e tyre si dhe të mbështesin këto dokumente me politikën e tyre qeveritare. Qëllimi im është që të konstatoj në rënd të parë, në çfarë sasive Konventa kornizë dhe Karta reflektohen në rregullimet kushtetuese të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Për shndritjen e karakterit të Këshillit të Evropës në lemën e mbrojtjes së drejtave të njeriut dhe të pakicave kombëtare si dhe ndikimit të tyre në rregullimin e brendshëm juridik të shteteve anëtare. Së pari do të prezantoj veprimin e Këshillit të Evropës në hapësirë të caktuar. Pas kësaj do të pasoj prezantimi i Konventës kornizë dhe Kartës e pastaj analiza e shkurt e dispozitave kushtetuese e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe krahasimi i atyre dispozitave të Konventës kornizë dhe Kartës. Si rrjedhojë e kësaj do të konstatoj se nënshkrimet dhe ratifikimet e Konventës kornizë dhe Kartës për gjuhë rajonale apo të pakicave nuk ka ndikuar në përmirësimin e mbrojtjes kushtetuese të pakicave në shtete nënshkruese të dokumenteve të cekur.

---

\* Ekstrakt nga një punim më i gjerë i dr. Martin Berishaj me titull "Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe karta evropiane për gjuhë rajonale në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës", prezantimi i këtij punimi është bërë në Strasbourg qershor 2001.



## Veprimi dhe roli i Këshillit të Evropës në lemën e mbrojtjes së pakicave kombëtare

Këshilli i Evropës është konstituar në vitin 1949 si organizatë evropiane për bashkëpunim ndërqeveritar dhe parlamentar (Thornberry in Estebanez, 1994: 9). Në anëtarësinë e tij ishin 10 shtete: Belgjika, Franca, Luksemburgu, Holanda, Britania e Madhe, Irlanda, Italia, Danimarka, Norvegjia dhe Sedija. Qëllimi i organizatës ishte para së gjithash të arrijnë unitet më të madh në mes shteteve anëtare dhe të përshpejtojnë zhvillimin ekonomik social<sup>1</sup>. Gradualisht kësaj organizatë i janë kyçur dhe shtetet tjera të Evropës perëndimore, kurse pas rënies së murit të Berlinit Këshilli i Evropës i ka çel dyert edhe për shtete të Evropës Lindore si dhe juglindore. Detyra themelore e Këshillit të Evropës është mbrojtja e të drejtave të njeriut. Nga konferenca në Wien në tetor të vitit 1993 ka filluar ti jepet rëndësi e posaçme në suaza të drejtave të njeriut poashtu dhe mbrojtjes së pakicave kombëtare. Mbrojtja e pakicave kombëtare në vitin 1993 u bë si kriter kyç në miratimin dhe pranimin e anëtarëve të rinj të Këshillit të Evropës. Para se të anëtarësohet ndonjë shtet në Këshillin e Evropës së pari shqyrtohet thellësisht kushtetuta dhe legjislatura e atij shteti si dhe kontrolli i administratorëve shtetëror, për të parandaluar »si në letër« e poashtu në praktikë shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave kombëtare. Rëndësia e atij evalvimi u ashpërsua në moment kur anëtarësia në Këshill të Evropës u bë parakusht i heshtur për hyrje në Bashkësi Evropiane. Deklarata trepalëshe e Këshillit, Komisionit dhe Parlamentit Evropian mbi të drejta të njeriut (1977) ka kërkuar nga shtetet aplikuese në Bashkimin Evropian që të jenë nënshkruese të konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut (e cila ishte e hapur vetëm për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës) dhe të miratojnë të drejtën e individit për peticione sipas dispozitave të asaj konvente. Komponenti themelorë e rëndit juridik (*acquis communautaire*) sërish u vërtetua me Marrëveshjen e Maastrichtit dhe kontratave të ndryshme evropiane të cilat ishin të bëra me shtete të Evropës lindore dhe asaj qendrore në vitet e 90. (Preece, 1997: 350).

<sup>1</sup> The aim of the Council of Europe is to achieve a greater unity between its Members for the purpose of safeguarding and realising the ideals and principles which are their common heritage, and facilitating their economic and social progress." (kapitulli i I. neni 1. i Statutit të Këshillit të Evropës)

Aktivitetet e Këshillit të Evropës në lemën e mbrojtjes së drejtave të pakicave kombëtare janë të ndryshme. Në mes tyre hasim në projekte sub rajonale dhe bilaterale siç janë organizimi i tryezave të rrumbullakëta dhe seminareve lidhur me problematikën e pakicave kombëtare.<sup>3</sup> Një nga aktivitetet më të rëndësishme është zhvillimi i standardeve evropiane juridike për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Në këtë lëmë në mes arritjeve tjera të Këshillit Evropian duhet të veçojmë para së gjithash dy dokumente:

- *Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe*
- *Karta evropiane për gjuhët rajonale apo të pakicave.*

Në pjesë të caktuara për mbrojtjen e pakicave kombëtare janë të rëndësishme poashtu<sup>4</sup>:

- *Konventa evropiane mbi të drejtat e njeriut<sup>5</sup>,*
- *Karta sociale evropiane dhe*
- *Karta evropiane mbi vetëqeverisjen lokale.*

Konform Planit të Aksionit (Plan of Action), të miratuar në takimin e lartë në Strasbourg (10.-11. tetor 1997), i cili Këshillin e Evropës e ngarkon me plotësimin e standardeve juridike me iniciativa politike, ku Këshilli i Evropës implikon aktivitete të panumërta si në rrafshin evropian e poashtu edhe në hapësirën individuale të shteteve veç e veç dhe shoqërisë civile. Do të cekim disa<sup>6</sup>:

- Formimi dhe veprimi i komiteti i eksperteve për çështje të lidhura me mbrojtjen e pakicave kombëtare që veprojnë në suaza të Këshillit për të drejtat e njeriut,
- Programi masave për ndërtimin e besimit,

---

<sup>3</sup> burimi : <http://www.coe.fr/cm/dec/1999/656/41.htm> (11. 9. 2001).

<sup>4</sup> burimi : <http://www.coe.fr/cm/dec/1999/656/41.htm> (11. 9. 2001).

<sup>5</sup> Me 4. nëntor 2000 u miratua Protokollin nr. 12 i asaj konventë, e cila posaçërisht e ndalon diskriminimin në bazë të racës, ngjyrës, religjionit, bindjes politike apo tjetërllloji, të burimit popullor apo social, të ndërlidhjeve të pakicave kombëtare lindjes apo statusit tjetër (Protokollin nr. 12, neni 1.). Pika e pestë e nenit të dytë të protokollit të cekur parashikon lejen e shtetit që individët, organizatat joqeveritare apo grupet e individëve, që mendojnë se u janë shkelur të drejtat nga neni 1 i protokollit, duke u ankuar në gjykatën evropiane për të drejtat e njeriut.

<sup>6</sup> Burimi : <http://www.coe.fr/cm/dec/1999/656/41.htm> (11. 9. 2001).

- Formimi i këshillit për migrime dhe bashkësitë e specializuara për Rom ,
- Formimi i këshillit për bashkëpunim kulturor ,
- Formimi i komisionit të Venecias,
- Formimi i pushteteve rajonale dhe lokale,
- Formimi i komisionit evropian për racizëm dhe jotolerancë ,
- Organizimi i takimeve informative brenda programit të aktivitetit<sup>7</sup> dhe programit të aktivitetit për zhvillim dhe konsolidim të stabilitetit demokratik ,
- Përpunimi dhe zgjerimi i dokumenteve informative dhe organizata e arsimit për organizata joqeveritare ,
- Programi i përbashkët për komisionin evropian: "Pakicat kombëtare në Evropë"<sup>8</sup> dhe "Integrimet e banorëve të burimit të huaj".
- Në mes organeve të Këshillit të Evropës të cilët merren me çështjen e mbrojtjes së pakicave kombëtare duhet të veçojmë rrolin e kuvendit parlamentar<sup>10</sup>, i cili nuk është i autorizuar për

<sup>7</sup> Programet ndërqeveritare të aktiviteteve përgatisin këshillin e ministrave të cilët mbështetën në propozimet («steering committees») që anëtarët e tyre janë përfaqësuesit e ministrave të shteteve anëtare. Trupi më i rëndësishëm ndërqeveritar në fushën e mbrojtjes së pakicave kombëtare dhe këshillave të eksperteve për çështje lidhur me pakica kombëtare që veprojnë në këshillin drejtues të këshillit për ruajtje të drejtave të njeriut. Në suaza të programit ndërqeveritar organizohen takime informative në lidhje me Konventën kornizë në rrafshin nacional apo lokal për deputet dhe përfaqësimit të pushtetit lokal dhe organizatave joqeveritare. URL: <http://www.humanrights.coe.int/Minorities/Eng/InterGovernmental/introductioninter.htm>

<sup>8</sup> Programi i përbashkët i quajtur «pakicat kombëtare në Evropë» ishte i futur në periudhën nga janari 1999 deri në qershor 2000. Ishte i bazuar para së gjithash në qasjen tematike (mediat, arsimimi, bashkëpunimi në procese të vendimmarrjes) në përgjithësi u kyç në projektet bilaterale dhe subrajonale më shumë në:  
URL: <http://www.humanrights.coe.int/Minorities/Eng/Cooperationactivities/JOintProg/introduction.htm>

<sup>10</sup> Kuvendi i parlamentit ka funksion këshillëdhënës dhe jo ligjvënës. Është e përbërë nga përfaqësuesit e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Përfundimet e kuvendit parlamentar janë transferuar këshillit të ministrave në formë të «rezolutës» dhe «qëndrimeve». Me çështjen e të drejtave të pakicave

pranimin e përfundimeve të obliguara juridike apo dokumenteve, mirëpo, me propozimet e tij iniciojnë dhe drejtojnë punën e këshillit të ministrave<sup>11</sup>. Qysh në vitin 1961 kuvendi propozoj kyçjen e nenit për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe protokollin plotësues në konventën evropiane mbi të drejtat e njeriut. Në draftin e protokollit ishte e shkruar: "Individëve që i takojnë pakicës kombëtare nuk guxohet tu mohohet e drejta që së bashku me anëtar tjerë dhe konform me rendin publik e gëzojnë kulturën e vetë, përdorimin e gjuhës së vet, formimin e shkollave të veta, duke praktikuar besimin e tyre me gjuhë që preferojnë ata" (Thornberry in Estebanez, 1994: 25).

Këshilli i ministrave i obligojë këshillin e eksperteve për të drejtat e njeriut të hulumtojnë draftin e cekur. Këshilli në vitin 1973 e miratoj vendimin dhe vendosi nga aspekti juridik brenda konventës ekzistuese nuk kishte nevojë për protokoll plotësues (Thornberry in Estebanez, 1994: 25).

Sipas rekomandimit 1201 (Recommendation 1201) në vitin 1993 u propozua miratimi i protokollit plotësues për konventë evropiane për të drejta të njeriut e që do të merrej me problemin e pakicave kombëtare e cila do të kyçte definicionin e terminit » pakicë kombëtare«. Në nenin e parë të propozimit të protokollit plotësues thuhet : "Për nevoja të konventës termini »pakicë kombëtare« ka të bëjë me grupin e individëve në shtet që:

- a) Jetojnë në territor të shtetit dhe janë shtetas të tij;
- b) I ruajnë marrëdhëniet afatgjate të forta dhe të përhershme me shtet,

---

merren këshille të ndryshme në mes të cilave më i rëndësishmi është këshilli për çështje juridike dhe të drejta të njeriut (Thornberry in Estebanez, 1994: 10).

<sup>11</sup> Këshilli i ministrave është trup ndërqeveritar i cili miraton konventën dhe marrëveshjet e shteteve anëtare. Çdo shtet anëtar ka nga një votë dhe një përfaqësues. Zëvendësit e ministrave janë përfaqësues të përhershëm në Këshillin e Evropës dhe kanë sa i përket vendosjes autorizime të njëjta sikurse edhe ministrat. Organet e përhershme në kontrollin e këshillit të ministrave janë të ashq. »këshillat drejtues« të cilët përkrye sekretarit gjeneral i përçojnë propozimet këshillit të ministrave. Në suaza të mbrojtjes së pakicave kombëtare do të ceksha dy këshilla; këshilli për mbrojtje të drejtave të njeriut dhe këshilli drejtues i migracioneve (Thornberry in Estebanez, 1994: 10-11).

- c) Kanë karakteristika të veçanta etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore,
- d) Janë mjaft reprezentues edhe sipas numrit paraqesin pjesën e pakët të popullatës në shtet, apo rajon të caktuar brenda shtetit,
- e) Janë të motivuar për ruajtjen e identitetit të tyre së bashku me kulturë, traditë, religjion dhe gjuhë.<sup>12</sup>

Përfaqësuesit e shteteve dhe qeverive anëtare në takimin në Wien me dt. 3. tetor 1993<sup>13</sup> kanë vendos për zgjedhje tjetër. Këshilli i ministrave është obliguar për përpilimin e standardeve juridike në formë<sup>14</sup>:

- *Konventës kornizë*, të hapur edhe për nënshkrime të shteteve joanëtare të Këshillit të Evropës që do të vendosin parime të cilat

---

<sup>12</sup> Në origjinal thuhet : "For the purposes of this Convention, the expression "national minority" refers to a group of persons in a state who: a) reside on the territory of that state and are citizens thereof; b) maintain longstanding, firm and lasting ties with that state; c) display distinctive ethnic, cultural, religious or linguistic characteristics; d) are sufficiently representative, although smaller in number than the rest of the population of that state or of a region of that state; e) are motivated by a concern to preserve together that which constitutes their common identity, including their culture, their traditions, their religion or their language." Shiko : Recommendation 1201 (1993) on an additional protocol on the rights of national minorities to the European Convention on Human Rights.

<sup>13</sup> Në origjinal thuhet : "For the purposes of this Convention, the expression "national minority" refers to a group of persons in a state who: a) reside on the territory of that state and are citizens thereof; b) maintain longstanding, firm and lasting ties with that state; c) display distinctive ethnic, cultural, religious or linguistic characteristics; d) are sufficiently representative, although smaller in number than the rest of the population of that state or of a region of that state; e) are motivated by a concern to preserve together that which constitutes their common identity, including their culture, their traditions, their religion or their language." Shiko : Recommendation 1201 (1993) on an additional protocol on the rights of national minorities to the European Convention on Human Rights.

<sup>14</sup> Burimi: <http://www.coe.fr/cm/dec/1999/656/41.htm>

shtetet nënshkruese pajtohen se do të mbrojnë pakicat kombëtare,

- *protokolli*, që do të plotësoj konventën evropiane për të drejtat e njeriut në hapësirën kulturore me dispozita që do të sigurojnë të drejta individuale për individ që u takojnë pakicave kombëtare.

Konventa kornizë për të drejtën e pakicave kombëtare ishte e miratuar në vitin 1995 dhe ka filluar të vlejë në shkurt të vitit 1998. Protokollin i cekur për konventën evropiane mbi të drejtat e njeriut deri tani Këshilli i Evropës nuk ka pranuar. Me formulimin e tekstit të protokollit është marr komisioni i eksperteve *ad hoc* për pakica kombëtare e që ka dhënë raportin e fundit në vitin 1995, mirëpo, këshilli i ministrave në janar të vitit 1996 ka vendosur që të ndalojnë punën për formulimin e protokollit të cekur. Shkaqet për vendim të tillë ishin se shtetet anëtare nuk patën sukses të merren vesh për definimin e pakicës e as rreth natyrës dhe vëllimit të drejtave të caktuara. Përkundër ndalimit të punës të CAHNMIN it, këshilli i ministrave e la të çelur hulumtimin e serishëm të kësaj çështje për një herë në të ardhmen <sup>15</sup>.

Se përpjekjet në at drejtim nuk janë shuar na tregon fakti se në rekomandimin 1492 që e ka dhënë kuvendi parlamentar në fillim të vitit 2001 sipas rekomandimit këshillit të ministrave që konform parimeve që janë në përmbajtje të rekomandimit 1201 (1993) filloj të formulohet protokollin i konventës evropiane për të drejtat e njeriut e që do të rregullonte të drejtat e pakicave kombëtare së bashku me definimin e pakicës kombëtare (Recommendation 1492 (2001) pika xi.).

Ne rekomandimin e cekur 1492 kuvendi ka propozuar që në suaza të kornizës së institucionit të komisarit për të drejtat e njeriut të jen personi i cili do të jete i ngarkuar me çështje specifike të lidhura me mbrojtjen e pakicave kombëtare (pika xii). Përpos kësaj këshillit të ministrave u është rekomanduar që të ftojnë të gjitha shtete anëtare që të nënshkruajn sa më parë dhe të ratifikojnë Protokollin nr. 12 të konventës evropiane për të drejta njerëzore, me shprehje që në këtë mënyre individëve që u përkasin pakicave kombëtare tu lejohet që të

---

<sup>15</sup> Burimi: <http://www.coe.fr/cm/dec/1999/656/41.htm>

drejtat e tyre te posaçme te konfirmoj Gjykata evropiane për te drejta te njeriut. (Recommendation 1492 (2001), pika vii).

Përpos kuvendit parlamentar dhe këshillave te tij si dhe këshillit te ministrave dhe këshillave drejtues (Steering Committees) duhet te përmendim edhe disa organe qe jane brenda Këshillit te Evropës e qe merren me problematiken e pakicave kombëtare. Sekretari gjeneral te cilin e zgjedh kuvendi ka rrol te posaçëm ne organizimin dhe jetën e mbrojtjen e te drejtave te pakicave kombëtare. Organ tjetër me rendësi është Kongresi i pushteteve lokal edhe rajonale<sup>16</sup>, e qe e përbejnë delegacionet nacionale te rajoneve te zgjedhur ne mënyrë demokratike ne rajone nga vijnë. Problematika e pakicave kombëtare është posaçërisht e rëndësishme për pushtetet lokale dhe rajonale dhe për at shkak nuk na befason fakti se iniciativa për kartën evropiane te pushtetit lokal dhe rajonal apo gjuhës se pakicave erdhi mu nga institucioni i Kongresit te pushteteve lokal dhe rajonale. Me çështje te pakicave merret komisioni evropian për demokraci ne përmjet te drejtës i quajtur si (Komisioni i Venecijes) i cili ka prezantuar draftin për konventën evropiane te mbrojtjes se pakicave kombëtare ne vitin 1991. (Thornberry in Estebanez, 1994: 10-11).

### **Konventa kornize për ruajtjen e pakicave kombëtare**

Konventa kornize ishte e çelur për nënshkrim qe nga 1 . shkurti 1995 kurse është bere fuqiplote me 1. shkurt 1998. Këtu behet fjale për dokumentin e pare obligues juridik me instrument multilateral për ruajtjen e pakicave kombëtare, e qe për nga themeli është universal (nuk është i kufizuar ne një apo disa shtete), mu për ketë shkak, dokumenti ka domethënie me te madhe edhe mund te konstatojmë se ka shume lëshime. Njeri nga lëshimet është gjithsesi mungesa e mekanizmit ndërkombëtare qe do te detyronte shtetin nënshkrues te këtij dokumenti ne përmbushjen e dispozitave nga kjo konvente. Konventa e shtien ne loje sistemin e kontrollit i cili bazohet ne propozimet e shteteve (neni i 25. i konventës kornize). Organi kryesor kontrollues i konventës është këshilli i ministrave te cilit ne

---

<sup>16</sup> Congress of Local and Regional Authorities in Europe (CLRAE).

pune te tij i ndihmon organi për dhënie te këshillave i cili është i përbërë nga ekipi e eksperteve te asaj leme. (Neni i 24. dhe 26. i konventës). Organi këshillëdhënës miraton mendimet për realizimin e konventës kornize ne shtetet qe e kanë nënshkruar konventën, këshilli i ministrave pastaj, miraton përfundimet dhe sipas nevojës jep rekomandime për shtete ne fjale. Porosite dhe ankesat nga ana e pakicës kombëtare apo nga bashkësitë si dhe organizatat joqeveritare nuk jane te parapara ne konvente, e kjo dmth. se shtetet qe jane te obliguara te realizojnë te drejtat sipas kësaj konvente qe kanë nënshkruar ata, paraqiten si kontrollues te vetëm dhe vlerësues i punës se tyre. Edhe me tepër është problematike për shkak se dispozitat nga konventa kornize nuk jane drejtpërdrejt te ekzekutuara, mirëpo shtetet do ti kryejnë ato veprime ne përmjet te legjislaturës nacionale dhe politikave kompetente te qeverise. Këtu u lihet liri e madhe shteteve ne realizimin e dispozicioneve nga konventa qe për shtete konkrete ne territor te vet siç është e shkruar ne tekstin zyrtar te eksplanatoriumit te kësaj konvente (kryerreshti i 11) u mundëson mu atyre shteteve te ikin nga obligimet e marrura nga konventa, poashtu këtu u shërben si ndihem fakti se, konventa si e tille nuk e definon pakicën kombëtare. Shkaku është pragmatik ne kohe te përpilimit te konventës nuk ishte e mundur te definohet koncepti i »pakicës kombëtare« ne at mënyrë qe do te ishte i kapshëm për te gjitha shtetet anëtare te kësaj organizate (Explanatory report, kryerreshti i 12.).

Përkundër kësaj konventa ne piken 1 te nenit te peste, i përcakton »elementet themelore ... te identitetit« Pakica kombëtare duhet te jen bashkësi e cila nga popullata shumice dallohet sipas çdo njërit nga këta kritere. Mirëpo, teksti eksplanator shpjegon, se etnitë e ndryshme kulturore, gjuhësore dhe fetare nuk shpien gjithherë deri te formimi i pakicës kombëtare (Explanatory report, kryerreshti 43.). Ky lloj komentari »u shkon për shtat« shteteve qe nuk dëshirojnë te pranojnë statusin e pakicës kombëtare bashkësive te ndryshme kombëtare (Gilbert, 1996: 177).

Një nder çështjet qe parashtrohen ne lidhje me konventën kornize është edhe çështja e te drejtave kolektive dhe individuale. Edhe përkundër vet titullit te konventës si te tille e qe përcaktohet për



mbrojtjen e te drejtave te pakicës kombëtare (dhe jo për te drejta kolektive dhe individuale te pakicës kombëtare) për konvente është karakteristike koncepti i mbrojtjes individuale. Shtetet anëtare janë pajtuar se është mundur te mbrohet pakica dhe të vetëkënaqet ajo me mbrojtjen e disa përfaqësuesve te saj. Ne shikim te pare ky koncept i mbrojtjes individuale është i zbutur deridiku me dispozicionin e pikës 2 te nenit 3. ne te cilën është shkruar qe, pjesëtarët e pakicës te drejtat nga konventa kornize i realizojnë ne mënyrë individuale apo ne grupe me te tjerët. Raporti eksplanator ne konvente e përcakton formulimin » ne grupe me tjerë« nënkupton vetëm pjesëtarët e pakicës mund te realizojnë te drejtat dhe lirit nga kjo konvente me te tjerët, me ç rast »tjerët« mund te jene pjesëtare po te njëjtës pakice kombëtare apo pjesëtarët e popullit shumice. Formulimi i cekur nuk u ndanë pakicave kombëtare te drejta kolektive (Explanatory report, kryerreshti 37.). Përkundrejt shpjegimit zyrtar te konventës ekzistojnë argumentime qe e bazojnë qëndrimin tjetër se është e mundur qe dispozicionet e caktuara (dhe si çështje racionale) te shpjegohen ne kuptim te drejtave kolektive te bashkësisë nacionale ( Gilbert, 1994: 178-179).

Te shikojmë se cilat te drejta u pranohen pjesëtarëve te pakicave kombëtare u garanton konventa kornize apo cilat përgjegjësi konventa u ngarkon shteteve nënshkrues ne lemën e mbrojtjes se pakicave. Ne nenin e pare konventa e përcakton mbrojtjen e pakicave si pjese integrale e mbrojtjes ndërkombëtare te drejtave te njeriut. Si e tille është mbrojtja e pakicave ne fushën e bashkëpunimit ndërkombëtare. Shtetet si te tilla, me nënshkrimin e konventës »çojnë duar« nga parimi sipas te cilit mbrojtja e pakicave është çështje e brendshme e çdo shtetit ne veçanti.

Konventa siguron çdo pjesëtari te pakicës kombëtare te vetëvendoset a dëshiron te jene i akceptuar si pjesëtar i pakicës kombëtare apo jo (neni 3.) kjo dmth., a dëshiron qe te vlejnjë për te apo me mire te themi te mbrojnë ate parimet e konventes kornize. Këtu assesi nuk do te thotë se behet fjale për vendim arbitrar te individit për çështje se ai takon apo nuk i takon pakicës kombëtare. Përzgjedhja subjektive e individit është domosdoshmërisht e lidhur me kritere objektive relevante për identitetin e individit (Explanatory report, kryerreshti 34. dhe 35.).

Ne vazhdim konventa kornize u ngarkon shteteve nënshkruese të saja se duhet pjesëtarëve të pakicave tu sigurojnë:

- barabarsin para ligjit dhe mbrojtjen para çfarëdo lloj diskriminimi (neni 4.);
- kushtet për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës dhe elementeve themelore të identitetit të tyre siç janë, m feja, gjuha, tradita dhe trashëgimia kulturore (neni 5.);
- lirinë e bashkimeve, të organizimit, të shprehjes së lire poashtu dhe bindjes fetare (neni 7.);
- të drejtën për formimin e institucioneve fetare, organizatave dhe shoqatave (neni 8.);
- të drejtën në pranimin dhe shpërndarjen e informacioneve në gjuhët të tyre, dhe formimin e mediave vetanake (neni 9.);
- të drejtën në përdorimin e gjuhës së vet në sferën private dhe publike, në marrëdhënie me pushtet (ku është e mundur ajo) si dhe pran gjykatave (neni 10.);
- të drejtën në mësimin e gjuhës amtare dhe mësimin në gjuhë amtare (neni 14.);
- të drejtën në përdorimin e emrave dhe mbiemrave në gjuhën e pakicave dhe mbishkrimet toponimike, ku është e mundur (neni 11.);
- të drejtën për formimin dhe administrimin e institucioneve private dhe arsimore (në harxhime të vet pjesëtareve të pakicës) (neni 13.);
- mundësi për bashkëpunim në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike si dhe në çështje publike posaçërisht për ata që janë të interesuar për ato çështje në mënyrë të drejtpërdrejtë (neni 15.);
- të drejtën për të vendosur të mirëmbajtur marrëdhënie të qeta me individ që jetojnë në shtete tjera, posaçërisht me persona që i lidh përkatësia e përbashkët kulturore, gjuhësore, fetare, etnike dhe trashëgimia kulturore (neni 17.);
- të drejtën për bashkëpunim me organizata joqeveritare në rrafshin shtetëror apo ndërkombëtar. (neni 17.).

Shtetet janë të obliguara poashtu të ndërprejnë dhe pa mundësojnë asimilimin e dhunshëm (neni 5.) dhe të përmbahen nga masat që do të ndryshonin pjesën e banorëve në hapësirë ku jetojnë pjesëtarët e pakicës kombëtare e që do të shpinte në përkufizimin e të drejtave dhe lirive që dalin nga kjo konvente (neni 16.).

Te drejtat e pakicave kombëtare dhe obligimet e shteteve në konventën kornize përpos asaj që nuk janë të realizueshme me një here janë edhe në shumicën e rasteve të kufizuara me formulime që i cekin, si p.sh. »kur është e nevojshme«, »me sa është e mundur«, »në hapësirë ku pjesëtarët e pakicave jetojnë tradicionalisht në numër të mjaftueshëm«, »ku ekziston oferta e bollshme« etj. u është lenë shteteve vet. Krejt kësaj kur i shtohet edhe mungesa e mekanizmit të kontrollit efektiv, e rëndon edhe më tepër mbrojtjen efektive të pakicave që del nga konventa kornize.

Pavarësisht nga mungesat e shumta të kësaj konvente duhet të vendosim në pah efektet pozitive të konventës kornize duke e potencuar natyrën e saj universale. Pra, behet fjale për dokument universal që është i dedikuar mbrojtjes së drejtave të pakicave kombëtare në të gjitha shtetet dhe nuk kufizohet vetëm në disa, e që dikur ishte karakteristike për periudhën kalimtare. Ky është argument i bollshëm në dritë të proklamimit të barazisë së shteteve sovrane.

### **Karta evropiane mbi gjuhët rajonale apo të pakicave**

Karta evropiane mbi gjuhët rajonale apo të pakicave u miratua në vitin 1992 dhe hyri në fuqi më 1.03. 1998. Propozimi i miratimit të kartës dhe draftit të tekut rezolutën 192 (1998) e ka dhënë konferenca e përhershme e pushteteve lokale dhe rajonale (CAHLR). Ate iniciativë e kanë mbështetur kuvendi parlamentar sipas Opinioneve nr. 142<sup>17</sup>, këshilli i ministrave e ka ngarkuar pastaj, ad hoc ekipin e eksperteve për gjuhë të pakicave në Evropë që të përgatitë tekstin e draftit të Kartës, duke u bazuar në draft që e ka propozuar CAHLR. Karta ishte e miratuar si konvente në takimin e zëvendësministrave më 25 qershor 1992, dhe

---

<sup>17</sup> Opinion No. 142 (1988).

është bere e çelur për nënshkrim me 5. nëntor të njëjtit vit (Thornberry dhe Estebanez, 1994: 31).

Që në fillim dëshiroj të cekim se qëllimi i Kartës është mbrojtja e gjuhëve rajonale apo të pakicave si aspekt të rrezikuar të trashëgimisë kulturore evropiane, e jo si mbrojtje e pakicave gjuhësore (Explanatory report, kryerreshti 10. dhe 11.). Pavarësisht nga shpjegimi i tillë zyrtar i Kartës, në praktike, shpesh herë kuptohet (edhe) si instrument i mbrojtjes së pakicave, me ç'rast qëndrojnë edhe shkaqet se kanë ratifikuar atë pak shtete Kartën deri më tani. Në këtë fakt na e tërheq vëmendjen poashtu edhe raportuesi në këshillin për kulturë dhe arsimit në kuvend Lluís Maria de Puig, i cili në Opinion mbi raportin për të drejtat e pakicave kombëtare<sup>18</sup> bën thirrje që të shtrohet me shumë kujdes dhe mundësi në prezantimin e Kartës si instrument të mbrojtjes së gjuhëve (edhe siç është) dhe jo si instrument politik për mbrojtjen e njerëzve që flasin ato gjuhë (siç shpesh kuptohet Karta e tillë.) (De Puig, 2001). Por kurrësi nuk mundemi të mohojmë faktin se mbrojtja e gjuhëve të pakicave kombëtare paraqet në fakt mbrojtjen e njërit (shpesh me të rëndësishmit) element të identitetit të pakicës. Për dallim nga Konventa kornize, Karta është tepër e sakte në definimin e objektit të cilat e kanë nënshkruar shtete dhe që janë të detyruara të mbrojnë. Në nenin e 1. është shkruar definicioni i gjuhëve rajonale dhe të pakicave, e që thotë se »gjuhët rajonale apo të pakicave« janë ato gjuhë që " i përdorin tradicionalisht në hapësirë të caktuar dhe në territor të shtetit, shtetasit e tij, që përbejnë grupin, numerikisht më të vogël sesa pjesa tjetër e banorëve të shtetit dhe ii që dallohen nga gjuha zyrtare apo gjuhët zyrtare të atij shtetit; termi nuk përcakton as dialektet e gjuhës zyrtare apo gjuhëve zyrtare dhe as gjuhën e migrantëve;" (neni 1. pika a)<sup>19</sup>.

<sup>18</sup> *Opinion on the report on the rights of national minorities* (Doc. 8941, 22 January 2001). Opinioni ka të bëjë me raportin mbi të drejtat e pakicave kombëtare, të cilat i ka përgatitur Këshilli për ruajtjen e të drejtave juridike dhe të njeriut (Doc. 8920, 29. janar 2001; vërejtje: Binding, 2001).

<sup>19</sup> Përkthimi është nga "Zakon o ratifikaciji Evropske listine o regionalnih ali manjšinskih jezikih" (Uradni list: MP 17/2000, 04.08.2000 (fq. 777)), i botuar në ueb faqën e Parlamentit slloven:

Gjuhët për të cilat bën fjalë Karta janë rëndomtë gjuhë »territoriale« që tradicionalisht përdoren në hapësirë të caktuar gjeografike. Shkaku se pse Karta merret me ato gjuhë është se shumica e masave që i parasheh Karta ka nevojë për definim të hapësirës gjeografike (ku do të realizohen ato masa), e që dallohen nga territori i tërësisë së shtetit. Për at shkak në Karte është e definuar poashtu edhe »territori në të cilën përdoren gjuhët rajonale apo të pakicave« (Explanatory report, kryerreshti 33.). Behet fjale për : "hapësirë në të cilën shprehet numri konsiderueshëm i banorëve të sajë e që arsyetojnë miratimin e masave mbrojtëse që i parasheh Karta " (neni 1. pika b)<sup>20</sup>.

---

[http://www.dzrs.si/si/aktualno/spremljanje\\_zakonodaje/sprejeti\\_zakoni/sprejeti\\_zakoni.html](http://www.dzrs.si/si/aktualno/spremljanje_zakonodaje/sprejeti_zakoni/sprejeti_zakoni.html) (11. 9. 2001).

<sup>20</sup> ibidem

## **AT ZEF VALENTINI - NJË ALBANALOG DHE NJË ALBANOFIL I JASHTËZAKONSHËM**

Shqiptarë! Duajeni At Valentinin, se ai ju dashuron me zemër. Çmojeni, se ai punon paprerë, për t'ia bërë të ditur botës vlerat tuaja shpirtërore dhe artistike. Ai është juaji, sepse i ka dhënë çështjes suaj mendjen dhe shpirtin e vet.

Ja, këto fjalë të kumbuara nga Papa Pauli VI përpara mijëra të ftuarve ndërkombëtarë që merrnin pjesë në solemnitetin kremtues të kongresit kastriotian mbajtur më 25 Prill 1968 në Romë, me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së heroit tonë të madh kombëtar, janë maja kulmore e vlerësimit të aktivitetit të mrekullueshëm gati 50 vjeçar të një studiuesi të shquar, të një njeriu të ditur të shkencës, të një figure shumëpërmasore e me interesa të gjithëllojshme, të një personi me shpirt sa të ndrojtur aq dhe të paepur, të një jezuiti italian, të lindur në Padova (bashkë me shekullin e kaluar, pasi është i datëlindjes 1900), që me të ardhur në Shqipëri nuk u ndal në zhvillimin e thjeshtë të aktivitetit të tij fetar dhe edukativ prej misionari, por me një dashuri të ethshme e çdo ditë e më të fortë, shoqëruar nga një formim rigoroz shkencorokulturor, u hodh me të gjitha forcat në vorbullën e njohjes së çdo këndi të jetës dhe historisë së popullit shqiptar, të gjuhës e zakoneve të tij, të panoramës sonë të pasur etnografike e arkeologjike, me rezultate të shkëlqyera në secilën prej këtyre, disiplinave, të atilla sa t'i japin sot njëzëri titullin e njerit nga mjeshtrit më të mëdhenj që ka njohur ndonjëherë shkenca e Albanologjisë.

Madje prania e figurës së një studiuesi me përmasa të tilla, në kaq shumë fusha të historiografisë dhe shkencave shoqërore, e bën të pamundur cilëndo përpjekje për ta karakterizuar veprën e tij në një fushë të caktuar. Gjithsesi nga pikëpamja e karakterit, e rëndësishme do të qe të ravijëzohej freskia e tij e përhershme shpirtërore, kureshtja gati foshnjore, kurrë i nginjur e asnjëherë i fashitur, i një njeriu që i sheh gjërat dhe njerëzit me një shpirt gjithmonë të ri, paragjykimdavaritës, ku shquhet gatishmëria intelektuale dhe vrulli "djaloshtar" për të rrokur gjithçka që i intereson me një pasion kurrë të mugëtuar e

vazhdimisht të gjallë. Nga ana tjetër, gjithë rregulli i tij sistematik në kërkime e gjithë ai formim e kultivim i vazhdueshëm shkencor, apo gjithë ai pathos i jashtëzakonshëm për punën që e shtynte të punonte natë-ditë, duke thënë gjithmonë "Duhet të ngutemi, sepse s'kemi shumë kohë", nuk do të kish mjaftuar për të bërë gjithë ato kryevepra që ai la pas, po që tek studiuesi dhe shkencëtari rigoroz nuk do të shihnim një "burrë fjalë pak, derë-çelë, shpirtgjanë, të arsyeshëm e të matur, njëlloj si banorët e maleve shqiptare", - siç i pëlqente ta thërrisnin shpesh; nëse nuk do të shihnim një enolog shije-hollë e anëtar të Akademisë Italiane të Kuzhinës, që i njihte përbërësit e një recete gjelle po kaq mirë sa dhe "aktet shqiptaro-venedikase", nëse nuk do të shihnin një lexues të apasionuar të librave policorë apo të dashuruar marrëzisht pas një Baccelli një Salgazi, një Wiecherti e një Çehovi; nëse nuk do të shihnin vallëtarin dhe këngëtarin magjepës të melodive bizantine me kalime të tonit të nivelit të katërt që ata të cilët kanë ndopak njohuri për muzikën i bënë të rrëqethen përpara asaj ç'ka kjo nënkupton; nëse nuk do të shihnin topografin e botanikun profesionist, kujtojmë këtu artikujt shpjegues mbi botanistin dhe albanologun e shquar italian Antonio Baldacci dhe një recension të tij mjaft special në këtë fushë mbi Wulfenian, një lloj bime shumë të rrallë por e gjetur edhe në Shqipëri.

Gjithsesi ia vlen të përmendim në këtë pikë, një episod mjaft interesant në zhbirimin e raportit të tij fillestar me shqiptarët, një episod ky i rrëfyer shumë vite më pas nga Koliqi, njëri prej bashkëpunëtorëve dhe miqve të tij më të mirë. "At Valentini mbërriti në Shqipëri në shtatorin e vitit 1922. Në at muaj të ëmbël e të pruar vjeshtor, Shkodra e priti me heshtjen dhe nxehtësinë e rrugëve të saj gjarpnuese, rrethuar me gjethet e zverdhura të lulvileve në agoni e me aromat e fshehta që asokohe vërshonin prej s'brendshmi në rrugë, tue ardhë prej matanë mureve të larta të oborreve të mbyllura". Sigurisht, në periudhën e qëndrimit të parë në Shkodër, ai do të jetë ndjerë në siklet përpara këtyre dyerve të mbyllura fort, në ato shtëpi prej të cilave vetëm dritaret e fortifikuara vështronin nga rruga, përballë atyre njerëzve të sjellshëm e madje ceremonialë, por të rezervuar e me pamje të mezidallueshme, mosbesimi, që s'lejonin me u folë as edhe një fjalë më tepër nga ajo që përmbante fjalori i tyre ngushtësisht konvencional.

Edhe pse mundohej të përshtatej me vullnetin më të mirë e me të gjithë "arsenalin" e tij të komunikimit, ai nuk arriti kurrsesi ta thyente akullin me nxënësit e vet, në klasat e gjimnazit ku jepte mësim mbi latinishten, greqishten, italishten, fenë apo historinë e natyrës. Ndihej sinqerisht i pikëlluar për këtë dështim, kur e la Shqipërinë për të shkuar në Gjenova e për të vazhduar studimet për filozofi. E po kaq i izoluar vazhdoi të ndihej edhe atëherë kur u kthye përsëri në Shkodër në vitin 1926, tashmë për të qëndruar gjatë. Mure që dukeshin të pakapërcyeshëm nga moskuptimi e pengonin të vendoste marrëdhënie miqësore me shqiptarët në përgjithësi dhe me nxënësit e vet në veçanti. I përfundonin pa rezultate të gjitha përpjekjet e depërtimit nëpër ata shpirtra që i dukeshin hermetikë. Aq më tepër që ky moskuptim, po i shkaktonte edhe dështimin e detyrës së tij si misionar. Kështu i tronditur së brendshmi nga një krizë e rëndë shpirtërore, arrin deri në pikën e dorëzimit dhe braktisjes së çfarëdolloj detyre. Vendos madje të kërkojë edhe transferimin. Mirëpo e gjitha kjo ndryshoi në ditën e përvjetorit të ditëlindjes së tij, kur ai vuri re papritmas se sjellja e atyre djelmoshave nuk diktohej nga mosbesimi apo nga mungesa e dashurisë dhe respektit, por nga karakteri i veçantë i shqiptarit, i cili shfaqet e hapura të ndjenjave i konsideron si akt dobësie".

Që prej atij çasti, akulli u thye. Pak nga pak ai u ndje i rrethuar jo vetëm nga simpatia, por edhe nga ngrohtësia e sinqertë e kujtdo shqiptari me të cilin takohej. Fliste hapur, komunikonte me banorë qytetesh, katundesh, malesh, dëgjonte me vëmendje njerëz të çdo niveli e feje, duke kërkuar të njihej madje dhe me problemet e tyre personale. Një padovani si ai banesat karakteristike shkodrane, i kujtonin shtëpitë e fshatit të vet, në Brenta. E mahniste atmosfera e botës së këtyre familjeve, mbujtur mes një fisnikërie autentike, e mbetur e pacënuar nga shtrëngatat shekullore. Shijonte me ëndje shurupet e ëmbla të limonëve, rritur në oborret e shtëpive, dardhat e kopshteve shtëpijakë, gatuar me kujdes e ngrohtësi sipas recetave tradicionale, rakinë e fortë të rrushit të vreshtave të Bardhaj e Recit. Në pazar të Shkodrës, i pëlqente të frekuentonte tezat e qëndistarëve të bastunëve të argjendta, të rrobashitësve e tregëtarëve që kishin shëtitur tërë botën. Ndërkohë që në Tiranë kur pas vitit 1941 filloi të punonte si



këshilltar e sekretar i përgjithshëm i Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare, kishte për zakon të vizitonte me radhë, një nga një çdo ditë, të gjitha gjellëtoret e vogla të rrugës së Dibrës, duke shijuar pjatat e shijshme të përgatitura prej guzhinierësh të aftë, ekspertë në artin e guzhinës të Lindjes dhe Perëndimit" ..

Po më mbresëlënës nga gjithçka ishte fakti se ai zhytej në botën shqiptare, jo vetëm me interesin e shkencëtarit, por me ankthin e të dashuruarit që mezi pret të zbulojë pjesët më të vërteta e më autentike të objektit të dashurisë së vet. Aq më tepër që kish qëlluar në një kohë kur misionarët e tyre jezuitë tashmë e quanin të konsoliduar pozitën e tyre në gjirin e katolicizmit shkodran. Megjithatë, me mprehtësinë dhe intuitën që e karakterizonte, ai e kuptoi menjëherë se veprimtaria e tyre vërtitej e gjitha brenda qerthullit katolik shkodran, pa e kapërcyer gardhin e tij dhe pa hyrë në lëmin e gjerë të lëvizjes kulturore dhe shoqërore që kishte nisur të shpërthente në Shqipëri, pas viteve 20-të. Këtë hap cilësor jezuitët do ta bënin vetëm më vonë, në fillim të viteve 30-të me botimin e një reviste me qëllime të qarta dhe të prera filozofike, letrare, shoqërore e kulturore, që ata e quajtën L.E.K.A. Është pikërisht kjo revistë ku At Zef Valentini do të dëftojë gjithë pasionin e tij për shkencë, gjithë aftësitë e tij mendore, gjithë vetitë e tij si studiues me përgatitje të thellë e të gjejë, që kapte skajet e erudicionit të ndriçuar nga kultura e tij humaniste dhe të veshur me petkun e largpamësisë dhe origjinalitetit të spikatur të talentit të vet, sidomos në dyert e fushave të shkencave shoqërore.

Asokohe në Shqipëri numëroheshin rreth 170 revista me veprimtari të përcaktuar në fusha të ndryshme të kulturës dhe fesë. Por kriteret nga të cilat nisi punën Zef Valentini qenë goxha të larta në krahasim me ato të të tjerëve. Dalloheshin kryesisht artikujt që filluan të përfaqësonin filozofinë dhe teologjinë, letërsinë dhe historinë, ekonominë dhe të drejtat politike e morale; pra, praktikisht të gjithë argumentet e nevojshëm për ringjalljen dhe zhvillimin e ambjentit shqiptar. Ky nivel mjaft i lartë filozofiko-shoqëror i shkrimeve, pati në fillim kritikë të shumtë që i mëshonin faktit se ai do të silte moskuptimin e artikujve e të lëndës në përgjithësi, në një kohë kur përkundrazi, ishte pikërisht ky stil ai që filloi të ngjallte kënaqësinë dhe

entuziazmin e lexuesve, duke i shtyrë gjithnjë e më tej caqet e zhvillimit të tyre kulturor e duke i bërë ata të ndiheshin krenarë që kishin nisur të arsyetonin në nivelin me të cilin trajtoheshin nga kjo revistë argumente të ndryshëm të realitetit shqiptar. Ishte koha kur në shpirtrat e shqiptarëve kish filluar të frynte një erë e pastër kthjelluese, çliruese dhe shpresëdhënëse. Ndaj, për ta përforcuar akoma dhe më shumë këtë prirje, revista LEKA, nisi të pohojë me ngulm dhe theks moral "se traditë nuk do të thotë fosilizim brenda një guacke parimesh anakronike, por transmetim e rimishërim progresiv i forcave dhe rezervave reaguese të shpirtit shqiptar, gjithnjë besnik ndaj frymëzimit autokton, porse gjithnjë e më i ndjeshëm ndaj frymës së kohrave të reja", në mënyrë që në këtë botë të veçantë shqiptare, që ka mënyrat e veta karakteristike në konceptimin e botës dhe vlerave të gjithkohshme të jetës, të gjendej një pikë e palëvizshme midis tendencave përçarëse të ekuilibrit midis Lindjes dhe Perëndimit.

E po të numërojmë disa nga kulmet e shkrimeve të mprehta, problemore, e të dendura plot me reçensa e informacione kulturore e filozofiko-shoqërore të nivelit bashkëkohor që botoheshin në radhët e kësaj gazete të shndrruar në model etike dhe iluminimi, do të kuptojmë menjëherë se ajo ka dhënë një kontribut vendimtar në mësimin se si duhen vëzhguar dhe zgjidhen problemet tona kombëtare me seriozitet dhe ndërgjegje kritike. Theksojmë këtu faktin se Valentini, në krye të kësaj reviste, nuk shfaqej aspak si shkencëtari i zyrave, si teoricieni pa kurrfarë kontakti me jetën, si mendimtar i shquar, por që nuk merr lëndë nga realiteti, por një njeri që impulsi i flaktë i dashurisë dhe humanizmit e shtynte të merrte pjesë në zgjedhjen e nyjeve komplekse të problemeve që lidheshin jo vetëm me albanologjinë, por edhe me vetë Shqipërinë dhe jetën e saj të brendshme. E gjitha kjo kishte vetëm një shpjegim të thjeshtë: brenda tij tashmë rritej e gjallohej një vrull i madh pasional, brenda tij tashmë ai ndihej përfundimisht shqiptar. Kësisoj, për të qe një dëfrim të kalonte nga kërkimi dhe zbulimi i një dokumenti të çmuar historik në një skutë të errët e të humbur të një rafti të pluhurosur biblioteke, në sqarimin dhe shtjellimin praktik të ideve e doktrinave filozofike, - si tek "Ndërgjegjja", kulturë, intelektualitet, diplomë, kolltuk, gjurmime filozofike mbi kuptime të drejta. E mira dhe e keqja, "Lindje e Perëndim", "Tue gjuermue kuptimin themelor të mistikës", "Të drejtat

e metafizikës": - apo në diskutime social-politike të kohës, si tek "Morali i pares, "Optimizëm e pesimizëm", "Paqifizëm dhe atdhetarizëm", "Ndërgjegja publike", "Ndërgjegja profesionale", "Një ligjë eugjenike" në Shqipëri" (mbi parimet morale të martesës), "Vetëvrasa, "Amicus Socrates" por folja hakun (një polemikë drejtuar Branko Merxhanit në lidhje me meritat e klerit shqiptar), etj. □ apo në kritikë e gjuhësi, si tek "Shoqatat gjuhësore të Rilindjes", "Dale,□" (mbi njësimin dhe zyrtarizimin e bashkimit të gjuhëve dialektore), "çështja e gjuhës", vlerësim, pasurim dhe pastaj bashkim i dy dialekteve", - apo më një studim më vete, të titulluar "Në parahistori të shqipes", ku hartohet një radhë prej 277 fjalësh shqipe të dëshmuara në dokumentet historikë të kohës, shumë më parë se sa të futeshin në tekstet shqiptare", - Apo në një punim të gjatë e të vazhduar në rreth 20 numra të "LEKA", mbi "studimin më objektiv të historisë së pedagogjisë", ku ai merret gjërësisht me davaritjen e kritikave dhe parashtrimin e parimeve frymëzuese të "Radio studiorum" metodës klasike të jezuitëve në edukimin e të rinjve; - apo në atë që mund të quhet perla e gjithë kësaj fushe hulumtimesh, që mban emrin "Nomen Klator" (e po të mblidhej do të formonte një libër të bukur me rreth 250-300 faqe), një fjalor bibliografik iliro-shqiptar, që përmban vërtet të dhëna deri në një pikë të gjermës A, por që fare mirë mund të quhet orvajtja e parë drejt krijimit të një enciklopedie të plotë e të vërtetë, e cila nëse do të vazhdonte të realizonte deri në fund, ashtu siç ishte planifikuar, do të jepte një vizion të mrekullueshëm nga pikëpamja sintetike, e jetës dhe shoqërisë shqiptare në rrjedhën e saj mijëvjeçare.

Në këtë parantezë, edhe pse të një lloji të veçantë e të shtrira nëpër fusha specifike të dijes, janë për t'u përmendur edhe përkthimet e tij të artikujve të ndryshëm mbi albanologjinë, si p.sh. ajo e Baldaccit kushtuar albanologut hungarez, baronit F. Nopça; ajo e kardinal Tagliavinit mbi "Kardinal Mezzofentin dhe gjuhën shqipe"; ajo e Flavio Banfit me titull: "M'a i moçmi humanist shqiptar, Gjon Gazuli", një kontribut ky mjaft origjinal e jashtëzakonisht i çmuar, i sjellë prej shkrimesh e dokumentesh të panjohura më parë, nga ana e historianit hungarez Ladislav Halik-Borak, që parapëlqente shpesh në artikujt e vet pseudonimin Flovio Banfi. Për t'u përmendur gjithashtu janë edhe studimet e tij mbi shenjtët (ç'ka mund të thuhet se shënon fillimin e traditës sonë hagjiografike-shkencës që merret me studimin e

emerave të shenjtëve), ku jepet një listë e hollësishme e një serie emrash të shenjtëve të periudhës kristiane dhe paleokristiane, pak a shumë të njohur e të përdorur në Shqipëri; studimin e titulluar "Një tjetër piktor shqiptar" ku thellohen akoma më shumë studimet e nisura nga Franz Babingeri mbi piktorin e njohur të shekullit të 16-të, me origjinë shqiptare Marco Bazaiti; studimin mbi albanologun e njohur gjerman të balkanologjisë Alois Schmaus, etj. Të gjitha këto, pavarësisht se janë tema që i përkasin një publiku të specializuar, janë shembuj të padiskutueshëm të erudicionet të jashtëzakonshëm që shquante Valentinin.

Megjithatë, raporti më i veçantë që autori arriti të krijojë përtej fushës së historisë ishte ai që i përket letërsisë shqiptare. Që në fillimet e qëndrimit të tij në Shkodër, e pastaj edhe në Tiranë, ato pak orë të ditës që i mbeteshin të lira, si për t'u shpłodhur, ai ia kushtonte ose ndonjë përkthimi ose ndonjë krijimi të tij origjinal si p.sh. poezia "Flamuri u ngjall", apo oda e mrekullueshme kushtuar Shtjefën Gjeçovit, këtij martiri të idesë kombëtare, e cila fitoi jo vetëm miratimin e të madhit Fishtë, që e botoi atë në revistën "Hylli i dritës", por edhe admirimin e tij, përderisa e ndërftoi këtë odë 21 strofëshe në veprën e vet antologjike "Bota shqiptare", botuar më 1943. Në këtë krijim Valentini shpreh qartë gjithë cilësitë e veta poetike me të cilat e kishte pajisur natyra, por njëherësh edhe dashurinë e tij të zjarrte për Shqipërinë dhe njerëzit e saj të shquar. Gjithësesi, fusha ku autori ka dhënë prova me të vërtetë të shkëlqyera zotësie poetike janë përkthimet (në prozë të ritmuar) e tragjedisë "Poliekti" të Korneit (së bashku me At Fulvio Cardionano) dhe "Sauli" të Alfierit, për të cilën Kalio, do të shprehej se "e gjykonte mjeshtëror përkthimin e Valentinit", duke ua paraqitur lexuesve shqiptarë me këto fjalë: "Sauli një ndër kryeveprat e Alfierit, jo vetëm i ka rrujtë vetitë e rralla artistike, por disi asht përtritun e rinue në kët përkthim të Valentinit".

Madje aq e famshme është kjo vepër, sa përdoret ende dhe sot si klasike e shqipes, në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe, në fakultetin e letrave të Universitetit të Palermos. E ashtu siç tregon Karl Gurakuqi, "Studentët e shumtë përgjatë brezave kanë përfituar mjaft nga ky përkthim, duke bërë krahasime në mes të dy gjuhëve, sidomos në pikëpamje të strukturës gjuhësore dhe pasurisë së mënyrave të

shprehjes, të posaçme për secilën prej tyre. Kjo e fundit është një fushë ku At Valentini tregoi jo vetëm pasionin dhe talentin, por edhe aftësi të spikatura prej shkencëtari të mirëfilltë. Duke marrë parasysh shembujt e poetëve të mëdhenj të asaj kohe si Fishta, Mjeda, Zef Skiroi, Prenushi, Asdreni e Koliqi, ai u orvat t'u japë këshilla e t'i mësojë të rinjtë si të fillojnë të bëjnë hapat e parë në lëmin e poezisë, si t'i njohin e t'i përdorin rregullat e metrikës, si të bëjnë numërimin dhe theksimin e rrokjeve, si të krijojnë vargjet e rrafshita, të këputura e rrëshqitëse, vargjet klasike e moderne, strofat dhe rimat". Madje, në lidhje me rimat, sipas rrëfimeve të bashkëpunëtorëve të tij, tregohet se Valentini pat punuar gjatë për të ndërtuar rimarin e gjuhës shqipe, një vepër kjo voluminoze, që përfshinte një sasi prej 30 mijë skedash të seleksionuara, por, që s'arriti dot të shihte dritën e botimit.

Fati i kësaj vepre nuk dihet as në dorëshkrim, por ajo patjetër që do të kishte zënë një vend me mjaft rëndësi në fondin e letërsisë sonë. Megjithatë, punimet e tij mbi metrikën e vargjeve të botuara në shumë pjesë në revistën "LEKA", nën okelion "këshilla të rinjve në punim të vjershave", duke i plotësuar, përmirësuar e strukturuar, Zef Valentini ia dorëzoi në formën e një traktati, Ministrisë së atëhershme të Arsimit, për ta përdorur si tekst në shkollat shqiptare, duke parë që asokohe një libër i tillë mungonte. Po të përjashtojmë këtu veprën e Luigj Gurakuqit të vitit 1906, "vargnimi në gjuhën shqipe" dhe ndonjë libër tjetër pa shumë rëndësi, ky do të qe i pari libër i këtij lloji në gjuhën shqipe, por që mjerisht nuk arriti të botohej për shkak të trazirave të luftës në Shqipërinë e viteve 1943-1944. Gjithësesi, vlera më e çmuar që i ka lënë letërsisë sonë, janë kritikant e një niveli elitar që ai ka dhuruar për figurat më të mëdha letrare të Shqipërisë së asaj kohe.

Kështu, në këtë panoramë recensionesh e artikujsh, paraqitet madhështore sprovë e tij mbi Fishtën, me anë të cilës autori mëson të japë çelësin për të hapur thesarin e poezisë fishtiane, duke e gjetur atë në konceptin heroik të një jetese të mbrujtur nga kurajoja, qëndrueshmëria, vlera morale, besnikëria dhe nga tërë ajo mori gjërash që janë rezultat i tyre i drejtpërdrejtë, si mënçuria, fisnikëria, mikpritja, bujaria dhe dekori i saj pafajësor e gati naiv. Duke vënë para syve të lexuesit jo vetëm shpirtin dhe format popullore që shfaqen

qartë në veprën e poetit të "Lahutës së Malcis" (metrika, stili, vlerat etike dhe juridike tradicionale), por edhe brenditë e reja ideologjike që e rigjallojnë atë, ai thekson se "duke pranuar stilin e rapsodëve që i pëlqen aq shumë popullit të tij, Fishta pranon gjithashtu edhe përralloren si sfond a dekor letrar, por nuk kërkon të pranojë kurrësesi përkundjen si në djep të njerëzve të Atdheut të vet në një jetë ëndërrimtare; Përkundrazi, kërkon ta parapërgatisë trimërisht dhe shpirtërisht popullin e tij për një Rilindje, të kuptuar jo vetëm si një luftë apo një luftë për pavarësi, por si një ringjallje të gjithanshme të jetës shpirtërore kombëtare, si një ngritje totale të saj në një shkallë më të lartë qytetërimi, bazuar gjithmonë në parimet e shëndosha etike tradicionale"

"Nuk gjejmë tek Fishta kurrfarë rrethanash motivuese e përjetuese të luftës, në një kohë kur është konstante përherë një thirrje e fortë ndaj virtyteve shoqërore themelore për etikën tradicionale shqiptare, të mishëruar në traditën juridike të kanunit të maleve". E, kjo për faktin se vlera të tilla, padyshim mjaft të çmueshme, mund të strukturojnë një bazë të fortë e për t'u pasur zili në ndërtimin e jetës kombëtare. "Është pikërisht ky program i frymëzuar nga ide të reja të shkruara aq natyrshëm me ato të vjetrat, e që ngjizet aq mirë në personalitetin e spikatur të Fishtës, ai që mund të na ndihmojë në zbërthimin e poezisë së tij" □ nënvizon Valentini. "Ndaj, merita më e madhe i takon jo vetëm intuitës për të pranuar dhe strukturuar këtë mpleksje të tillë vlerash, por edhe aftësia për t'i dhënë këtij drejtimi të ri të jetës shqiptare një zë të fuqishëm e një program të thellë e të ekuilibruar, të hartuar në gjirin e një poetike që e lartëson jo vetëm si poet të madh, por edhe poet kombëtar, e padyshim njëri nga më të mëdhenjtë në botë, të cilit për t'u emëruar si i tillë, i mungon vetëm fakti i të qenit të përkthyer në gjuhët kryesore".

I rëndësishëm për t'u theksuar në studimet e Valentinit mbi Fishtën është edhe cilësia homerike dhe prirjet mikelangjeloliste që ai vëren në poezinë e tij. Kështu, shfaqet gjenial krhasimi bazuar në vargje, detaje historike e koncepte, i "Lahutës së Malcis" dhe kryeveprave homerike (i vazhduar në disa numra të "Leka"-s), për të arritur në "përfundimin e lavdishëm" (siç shprehet P. Marlekaj) se "Fishta mund të rrijë fare mirë në radhë me Homerin, ose më përpiktas, në analogji

proporcionaliteti me të". Aq më tepër që ai e cilëson atë "homerik, por jo homerid", me fjalë të tjera: "Dy poemat, po të ishin dy piktura, do t'i vinim në të njëjtën dhomë galerie, për të ba "pendant" njëra-tjetrën, pa guxuar të caktojmë diçka më tepër, por duke mohuar prerazi se njëra është kopje e tjetrës". E kjo për faktin e pamohueshëm se "Fishta nuk kopjon, as nuk imiton, por mban me Homerin një ngjashmëri të përpjeshshme, mjaft ngjashmëri që nuk e vendos nxënësin në një shkallë më të ulët nga mjeshtri, apo si një shtojcë e tij, por baraz me të".

Po kaq e paharrueshme është edhe përpjekja tjetër e Valëentinit për të analizuar poezinë e Koliqit. Në këtë pikë, do të qe me vlerë të paraqisnim teknikë dhe zgjidhjen e veçantë të metodës që Valentini përdorte në kompozimin e një kritike letrare. Në studimet e tij, vendin parësor nuk e zë kurrë vepra letrare në autonominë e saj, me përfundimet pasuese, vlerësuese apo paragjykuese; përkundrazi, parësor dhe konstant është qëllimi për të rrokur heteronominë në thelbin e vet, ose e shpjeguar më tej, për të ngërthyer indet e larmishme e nyjet e pazgjidhshme të lidhjeve me format e qytetërimit dhe ethshmërinë shekullore të jetës kolektive, prej së cilës ato marrin domethëniet më të vërteta e më të përjetshme. Shëmbulli më i mirë i përdorimit të kësaj metodologjie është sprovë "Jeta shkodrane përmes shkrimeve të Koliqit", e përpunuar më vonë në të famshmen "Shkodra dhe poeti i saj", sprovë në të cilën hapësira (vepruese) e poetit shërben me një efikasitet befasues në kuptimin e ideologjisë dhe spiritualitetit intim që qarkullon në veprën letrare të Koliqit, i poetit i cili qe i pari që arriti të kuptojë e të këndojë në lirikën e tij Shkodrën, "këtë qytet sekret e shumëformësh, që sa më shumë ta njohësh e ta studiosh aq më shumë forma të reja i zbulon; ato të duken sikur të zhvillojnë shumë kinde të këtij sekreti, kur në realitet të bëjnë të gjendesh përballë një misteri të ri".

Duke bërë krahasimin midis Mjedës dhe Koliqit, Valentini vëren se "gjer në kohën e daljes së tyre, Shkodra s'kish pasur kurrë një poet të saj. Duam të themi jo një poet që t'ishte biri i saj e ta ilustronte hijshëm me famën e vet, por një poet që ta ndjente e ta kremtonte në gjithë madhështinë e saj". Sepse janë pikërisht këto karakteristika të historisë së qytetit, ajo lëndë që Koliqi rroku, blatoi por edhe përjetoi

në mënyrën e vet misterioze prej shpirti poeti. Është pikërisht kjo aventura në të cilën ai u rrek: "Të ndjekë fijet e pejzave të shpirtit shkodran, me rezultat atë "shkundje" të fortë ideologjike që ai arriti t'i japë kësaj bote në krizë të plotë transformimi, për shkak të shqyerjes nga aspiratat e reja për të provuar bashkë me kënaqësinë e kësaj shkundjeje edhe shijen e skandalit që i rri gjithmonë përbri gjithçkaje: "për konservatorët ajo nuk qe mjaftësisht konservatore, për inovatorët tejmasësisht konservatorë", një skandal ky që asokohe nga letrar shndërrohej menjëherë edhe në moral". Nisur nga kjo metodë e studimit kritik dhe nga rrjedha e arsyetimit esëtetik dhe lirik të autorit në përfundim të sprovës Valentini na jep një portret mjeshtëror të Koliqit dhe një mesazh të sintetizuar, teknik dhe shpirtëror të veprës së tij: "Gjuha e poetit kullon prej Shkodrës dhe maleve të saj" □ shpjegon ai, por nuk është as njëra as tjetra: "Ëmbëlsia dhe ngrohtësia e saj i drejtohet kujtimeve shkodrane, ndërkohë që entuziazmi dhe pathosi i jepet misionit të Shkodrës në shërbim të Atdheut", për t'u ngërthyer në një ndjesi të vetme: "Shkodra nuk mundej e nuk do të mundet kurrë të bëjë pa poezinë e tij. Përkundrazi, me të në gji, ajo do të jetojë gjithmonë e gjallë, si një pikturë prekëse dhe gjallimndjellëse, një pikturë që s'ë pat bërë e s'ka për ta bërë askush ndonjëherë".

Në vazhdim të udhës së vet në "historinë" e mendimit kritik shqiptar i prirur nga formimi i tij i spikatur dhe i rreptë me theks klasik, Valentini shpejt do të gjendej në pragun e kërkimit dhe të zbulimit të asaj çka klasike përmban brenda saj tradita letrare shqiptare. Kështu, ai ishte i pari që rrëmoi në vargun e humanistëve të mëdhenj shqiptarë duke shkruar një studim të gjatë (në disa numra) për më të madhin prej tyre, Marin Beçikemi (me nëntitullin "Një humanist shkodran"), për të kaluar më pas në sprovat madhështore mbi De Radën ("Jeronim De Rada në literaturën dhe historinë shqiptare) dhe Zef Skiroi-n (Zef Skiroi: përfaqësuesi i traditës klasike të poezisë shqiptare"). Përsa i përket veprës së De Radës, tek Valentini spikat mbi të gjitha trajtimi i mprehtë e filozofik që ai i bën karakterit parësor e mbizotërues të shpirtit të poetit: religjiozitetit, bazuar filologjikisht edhe në detajet që jep vetë autori në shkrimet e tij autobiografike. Në këtë këndvështrim, duke nxjerrë në pah mistiçizmin e De Radës, sentimentit që shfaq veten më shumë se të gjithë të tjerët në poezinë e tij, studiuesi argumenton se prej zemrës së këtij mistiçizmi grafillon pohimi konstan i një



previdence, që ruan në vetvete fatet e njeriut, të kombeve e të gjithë botës.

Një sentiment ky që e bindi De Radën të ndihej i shënjuar për të ringjallur shpirtin e bashkëkombasve të tij, që ai besonte se kish një mision të pashlyeshëm nga çfarëdolloj shtypje dhe pengimi. Një misioni të cilit Valentini do t' i përgjigjej me të gjithë pathosin shqiptar të kredos së tij. "Edhe ne si ai, besojmë në providencën e kësaj veprë" "E mund të thuhet pa ndroje se De Rada që i pari që arriti t' i bëjë të njohur Evropës ekzistencën e një Shqipërie Atdhe të heronjve e truall të njerëzve me ndjenja fisnike, të denjë për të rrojtur një jetë të tyren krahas të gjithë atyre kombeve që Zoti u ka dhënë një fytyrë, e rrjedhimisht një mision". Por nga ana tjetër, s' mund të lëmë pa përmendur e pa i quajtur filatë, të gjithë ata që nuk arrijnë dot të njehësohen me konceptin fetar fisnik të Atdheut, pikërisht pse për ta është më interesante lënda se sa shpirti i veprës". E diku më tej, shpall hapur thirrje-sfidën e tij për të gjithë shqiptarët, duke thënë: "Ndaj, ne vazhdojmë të kemi edhe sot, të njëjtën kredo me De Radën. Besojmë si dhe ai në Zot, e besojmë si dhe ai në Providencë, rrjedhimisht besojmë edhe në misionin që zoti i ka dhënë Shqipërisë e që do të bëhet realitet vetëm atehere kur të vihen në jetë idealet fisnike të De Radës".

Pra, po të kalojmë përtej meritave letraro-shkencore të studimi dhe ta zhveshim atë nga petku i klerikut, fjalë të tilla janë emblemë e faktit se brenda zemrës së At Zef Valentinit, nuk flakëron vetëm zjarri i një albanofili (gjë, që dhe më vete do të qe kolosale), por gjallon regëtima më përshkënditëse e zemrës së një shqiptari të zhurritur për Atdheun e vet. Për këtë lloj zjarrmie proverbiale dashurie, brezat le t' i mbeten përjetësisht mirënjohës kujtimit të tij. Gjithësesi, ai nuk mbeti me kaq. E vazhdoi hulumtimin edhe me veprën e italo-arbëreshit tjetër të madh, Zef Skiroit, duke nxjerrë në dukje frymëzimin e poetit bazuar nga njëra anë në njohjen e thellë të këngëve tradicionale shqiptare dhe nga ana tjetër në traditën klasike të Karduçit, Dantes dhe Naim Frashërit, për të arritur në një formë aq të përpiktë e të lëmuar rime e ritmi e me një mjeshtëri të atillë në përdorimin dhe ndriçimin e vlerës së fjalës, që asnjë poet shqiptar para dhe pas tij s' arriti ta tejkalojë. Madje për kryeveprën e (pambaruar) të Skiroit, "Kthimi", Valentini do të shprehej akoma dhe më bujshëm, duke i mëshuar idesë së njohjes

së saj në rolin e një poeme të shenjtë të një doktrine të lartë □ si kryevepra e poezisë filozofike dhe religjioze shqiptare, e cila për nga shtrirja dhe thellësia e doktrinës që përfaqëson, për nga kthjelltësia, fuqia shprehëse, shkrepëtima dhe lartësia marramendëse e gjuhës së përdorur, është për shqiptarët ajo ç'ka është për italianët "komedia hyjnore" e Dantes. "Madje, përveç kësaj, "Kthimit" duhet t'i njihet - akoma dhe më shumë se çdo gjë tjetër - parësia në rang botëror si poemë e ekumenizmit, ku çdo e vërtetë filozofike dhe religjioze arrin të shprehet ashtu siç mund të konceptohet më mirë, brenda ambjentit të vet, të marrë, të çliruar nga lënda bazë, e pastaj të ripunuar si një diamant, të ngallmuar për të shkëlqyer fisnikërisht në kurrorën e mrekullueshme të katolicizmit më ortodoks; e bashkë me të edhe vetë Shqipëria e vogël, aq e ngucur në kufij, po aq vërshonjëse në vitalitet njerëzor, gjithnjë e më shumë efikase sa më shumë e injoruar, aq xheloze në ruajtjen e individualitetit të saj etnik, po njëherësh edhe aq universaliste, kaq fatkeqe, por dhe gjithmonë e ruajtur nga Zoti në vijim të misionit të saj sekret; Ja, falë tij, Shqipëria e vogël dhe e madhe, zë një vend të merituar, në mos nderi, në historinë e ekumenizmit botëror".

Megjithatë, pavarësisht nga ky kontribut i çmuar në lëtersinë shqiptare dhe në fondin e mendimit kritik të figurave të saj të shquara, pasioni i tij më i gjallë për gjatë gjithë jetës dhe fusha shkencore e studimeve ku ai shpalosi gjithë erudicionin e vet të stërmadh ishte historia e Shqipërisë, shoqëruar me predispozitën më se konkrete për një rradhitje, seleksionim e dokumentim kapilar të të gjitha burimeve të saj të mundshme. Në këtë pikë, si për ta ilustruar këtë predispozitë të tij të brendshme, ia vlen të theksohet një karakteristikë a dhunti e veçantë e Valentinit: rregulli i përpiktë mendor në të cilin çdo ide për aq sa është e mundur nga pikëpamja njerëzore, shohitet, kontrollohet e zinxhirësohet racionalisht në të gjitha të tjerat. "Shqiptarët janë një popull i çuditshëm. Të huajve u duket se kanë një tërësi ligjesh e parimesh që kundërshtojnë njëra-tjetrën, konflikte të pashërueshme, grindje të brëndëshme ku ndryshimet fetare, rajonale dhe kulturore, nxisin impulse të papërmbajtshme shkatërruese, mirëpo pas kësaj, kur bëhen gati të shprehin një gjykim negativ mbi mundësitë e mbijetesës kombëtare, vërejmë se si shpërthen papritmas prej thellësive të

shpirtit të tij një ndjenjë e fortë vëllazërimi që të shtang e të magjeps´´.

Valentini e njihte këtë fenomen të jashtëzakonshëm, por dëshironte që të gjente prova shkencore që manifestimet e unitetit kombëtar nuk ishin shpërthime çastnore të krenarisë, por simptoma të pandryshueshme të një homogjeniteti të fshehtë të themelit të vet autokton. Ja, kjo ishte arsyeja madhore që ai iu përvesh punës studimore nëpër rafte e arkiva bibliotekash, duke grumbulluar një sasi të bollshme dokumentash të pa botuara ose të botuara veç pjesërisht apo të mbetura në dorëshkrim. Qëllimi i tij kryesor ishte sistemimi në mënyrë të qartë i periudhave më të trazuara të historisë shqiptare, nëpërmjet sitës së një kontrolli të saktë të dokumentacionit. Për këtë arsye, ai ndër morri fushata të shpeshta kërkimesh arkivistide në Itali, veçanërisht gjatë verës, duke filluar që në vitin 1932 në Arkivin Civil të Padovës, më 1934-35 në atë të Ambasadës së Spanjës në Romë pranë Selisë së Shenjtë, nga 1935 deri më 1938, frekuenton dendur Arkivën Sekrete të Vatikanit dhe atë të Shtetit në Venezia. Më 1939 shkon në Napoli, ku viziton Benedeto Crocen, asokohe filozof me famë botërore, duke i kërkuar atij tregues shpjegimorë për Arkivën e Napolit dhe një letër rekomandimi për drejtorin e këtij arkivi. Madje tregohet se ai s´u zmpraps së vazhduari kërkimet e tij si inspektor i Arkivës historike të Korfuzit më 1942, edhe pse gjatë shfletimit të materialeve i duheshin mjete të posaçme mbrojtëse nga infeksioni që mund t´i përhapte mortaja e një lloji të veçantë që shkakton "lunga" të mëdha në trup e që mikrobin e saj mund ta mbajë të mbijetuar për shekuj të tërë.

Fryt i gjithë kësaj veprimtarie hulumtuese qenë studime me të vërtetë të çmuara për shkencën e historiografisë shqiptare, ku më hollësisht mund të përmendim serinë e gjatë të dokumenteve të botuara në "Leka", në okelion "Përpyjekje për liri të Shqipnisë" nga sundimi turk në fundin e shekullit të XXI dhe fillimin e shek. XVII, "Hulumtime të para ndër arkiva spanjolle për historinë e Shqipërisë"; serinë tjetër të gjatë të dokumentave me titull "Shkodra dhe Shqipëria në vitet 1732-1735; "Prej dokumentave të Farlatit", tekst, përkthimi në shqip dhe komenti historik i një dorëshkrimi anonim shkodran midis viteve 1772-1798, mbi gjëndjen e dioqezës së Shkodrës; "Dokumente mbi kohën e Mustafa Pashës (1826-1827); "Dokumente mbi Pashallarët e Shkodrës në

shekullin e XVIII", botim ekstraktesh e komentimi historik i Relatave të paraqitura Princit dhe Senatit nga Zorzi Grimani, proveditor i përgjithshëm i Dalmacisë dhe Shqipërisë (1732-1735); etj, Duke i këshilluar studiuesit të dilnin nga rebuloza e miteve patriotike dhe t'i përvisheshin argumentimeve shkencore, por edhe duke flakur tej vetes pohimet e disa etnologëve dhe linguistëve të huaj mbi Shqipërinë, At Zef Valentini filloi të bindej përditë e më shumë se ishte i pranishëm në një komb me fizionomi të veçantë. Dora-dorës zbulonte tek ai elementë origjinalë dhe me intuitën që e karakterizonte, dallonte brenda tij një strukturë të fshehtë unitare. Megjithatë, me instinktin e shkencëtarit, ai donte që të gjitha këto cilësi të arrinin të shpallehin shkencërisht. Synonte t'u vinte sa më shumë në ndihmë historianëve të Shqipërisë për të pikasur e përcaktuar si duhet konturet e qenies shqiptare, e për të saktësuar kështu qëndrueshmërinë dhe autenticitetin e vlerave origjinale të racës.

Mirëpo çelësin për të zhbiruar hapësirat e fshehta të shpirtit shqiptar, atij ia dha kodi i maleve shqiptare, "kanuni i Lekë Dukagjinit" në të cilën përmbledhen rregullat dhe të drejtat zakonore, që organizonin jetën e këtyre njerëzve. Do të qe kjo një dashuri e re për jezuitin e pasionuar nga e cila s' do të shqitej dot gjer në fund të jetës. Madje, tregohet se ai u zhyt aq shumë në njohjen e mentalitetit shqiptar të rrëfyer nga kanuni, e përqafoi atë me aq shumë entuziazëm, sa që shumë gjëra të jetës (qoftë edhe të përditshme) nisi t'i arsyetonte bazuar në parimet e këtij Kanuni. Ndaj, nuk ke si të mbetesh i mahnitur përballë ndërmarrjes që ai i kushtoi studimit të kodit tonë zakonor, për t'i dhuruar kështu kësaj fushe të kulturës sonë, një korpus të tërë veprash monumentale. E filloi me "Mendime paraprake dhe të përgjithshme mbi kanunin" të botuar më vete në vitin 1942 në "Studime dhe tekste", së cilës i shtoi "Tributë e Shqipërisë së Veriut": Shënime mbi organizimin e tyre shoqëror dhe politik" (botuar në vitin 1943). Pastaj vazhdoi me "Kanunin e Lek Dukagjinit sipas versionit të Mark Sadikut", të parit të djelmnisë së Shalës" (po në "Studime dhe tekste"), për ta përfunduar me ajkën e hulumtimeve të tij në lëmin e studimeve mbi kodin tonë zakonor, ku spikasin: "Familja në të drejtën tradicionale shqiptare" (Vatikan, 1945); "E drejta e komunitetit në traditën juridike shqiptare" (Firence, 1956), ku trajtohen gjërësisht parimet themelore të së drejtës publike shqiptare dhe në shtojca të

veçanta jepet një informacion i bollshëm mbi fiset antike ilire dhe tributë shqiptare të mesjetës dhe kohëve moderne", "Ligji i maleve shqiptare" (Firence, 1969), ku përmbledhet një bashkësi prej 252 dokumentesh mbi të drejtën tonë zakonore, të mbledhura e të strukturuar nga Zef Valentini, bazuar në kërkimet e bëra nga misionet e ndryshme jezuite gjatë viteve 1880-1932; e së fundi "Akte juridike shqiptare", botuar në dy vëllime, në Munich në vitet 1968-1969, dhe kushtuar kujtimit të historianit me famë ndërkombëtare Franc Babinger. Është një vepër që përfshin një korpus interesant dokumentesh nga historia e së drejtës shqiptare në një periudhë të gjatë kohore. Janë rreth 320 tekste juridike, latine, greke, sllave, italiane, franceze e shqiptare, të mbledhura nëpër arkiva e koleksione të ndryshme, të përkthyer në latinisht, që shkojnë që nga shekulli V e.s. deri në vitin 1406.

Janë këto 3 veprat e fundit, maja më gjeniale e studimeve të tij në këtë fushë, që së bashku me përshkrimet e Gjeçovit e të misionarit italian Ernesto Cazzi mbi kanunin, formojnë bazën themelore për njohjen e thellë dhe shkencore të këtij aspekti magjeps të traditës shqiptare. Po ajo që ia vlen të nënvizohet është se në të gjitha këto punime, filli përshkrues i mendimit të tij ishte kundrimi jo i vlerës letrare të kanunit si diçka kalimtare, por i shpirtit të tij të pavdekshëm, për të vënë në lëvizje racën e vjetër, me qëllim që ajo t'i shërbejë krijimit të një shteti të ri e të pavarur drejt arritjeve të larta të qytetërimit, në përputhje me nevojat e kohrave të reja. E pikërisht për të arritur këtë mision gjatë 8 vjetëve që drejtoi revistën "Leka", Valentini ndërroi një program tendencë që synonte analizimin e së tashmes dhe ndërtimin e së shkuarës, që përgjatë një orvajtje të guximshme të vendoste bazat e një ardhmërie të karakterizuar nga cilësitë e veçanta të shpirtit etnik, që janë dashuria për lirinë, lidhja e fortë me traditat e shëndosha, ndjenja e lartë e nderit, tek e cila shkrihen njëherësh ndjenjat e dinjitetit të drejtësisë, aq shumë të përhapura mes shqiptarëve në bazë të ligjeve të sakta gdhendur në kanun.

Në këtë kuptim analet historike të revistës "Leka", mbeten një monument i shkëlqyer i veprës së ringjalljes kombëtare, që u nxit dhe u udhëhoq me një urtësi gjeniale dhe ngutje vëllazërore në shërbim të Atdheut të vet të "adaptuar", Shqipërisë, nga ana e Zef Valentinit dhe

e bashkëpunëtorëve të guximshëm që e rrethonin. Edhe pse në vitin 1940, e ndërpreu botimin e kësaj reviste, për shkak se siç pohoi ai vetë më pas, "nuk ndihej i lirë të thoshte atë ç'ka dëshironte", ndërmarrjen e vet të palodhur hulumtuese ai se rreshti kurrë. Në vitet 1937-40 punon për hartimin e një vëllimi të çmuar me titull "Sprovë mbi një rregjistër historik të Shqipërisë" të botuar në bashkëpunim me At Fulvio Cordignano, e të vlerësuar me çmim nga Akademia Italiane. Është ky një vëllim me rreth 150 faqe, në të cilin listohen rreth 1500 dokumente që i përkasin shekujve të XII-XV, duke arritur saktësisht deri në vitin 1568, me një rëndësi të jashtëzakonshme për të saktësuar panoramën historike të ngjarjeve të ndryshme në të cilat është trazuar jeta shqiptare gjatë këtyre shekujve.

Pas kësaj përpjekje triumfale, në detyrën e re si këshilltar i Qendrës së Studimeve Shqiptare, ai nis përpilimin e dy serive të reja nën emrin "Studime dhe tekste", që përmbajnë një vëllim me studime dhe tekste juridike dhe një tjetër me studime dhe tekste arkeologjike. Gjatë kësaj kohe, i ngarkuar nga Qendra e Studimeve të Akademisë Italiane, ai vazhdon të hulumtojë e të skedojë disa qindra vepra, shumica prej të cilave pranë Institutit Oriental të Romës, për të arritur kështu në hartimin dhe redaktimin e 5 vëllimeve të mëdhenj të një kronologjie krahasuese të quajtur "kontribute të kronologjisë shqiptare". Është ky një tjetër "moment", që me plot gojën mund të emërtohet i rrallë për nga vlera që ka në mbushjen e periudhave të errëta e të pak-dokumentuara të historisë sonë. Madje në parathënien e vëllimit të parë, autori shpjegon se "ka për qëllim të mbledhë me 16 vëllime me nga 350 faqe secili, ngjarjet më kryesore historike, etnografike, religjioze e politike të Shqipërisë, duke filluar nga epoka e Ilirisë antike deri në vitin 1945. Kështu, vëllimi i parë, sipas idesë së Valentinit përmban kronologjinë e periudhës romano-bizantine nga vdekja e Konstantinit deri në vdekjen e Teodosit dhe ndarjen përfundimtare të Perandorisë (331-395 p.k). Kurse vëllimi i dytë, i ndarë në dy pjesë, (nga i cili u botua vetëm pjesa e parë), merret me trajtimin e "Invazioneve barbarike" të periudhës 395-700. Në fakt, materiali i mbledhur dhe i redaktuar nga ana e autorit për 5 vëllimet e para shkon deri në shekullin e XIII.

Gjithësesi, edhe në vëllimet e botuara, me aq ndërgjegje shkencore dhe me aq dashuri për vendin tonë, Zef Valentini arriti të tregonte me fakte se Iliria në atë periudhë ka luajtur një rol të dorës së parë në historinë e Romës, duke i dhënë asaj: perandorë, gjeneralë e dijetarë të lartë. Gjejmë ilirë të mëdhenj jo vetëm në administratën civile e ushtarake, por edhe në lëmin kultur e fetar, ç'ka dëshmon kontributin tonë me të vërtetë të madh, në fushën e "euristikës" historike. Të rëndësishme në këtë periudhë janë edhe studimet e llojit të veçantë që Valentini kreu mbi numizmatikën të kulmuara në artikujt: "Numizmatika saveriane" (1939), ku bëhet një përshkrim i hollësishëm i koleksionit të këtij kolegji, me rreth 3500 njësi monedhash të ndryshme, ku interes special paraqesin ato ilirike dhe mesjetare; "Numizmatika në Shqipëri" (1939) ku bëhet një panoramë e përgjithshme e elementeve numizmatikë të vendit tonë dhe "Sprova mbi numizmatikën shqiptare" (1941), një seri artikujsh të fokusuar kryesisht mbi numizmatikën iliro-epiriote.

Në vijim të kësaj veprimtarie mund të përmendim një studim të veçantë mbi arkeologjinë, të botuar në "Leka", të pajisur me skica, planimetri e foto, e të titulluar "M'a e bukura kishë e moçme shkodrane", që i bashkëngjitet një studimi më të gjerë të quajtur "Shëtitje historike në Shqipërinë e Veriut", një punim ky i rrallë, i botuar me vijime gjatë viteve 1941-1942, në revistën "Drini", i pajisur me mjaft ilustrime të qyteteve, kishave, kështjellave dhe kostumeve shqiptare, përbri shumë disenjove të monedhave tona antike; Një punim ky që po të mblidhet e strukturohet do të përbënte një libër të mrekullueshëm, tërheqës e të rrëfyer këndshëm, në rolin e një guide udhëheqëse për këdo që donte të vizitonte Shqipërinë e të njihej me aspekte arkeologjike, historike, etnografike, folkloristike e toponomastike të shoqërisë së saj. Për fat të keq, lastrat madje të shtypura të librit u varrosën nën gërmadhat që lanë bombardimet e vitit 1943, po gjithësesi, një kopje e bocës së tij gjendet sot në Institutin Albanologjik të Palermos.

Në po këto vite zënë fill edhe shkrimet e para mbi atë që do të përbëjë më vonë kryeveprën e tij në fushën e historisë, hulumtimet mbi dokumentet arkivorë të epokës së Skënderbeut. Që në pjesën e parë të punimit "Shënime mbi historinë kulturore të Shqipërisë", (Palermo,

1956), Valentini do të theksonte se "Fryma mbizotëruese perëndimore në kulturën e Shqipërisë nuk duhet t'i detyrohet vetëm faktit që ajo gjeografikisht hapet e tëra para Adriatikut dhe është pothuajse krejt e mbyllur nga malet për karshi Lindjes, por gjithashtu edhe falë ndikimit të madh ndaj saj të perandorisë romake, si gjatë periudhës së parë ashtu dhe gjatë periudhës bizantine e në vazhdim, në shpërhapjen prej Romës së rrezatimit të kulturës latine dhe Perëndimore". Një ide të tillë ai e kish shtjelluar më parë edhe në studimin "Qytetërimi katolik: elementët romako-katolikë në kulturën shqiptare" (1940), studim ky me të vërtetë erudit, i udhëhequr nga një kthjelltësi dhe objektivitet i pazakontë, që përmbledh gjithë historinë e letërsisë shqiptare që nga fillimet e saj, për të vënë theksin në fokusimin që ajo ka pasur në sferën e kulturës romako-katolike. Por mbi të gjitha bota jonë kulturore (pse jo dhe ajo shtetërore) lipset t'i kushtojë nderimin dhe respektin e vet më unikal këtij hulumtuesi të jashtëzakonshëm me ndërgjegje dashurore dhe shkencore për Shqipërinë, që ajo sot ka në dorë një material të bollshëm për të shtuar faqet më kryesore të Historisë së Shqipërisë, sidomos ato të periudhës së Skënderbeut.

Për fat të keq, shteti ynë në vitet e trazuara të luftës e në vazhdim, tregoi më e pakta një shenjë të lartë mosmirënjohje ndaj një njeriu që me famën e krijuar nëpërmjet dy revistave që drejtoi dhe aktivitetit të stërmadh në fushën e Albanologjisë, kish arritur të përfaqësonte një nga majat më të larta në etikën dhe iluminimin e kulturës shqiptare të atij brezi të viteve 30-të, që u shfaq plot energji e vullnet përtëritës në skenën shoqërore dhe politike të Shqipërisë. Nga mirëdashës dhe mirëbërës i kulturës sonë kombëtare, ai u "shndërrua" menjëherë në një armik të Atdheut, madje në njërin nga më të rrezikshmit. Se si mund të klasifikohet i tillë një njeri kaq i ditur, kaq i butë, kaq i qetë e i ndrojtur, e mbi të gjitha kaq shqiptardashës, ndoshta është një enigmë që s' do të zgjidhet kurrë. I shpëtuar, ndoshta falë intuitës së Koliqit, i cili duke parë përkeqësimin e gjendjes në Shqipëri e dërgon të punojë në arkivat e Italisë, ai do të vazhdonte të kërkohet për vite të tëra e të proçesohej vazhdimisht nga ana e rregjimit komunist, njëlloj si kriminelët e tjerë të luftës, si ai që "kish guxuar të monopolizonte kulturën shqiptare apo si spiun i vjetër i SIMit e Gestapos", - siç tregon vetë Valentini në kujtimet e tij. Por në këtë pikë, do të qe me vlerë të citonim një pasazh nga një shkrim i vonshëm i Koliqit me rastin e 70-të



vjetorit të lindjes së Valentinit, ku ai thekson: "ai nuk u morr kurrë me politikën militante. Aq më tepër që një qëndrim i tillë del qartë në pah edhe nga citimet e kujtimeve të At Valentinit ku ai shprehet: "Kam luftuar gjithmonë hapur marksizmin si koncept, por kam luftuar gjithashtu edhe çdo koncept fashist që nuk më dukej i pranueshëm". Ndaj, do të ishte e rëndësishme të nënvizohej qëndrimi që ai ruajti pas largimit nga Shqipëria, duke shfaqur prerazi madhështinë e një shpirti fisnik dhe dashurinë e vet të kulluar e sublime për të, një dashuri që gjallonte veç për hir të vetvetes, që buronte nga vetë thelbi i qenies e që ngrihej mbi zhgënjimet, mohimin apo mosmirënjohjen.

Menjëherë pas luftës, më 1945 At Zef Valentinit në Itali i caktohet drejtimi i revistës kulturore "Letture", një revistë të cilën ai e orientoi, strukturoi dhe frymëzoi në mënyrë aq efikase, sa që brenda 10 vitesh të aktivitetit ajo arriti të transformojë në mënyrë radikale gjithë këndvështrimin kritik katolik italian përballë letërsisë moderne. Me këtë qëllim, Valentini sajoi e më në fund ia doli mbanë edhe të diktojë edhe rregullat e reja, të kritikës katolike në përzgjedhjen e kësaj literature. Madje tregojnë se për të përballuar sa më mirë rreziqet e profesionit të tij të ri si kritik letrar, Valentinit asokohe mesoburrë, me flokë ende të zinj e të dendur iu desh të linte një mjekërr të gjatë e të rruar me kujdes. "Letërsia është një botë misterioze, e ndërlikuar, kështu që nevojitet një mjekërr e dendur, shenjë e një diturie dhe një përvojë të gjatë jetësore, për të qarkulluar sa më i mbrojtur në rrethet e kolegëve apo shkrimtarëve që recensoj" □ rrëfente ai me shaka. Është pikërisht kjo periudhë ku nisin edhe miqësitë e mëdha. Kështu, ai bëhet mik i ngushtë i botuesit Bompiani, me të cilin shkëmbente shpesh batuta humori, por miqësi të forta zë edhe me Mondadorin dhe Vallecchin, Safanin apo Marcellianin. Për t' u përmendur këtu edhe miqësitë me autorë të njohur, ku më të veçantë për të qenë Bacchell dhe Sagonaro.

Megjithatë, ishte pikërisht metoda e tij e hartimit të një kritike, cilësia e lartë e mendimit të tij kritik, të shquar për shqetësimin gjithmonë të gjallë, kuriozitetin gjithnjë të pashterrur e të shtrirë në çfarëdo lloj caku të ri, besnikëria e pasuruar me harenë më të madhe të mundshme ndaj ndershmërisë intelektuale, ato që pas disa mijëra recensioneve i dhanë emërtimin "Papa Gjovani i kritikës". Në këtë

aspekt, mund të dallojmë si madhështore interpretimet e tij sa të thella aq edhe të guximshme mbi Hamletin Shekspirian apo në atë që mbahet si "perla e recensioneve valentiniane, të quajtur "Roma oratoriane" mbi një libër të titulluar "Jeta e lutjeve në artin e Romës". Megjithatë, dashuria e tij më e thellë shpirtërore, Shqipëria dhe historia e saj, nuk e la kurrë të qetë. Pas drejtimit të "Letture", duke filluar që nga viti akademik 1952-53, pas vdekjes së profesor Gaetano Pettvota, Ventini pas shumë përpjekjeve, lejohet të drejtojë katedrën e gjuhës dhe literaturës shqiptare në Universitetin e Palermos. Këtu, ai shpalos gjithë dijet e tij mbi botën shqiptare dhe gjithë zellin e vet të parrëfyer mbi Shqipërinë. Nxit profesor Karl Gurakuqin të hartojë një gramatikë të gjuhës shqipe, shkruan vetë për ta përdorur si tekst mësimor dispencën "Shënime mbi historinë e kulturës shqiptare", mban leksione mbi kanunin, mbi Fishtën dhe Koliqin, mbi Mjedën e Bernard Palaj, duke u bërë kështu shëmbullii një përkushtimi autentik në punë dhe i një forme altriuizmi nga më fisnikët që mund të ekzistojë.

Ndërkaq, vit pas viti, me një zell vërtet të pashoq, me një durim të mrekullueshëm e me një dashuri e kopetencë shkencëtari, aktiviteti i tij i drejtonte energjitë e veta kah asaj që do të ishte projekti më madhor i gjithë jetës, korpusit gjigand prej 30 vëllimësh, të mbledhura e të dokumentuara mes mijëra e mijëra skedash biblioteke, të titulluar "Akte albane-venese të shekullit XIV-XV", një kompleks ky sa monumental aq edhe i gjithanshëm, rigorozisht shkencor, që përmbledh një numër prej 4000 dokumentesh që, sipas vëllimeve, datojnë që nga viti 1301 deri në vitin 1447, duke përbërë kështu panoramën gjërësisht më të plotë dokumentare që ekziston deri më sot për historinë e Shqipërisë. Nga ana tjetër, kjo vepër është e një rëndësie kapitale edhe për dy arsye të tjera. Së pari, ajo shënon kulmimin e një studimi kapilar dokumentacionesh mbi historinë e periudhës së Skënderbeut dhe veçanërisht mbi lidhjet shqiptaro-venedikase që fillon me artikujt më të hershëm "Venecia dhe Shqipëria", ku shtjellohen lidhjet e shumta tregtare, kulturore dhe politike midis këtyre dy vendeve; Vazhdon me "Instalimet venedikase në Shqipëri gjatë shekullit XIV-XV" (1966)., një studim ky i hollësishëm mbi një periudhë të caktuar të këtyre marrëdhënieve, atëherë kur përfaqësuesit e Princit dhe komunitetet shqiptare vendosën ngritjen e

"instalimeve" venedikase në tokën shqiptare, veçanërisht përgjatë bregdetit, me qëllim sigurimin e trafikut të mallrave në Adriatik; për të përfunduar me "Statutin personal të Shqipërisë në epokën e Skënderbeut (1966), një vepër kjo me shënime të mbledhura nga arkivat e Republikës së Venecias, që sjell mjaft vërtetësi mbi historinë e Skënderbeut, këtij kampioni të kristianizmit dhe pararoja e Evropës përballë turqve", □ siç e përcakton vetë Valentini.

Së dyti, ky korpus monumental vëllimesh hedh mjaft dritë rrezatuese mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me perëndimin, që shkojnë përtej këtyre shekujve, thellë gjer në historinë e Romës, duke i ngritur kështu një përmendore madhështore këtij profili të kulturës shqiptare. Në këtë pikë, do të qe me vend të citonim pasazhe nga letrat e dy profesorëve të njohur të Universitetit të Mynihut, në lidhje me vlerën e saj; kështu, profesor Stadtmüller shkruan se këto vëllime janë "dëshmi mbresëlënëse të këmbënguljes së tij të shquar për erudicion", ndërsa doktor Martin Camaj shprehet se "botimi i këtyre dokumenteve po bën mjaft bujë në rrethet shkencore gjermane duke bërë që At Zef Valentini të konsiderohet sot historiani më i madh i kohës, jo vetëm në Shqipëri, por njeri nga më të mëdhenjtë në gjithë Gadishullin Ballkanik".

Ja, pse Papa Pauli VI, në atë ditë prilli të vitit 1968, u shpreh me fjalë aq lëvdonjëse e triumfale për këtë albanolog të madh, që sa herë flitet për punët e Shqipërisë nuk thotë kurrë "Shqiptarët", por "Ne shqiptarët□", për këtë njeri që luftoi gjithë jetën, pa lënë rast pa humbur për ta lartuar emrin e Shqipërisë, historinë dhe kulturën e saj, para syve të gjithë botës, siç qe psh. rasti i një konference të mbajtur në Romë (1966) ku nëpërmjet referatit "Shqipëria dhe ekumenizmi" ai arriti që me fakte e dokumente të theksojë kontributin e çmuar të shqiptarëve dhe arbëreshëve në lëvizjen kulturore dhe universale ekumenike. Ndaj, është me të vërtetë shtangëse, por edhe e hidhur në thelbin e vet, që një autor i tillë i përmasave ndërkombëtare në Albanologji të mos ketë rrezatuar me gjithë fuqinë e diellit të tij shqiptar-dashës në hapësirat e ftohta kulturore dhe akademike të Shqipërisë së pas 90-ës. Si është e mundur të lihet në harresë lëvdata e pazakontë e një Pape? Si mund të ketë ndodhur vallë anashkalimi i një historiani me një famë të tillë? Gjithësesi, "hija" ku ai është lënë duhet

të ndriçohet medoemos; ajo s' duhet të ngelet "pre" e skutave të egoizmit qoftë intelektual qoftë njerëzor. Në këtë vit të 25-vjetorit të vdekjes së tij, do të qe në nderin dhe dinjitetin tonë kombëtar që figura e tij të nderohet ashtu siç e meriton. E kjo jo vetëm pse veprat që ai la pas mund të na shërbejnë si një domethënie e sigurtë në konjunkturën e sotme gjeopolitike, por edhe pse është e një rëndësie jetike që shoqëria shqiptare ta kthejë kokën e ta shohë drejt e përballë këtë diell dashurie dhe erudicioni, të atij që mund të quhet pa pikë droje emblema e një albanologu të madh, por mbi të gjitha e një albanofili të jashtëzakonshëm.

## Zëri Studentor

1000 km larg... larg shtëpisë, larg atdheut... larg nga votra jonë, vendi ku harxhuam tërë këto vite, larg nga vendi më i ëmbël, larg Kosovës sonë.

Kosova jonë është vendi më i dashur, më i bukur, vendi që mban në vete tërë ëmbëlsinë e botes, dhe tërë bukurinë natyrale. Është lehtë të jesh i bukur kur ke para, por të kesh bukurinë natyrale (pa investime), të kesh aromë lulësh, freski natyrale... kjo është ajo që quhet vlerë, vlerë të cilën pa dyshim e ka Kosova. A ka më bukur se të jesh në Kosovë, e të dëgjosh se si buçet zëri i shqipes, se si valon flamuri kuq e zi, sigurisht jo.

1000 km larg.. shtëpi e re, vendi i ri, mënyrë e re e jetesës, Sllovenia. Asgjë nuk është e njëjtte dhe në të njëjtën kohë çdo gjë e njëjtte. Në fillim çdo gjë dukej ndryshe, mënyra e jetesës, kushtet, vendi, por me kalimin e kohës çdo gjë filloj të duket pothuajse e ngjashme, madje filluam të mendojmë se këtu kemi jetuar ka tash shumë vite. Vete fakti se banoret e Sllovenisë janë të afërt dhe se në Slloveni ka përplot shqiptarë, të cilët mundohen ta fitojnë kafshatën e bukës; na ka dhënë një frymë jo shumë të largët për Slloveninë, madje na ka bërë të ndihemi se jemi këtu për aq shumë vite.. Por përsëri kaq dallim.. E dini se si jemi ndier në, kur pas një kohe kemi dëgjuar personin e parë të flet në shqip, ishte mrekullia më e madhe, të dëgjosh dike të flet në gjuhën tendë, në gjuhën e shqipes. Ate ditë kemi kuptuar se me vlerë është shqipja jonë, se sa lartë duhet ngritur kokat kur flasim për Shqiptarët.

Të gjitha, malli për familjen, atdheun, dashuria për Kosovën tonë dhe çdo gjë që ajo mbanë në vete, janë shumë të mëdha, por dëshira për edukim dhe arsimim, që edhe në të ndihemi rini e barabartë me pjesën tjetër të perëndimit, që edhe zëri ynë të dëgjohej anë e kënd botes, na bënë ta rezistojmë këtë alle dhe kjo po na jep kurajë e forcë për më tutje.

Meqenëse në jemi vetëm student të cilët ndjekim klasën internacionale në Gea College, në Piranin e bukur të Sllovenisë, dhe tërë kohën jemi të rrethuar me student nga shtete të huaja, andaj dhe kemi ndjere mungesën e një fjale shqipe, mungesën e një krahu të fortë që të uron në ditë të mira e të ngushëllon në ditë të këqija;

derisa ne ditën kur u njoftuam me Shoqatën Migjeni, te cilët do te na përkrahin ne dite tone te madhe, kur do ta prezantojmë Kosovën tone. Te jesh student është shume e vështire, por te jesh student ne vend te huaj është ende me vështire. Ne na duhet përkrahja e juaj, te paktën ajo morale, ta dimë se dikush është pas nesh dhe se ajo çfarë ne bëjmë vlerësohet nga njerëzit tone. Ndaj t'i ndihmojmë njeri tjetrit, se këtu jemi vetëm dhe kemi nevojë për përkrahjen e njeri tjetrit, le te jemi se bashku ne dite te mira dhe te këqija, le te bëhemi një zë dhe te ecim përpara. Ndhmoni te rinjtë se e ardhmja e vendit dhe popullit tone është ne duar tona, te rinjve, ndaj ti ngrisim edhe me tutje vlerat tona me ane te arsimit, se te gjithë ne e dimë se arma me e mire për lufte është shkollimi.

Studentet e Gea College-it

Rudina Heroi, Flora Shotka, Lindor Sokoli, Robertina Gjoka, Jehona Kastrati









NARODNA IN UNIVERZITETNA KNJIŽNICA

403 668/2005



920060638, 1

COBISS 0

